

E DREJTA PËR PROCES TË RREGULLT GJYQËSOR NË KOSOVË PËRGJATË DY MISIONEVE NDËRKOMBËTARE

Rafet Haxhaj

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Juridik, me profil E Drejtë Publike, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr. Darjel Sina

Numri i fjalëve: 82,372

Tiranë, Maj 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Punimi i doktoratës “E drejta për proces të rregullt gjyqësor përgjatë dy misionëve ndërkombëtare” është punë origjinale e kandidatit. Kjo punë është e bazuar dhe realizuar kryesisht në konsultimin dhe përpunimin e literaturës së gjerë shkencore dhe në rastet gjyqësore.

Të gjitha referimet në mendimet e autorëve, rastet gjyqësore apo vendimet gjyqësore si dhe raportet e ndryshme, shënimet e tjera statistikore dhe punimet shkencore apo artikujt e ndryshëm janë përcjellë me citimet adekuate, gjë që tregon në mënyrë të përpiktë se mendimet e cilit autor janë dhe nga kush është marrë një citim i tillë apo cili burim tjetër reference është marrë në shfrytëzim për t’u cituar.

Në përgjithësi rezulton se punimi doktoral nuk përbën plagjiaturë, por në fakt është rezultat i punës kërkimore e shkencore të kandidatit.

A u t o r i

ABSTRAKTI

E drejta për proces të rregullt gjyqësor është e drejtë themelore e njeriut. Kjo e drejtë zbatohet në çdo rast kur një subjekti të së drejtës i garantohet një e drejtë, qoftë materiale, qoftë procedurale, nga normat juridike në fuqi dhe nënkupton zhvillimin e gjykimit të mosmarrëveshjes lidhur me këtë të drejtë, sipas një procedure të drejtë. Kosova gjatë rrugës së shtet-ndërtimit të saj provoi dy misione ndërkombëtare: njëren që u instalua nga vet OKB e që emërtohej si UNMIK, dhe tjetri mision që u instalua sipas vendimit të institucioneve të BE dhe që njihet me emrin EULEX. Që të dy misionet kishin kompetenca të rezervuara në gjyqësor. Kjo për shkakun e rëndësisë që ka gjyqësori si njëra ndër shtyllat e pushtetit shtetëror dhe që duhet të ruaj pavarësinë nga dy pushtetet e tjera, legjislativi dhe ekzekutivi. Tematika e cila do të përfshihet në këtë punim, përbën një periudhë mbi 15 vjeçare dhe do të trajtojë çështje me rëndësi në sferën e procesit të rregullt në punën e përditshme të gjyqësorit të zakonshëm por edhe të praktikës së Gjykatës Kushtetuese si autoriteti i fundit për garantimin e kushtetutshmërisë në Kosovë. Përmes pyetjes kryesore punimi synon përcaktimin e nivelit të respektimit të të drejtës për proces të rregullt gjyqësor. Pyetjet tjera nderlidhen me identifikimin e garacive ligjore dhe institucionale për të siguruar këtë të drejtë thelbësore për procesin e rregullt gjyqësor në Kosovë.

Përgjatë dy misioneve ndërkombëtare nuk është respektuar e drejta për proces të rregullt gjyqësor ndonëse për një proces të tillë në Kosovë ekziston minimumi i nevojshëm i garancive ligjore. Megjithatë mungojnë edhe garancitë institucionale për këtë proces. Punimi analizon praktikën dhe do të gjejë mbështetje në rastet e ndryshme gjyqësore, dosjet gjyqësore por edhe në literaturën e gjerë shkencore të konsultuar për këtë qëllim. Në punim

është aplikuar metodologjia e nevojshme shkencore e hulumtimit, e shprehur përmes metodave të përparuara bashkëkohore shkencore.

Fjalët çelës: E drejtë, respektim, mision ndërkombëtar, gjyqësor, proces i rregullt.

A B S T R A C T

The right to fair trial is a basic human right. This right applies in any case where a subject of law is guaranteed with a right, whether substantive or procedural, from applicable legal norms and shall mean development of the trial of the dispute over such right, according to a fair procedure. Kosovo during its path of state building has experienced the presence of two international missions. One that was installed by the UN to be named as UNMIK, and other mission was installed by the decision of the EU institutions which is known as EULEX. Both missions have had reserved powers in the judiciary, certainly because of the importance of the judiciary as one of the pillars of state power to maintain its independence from the two other powers, legislative and executive. A matter to be elaborated in this paper is a period of over fifteen years and will address important issues in the area of due process in the ordinary judicial work but also the practice of the Constitutional Court as the final authority to ensure constitutionality in Kosovo. The paper aims through research question to set forth level of respecting the right to a regular court process. Other questions are related to identification of legal and institutional guarantees to ensure this essential right for a regular court process in Kosovo. Through two international missions, the right for a regular court process was not respected, although for such process in Kosovo exists necessary minimum of legal guarantees. Furthermore, institutional guarantees are not available for such process. The paper will refer to case law, to be supported by various court cases, court files but also in the wider scientific literature consulted for this purpose. The paper will permeate necessary scientific research methodology introduced by advanced contemporary scientific methods.

Keywords: Right, respect, international mission, judiciary, due process

DEDIKIMI

Punimi i dedikohet familjes sime: Nushës, Lumbardhit, Legjendës, Dukagjinit dhe Donikës, të cilët i kisha në krah në çdo sfidë dhe në çdo kohë.

Punimi gjithashtu u dedikohet prindërve të mi, nga të cilët trashëgova dhe mora gjithçka, që të bëhem ky që jam.

FALENDERIME

Njohuritë teorike dhe njohuritë e tjera metodologjike të fituara pranë Shkollës Doktorale në UET, kanë qenë të nivelit të lartë dhe kanë pasur reflektimin e tyre në punën time shkencore dhe punët e përditshme profesionale në gjyqësor. Për këtë edhe shpreh falënderimin tim të thellë për mbështetjen dhe këshillat e ofruara nga ana e profesorëve të UET-it, Prof. Dr. Migena Leskoviku, Prof. Dr. Ksenofon Krisafi dhe Prof. Assoc. Hemion Braho, PhD, të cilët kanë qenë të gatshëm në çdo moment t'u përgjigjen kërkesave, nevojave dhe këshillimeve gjatë ciklit teorik të studimeve dhe marrjes teorike e praktike të njohurive akademike e shkencore.

Shpreh gjithashtu falënderimin e thellë për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, që me vendim të posaçëm më kanë dhënë lejen që të kam qasje në dosjet gjyqësore në gjykata, arkiva të gjykatave dhe komunikim të lirshëm e të papenguar më personelin tjetër gjyqësor, për sigurimin e materialit studimor.

Një falënderim shumë i veçantë i bëhet edhe udhëheqësit shkencor Prof. Assoc. Dr. Darjel Sina, i cili me një përkushtim prej pedagogu të jashtëzakonshëm, ka përcjellë çdo fazë të hartimit të këtij punimi, ka dhënë sugjerimet e nevojshme, kontribut ky i cili ka bërë që puna ime studimore dhe ky punim doktoral të marrin formën e finalizimit.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

PËRMBAJTJA E LËNDËS.....	8
LISTA E TABELAVE.....	11
LISTA E SHKURTIMEVE	12
KAPITULLI I: HYRJE.....	14
KAPITULLI II: SKELETI TEORIK DHE MODELI ANALITIK I TEMËS.....	17
KAPITULLI III: KONTEKSTI HISTORIK.....	23
KAPITULLI IV: E drejta për proces të drejtë – definimi dhe përshkrimi i procesit të rregullt gjyqësor.....	24
4.1. E drejta për proces të rregullt dhe sundimi i ligjit.....	24
4.2. E drejta për proces të rregullt dhe elementet përbërës të saj.....	26
4.2.1. E drejta për barazi para ligjit dhe para gjykatës.....	29
4.2.2. E drejta për gjykim nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj.....	31
4.2.3. E drejta për proces publik dhe të hapur.....	33
4.2.4. E drejta për t'u gjykuar pa vonesë të tepruar	35
4.2.5. E drejta për t'u mbrojtë vetë ose përmes përfaqësuesit ligjor	39
4.2.6. Presumimi i pafajësisë	41
4.2.7. E drejta për mjete juridike	43
KAPITULLI V: Procesi i rregullt në procedurat gjyqësore në Kosovë.....	45
5.1. Kuadri kushtetues dhe normativ lidhur me gjykimin e drejtë.....	45
5.2. Disa elemente të gjykimit të drejtë në institucionin e Pleqnisë në Kosovë.....	48
5.3. Procesi i rregullt gjyqësor gjatë Misionit të UNMIK.....	54
5.3.1. Ligji i zbatueshëm në Kosovë gjatë administrimit të UNMIK.....	55
5.3.2. Procesi i hartimit të ligjeve gjatë Misionit të UNMIK.....	63
5.3.3. Implementimi i Rregulloreve të UNMIK-ut.....	65
5.3.4. Problemet lidhur me zbatimin e ligjeve të aplikueshme në Kosovë para Marsit 1998 dhe pas Marsit 1999.....	72
5.3.5. Gjyqtarët ndërkombëtar në gjyqësorin e Kosovës nën administrimin e UNMIK dhe ndikimi i tyre në procesin e rregullt.....	75
5.3.6. Gjyqtarët vendor në gjyqësorin e Kosovës nën administrimin e UNMIK dhe ndikimi i punës së tyre në procesin e rregullt	77

5.3.7. Gjykatat paralele në Kosovë gjatë kohës së administrimit të UNMIK	84
5.3.8. Ndërhyrjet në proceset gjyqësore gjatë Misionit të UNMIK.....	86
5.3.8.1. Paraburgimet nga KFOR-i	93
5.3.8.2. Zgjatja e paraburgimit në bazë të Urdhërave Ekzekutiv të PSSP-së	96
5.3.8.3. Ndërhyrjet e legjislativit në pavarësinë e gjyqësorit.....	102
5.4. Procesi i rregullt gjyqësor gjatë Misionit të EULEX	103
5.4.1. Caktimi dhe përdorimi i paraburgimeve.....	105
5.4.2. Kërkesat për caktimin e paraburgimit dhe seancat e dëgjimit.....	108
5.4.3. Kryerja e dobët e detyrave nga ana e avokatëve mbrojtës në procedurën penale dhe atyre përfaqësues në procedurën civile.....	114
5.4.4. Kohëzgjatja e paraburgimit në pritje të gjykimit	120
5.4.5. Vonesat në hartimin dhe dërgimin e vendimeve gjyqësore	127
5.4.6. Dhënia e vendimit gjyqësor pa dëgjim para gjykatës	130
5.4.7. Gjykatat paralele në Kosovë gjatë Misionit të EULEX	134
5.4.8. Dështimi në mbrojtjen e dëshmitarëve.....	137
5.4.9. Menaxhimi jo i mirë i lëndëve gjyqësore	141
5.4.10. Pavarësia e gjyqësorit.....	144
5.4.11. Shqyrtimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut jashtë institucioneve gjyqësore	153
5.4.12. E drejta për kompensimin e burgimit të padrejtë.....	156
KAPITULLI VI: Procesi i rregullt gjyqësor në praktikën e Gjykatës	
Kushtetuese të Kosovës	166
6.1. Ankimi individual kushtetues dhe procesi i rregullt gjyqësor.....	166
6.2. Kushtet formale për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për proces të parregullt gjyqësor....	168
6.2.1. Subjektet kërkuese	169
6.2.2. Afati kohor	171
6.2.3. Shtërimi i mjeteve juridike.....	172
6.3. Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës	175
6.4. Efekti juridik i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese	184
6.5. Efektet e vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.....	192
6.6. Elementet e procesit të rregullt gjyqësor sipas Gjykatës Kushtetuese të Kosovës	200
6.6.1. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës.....	201
6.6.2. E drejta për tu gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme	207

6.6.2.1. Prania e të njëjtit gjyqtar në shkallë të ndryshme të gjykimit.....	208
6.6.2.2. Imuniteti i gjyqtarit në rast të ndjekies penale për dhënien e një vendimi të padrejtë	215
6.6.3. E drejta për jetë dhe e drejta për mjete juridike- Rasti KI 41/12, Parashtrues Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykata Komunale në Prishtinë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës ..	227
6.6.4. Barazia e armëve (kontradiktoriteti), Rasti Adije Iliri kundër Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Ac.nr,95/2011, datë 8 dhjetor 2011.....	238
6.6.5. E drejta për pronë dhe e drejta për siguri juridike për shkak të ekzistimit të dualitetit të vendimeve gjyqësore dhe administrative.....	244
6.6.6. Liria e lëvizjes dhe e drejta për mjete efektive – Rasti Valon Bislimi kundër Ministria e Punëve të Brendshme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë	248
KAPITULLI VII: Garancitë ligjore dhe institucionale për të siguruar të drejtën për proces të rregullt gjyqësor - nevoja për përmirësim.....	254
7.1. Reformimi i gjyqësorit.....	254
7.1.1. Propozimi për përmirësim.....	256
7.2. Nevoja për hapje gjykate në nivel të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit edhe nëpër qendra të tjera të Kosovës.....	258
7.2.1. Propozimi për përmirësim.....	260
7.3. Nevoja për hapjen e Gjykatës Administrative.....	262
7.3.1. Propozimi për përmirësim.....	263
7.4. Respektimi i pavarësisë së gjyqësorit.....	265
7.4.1. Propozimi për përmirësim.....	266
7.5. Procesi i emërimit dhe ngritja profesionale e gjykatësve.....	268
7.5.1. Propozime për përmirësim.....	270
8. KAPITULLI VIII: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	274
SHTOJCA.....	293
BIBLIOGRAFIA.....	298

LISTA E TABELAVE

- 1.** Tabela.1 – Personat e burgosur që kishin akatakuzë dhe që ishin në pritje të gjykimit dt. 26.08.2013, fq. 124.
- 2.** Tabela nr.2 – Numri i kërkesave për kompensim dëmi të trajtuara nga Komisioni për Kompensimin e Dëmit në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë Misionit të EULEX, fq. 160.
- 3.** Tabela nr. 3.- Rastet e shqyrtuara në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës në vitin 2009-2013, fq. 168.

LISTA E SHKURTIMEVE

UNMIK- Misioni civil i OKB i vendosur në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244

EULEX- Misioni i BE-së në Kosovë

KFOR- Komponenta ushtarake e misionit ndërkombëtar në Kosovë

COMKFOR- Komanda e KFOR

OKB- Organizata e Kombeve të Bashkuara

OSBE- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim European

OJQ- Organizata Jo Qeveritare

KEDNJ- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

PNDKP- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike

KQZ- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

PZAP- Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

GJEDNJ- Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KFOR- Komponenta ushtarake e NATO-s në Kosovë

PSSP- Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

KSA- Krahina Socialiste Autonome e Kosovës

RSFJ- Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë

IPVQ- Institucionet e Përkohëshme të Vetëqeverisjes

LMD- Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve

KPK- Kodi Penal i Kosovës

KPPK- Kodi i Procedurës Penale i Kosovës

KEK- Korporata Energjetike e Kosovës

PTK- Postë- Telekomuni i Kosovës

KAPITULLI I: HYRJE

E drejta për proces të rregullt gjyqësor është e drejtë themelore e njeriut. Janë të shumta arsye që na bindin se kjo e drejtë duhet të studiohet dhe t'i jepet vendi të cilin e meriton në nivelin e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë. Kosova gjatë rrugës së shtet ndërtimit të saj provoi dy misione ndërkombëtare: njërën që u instalua nga vet OKB e që emërtohej si UNMIK, dhe tjetri mision që mori bekimin e institucioneve të BE dhe që njihet me emrin EULEX. Që të dy misionet kishin kompetenca të rezervuara në gjyqësor. Kjo për shkakun e rëndësisë që ka gjyqësori si njëra ndër shtyllat e pushtetit shtetëror dhe që duhet të ruaj pavarësinë nga dy pushtetet e tjera, ekzekutivi dhe legjislativi.

Për procesin e rregullt gjyqësor në Kosovë filloi që të flitet vetëm pas vënies së Kosovës nën administrimin ndërkombëtar. Kjo për shkakun se, së pari, problemet e grumbulluara të pas luftës dhe administrata që po vendosej, nuk po tregohej e aftë që t'u përgjigjej sfidave që po kërkonte vendosja e rendit dhe ligjit në një vend të sapo dalë nga lufta. Dhe së dyti, shkeljet e shumta karshi të drejtës për proces të rregullt gjyqësor, më nuk po mund t'u shmangeshin mbikëqyrjes që po bënin tanimë mekanizmat e shumtë monitorues siç ishin OSBE, OJQ-të ndërkombëtare e vendore. Në këtë kohë filloi edhe krijimi i mekanizmave vendor mbrojtës të të drejtave të njeriut siç ishte institucioni i Avokatit të Popullit.

Që të ndriçohet respektimi i njërës prej të drejtave të njeriut, të drejtës për proces të rregullt gjyqësor, jam përcaktuar që të hulumtoj një periudhë mbi 15 vjeçare dhe të prekë çështjet më thelbësore të mos respektimit të të drejtës për proces të rregullt gjyqësor. Punimi, gjithashtu, nuk synon që të jetë vetëm një përshkrim i ngjarjeve dhe analizë e

rasteve që kanë ndodhur gjatë dy misioneve ndërkombëtare, por do të paraqesë një përpjekje për nxjerrjen e rekomandimeve se çka duhet që të bëhet në të ardhmen në Kosovë lidhur me respektimin e të drejtës për proces të rregullt gjyqësor.

Punimi doktoral "E drejta për proces të rregullt gjyqësor në Kosovë përgjatë dy misioneve ndërkombëtare" paraqet punimin e parë të këtij lloji në Kosovë dhe synon që audiencës akademike t'i sjellë një trajtim të tillë të analizuar dhe vendosur mbi bazën e fakteve shkencore. Punimi do të tërheqë vëmendjen se procesi i rregullt gjyqësor duhet ta përshkojë secilin proces, të cilët zhvillohen tani dhe do të zhvillohen në të ardhmen në Kosovë. Tema e cila është objekt studimi vjen nga praktika dhe paraqitet mjaft komplekse dhe aspak e lehtë për t'u trajtuar. Studimet nga kjo fushë janë të pakta, për të mos thënë mungojnë fare në Kosovë. Periudha në fokus përbën një periudhë mbi 15 vjeçare dhe disa procese gjyqësore që kanë filluar gjatë Misionit të UNMIK kanë përfunduar ose janë duke përfunduar gjatë Misionit të EULEX.

Përkundër të gjitha këtyre vështirësive, përparësi e imja është se jam pjesë e gjyqësorit me një përvojë rreth 15 vjeçare në gjyqësor dhe pjesëmarrës në mijëra procese gjyqësore, ndër të cilat edhe disa së bashku me gjyqtarët ndërkombëtarë nga EULEX. Përparësi tjetër e imja është se jam anëtar i tri komisioneve me rëndësi shtetërore nga fusha e drejtësisë me pjesëmarrje aktive në to, gjë që më bëjnë të denjë në përballjen dhe analizimin e shumë proceseve vendimmarrëse nga lëmi i drejtësisë. Leja që më është dhënë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, që të kam qasje institucionet gjyqësore dhe në lëndët gjyqësore, ka pasur ndikim të rëndësishëm së veçantë në suksesin e hulumtimit. Duke qenë pedagog në universitet, dhe pjesëmarrës deri më tani në tetë konferenca shkencore dhe autor i mbi dhjetë publikimeve të bëra deri më tani, punimi doktoral "E drejta për proces të

rregullt gjyqësor në Kosovë përgjatë dy misionëve ndërkombëtare” vjen natyrshëm pas tërë kësaj pune shkencore e profesionale. Kur kësaj i shtohen edhe njohuritë e fituara gjatë studimeve në Shkollën Doktorale, kontakti dhe debati me profesorët e kësaj shkolle si dhe bashkëpunimi i shkëlqyer që kam pasur me udhëheqësin shkencor, vlerësoj se përbëjnë një trinom të qëndrueshëm që të besojmë se suksesi i dëshiruar është arritur.

KAPITULLI II: SKELETI TEORIK DHE MODELI ANALITIK I TEMËS

Pyetja kërkimore

Pyetja kryesore e studimit lidhet me procesin e rregullt gjyqësor dhe konkretisht ka marrë një formulim të tillë: **Cili ishte niveli i respektimit të të drejtës për proces të rregullt gjyqësor në Kosovë, në periudhën përgjatë dy misionëve ndërkombëtare?**

Pyetjet tjera që do të shtroheshin me këtë rast janë edhe: **Cilat janë garancitë ligjore dhe institucionale për të siguruar të drejtën për proces të rregullt gjyqësor në Kosovë? Cilat janë nevojat për përmirësim dhe cilat veprime duhet të ndërmerren në të ardhmen nga ana e institucioneve të Kosovës?**

Hipoteza 1:

Përgjatë dy misionëve ndërkombëtare, në Kosovë nuk është respektuar e drejta për proces të rregullt gjyqësor.

Hipoteza 2:

Në Kosovë ekziston minimumi i garancive ligjore për një proces të rregullt gjyqësor, ndërsa nuk ekzistojnë garancitë institucionale për këtë proces.

Struktura e punimit

Punimi doktoral ”E drejta për proces të rregullt gjyqësor në Kosovë përgjatë dy misionëve ndërkombëtare”, përbëhet nga tetë kapituj. Kapitulli *i parë* përmban hyrjen e punimit, kapitulli *i dytë* skeletin teorik dhe modelin analitik të temës, kurse në kapitullin e *tretë* është përfshirë konteksti historik i temës. Në kapitullin *e katërt* kam synuar që të bëjë definimin dhe përshkrimin e procesit të rregullt gjyqësor dhe t’i bëjë një analizë vendit të saj në atë që quhet sundimi i ligjit dhe rolit të kësaj të drejte edhe në përparimin demokratik të shoqërisë në përgjithësi. Në këtë pjesë i është bërë një analizë e thellë procesit të rregullt gjyqësor në frymën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe gjithashtu janë analizuar raste nga praktika gjyqësore nga Shqipëria dhe Kosova që ishin në shqyrtim para gjykatës në Strasburg. Janë bërë gjithashtu edhe shqyrtime të shtjelluara lidhur me procesin e rregullt gjyqësor dhe elementet e tij siç janë barazia para ligjit dhe para gjykatës, e drejta të t’u gjykuar pa vonesë të tepruar, dëgjimi publik, prezumimi i pafajësisë etj.

Në kapitullin *e pestë* bëhet fjalë për të drejtën për proces të rregullt gjyqësor dhe aplikimin e saj në procedurat gjyqësore në Kosovë. Janë shtjelluar raste thelbësore që kanë karakterizuar shkeljen e të drejtës për proces të rregullt gjyqësor në kohën e administrimit të UNMIK siç janë: paraburgimet e aplikuara nga KFOR-i, Urdhrat ekzekutiv të PSSP-së në bazë të cilave bëhej mbajtja në burg e personave pa asnjë vendim gjyqësor, ndërhyrjet e legjislativit në punën e gjyqësorit etj. Në këtë pjesë është bërë analizimi i rasteve gjyqësore me rëndësi për të drejtën për proces të rregullt gjyqësor të cilat janë zhvilluar edhe nga personeli gjyqësor ndërkombëtar i Misionit të EULEX dhe raste të zhvilluara nga personeli gjyqësor vendor, të cilat raste përbëjnë shkelje flagrante të të drejtës për proces të rregullt gjyqësor.

Kapitulli *i gjashtë* i punimit paraqet aktivitetin dhe proceset para Gjykatës Kushtetuese të Kosovës lidhur me të drejtën për proces të drejtë. Janë analizuar raste nga praktika e Gjykatës Kushtetuese si dhe është analizuar në detaje raporti gjyqësori klasik me gjyqësinë kushtetuese dhe papajtueshmëria ndërmjet tyre që **gjatë periudhës në fokus** ka mbretëruar në Kosovë.

Në kapitullin *e shtatë* është bërë fjalë për garancitë ligjore dhe institucionale për të siguruar të drejtën për proces të rregullt gjyqësor, dhe është shtruar nevoja për përmirësim të punës së institucioneve të Kosovës, duke dhënë propozime konkrete se si do të duhej që të jetë në të ardhmen.

Kapitulli *i tetë* u është kushtuar konkluzioneve të cilat janë sintezë e shqyrtimit dhe analizës që përshkon katër kapitujt kryesor si dhe rekomandimeve shtesë të cilat nuk janë dhënë në propozimet për përmirësim. Në fund jepet e plotë bibliografia e shfrytëzuar për hartimin e këtij punimi.

Modeli analitik

Gjithashtu, do të theksoja se puna për përfundimin e punimit ka kaluar në tri faza kryesore, ku secilës i korrespondon një metodologji e veçantë shkencore:

- **Faza e parë** është përshkruar me natyrë grumbullimi dhe seleksionimi të informacionit, kombinuar njëkohësisht me kërkim intensiv shkencor dhe sistemim të materialeve që janë vlerësuar të rëndësishme për punimin.
- Në **fazën e dytë** vemendja është përqëndruar në hartimin e pjesës teorike të punimit, dhe është bërë evidentimi i standardeve

bashkëkohore, bazuar në dokumentet kryesore ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut e me këtë edhe të drejtës për proces të rregullt gjyqësor. Gjithashtu në këtë fazë është bërë një selektim dhe studim i vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në nivel të përgjithshëm dhe atyre karshi Shqipërisë duke i kombinuar me shqetësimet dhe gjetjet më të rëndësishme të cënimit të procesit të rregullt ligjor në nivelin kombëtar (të Kosovës).

- Në **fazën e tretë** që është edhe faza më e rëndësishme e punimit, është trajtuar e drejta për proces të rregullt gjyqësor, niveli i respektimit të saj në kohën përgjatë dy misionëve ndërkombëtare. Kjo e drejtë, është analizuar duke marrë për bazë zgjidhjet që jep Kushtetuta e Kosovës, Konventa dhe jurisprudenca e GJEDNJ. Duke marrë për bazë këto gjëra, përveç analizimit të asaj se si ishte, janë dhënë edhe argumentime të plota dhe është bërë nxjerrja e përfundimeve së bashku me rekomandimet se çfarë do të duhej të ndërmerrej në të ardhmen.

Metodologjia

Sa i përket metodologjisë së punës, në këtë është përdorur metoda e studimit të rasteve, metoda e intervistës, pyetësorët, metoda statistikore metoda e analizës etj.

Metodën e studimit të rasteve në këtë punim doktoral e ka imponuar vet objekti i hulumtimit pasi për çështje të analizës së përgjithshme janë marrë si trajtesë studimore çështjet të cilat janë zhvilluar në gjykatë. Një arsye më shumë për aplikimin e kësaj metode

është edhe fakti se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata Kushtetuese e Kosovës etj, flasin përmes rasteve- *Airey kundër Irlandës; Universiteti AAB sh.p.k. kundër Qeveria e Republikës së Kosovës*, etj. Përmes rasteve flet gjithashtu edhe gjyqësori i zakonshëm në Kosovë- *Rasti "Bllaca-I."*, *Rasti "Drenica"* etj. Natyrisht se kjo metodë nuk është përdorur si e vetme, por përdorimi i saj është bërë në kombinim me metodat tjera të hulumtimit.

Me metodën e intervistës është bërë marrja e informacionit duke përdorur pyetje dhe dialog ndërveprues (siç është rasti në punim me bërjen e intervistës me z Mustafë Gashi, apo të tre pleqve në pjesën e punimit lidhur me Pleqninë). Përmes metodës së pyetësorëve është bërë mbledhja e të dhënave ku pjesëmarrës në hulumtim kanë qenë 20 gjykatës të ish Gjykatës Komunale dhe asaj të Qarkut në Pejë, 20 gjykatës të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe 20 gjykatës të Gjykatës së Apelit të Kosovës. Gjithashtu pyetësorëve iu përgjigjen edhe 20 avokatë të Prishtinës (shih shtojcat në fund të punimit).

Metoda statistikore ka shërbyer për të paraqitur të dhënat lidhur me personat e burgosur që kishin aktakuzë dhe që ishin në pritje të gjykimit, pastaj numrin e kërkesave për kompensim dëmi të trajtuara nga Komisioni për Kompensimin e Dëmit në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë Misionit të EULEX, si dhe numrin e rasteve të paraqitura në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës në vitin 2009-2013.

E tërë kjo mënyrë e mbledhjes së të dhënave i është nënshtruar metodës së analizës, e cila ka përshkruar punimin që nga fillimi i projektit të tij. Përmes kësaj metode është bërë analizimi i të dhënave në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse, e cila analizë ka dërguar në përfundim duke i dhënë përgjigjen e argumentuar pyetjeve të hulumtimit shkencor.

Të theksojmë se hulumtimin e ka përshkuar një nivel i lartë etik duke u siguruar që më parë se hulumtimi nuk paraqet probleme etike, krejt kjo, se apriori hulumtuesi ka siguruar lejen e nevojshme të hulumtimit për studimin e dosjeve gjyqësore nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Përveç kësaj kam treguar kujdes të veçantë për të mos bërë paragjykimin e rasteve gjyqësore në zhvillim, si dhe duke iu dhënë shpjegimet e nevojshme të intervistuarve që do t'u ruhet anonimiteti dhe konfidencialiteti.

Literatura e shfrytëzuar

Që punimi të jetë sa më i suksesshëm dhe përmbajtjesor kam shfrytëzuar një literature të gjerë e cila ka qenë e botuar në Shqipëri, në Kosovë, por edhe materiale të botuara nga shtëpi të njohura ndërkombëtare, materiale zyrtare të organizmave ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut etj. Janë përdorur gjithashtu edhe burime të shumta juridike si Kushtetuta, ligje, rregullore, e akte të tjera normative. Për nevojat e punimit janë shfrytëzuar gjithashtu dosje të shumta gjyqësore, vendime gjyqësore nga GJEDNJ dhe ato nga gjyqësori në Kosovë, statistika e të dhëna të tjera, përdorimi i të cilave ka qenë më se i domosdoshëm për nevojat e hartimit të këtij punimi. Analizimi, krahasimi si dhe dhënia e vlerësimit kritik mbi to për çështje të caktuara i kanë dhënë një bazament të fuqishëm punimit, e kanë pasuruar atë si dhe mendojmë se do ta bëjnë të afërt, të kuptueshëm dhe lehtësisht të përdorshëm për audiencën e gjerë.

KAPITULLI III: KONTEKSTI HISTORIK

Kosova gjatë rrugës së shtet-ndërtimit të saj provoi dy misione ndërkombëtare. Njërën që u instalua nga vet OKB e që emërtohej si UNMIK, dhe tjetri mision që mori bekimin e institucioneve të BE dhe që njihet me emrin EULEX. Që të dy misionet kishin kompetenca të rezervuara në gjyqësor, sigurisht për vetë shkakun e rëndësisë që ka gjyqësori si njëra ndër shtyllat e pushtetit shtetëror dhe që duhet të ruaj pavarësinë nga dy pushtetet e tjera.

Pikërisht që të ndriçohet respektimi i njërës prej të drejtave të njeriut –të drejtës për proces të rregullt gjyqësor, jam përcaktuar që të hulumtoj një periudhë mbi 15 vjeçare dhe të prekë çështjet më thelbësore të mos respektimit të të drejtës për proces të rregullt gjyqësor.

Pra Punimi Doktorat ”E drejta për proces të rregullt gjyqësor përgjatë dy misioneve ndërkombëtare gjen fillimin e tij në periudhën kur është vendosur administrimi ndërkombëtar nën emrin UNMIK (nga qershori i vitit 1999), për të vazhduar më pas me vendosjen e këtij misioni dhe përfundimin e tij kur Kosova shpalli pavarësinë e saj (në shkurt të vitit 2008). Kohështrirja e këtij arrin deri në ditët e sotme me Misionin e EULEX dhe me praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në përbërjen e së cilës edhe më tutje veprojnë edhe gjykatësit ndërkombëtarë.

KAPITULLI IV: E drejta për proces të drejtë – definimi dhe përshkrimi i procesit të rregullt gjyqësor

4.1. E drejta për proces të rregullt dhe sundimi i ligjit

Rrënjët e idesë për sundimin e ligjit mund të ndiqen deri në Greqinë antike. Filozofë si Aristoteli e vinin parimin e sundimit të ligjit mbi parimin e sundimit me dhunë. Parimi i sundimit të ligjit ka rrënjët e tij qysh në Anglinë mesjetare. Që në vitin 1066 Uilliam Pushtuesi (William the Conqueror) kishte vendosur një pushtet qendror. Edhe pse mbreti e vuri në jetë pushtetin qendror ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, ai vetvetiu nuk qëndroi mbi ligjin – ishte ligji ai që e bëri mbret (Kuptimi i të Drejtave të Njeriut- Manual për arsimimin për të Drejtat e Njeriut, “ Zhvillimi historik i sundimit të ligjit”, 2014:217). Nga një koncept i këtillë në këtë vend në atë kohë formohen edhe institucionet shtetërore dhe ndërtohet monarkia e parë parlamentare në Evropë. Bazat e zhvillimit të sundimit të ligjit ishin *Magna Charta Libertatum (1215)*, e cila u ofronte feudalëve disa të drejta, kufizohet pushteti i monarkut në disa sfera si dhe zbatohet supremacioni i drejtësisë në raport me pushtetin e monarkut dhe *Habeas Corpus Act (1679)*, i cili u jepte njerëzve në arrest të drejtën e pamohueshme për t’u njoftuar për arsyet e kufizimit të lirisë së tyre. Që nga ajo kohë parimi i sundimit të ligjit do të fillojë që të zhvillohet krahas zhvillimeve të shoqërisë njerëzore dhe ngritjes së institucioneve shtetërore, ndërsa sot është parim bazë i institucioneve vendore dhe shtetërore e regjionale në gjithë botën (Saliu, 1998: 20).

Sundimi i ligjit prek fusha të ndryshme të politikave dhe në vete përfshin çështje politike, kushtetuese, ligjore, si dhe çështje të të drejtave të njeriut. Çdo shoqëri demokratike që synon nxitjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, si parim fundamental

duhet që ta njohë supremacinë e ligjit (Kuptimi i të Drejtave të Njeriut- Manual për arsimimin për të Drejtat e Njeriut, “Zhvillimi historik i sundimit të ligjit”, 2014: 215). Autori Hans Kelzen mendonte se: ”Çdo veprim i pushtetit shtetëror duhet të jetë paraprakisht i rregulluar me të drejtën” (Ismaili, 2007: 56). Rudolf Van Jhering që në vitin 1898 ishte shprehur se “Forma është armiku i betuar i arbitraritetit dhe motra binjake e lirisë” (Sauli, 2011: 78). Lidhur me sundimin e ligjit nuk ekziston ndonjë konsensus i plotë se cilat janë të gjitha elementet përbërëse të tij. Disa nga këto do të mund të përmbledheshin në atë se qytetarët mbrohen nga veprimet arbitrare të autoriteteve publike vetëm atëherë kur të drejtat e tyre janë të parapara me ligj. Ky ligj duhet t’i bëhet publikut i njohur, të aplikohet njësoj për të gjithë dhe të zbatohet në mënyrë efektive. Ushtrimi i pushtetit shtetëror duhet të bazohet në ligje të cilat janë nxjerrë në pajtim me kushtetutën dhe kanë për qëllim sigurimin e lirisë, drejtësisë dhe sigurisë juridike.

Ndër elementet themelore të sundimit të ligjit është e drejta për proces të drejtë, e cila ndryshe njihet si “udhëheqje e drejtë e drejtësisë”. E drejta për një gjykim të drejtë lidhet me administrimin e gjyqësisë për të dy llojet e kontesteve, ato civile dhe penale. Kjo e drejtë gjithashtu paraqet gurthemelin e një shoqërie demokratike drejt zbatimit të “sundimit të ligjit”. Respektimin e të drejtave të tilla e garantojnë një sërë dispozitash të dokumenteve ndërkombëtare siç janë: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Neni 11 (1948), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 6 (1950), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Neni 14 (1966), Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut (1969), Parimet Themelore të OKB-së për Gjyqësi të Pavarur (1985), Rregullat Standarde Minimale të OKB-së për Administrim të Gjyqësisë së të Miturve (1985), Karta

Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve, Neni 7 (1986), Parimet Themelore të OKB-së për Rolin e Avokatëve (1990), Udhëzimet e OKB-së për Rolin e prokurorëve, etj.

4.2. E drejta për proces të rregullt dhe elementet përbërës të saj

E drejta për proces të rregullt, natyrshëm dhe qartazi lidhet me proceset gjyqësore (Zaganjori, 2011: 88). Ndërsa, nocioni i procesit të rregullt ligjor është më i gjerë, pasi ai përfshin aspekte të procesit të rregullt ligjor që ushtrohen nga organet e tjera publike, të cilat ndjekin procedura jashtëgjyqësore (administrative, parlamentare, arbitrazhi, etj). Ndërkohë që procesi i rregullt gjyqësor mbetet një pjesë thelbësore e kësaj të drejte (Kondo, 2012: 131). Proces i rregullt ligjor është një parim i cili shtrihet përtej proceseve gjyqësore; jo më kot edhe termi është “ligjor” e jo “gjyqësor” (Zaganjori, 2011: 88). Proces i rregullt gjyqësor përbën tërësi të drejtash, lirish dhe garancish të cilat duhet të i sigurohen çdo personi i cili përballlet me vet procesin gjyqësor. Kjo e drejtë zbatohet në çdo rast kur një subjekti të së drejtës i garantohet një e drejtë, qoftë materiale, qoftë procedurale, nga normat juridike në fuqi dhe nënkupton zhvillimin e gjykimit të mosmarrëveshjes lidhur me këtë të drejtë, sipas një procedure të drejtë (Daci, 2008: 253). Administrimi i gjyqësisë ka dy aspekte, atë institucional (p.sh pavarësia dhe paanshmëria e organeve gjyqësore) dhe procedural (p.sh rregullsia e dëgjimit). Parimi i gjykimit të drejtë nënkupton respektimin e një sërë të drejtash individuale duke siguruar kështu administrimin e mirë të gjyqësisë që nga momenti i dyshimit e deri tek ekzekutimi i dënimit. Gjykatësit si në çështjet civile ashtu edhe në ato penale duhet të shqyrtojnë çdo pretendim të palëve në lidhje me këtë të drejtë duke ia nënshtruar atë hapësirës së

vlerësimit që KEDNJ i ka lënë gjykatave duke u siguruar që drejtësia e dhënë të jetë si rrjedhojë e një procesi të rregullt dhe të drejtë gjyqësor (Hila, 2010: 45). E drejta për proces të rregullt është një e drejtë themelore e të drejtave dhe lirive të njeriut. Kur shkelet kjo e drejtë, njerëz të pafajshëm deklarohen fajtor për kryerjen e krimit, burgosen, madje edhe ekzekutohen. Vetë sistemi i drejtësisë humbet kredibilitetin (Amnesty International Publications, *Manual i Gjyimit të Drejtë, 1998: 180*).

Procesi i rregullt gjyqësor është sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë : ”Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj” (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë- neni 42). Procesit të rregullt gjyqësor i është dhënë vend i merituar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës kurse neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut-KEDNJ garanton të drejtën e personave për dëgjimin dhe gjykimin e drejtë të çështjes nga gjykata. Çdo qytetar duhet të njihet me të drejtën për proces të rregullt sepse administrimi i drejtësisë ka si qëllim shërbimin sa më të mirë ndaj qytetarëve. Po kështu edhe zbatuesit e ligjit si prokurorët, policia gjyqësore, gjyqtarët avokatët etj., në punën e tyre të përditshme kanë detyrimin të njohin dhe të respektojnë veç të tjerash, të drejtat e garantuara nga e drejta për proces të rregullt.

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor por edhe në atë me karakter disiplinor dhe administrativ (Zaganjori, 2012: 428). Ndërsa, Kushtetuta e Republikës së Kosovës të drejtën për proces të rregullt

gjyqësor e ka sanksionuar në një varg dispozitash dhe i ka dhënë vendin e merituar si njëra nga të drejtat themeltare të njeriut. Sipas Kushtetutës “Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutën ose me ligj, si dhe të drejtën për mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur” (Kushtetuta e Republikës së Kosovës- neni 54). Për rëndësinë që ka procesi i rregullt, instancë e fundit për ushtrimin e ankesave për pretendimet për shkelje të procesit të rregullt është Gjykata Kushtetuese. Procesit të rregullt gjyqësor është sanksionuar edhe në kodet etike për gjyqtarë, prokurorë dhe në Kodin e Etikës për Avokatët. Shkelja eventuale e dispozitave të këtyre kodeve nga ana e gjyqtarëve apo prokurorëve sanksionohet mjaft rreptë dhe përbën edhe kusht për shkarkimin e tyre nga detyra.

E drejta për proces të rregullt gjyqësor është me rëndësi themelore për gjithë Konventën, pasi ajo ndryshe nga të drejtat e tjera ka natyrë procedurale. Pra, ajo është garanci procedurale (Kondo, 2012: 132). E drejta për proces të rregullt përfshin brenda saj një sërë të drejtash që duhet të i garantohen çdo personi dhe që i shërbejnë mbi të gjitha dhënies së drejtësisë. Për kuptimin dhe interpretimin sa më të mirë të kësaj të drejte do të na duhet të analizojmë disa nga elementet me kryesor e që janë:

1. E drejta për barazi para ligjit dhe para gjykatës;
2. E drejta për gjykim nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj;
3. E drejta për proces publik dhe të hapur;
4. E drejta për t’u gjykuar pa vonesë të tepruar;
5. E drejta për t’u mbrojt vetë ose përmes përfaqësuesit ligjor;
6. Prezumimi i pafajësisë;
7. E drejta për mjete juridike, etj.

4.2.1. E drejta për barazi para ligjit dhe para gjykatës

Të gjithë njerëzit janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa kurrfarë diskriminimi në mbrojtje të barabartë ligjore. Të gjithë kanë të drejtë në mbrojtje të barabartë kundër çfarëdo diskriminimi që paraqet shkelje të kësaj Deklarate dhe kundër çfarëdo nxitjeje në diskriminim të tillë thuhet në nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (Alfredsson, 1998: 163). Neni 2(1) i PNDKP ka paraparë se: “Çdo shtet palë në këtë Konventë merr përsipër të respektojë e garantojë për të gjithë individët brenda territorit të vet dhe që janë nën juridiksionin e tij të drejtat e njohura me këtë Konventë, pa asnjë lloj dallimi race, ngjyre, seksi, gjuhe, feje, bindjeje politike, origjine kombëtare a shoqërore, prone, statusi në lindje ose të tjerë” (Amnesty International Publications, *Manual i Gjyqimit të Drejtë*, 1998: 73). I njëjti dokument ndërkombëtar në nenin 26 ka paraparë se të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe gëzojnë, pa asnjë diskriminim mbrojtjen e barabartë prej ligjit.

Se çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore pa diskriminim ka përcaktuar edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Kushtetuta e Republikës së Kosovës-neni 24). Njerëzit janë të barabartë në të drejta dhe detyra dhe gëzojnë mbrojtje të njëjtë para organeve shtetërore dhe organeve të tjera pa dallim kombësie, etnie, race, gjinie, gjuhe, feje, bindjeje politike dhe bindjeje tjetër, arsimi, prejardhjeje sociale, gjendjeje materiale ose vetie tjetër personale. Liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarit janë të kufizuara vetëm me liritë dhe të drejtat e barabarta të të tjerëve. Kjo barazi paraqet bazë të parimit të jodiskriminimit. Parimi, se të gjithë njerëzit janë të barabartë pa dallim të veçorive personale, sot kuptohet si imperativ etik i çdo shoqërie dhe i çdo shteti demokratik

që bazohet në parimin e sundimit të ligjit. Diskriminimi është i ndaluar me ligj, i pa dëshiruar shoqërisht dhe i papranueshëm moralisht (Bajrami, 2011: 190).

Garancia e barazisë në kontekstin e procesit gjyqësor është shumëplanëshe. Ajo ndalon ligjet diskriminuese dhe përfshin të drejtën për qasje të barabartë para gjykatave dhe për trajtim të barabartë nga gjykatat (Amnesty International Publications, *Manual i Gjyimit të Drejtë*, 1998: 73). E drejta për dëgjimin e çështjes nënkupton të drejtën e çdo personi për t'iu drejtuar gjykatës. Gjykata e Strasburgut ka njohur për herë të parë këtë të drejtë në çështjen Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar më 21 shkurt, 1975 ku është shprehur se “*parimi në bazë të të cilit çdo pretendim civil ka mundësinë t'i drejtohet gjykatës, është një nga parimet themelore të së drejtës të njohura universalisht*”. Kjo e drejtë është avancuar nga ana e Gjykatës në çështjen *Airey kundër Irlandës* duke thënë se “*e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, jo vetëm duhet të ekzistojë por ajo duhet të jetë edhe e efektshme*” (Kondo, 2012: 136). Aspekti më i rëndësishëm praktik i këtij parimi është **barazia e armëve**, që përfshinë idenë se secila palë në procedurë duhet të ketë mundësi të barabarta për të prezantuar rastin dhe se asnjëra palë nuk duhet të gëzojë ndonjë përparësi substanciale ndaj kundërshtarit të vet. Në çështjen *Airey kundër Irlandës*, mos garantimi nga ana e shtetit e asnjë lloj ndihme ligjore për kërkuesen, znj. Airey, gjatë një mosmarrëveshje familjare, në kushtet e pamundësisë financiare të saj për të marrë avokat që ta përfaqësonte atë në gjykatë, u konsiderua nga Gjykata si shkelje e nenit 6 (1), për shkak se asaj i ishte mohuar e drejta efektive për t'iu drejtuar gjykatës.

4.2.2 E drejta për gjykim nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj

E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme duhet të zbatohet në të gjitha kohërat dhe është një e drejtë që përfshihet në nenin 14(1) të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i cili parasheh që “gjatë përcaktimit të çfarëdo akuze ndaj tij, apo të drejtave dhe obligimeve të tij sipas ligjit, secili duhet të ketë të drejtë për një dëgjim të drejtë dhe publik nga një **tribunal i pavarur, kompetent dhe i paanshëm** i themeluar me ligj”. Kjo e drejtë është e sanksionuar edhe në dokumentet e tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut si në nenin 10 të Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut, nenin 7(1) të Kartës Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve, nenin 8(1) të Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut, kurse është i sanksionuar edhe në nenin 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i cili i referohet “një tribunali kompetent, të pavarur dhe të paanshëm, të themeluar me ligj” (HUMAN RIGHTS IN THE ADMINISTRATION OF JUSTICE: A Manual on Human Rights for Judges, Prosecutors and Lawyers, 2002: 249).

Garancia parësore institucionale për një gjykim të paanshëm është që vendimet nuk do të merren nga institucionet politike por nga gjykata e pavarur e paanshme dhe e krijuar me ligj. E drejta e individit për gjykim në gjykatë, me garancitë për të akuzuarin në procedurat penale, qëndron në zemër të procesit të drejtë ligjor (HUMAN RIGHTS IN THE ADMINISTRATION OF JUSTICE: A Manual on Human Rights for Judges, Prosecutors and Lawyers, 2002: 75). Në Republikën e Shqipërisë dhe në Kosovë gjykimi nga një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme” është një ndër parimet kushtetuese që qëndrojnë në

themel të një procesi të rregullt ligjor. Në nenin 31 të saj Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar se *”çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”*.

Roli i gjykatave të pavarura dhe të paanshme është një nga elementet themelore të sundimit të ligjit në kuadër të një sistemi juridik. Pavarësia e gjykatës është thelbësore për një gjykim të drejtë. Ajo do të thotë që vendimmarrësit në një rast konkret gjyqësor janë të lirë të vendosin pa anshmërisht në bazë të fakteve dhe në pajtim me ligjin, pa asnjë ndërhyrje, presion ose ndikim të papërshtatshëm prej dy pushteteve të tjera. Sipas parimit të ndarjes së pushteteve, pushteti gjyqësor duhet të jetë plotësisht i ndarë nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv. Pavarësia e gjyqtarëve është një nga shtyllat e gjyqësisë së pavarur. Kur jemi te pavarësia e gjyqtarëve mendojmë se është me rëndësi të theksohen dy momente. E para, kë të bëjë me pavarësinë e tërë sistemit gjyqësor dhe gjyqtarëve nga ndikimet e jashtme. Dhe e dyta, ka të bëjë me pavarësinë e gjyqtarëve brenda vet sistemit. Kjo mund të manifestohej si ndikim në vet gjyqtarët nga ana e zyrtarëve të trupës administrative të administrimit të gjyqësisë, apo nga ana e eprorit të vet gjykatës. Ndikimi i jashtëm do të mund të shprehej edhe në formën e ndërhyrjes në përzgjedhjen e gjyqtarëve ose në shkarkimin e tyre, por edhe në kushtet e pagesës së gjyqtarëve, mundësia e degëve të tjera për t’u dhënë instruksione gjykatave, mos përzgjedhja në pozitat për të cilat është paraparë ekskluzivisht që të udhëhiqen nga gjykatësit etj. Në Kosovë me ligj është e paraparë që kryesuesit e disa funksioneve me rëndësi shoqërore të jene gjyqtarë me profesion, p.sh Kryesuesi i KQZ, Kryesuesi i Panelit Zgjedhor për Ankesa e Parashtresa-PZAP, Kryesuesi i Komisionit për Provimin e jurisprudencës etj.

Pavarësia e gjyqësorit nënkupton ekskluzivitetin e tij në të gjitha çështjet gjyqësore. Kjo do të thotë që vendimet e gjykatës nuk mund të ndryshohen nga autoritetet jo gjyqësore në dëm të njëres nga palët, përveç në çështjet që kanë të bëjnë me amnistinë ose faljen.

Mbrojtja e pavarësisë së gjyqësorit nënkupton që njerëzit të përzgjidhen si gjyqtarë në bazë të përgatitjes dhe përvojës së tyre juridike. Me qëllim që të sigurohet pavarësia e gjyqësorit gjyqtarët duhet të kenë imunitet nga ndjekja penale dhe paditë civile për mendimin e dhënë në çështjet gjyqësore dhe ligjore. Ata duhet të kenë sigurinë e vendit të punës, të kenë post të garantuar derisa të arrijnë moshën e pensionimit të detyrueshëm apo derisa të skadojë afati në detyrë. Ata mund të shkarkohen vetëm nëse janë të paftë të zbatojnë detyrat e veta ose për sjellje të papërshtatshme në raport me detyrën e tyre.

4.2.3. E drejta për proces publik dhe të hapur

Me qëllim që të nxitet besimi ndaj administrimit të gjyqësisë dhe të sigurohet dëgjimi i drejtë i palëve, seancat gjyqësore duhet që të jenë të hapura për publikun e gjerë. Sipas aksiomës së njohur se drejtësia jo vetëm që duhet të bëhet por edhe duhet të shihet se si bëhet, publiku ka të drejtë të dijë se si bëhet drejtësia dhe çfarë vendimesh merren (Kuptimi i të Drejtave të Njeriut- Manual për arsimimin për të Drejtat e Njeriut, “Zhvillimi historik i sundimit të ligjit”, 2014: 168). Dëgjimi publik, nënkupton dëgjimet e prezantimeve gojore për çështjet thelbësore të rastit, të cilat duhet të jenë publike dhe të cilat mund të i përcjellin publiku dhe mediet. Gjykatat duhet ta bëjnë publike kohën dhe vendin e dëgjimeve të prezantimeve gojore. Në procedurat gjyqësore parimi i publicitetit duhet të respektohet në tërësi përveç nëse ekziston ndonjë arsye që lejon përjashtimin e

publikut. Neni 6 i garanton çdokujt të drejtën për një seancë të hapur në përcaktimin e të drejtave të tij civile dhe detyrimet, ose të ndonjë akuze penale të ngritur kundër tij (Mole, 2005: 19). Ndërsa arsyet për **kufizime** janë theksuar në nenin 6 ku është përcaktuar se shtypi dhe publiku mund të përjashtohen nga i gjithë procesi gjyqësor ose një pjesë e tij në interes të moralit, rendit publik ose sigurimit kombëtar në një shoqëri demokratike, kur kërkohen që të mbrohen interesat e të miturve ose të jetës private të palëve, ose në një masë që është rreptësisht e domosdoshme në opinionin e gjykatës në rrethana specifike ku publiciteti do të paragjykonte interesat e drejtësisë. Autorët Mole dhe Harby argumentojnë se një seancë e hapur përbën një **tipar thelbësor** të së drejtës për një proces të drejtë gjyqësor.

Argumentimi i tyre shprehet në këtë fragment pasues:

Në çështjen Axen kundër RF të Gjermanisë gjykata u shpreh se: “karakteri i hapur i procedimeve përpara organeve gjyqësore që i referohet nenit 6.1 mbron palët ndërgjyqës kundrejt ushtrimit të drejtësisë në fshehtësi dhe pa mbikëqyrje publike, është gjithashtu edhe një nga mjetet me anë të cilave mund të ruhet konfidenca në gjykata si të shkallës së ulët edhe të shkallëve të larta. Duke e bërë të dukshëm ushtrimin e drejtësisë, publiciteti kontribuon në përmbushjen e synimit të nenit 6.1, shprehimisht një proces të drejtë gjyqësor, garantimi i të cilit përbën një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike brenda kuptimit të Konventës (Mole, 2005: 24).

4.2.4. E drejta për t'u gjykuar pa vonesë të tepruar

Periudha kohore që parashihet me dispozita ligjore lidhur me vonesën e tepruar, përfshin jo vetëm kohën deri te fillimi i gjykimit, por totalin e gjatësisë së procesit në tërësi, përfshirë këtu edhe ankesat e mundshme më të larta gjyqësore, deri te Gjykata Supreme ose ndonjë autoritet tjetër përfundimtar gjyqësor. Neni 6 i garanton çdokujt seancë brenda një afati të arsyeshëm dhe Gjykata ka deklaruar se qëllimi i këtij garantimi është që të mbrojë të gjitha palët në procesin gjyqësor kundër vonesave të gjata procedurale. Ky garantim më tej thekson rëndësinë e dhënies së gjykimit pa vonesë sepse mosdhënia e tij mund të vërë në rrezik efikasitetin dhe besueshmërinë e gjykatës (Mole, 2005: 24). Është një ndër standardet që procesi i rregullt sanksionon në bazë të cilit qëndron fakti që dhënia e drejtësisë duhet të jepet brenda një kohe sa më të shkurtër të mundshme. Se çka nënkuptohet me gjatësinë e kohës së arsyeshme ndryshon varësisht nga natyra e rastit në procedurë (Kuptimi i të Drejtave të Njeriut- Manual për arsimimin për të Drejtat e Njeriut, “Zhvillimi historik i sundimit të ligjit”, 2014: 169). Koha që duhet marrë në konsideratë sipas Gjykatës fillon me nisjen e procedimeve në çështjet civile dhe në ato penale me akuzën. Kjo kohë e shqyrtimit përfundon kur procedimet janë përfunduar në shkallën më të lartë të mundshme të gjykatës d.m.th. kur vendimi bëhet final. Vlerësimi i asaj se çka mund të konsiderohet vonesë e tepruar varet nga rrethanat e rastit dhe duhen marrë parasysh faktorët: kompleksiteti i çështjes, sjellja e kërkuesit, sjellja e autoriteteve gjyqësore dhe administrative të shtetit dhe çfarë rrezikon kërkuesi.

Kompleksiteti i çështjes. Të gjitha aspektet e çështjes merren në konsideratë në vlerësimin e faktit nëse ajo është komplekse. Kompleksiteti mund të ketë të bëjë si me

çështjet e faktit e po ashtu edhe me çështjet e ligjit (Kondo, 20012: 140). Gjykata në këtë aspekt i ka dhënë rëndësi, bie fjala natyrës së fakteve që duhet të provohen, numrit të të akuzuarve dhe dëshmitarëve, elementet ndërkombëtarë, lidhja e çështjes me çështje të tjera si dhe ndërhyrja e personave të tjerë në procedurë. Kjo, pasi niveli i kompleksitetit mund të justifikojë edhe një proces të gjatë. Për shembull, në rastin *Boddaert kundër Belgjikës*, gjashtë vjet e tre muaj nuk u konsideruan të paarsyeshëm nga Gjykata, pasi kishte të bënte me një hetim të vështirë mbi një vrasje dhe zhvillimin e njëkohshëm të dy çështjeve. Megjithatë, edhe në rastet shumë komplekse mund të ndodhin vonesa të panevojshme. Në rastin *Fernatelli dhe Santangelo kundër Italisë*, Gjykata konstatoi se 16 vjet ishte një afat i pa arsyeshëm edhe për një çështje komplekse e të vështirë që kishte të bënte me një vrasje ku përfshiheshin probleme të ndjeshme në trajtimin e të miturve (Mole, 2005: 24).

Sjellja e kërkuesit. Nëse kërkuesi është ai që ka shkaktuar vonesën, kjo qartazi dobëson pretendimin e tij. Megjithatë, Gjykata në rastin *Eckle kundër RF të Gjermanisë, 1982*, është shprehur se kërkuesit nuk i kërkohet që të jetë bashkëpunues për përsheptimin e procedurës, e cila mund të sjellë si pasojë edhe dënimin e tij.

Në çështjen Union Alimentaria Sanders S.A kundër Spanjës, Gjykata u shpreh se: "detyra e kërkuesit është që të tregojë kujdes në kryerjen e hapave procedurale të lidhur me të, për të shmangur përdorimin e taktikave vonuese dhe duhet të bëhet i dobishëm për shkurtimin e procesit" (Mole, 2005: 24). Gjithashtu, në çështjen Balliu kundër Shqipërisë, Qershor 2005, Gjykata arriti në përfundimin se, ndër të tjera, nuk kishte pasur shkelje të së drejtës së kërkuesit për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm nga ana e shtetit shqiptar, pasi gjatë procesit në apel kishte qenë

mosparaqitja e përsëritur dhe e pajustificuar e përfaqësuesit të kërkuarit, që kishte përbërë shkakun për zvarritjen e procesit (Kondo, 2012: 140).

Sjellja e autoriteteve. Përça i përket sjelljes së autoriteteve Gjykata merr në konsideratë vetëm vonesat që i atribuohen shtetit, kur përcakton nëse është respektuar garancia e afatit të arsyeshëm. Shteti është përgjegjës për të gjitha vonesat e shkaktuara nga të gjitha autoritetet e veta administrative ose gjyqësore (Mole, 2005: 24). Gjatë trajtimit të çështjeve për kohëzgjatjen e procesit, Gjykata ka konstatuar se gjykatat e brendshme kanë detyrim të veçantë, për të siguruar që të gjithë ata që luajnë rol në proces do të bëjnë maksimumin e tyre që të shmangin vonesat e panevojshme (Kondo, 2012:141).

Në çështjen *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës, 1983*, Gjykata u shpreh, se: *“shtetet kanë për detyrë që të organizojnë sistemin e tyre ligjor në mënyrë të tillë që t’u lejojnë gjykatave që të veprojnë në përputhje me nenin 6.1, përfshirë gjykimin brenda një afati të arsyeshëm”*. Në këtë çështje Gjykata konstatoi se kur arsyeja për një vonesë ishte një punë e prapambetur afatgjatë në sistemin e gjykatës së Shtetit, kishte ndodhur shkelje e garantimit të kohës së arsyeshme në nenin 6 duke qenë se Shteti nuk kishte marrë masat e duhura për të përballuar situatën. Masat e duhura përfshijnë edhe emërimin e gjyqtarëve apo stafit administrativ shtesë (Mole, 2005: 25).

Në çështjen *Gjon Boçari etj. Kundër Shqipërisë, Tetor 2007*, Gjykata rikujtoi që shtetet palë janë të detyruara që të i modifikojnë sistemet e tyre ligjore, në mënyrë që të lejojnë gjykatat që të përshtatin praktikën e tyre sipas kësaj kërkesë të Konventës. Në këtë rast, lidhur me faktin se kishin ekzistuar edhe procese të tjera paralele, të cilat kishin të

bënin me të njëjtën pronë të pretenduar nga kërkuesit, dhe faktin se gjykatat vendëse nuk kishin marrë asnjë hap për bashkimin e tyre, pezullimin apo refuzimin për të iniciuar procedura të reja, dhe për pasojë zvarritjen dhe ndërlikimin e zgjidhjes së kësaj çështjeje, Gjykata vlerësoi se kohëzgjatja e të tre procedurave në tërësi nuk ishte në përputhje me kërkesat e nenit 6 të Konventës dhe ka konstatuar shkeljen e këtij neni në këtë aspekt (Kondo, 2012: 1410). Gjykata ka refuzuar argumentet qeveritare se pamjaftueshmëria e personelit apo mangësitë e përgjithshme administrative përbëjnë justifikim të mjaftueshëm për të ekzistuar shkelje e standardit “afat i arsyeshëm” (Hila, 2012: 62).

Çfarë përbën rrezik për kërkuesin? Ajo çka rrezikon kërkuesi është një faktor që merret në konsideratë për vlerësimin e faktit nëse është përmbushë garantimi i afatit të arsyeshëm kohor. Për këtë arsye veçanërisht në rastet e çështjeve penale nevojitet që proceset të jenë më të shpejta se sa në çështjet civile, sidomos kur i akuzuari mbahet në paraburgim (Mole, 2005: 25). Kërkesa për një afat të arsyeshëm, sipas nenit 6.1 është e lidhur ngushtë me të drejtën për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm sipas nenit 5.3 të Konventës. Kjo dispozitë e fundit i referohet vetëm rasteve të gjykimeve penale për personat në gjendje paraburgimi, kurse neni 6.1 ka një objekt me shtrirje më të gjerë. Gjykata ka shpjeguar se nëse seancat gjyqësore stërzgjaten në mënyrë të panevojshme mbajtja në paraburgim do të bëhet e pa ligjshme. Parimi i përmendur i kësaj rregulle është shprehur në këtë frazë: *“drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar”* (Kuptimi i të Drejtave të Njeriut - Manual për arsimimin për të Drejtat e Njeriut, “Zhvillimi historik i sundimit të ligjit”, 2014: 169). Sa u përket çështjeve civile përshpejtimi i procesit nga ana e autoriteteve lipset sidomos në rastet kur të drejtat janë m rëndësi kritike për kërkuesin, apo kanë karakter të pakthyeshëm. Gjykata në një sërë rastesh ka cilësuar çështjet që duhet të

trajtohen me shpejtësi siç janë ato që kanë të bëjnë me kujdestarinë e fëmijëve -*Hokkaken kundër Finlandës*, mosmarrëveshjet mbi punësimin -*Obermeier kundër Austrisë*, rastet e plagosjeve personale - *Silvia Pontes kundër Portugalisë* etj. Çështje të tjera ku shpejtësia e gjykimit është konsideruar me rëndësi të madhe, për shembull, raste si: *X kundër Francës*, ku kërkuesi kishte marrë HIV-in nga një transfuzion i infektuar i gjakut, dhe kërkonte shpërblim nga shteti. Gjykata duke pasur parasysh kushtet e kërkuesit dhe pritshmërinë e tij për jetën u shpreh, se: “*procesi gjyqësor që zgjati për dy vjet ishte i gjatë në mënyrë të paarsyeshme*”. Ndërsa në çështjen *A dhe të tjerë kundër Danimarkës*, Gjykata u shpreh, se: “*autoritetet kompetente administrative dhe gjyqësore kishin detyrimin pozitiv sipas nenit 6 që të vepronin me një kujdes të veçantë që kërkohet nga jurisprudence e Gjykatës lidhur me çështje të kësaj natyre*”(Kondo, 2012: 142).

4.2.5. E drejta për t’u mbrojt vetë ose përmes përfaqësuesit ligjor

Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë për t’u mbrojtur vetë ose përmes përfaqësuesit ligjor. Ai gëzon të drejtën të ndihmohet nga një avokat të cilin e zgjedhë vetë, ose të ketë një avokat që është i caktuar për ta ndihmuar në interes të drejtësisë dhe pa pagesë, nëse ai nuk është në gjendje të përballojë pagesën (Amnesty International Publications, *Manual i Gjykimit të Drejtë*, 1998: 100). Neni 14 (3) (d) i PNDKP ka paraparë se për përcaktimin e çdo akuze penale kundër një personi, ai ose ajo ka të drejtë “*të jetë i pranishëm gjatë procesit dhe të mbrohet vetë ose të ketë ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij; në qoftë se nuk ka mbrojtës, ai duhet që të informohet për të drejtën e tij që të ketë një të tillë dhe kurdoherë që e kërkon interesi i drejtësisë, atij duhet t’i*

caktohet një mbrojtje detyrueshme pa shpenzime, nëse ai nuk ka mjete për të paguar” (Kuptimi i të Drejtave të Njeriut - Manual për arsimimin për të Drejtat e Njeriut, “Zhvillimi historik i sundimit të ligjit”, 2014: 169). Neni 6 (3) c, siguron të akuzuarin të drejtën për t’u mbrojtur vetë ose nëpërmes asistencës ligjore sipas zgjedhjes së tij nëse ai/ajo nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar asistencë ligjore, ti jepet pa pagesë kur e kërkojnë këtë interesat e drejtësisë (Mole, 2005: 57).

E drejta për mbrojtës gjatë fazave paraprake të procedurave penale është qartazi e lidhur me të drejtën për të qenë i mbrojtur gjatë gjykimit. E drejta për t’u mbrojt vetë ose përmes përfaqësuesit ligjor përfshin të drejtën për të qenë i pranishëm gjatë gjykimit, të drejtën për të mbrojtur vetën, të drejtën për ta zgjedhur vet mbrojtësin, të drejtën për të qenë i informuar mbi të drejtën për mbrojtës dhe të drejtën për të marrë ndihmë ligjore pa pagesë. Shteti nuk është i obliguar që për çdo rast të caktojë mbrojtës ligjor. Kjo bëhet varësisht nga serioziteti i dënimit të mundshëm. Për shembull, Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut ka vendosur se çdo personi të akuzuar për vepër penale për të cilën parashihet dënimi me vdekje, duhet t’i caktohet mbrojtësi. Sidoqoftë një personi të akuzuar për tejkalim të shpejtësisë nuk është e domosdoshme që në llogari të shtetit t’i caktohet mbrojtësi (Kuptimi i të Drejtave të Njeriut - Manual për arsimimin për të Drejtat e Njeriut, “Zhvillimi historik i sundimit të ligjit”, 2014: 169).

Gjykata ka vlerësuar se kur i akuzuari ka të drejtën e asistencës ligjore pa pagesë ajo duhet që të jetë praktike dhe efektive dhe jo thjesht teorike dhe e gënjeshtërt sa për të plotësuar kushtin ligjor. Në rastin *Atico kundër Italisë* Gjykata u shpreh se edhe nëse autoritetet nuk mund të jenë përgjegjëse për çdo gabim të një avokati të ndihmës ligjore dhe drejtimin e mbrojtjes, theksoi se:Neni 6 (3) c flet për “asistencë” dhe jo “emërim”.

Përsëri, edhe thjesht emërimi nuk siguron asistencë efektive duke qenë se avokati i caktuar për qëllime të ndihmës ligjore mund të vdesë, të sëmuret rëndë, të ndalohej për një periudhë të gjatë të veprojë si i tillë ose ti shmanget detyrimeve të tij. Nëse ata nuk vihen në dijeni mbi situatën, autoritetet ose duhet ta zëvendësojnë atë, ose ta detyrojnë të përmbushë detyrimet e tij”(Mole, 2005: 57). I akuzuari gjithashtu ka të drejtë për komunikim të fshehtë me mbrojtësin e vet. Edhe pse ekziston e drejta për të qenë i pranishëm gjatë gjykimit, në raste të jashtëzakonshme dhe për shkaqe të arsyeshme, gjykimet mund të mbahen edhe në mungesë, por gjithnjë e më i domosdoshëm është duke u bërë vëzhgimi me përpikmëri i të drejtave të mbrojtjes.

4.2.6. Presumimi i pafajësisë

Parimi i prezumimit të pafajësisë përbën gjithashtu një element të rëndësishëm të të drejtës për proces të rregullt gjyqësor. E drejta për t’u prezumuar i pafajshëm do të thotë se secili i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të prezumohet i pafajshëm dhe duhet të trajtohet si i pafajshëm deri, dhe vetëm atëherë, kur në bazë të ligjit dhe në gjykim të drejtë, provohet se ai, ose ajo është fajtor (Kuptimi i të Drejtave të Njeriut - Manual për arsimimin për të Drejtat e Njeriut, “ Zhvillimi historik i sundimit të ligjit”, 2014: 169). Presumimi i pafajësisë përbën të drejtën e çdo personi për tu konsideruar i pafajshëm që nga momenti i dyshimit ngritjes së akuzës e derisa fajësia të vërtetohet me aktgjykimin e formës së prerë. Rrjedh nga parimi ligjor latin “*qui dicit, non qui negat*”(barra e provës qëndron tek akuzuesi e jo tek i akuzuari), (Hila, 2010: 65). Parimi i prezumimit të pafajësisë është sanksionuar në nenin 11 të Deklaratës Universale, nenin 14(2) të PNDKP, nenin 6.2 të

KEDNJ dhe i njëjti është sanksionuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës në nenin 31 (5), sipas të cilit *“Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij ose saj në pajtim me ligjin”*.

E drejta për t’u prezumuar i pafajshëm duhet të aplikohet jo vetëm për trajtimin në gjykatë dhe vlerësimin e dëshmisë, por gjithashtu edhe në trajtimin përpara gjykimit. Personat e dyshuar duhet të shoqërohen nga kjo e drejtë edhe në fazën para ngritjes së aktit akuzues, gjatë gjykimit dhe fazës së gjetjes fajtor por edhe pas apelit përfundimtar. Prezumimi i pafajësisë ka rëndësi të madhe për personat që gjenden në fazat pas ngritjes së aktit akuzues siç është faza e marrjes në pyetje nga hetuesia dhe prokuroria, faza e lirimit në pritje të ngritjes së aktit akuzues apo pushimit të hetimeve, faza e lirimit nga paraburgimi në pritje të gjykimit etj. E drejta për të mos u detyruar që të dëshmosh kundër vetvetes ose të pranosh fajin dhe e drejta për të heshtur janë të rrënjësura në prezumimin i pafajësisë. Aktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut kanë përcaktuar se asnjë i akuzuar për vepër penale nuk mund të dëshmojë kundër vetvetes ose të pranojë fajësinë (Amnesty International Publications, 1998: 90). E drejta për të heshtur, gjithashtu, kërkon nga prokurori se para se të zhvillohen hetimet nga ana e prokurorit, heshtja të mos merret në konsiderim gjatë përcaktimit të fajësisë apo pafajësisë, ndërkaq e drejta për të mos u detyruar për të dëshmuar kundër vetvetes nënkupton ndalimin e çfarëdo forme të presionit.

E drejta e prezumimit të pafajësisë kërkon që gjyqtarët apo juritë të mos paragjykojnë në asnjë çështje. Kjo është e rëndësishme të respektohet edhe nga autoritetet tjera publike si dhe mediet. Zyrtarët publikë, në veçanti prokurorët dhe policia nuk duhet që të bëjnë deklarata rreth fajësisë apo pafajësisë së një të akuzuari përpara përfundimit të gjykimit. Është obligim i autoriteteve që të disiplinojnë medien apo grupet e tjera të

fuqishme shoqërore që të mos ndikojnë në rezultatin e një çështje e cila është në zhvillim në procedurat gjyqësore. Sidoqoftë Gjykata në çështjen *Kraus kundër Zvicrës* ka vlerësuar se prezumimi i pafajësisë nuk vlerësohet të jetë shkelur nëse autoritetet nëse ato informojnë publikun rreth hetimeve penale dhe duke vepruar kështu, emërtojnë një të dyshuar ose thonë se një i dyshuar është arrestuar apo ka pranuar fajin, për sa kohë nuk deklarojnë se personi është fajtor (Amnesty International Publications, 1998: 87).

Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga tre element thelbësor: barra e provës, niveli i të provuarit duhet që të jetë mbi fakte të arsyeshme, mjetet e të provuarit duhet që të jenë marrë në përputhje me ligjin. Barra e provës i përket akuzuesit i cili ka detyrimin të provojë me fakte bindëse fajësinë e të akuzuarit. Në rast se pas çmuarjes së provave nga ana e gjykatës mbetën ende dyshime lidhur me fajësinë e të akuzuarit, gjykata ka për detyrë që personin ta shpallë të pafajshëm. Prezumimi i pafajësisë gjithashtu nënkupton edhe të drejtën e të akuzuarit për mbrojtje dhe dhënien e mundësisë së tij për t'i kundërshtuar. Prezumimi i pafajësisë ka rëndësi edhe për personat të cilët lirohen për mungesë provash. Nëse një person lirohet nga gjykata me vendim përfundimtar të gjykatës për mungesë provash, vendimi është detyrues për të gjithë autoritetet shtetërore.

4.2.7. E drejta për mjete juridike

Secili ka të drejtë për mbrojtjen e barabartë të të drejtave të veta në çdo procedurë. Nënkupton të drejtën e secilit që të parashtrojë ankesë ose mjete tjera juridike kundër akteve të veçanta juridike të nxjerra në procedurën në shkallë të parë para gjykatës, organit të administratës ose organizatës dhe institucioneve të tjera që ushtrojnë autorizime publike.

Shfrytëzimi i mjetit juridik është një mundësi e mirë që edhe njëherë autoritetet publike shtetërore t'i shqyrtojnë vendimet e tyre, t'i përmirësojnë gabimet ose lëshimet eventuale, që kanë mundur të ndodhin gjatë procedurave të ndryshme. Kjo e mundëson edhe parandalimin e padrejtësive, shpërdorimin e pushtetit, ofron vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj dhe e garanton parimin e sundimit të ligjit (Bajrami, 2011: 199).

Përdorimi i mjeteve efektive dhe shterimi i tyre është rregull i përcaktuar nga ana e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, i cili nga ankuesit që i drejtohen kësaj gjykate kërkon t'i shterin të gjitha mjetet që garanton sistemi i brendshëm ligjor.

KAPITULLI V: Procesi i rregullt në procedurat gjyqësore në Kosovë

5.1. Kuadri kushtetues dhe normativ lidhur me gjykimin e drejtë

Procesi i rregullt ligjor ka gjetur sanksionimin edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kështu, në nenin 53 interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut është paraparë që të bëhet në harmoni me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. **E drejta e lirisë dhe e sigurisë** e garantuar me nenin 5 të KEDNJ-së, është bartur pa asnjë ndryshim, në nenin 29 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Bajrami, 2011: 195). Kushtetuta duke përqafuar këtë frymë, garanton një tërësi të të drejtave substanciale, që kanë për qëllim të minimizojnë rreziqet e arbitraritetit, duke paraparë një kontroll gjyqësor ndaj veprimit të privimit të lirisë, me përgjegjësi të përcaktuara të autoriteteve për veprime të tilla (Bajrami, 2011:195). Duke i dhënë një rëndësi shumë të madhe çështjes së garantimit të sigurisë, Kushtetuta ka përcaktuar se askush nuk mundët që të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendimin e gjykatës kompetente. Në nenin 29 Kushtetuta ka përcaktuar të drejtat e personit të ndaluar dhe ka theksuar të drejtën e tij që të vihet menjëherë në dijeni mbi shkaqet e arrestimit në gjuhën që ai e kupton dhe kjo të bëhet sa më shpejtë që të jetë e mundshme. Me kushtetutë është përcaktuar afati prej 48 orësh, në të cilin afat duhet që të dalin para gjykatës personat e privuar nga liria pa urdhër të gjykatës, dhe gjyqtari duhet të vendos për paraburgimin ose lirimin jo më vonë se 48 orë nga momenti kur personi i ndaluar është sjellë para gjykatës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës me këtë nen ka përfshirë edhe një varg të drejtash të personit të privuar nga liria si: të drejtën e të ndaluarit që të nxirret në gjykim

brenda një kohe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjyqimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përben rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e tij para gjyqimit. Me kushtetutë është përcaktuar e drejta e personit të ndaluar që të njoftohet se ka të drejtë të mos jap asnjë deklaratë dhe se ka të drejtë për mbrojtës sipas zgjedhjes së tij dhe ka të drejtë pa vonesë që ta informojë për këtë personin sipas zgjedhjes së vet. Neni 29, paragrafi 5, ia garanton personave të ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj.

Të drejtat e të akuzuarit në Kosovë janë të garantuara në pajtueshmëri me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe me ligjin vendor. Sikurse Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 30) edhe neni 6 i KEDNJ-së, garantojnë të drejtat minimale siç janë: të njoftohet menjëherë në gjuhën që e kupton; për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij; të njoftohet me të drejtat e tij sipas ligjit; të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi kur nuk flet ose kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi; të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht dhe nëse nuk ka mjete të mjaftueshme mbrojtja të i sigurohet falas; të mos shtrëngohet të dëshmojë kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë etj.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe në përgjithësi legjislacioni penal dhe ai civil, sa i përket **të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm**, kanë mishëruar elemente nga instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht nga KEDNJ-ja (neni 6). Në nenin 31 të Kushtetutës garantohej: e drejta për trajtim të barabartë në gjykatë dhe në organet e tjera shtetërore; e drejta e shqyrtimit publik që mund të garantohej vetëm në rastet e parapara me ligj; e drejta për gjykim brenda një

afati të arsyeshëm kohor; të drejtën e prezumimit të pafajësisë; të drejtën në zgjedhjen e përfaqësuesit ligjor dhe lejimin e ndihmës pa pagesë etj (Bajrami, 2011:198).

Kushtetuta dhe në përgjithësi legjislacioni penal, civil ose administrativ, ia garantojnë qytetarit mundësinë e shfrytëzimit të **mjeteve juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative**, të cilat i cenojnë të drejtat ose interesat e tij në mënyrën e përcaktuar me ligj. Sa i përket shfrytëzimit të mjeteve juridike, legjislacioni i Kosovës është mjaft i qartë dhe nuk ekziston ndonjë problem ose paqartësi që e bëjnë të vështirë të kuptohet nga qytetarët.

Në Kushtetutë i është dhënë vend i merituar edhe **Parimit të Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale**. Parimi se nuk mund të ketë veprë penale as dënim, me përjashtim kur është parashikuar me ligj, përbën themelin e drejtësisë dhe si i tillë është inkorporuar në Kushtetutën dhe në Kodin Penal të Kosovës. Kushtetuta gjithashtu, ka përcaktuar se dënimi i shqiptuar për një veprë penale nuk mund të jetë më i ashpër se sa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës dhe se ashpërsia e dënimit nuk mundet që të jetë në disproporcion me veprën penale. Ligji ka efekt prapaveprues vetëm nëse është më i favorshëm për kryesin e veprës.

Parimi *Ne bis in idem* në sistemin ligjor të Kosovës është kodifikuar si e drejtë kushtetuese. Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën veprë penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj.

Në legjislacionin e Kosovës jo vetëm në legjislacionin penal, por edhe në atë civil, dhe disiplinor procesi i rregullt ligjor është harmonizuar në pajtim me nenin 6 të KEDNJ. Pothuajse të gjitha procedurat gjyqësore civile kanë akceptuar të drejtën e gjykimit brenda

një kohe të arsyeshme, apo mbajtjen e procesit pa zgjatje të panevojshme. Procesi i rregullt ligjor është i sanksionuar edhe në kodet etike. Kodi i Etikës për gjyqtarët ka sanksionuar se zvarritja e paarsyeshme e çështjeve gjyqësore përbën Sjellje të Pahijshme dhe është shkak për shqiptimin e sanksionit disiplinor. Megjithëkëtë në Kosovë ende mbetet punë për tu bërë sa i përket disa neneve të Kodit të Procedurës Penale ku për disa vepra penale tek Urdhri Ndëshkimor, është paraparë shqiptimi i dënimit pa prezencën e palës në gjykatë dhe dhënien e të drejtës për t’u deklaruar.

5.2. Disa elemente te gjykimit të drejtë në institucionin e Pleqnisë në Kosovë

Si rezultat i rrethanave historiko-shoqërore, në Kosovë është zhvilluar një formë e zgjidhjes alternative të kontesteve ndërmjet njerëzve ku mosmarrëveshjet kanë marrë formën e zgjidhjes pas dhënies së mendimit dhe vendimit, që është njohur me emrin Pleqni. Grupi i njerëzve të cilët janë marrë më këtë çështje në popull janë njohur me emrin Pleqnar. Pavarësisht nga e drejta ne fuqi, shqiptarët ndërtuan Pleqninë si institucion juridik popullor që paraqet një formë mjaft të vjetër të zgjidhjes së konflikteve ndërmjet njerëzve. Kanuni i Lekë Dukagjinit apo Kanuni i Lekës siç u quajt në Kosovë dhe në Veri të Shqipërisë, në institucionin e pleqnisë ishte dhe mbeti bazë për marrjen e qëndrimeve dhe sistem i argumenteve. Që në atë kohë u zhvillua parimi i barabarësisë së palëve ku për të njëjtën temë flasin dy oratorë, me kuptime të kundërta, duke u mbajtur mend ajo që është kryesore dhe duke qenë imun ndaj përpjekjeve për bindje të gabuara (Rukiqi, 1998: 83). Parimi i mos diskriminimit gjente aplikim, ndonëse jo në formën ideale për kohen edhe në rastet e ndarjes së pleqnisë. Të gjithë pa dallim gëzonin të drejtën që kërkesën e tyre “ta qitnin në

plak”, e më këtë edhe të zhvillohej kuvendi për një çështje të tillë. Profesor Anton Çetta lidhur me pleqnitë e Ramadan Shabanit thotë: “... gjithkë në Kosovë, Ramadani dante (ndante) pleqni pa ndonjë interes vetjak, kishte qëndrim konsekuent si për të madhin si për të voglin, si për të pasurin si për të varfrin, si për pjesëtarët e njërit si për të tjetrit konfesion apo edhe të njërës e të tjetrës trevë. Për të gjitha këto fjala e tij i zinte vend dhe vetë Ramadani u çmua dhe u quajt sa ishte gjallë pleqnari i Kosovës. Në veprimtarinë e Ramadan Shabanit e cila veprimtari më vonë do të bëhet precedent për zgjidhjen e rasteve të tjera, janë vërejtur edhe përpjekje për evitimin e dispozitave të vrazhda kanunore. Kështu bëhet fjalë për abrogimin e paragrafit të kanunit mbi konfiskimin e pasurisë së dorasit si dhe kundërshtonte shtypjet kanunore të femrave. Në pleqnitë e Ramadan Shabanit askund nuk ndeshet nënshtrimi absolut i gruas. Sipas tij femra është e barabartë me mashkullin në shoqëri e jo “posë për bukë të gojës” (ka kuptimin se femra nuk është vetëm që të gatuj bukën –vër.jona.), (Foniqi, 1989: 70).

Në institucionin e Pleqnisë çështjet më të rënda zgjidheshin në Kuvend të burrave ku mblidhej kuvendi dhe bëhej pleqni. Këto raste kishin të bënin me raste të rënda siç ishin vrasjet apo çështjet e moralit, vjedhjet etj., e që për të cilat duhej që të mblidheshin numri i caktuar i pleqve të cilët duhej që para pleqve dëshmitarë të bënin “be” (betoheshin) se akuza i ishte shpifur të paditurit. Për vjedhjen në oborr (në shtëpi ose afër saj) nëse i padituri e mohonte atë që i ngarkohej, caktoheshin nga dy pleq për secilën anë të cilët para pleqve dëshmitar rrëfenin secila palë versionin e tyre, e më pastaj nevojiteshin dymbëdhjetë pleq që të bënin be se akuza nuk ishte e vërtetë dhe se i ishte shpifur të paditurit. Nëse këta të dymbëdhjetë nuk bënin be që të gjithë atëherë i padituri shpallej fajtor dhe dënimi mund të mbërrinte deri në “gjysmë gjaku”. Nga ajo që nga mendimtarët e ndryshëm flitet në

Llapushë dhe Drenicë, vepra e vjedhjes në shtëpi sanksionohej rëndë sepse përveç të mirës materiale që vidhej (mallit të humbur siç quhej në gjuhën e pleqnarëve), pala e dëmtuar ishte cenuar edhe në nderë sepse mendohej se “oborri ka namuz” (ka nderë). Nga ajo që është e njohur për institucionin e pleqnisë lidhur me veprat e vjedhjes jashtë shtëpisë numri i pleqve dëshmitarë duhej që të ishte gjashtë, kurse te vrasja kur i padituri nuk e pranonte se është kryes i veprës, numri i pleqve dëshmitar duhej të ishte njëzetekatër. Përveç këtyre që u cekën më lartë, shumë çështje zgjidheshin edhe para një plakut të vetëm – pleqnarit i cili gëzonte besim të plotë në popull për zgjuarsinë në aplikimin e kanunit dhe paanësinë e tij. Kështu të dy palët në kontest e dërgonin nga një plak duke mbrojtur secili klientin e vet dhe jepnin edhe dorëzanin me vete. Kjo ishte një si garanci që pas dëgjimit të palëve, vendimi i dhënë nga pleqnari kur pranohej nga pleqtë përfaqësues do të respektohej me përpikëri, sepse dorëzanët ishin ndërmjet tyre (Çetta, 2010: 29. Këtë e konfirmuan edhe tre pleq nga fshati Gllarevë, Klinë, *Ali Pantina (92), Jashar Hasanaj (73) dhe Milazim Haxhaj (71)- marrë në qershor 2012*).

Pavarësisht mënyrës së zgjidhjes së rasteve të tilla dhe mënyrës së marrjes së vendimit, mendojmë se vetë dhënia e mundësisë palëve që para kuvendit të deklaroheshin nëpërmjet pleqve që i përfaqësonin dhe dhënia e vendimit përfundimtar nga një numër i caktuar i pleqve dëshmitar, për shkencën juridike shqiptare paraqet një bazament të qëndrueshëm për formën e aplikimit të gjykimit të drejtë, dhe shmangien nga çfarëdo forme e aplikimit të vetëgjyqësisë apo çfarëdo forme tjetër të arbitraritetit. Një element shumë i rëndësishëm i ndarjes së pleqnisë ishte e dhëna se pleqnarët zhvillonin veprimtarinë e tyre pa shpërblim për punën që e bënin. Duke kryer këtë mision të rëndësishëm në shoqëri, pajtimin e personave dhe familjeve me marrëdhënie të acaruar, pleqnarët janë gjetur

shpeshherë në situata të pakëndshme, gjegjësisht kanë qenë të detyruar që të sakrifikojnë shumëçka: shëndetin, humbjen e kohës së punës. “Pleqnar e me fitim nuk ka”, thuhet në Llapushë (krahinë e Kosovës prej nga vinin pleqnarët). Zhvillimi i veprimtarisë së ndarjes së pleqnisë pa shpërblim shtonte kredibilitetin e besueshmërisë së tyre në popull dhe kjo bënte që vendimet e tyre respektoheshin nga palët në mosmarrëveshje. Kjo na bënë të mendojmë se etika në gjykimin e drejtë, në mënyrën e ndarjes së drejtësisë tek populli i jonë është zhvilluar shumë kohë më parë, ndër shekuj.

Parimi i prezumimit të pafajësisë që askush të mos gjykohej pa pasur faj dhe zbutja apo edhe dhënia fund e konflikteve aty ku ka qenë e mundur, kanë qenë të zhvilluara në institucionin e pleqnisë. Parimi kryesor i çdo pleqnari ishte që ta zgjidhë çështjen në mënyrën më të drejtë që të mos dëmtohej askush pa pasur faj. Kjo varej prej inteligjencës së pleqnarit, njohjes së mirë të Kanunit të Lekës, mentalitetit të problematikës dhe përvojës së tij për të pleqëruar (Çetta, 2010: 29).

Aplikimi i rrethanave lehtësuese ka gjetur vend edhe tek kjo formë e ndarjes së drejtësisë. Në rast se personi vepra e të cilit ishte objekt i pleqnisë gabonte për herë të parë tek veprat e rëndësisë më të vogël, atëherë për fajtorin e tillë tentohej që të gjendeshin arsye që ai të amnistohet apo lehtësohet. Ramadan Shabani interesohej për fajtorin se a ka bërë edhe më parë ndonjë faj. “Nuk vritet ati (kali) që zë njëherë n’thue”(zë në thua, rrëzohet-vër.jona), thoshte Ramadan Shabani në raste të tilla (Foniqi, 1989: 69).

Mund të përfundohet se institucioni i pleqnisë ka luajtur rolin e tij të pa zëvendësueshëm për kohën. Jo vetëm që një mosmarrëveshje merrte rrugëzgjidhjen e saj, por ka ndikuar në masë të madhe edhe në përfundimin e armiqësive ndërmjet palëve në kontest. “Jo me i lanë hasëm- po me i lanë vllazën”, thonin pleqnarët e Kijevës. Pas

përfundimit të çështjes në kontest palët sipas traditës përqafoheshin, i shtrinin dorën njëri tjetrit dhe këtu mbaronte edhe armiqësia në mes tyre. Për të drejtën zakonore shqiptare është e njohur botërisht se nuk njihte dënimin e heqjes së lirisë (Sahiti, 1973: 54, a).

Për më tepër sjellim materialin, shënimin e më poshtëm, në të cilin në detaje vlerësohet rëndësia e institucionit të Pleqnisë në Kosovë dhe veprimtarinë e familjes së Tahirhasanve të Kijevës:

Pleqnia si institucion juridik popullor ndër shqiptarët është mjaft e vjetër. Në një dokument arkivor mbi pajtimin e gjaqeve midis fiseve të Gashit të fshatit Deçan dhe të atyre Shalë të fshatit Isniq më 1890 thuhet: "Fiset shqiptare i zgjidhnin të gjitha çështjet, marrëdhëniet dhe mosmarrëveshjet në bazë të zakoneve tradicionale deri në gjysmën e shek. XIX, kur pushteti osman formoi gjykata të posaçme të përbëra nga përfaqësuesit e organeve të tij". Pleqnia në Kosovë u zhvillua si institucion që ishte domosdoshmëri e kohës dhe në një gjendje të këtillë u krijuan institute vendosëse që kishin fjalën e fundit në kontestet ndërmjet njerëzve dhe që pleqninë e zhvillonin si trashëgimi që bartej brez pas brezi e që në popull u quajtën Dyer të pleqnarëve. Në Kosovë njihen tri dyer të pleqnarëve: Dera e Ali Ibrës së Malësisë, Dera e Rexhë Hysenit të Bellopojës (Podujevë) dhe Dera e Tahir Hasanëve të Kijevës (rajoni i Llapushës- Kosova Qendrore). Në Kosovë emri i kanunit lidhet me Lekë Dukagjinin. Populli thotë "si tha Leka ashtu edhe mbet", "ashtu e la Leka" etj. Pleqnarët kishin "kodin" e tyre Kanunin e Lekë Dukagjinit, në bazë të të cilit aplikonin të drejtën zakonore dhe u jepnin zgjidhje mospajtimeve ndërmjet njerëzve për kontestet e caktuara, qoftë nëse ato ishin të karakterit penal, civil apo të dyja këtyre së bashku. Kanuni edhe pse u mblodh dhe u kodifikua nga At Shtjefen

Gjeqovi është shumë interesante se në Kosovë pothuajse që të gjithë pleqnarët që e zbatuan në praktikë nuk e posedonin në formën e shkruar apo nuk dinin shkrim – lexim. Dera e Tahirhasanëve nga Kijevë- Kosova Qendrore më tepër se treqind vjet në mënyrë verbale përdori Kanunin e Lekë Dukagjinit për pleqëri. "Për nëndë shokë njeri (nëntë breza) pajtoi gjaqe dhe shymi (shoi) zjarre jo vetëm në Llapushë por edhe në mbarë Kosovën". Dera e Tahirhasanëve cilësohej edhe si "Kandar (kandar) i Pleqnisë" ose "Vulë e Pleqnisë". Për këtë familje pleqnarësh thuhet se me pleqni u mor që nga gjysma e parë e shek XVIII kur në atë kohë i pari i tyre Sylë Bardheci jetonte në Malësinë e Shkodrës. Arti i dhënies së mendimit përfundimtar dhe dhënies fund të mosmarrëveshjeve ndërmjet njerëzve, u bart ndër breza. Njihen Ramadan Shabani, Asllan Shabani, Tafil Shabani, Rexhë Asllani e Sadik Asllani dhe një varg i tërë brezash të pleqnarëve deri në përfundimin e luftës së fundit në Kosovë. Pleqnari më i njohur dhe më i dëgjuar i kësaj familje ishte Ramadan Shabani (1861- 1931) për të cilin në Kosovë mendohet se ka ndarë pleqni në qindra raste duke zgjidhur edhe ngatërresa më të ndërlikuara. Ai ka pleqnuar individualisht dhe kolektivisht me mexhlis (në mesin e burrave). Lidhur me veprimtarinë e këtij pleqnari profesor Anton Çetta thotë se "për zgjidhjen e çështjeve më të ndërlikuara nga fusha e të drejtës zakonore Ramadan Shabani ishte gjithmonë në krye të "meshlazit" dhe fjala e tij pritej si vendim që pranohej me kënaqësi nga pleqnarët e tjerë. Institucioni i Pleqnisë në kushtet e okupimit klasik të Kosovës pas marrjes me dhunë të autonomisë nga Serbia, në vitin 1990 u ngrit në nivelin e Këshillave të Pajtimit. Këto këshilla tanimë nuk përbëheshin vetëm nga pleqnarët por edhe nga njerëz të shkencës e të dijes dhe rinia studentore. Në këtë

kohë lindi Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve në ballë të së cilës u vu profesor Anton Çetta gjatë të cilës iu dha fund mbi një mijë gjaqe e shumë ngatërresa. Përveç pajtimit të gjaqeve Këshillat e Pajtimit, gjatë okupimit serb, ndërmjetësuan në zgjidhjen e shumë mosmarrëveshjeve qoftë në lëmin penale e po ashtu edhe në atë civile. Me formimin e Sistemit Gjyqësor të Kosovës veprimtaria e Këshillave të Pajtimit e po ashtu edhe institucioni i pleqnisë zbehin, përkatësisht pushojnë veprimtarinë e tyre. Kështu në vitin 2003 pjesëtarët e Familjes së Tahirhasanëve në Kijevë kanë marrë vendim që ti japin fund misionit të tyre qindrayjeçar të ndarjes së drejtësisë, në mënyrë që çështjet e mosmarrëveshjeve ndërmjet njerëzve, epilogun e tyre ta marrin në institucionet gjyqësore që u krijuan në Kosovë. Ky vendim është marrë me 07.05.2003 pas vdekjes së Idriz Asllanit i cili edhe ka qenë edhe pleqnari i fundit nga kjo familje që ka ndarë pleqni. (Nga puna hulumtuese në terren, si dhe të dhëna të shfrytëzuara nga autorët e sipërcituar Sahiti, Çetta, Foniqi dhe Rukiqi. Është shfrytëzuar edhe intervista me z. Mustafë Gashi, profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe, e që vjen nga familja e pelqnarëve të Kijevës. Intervista është zhvilluar në tetor 2012).

5.3. Procesi i rregullt gjyqësor gjatë Misionit të UNMIK

Procesin e rregullt gjyqësor në Kosovë gjatë administrimit të Misionit të UNMIK e karakterizuan shumë faktor. Gjatë këtij misioni në sistemin gjyqësor të Kosovës ishin të angazhuar edhe gjykatësit ndërkombëtar të cilët vinin nga vende të ndryshme dhe me përvoja të ndryshme në zgjidhjen e rasteve. Gjatë këtij misioni në Kosovën Veriore

funksionuan edhe gjykatat paralele të cilat i financonte shteti i Serbisë, kurse në shumë qytete të këtij shteti funksionuan gjykata të cilat në vendimet e tyre thirreshin se janë gjykata nga Kosova. UNMIK erdhi pa kornizë të qartë ligjore në Kosovë. Në fazën fillestare korniza ligjore ndërtohej në formë të rregulloreve të UNMIK-ut, ligjeve ekzistuese të Kosovës të para marsit 89, dhe ato të pas marsit 89 në vendet ku paraqitej vakumi juridik, si dhe bëhej aplikimi i konventave ndërkombëtare. Edhe në kohën kur filloi bartja e kompetencave tek institucionet vendore, ndërtimi i kornizës ligjore nuk tregoi suksesin e duhur dhe projektligjet e dërguara në Kuvend dhe ato të miratuara nga ai shpeshherë kanë qenë të kritikuara qoftë nga ekspertë vendor apo nga ata ndërkombëtar. Procesin e rregullt gjyqësor e karakterizuan edhe paraburgimet jashtëgjyqësore të bëra nga ana e KFOR-it dhe nga Urdhrat Ekzekutiv që jepeshin nga ana e PSSP. Gjatë kësaj kohe KFOR-i dhe UNMIK nuk i nënshtroheshin juridiksionit të gjykatave vendore. Kishte edhe ndërhyrje në procesin e rregullt gjyqësor nga ana e organit legjislativ.

5.3.1. Ligji i zbatueshëm në Kosovë gjatë administrimit të UNMIK

Bazuar në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, UNMIK-u i kishte mandat për të siguruar një administratë të përkohshme për popullin e Kosovës. Kjo nënkupton autorizimin për të nxjerrë ligje edhe pse nuk është e shprehur qartë në Rezolutë. Mbi këtë bazë PSSP me aktin e parë legjislativ të UNMIK-ut, Rregullorja Nr. 1999/1 e datës 25 korrik 1999 përcaktoi që të gjitha autorizimet legislative dhe ekzekutive në lidhje me Kosovën duke përfshirë edhe administrimin e gjyqësisë, i

jepen UNMIK-ut dhe ushtrohen nga PSSP (Rregullorja e UNMIK, 1999/1). Sipas kësaj rregulloreje PSSP do të nxjerrë akte legislative në formë të rregulloreve.

Sipas Rregullores 1999/1 të UNMIK-ut Ligji i aplikueshëm në Kosovë duhet të jetë ligji që ishte në fuqi para intervenimit të NATO-s, me 24 mars 1999. Kjo rregullore kërkonte që ligji i aplikueshëm të jetë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të të drejtave të njeriut, Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe Rregulloreve të tjera të UNMIK-ut (OSBE- Misioni në Kosovë, *Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë 1999-2006*, 2006:17). I sanksionuar në këtë mënyrë me këtë rregullore, ligj i aplikueshëm në Kosovë, pra, do të ishin ligjet serbe të regjimit represiv të Milosheviqit andaj edhe një çështje e këtillë krijoi shqetësim tek aplikuesit shqiptar të ligjit. Gjyqtarët të cilët ishin larguar nga puna, në kohën e marrjes me dhunë të autonomisë së Kosovës nga ana e Serbisë, me Rregulloren 1999/1 po bëheshin sërish aplikues të ligjit që më parë i kishte diskriminuar ata vetë.

Të gjetur në këtë gjendje e cila edhe pse ishte shumë e pa pranueshme, gjyqtarët dhe prokurorët shqiptar nuk morën guximin që një gjë të tillë ta kundërshtonin hapur sigurisht nga frika e edhe një suspendimi tjetër nga puna dhe të mos emërimit të sërishëm në detyrat gjyqësore. Megjithatë zëri i guximit nuk mungoi. Ndaj këtij vendimi të PSSP-së (në kohën e z Kushner), Ymer Hoxha gjyqtar nga Prizreni ngre zërin e kundërshtimit të tij duke u shprehur kundër ligjeve të periudhës së Milosheviqit dhe në shenjë proteste paraqet edhe aktin e dorëheqjes. “Janë pikërisht këto ligje diskriminuese që kanë bërë që Ju sot të jeni në Kosovë së bashku me misionin e OKB-së”, ishin fjalët e këtij gjyqtari drejtuar kryeadministratorit të parë të Kosovës, z Kushner. Arsyeimi i këtillë i gjyqtarit prizrenas në vete ngërthente një domethënie të madhe duke dhënë shpjegimin se regjimi i egër i

Milosheviqit kishte nxjerrë dhe aplikuar ligje diskriminuese, se pasojat e ligjeve të tilla kishin rënduar jetën e shqiptarëve të Kosovës dhe si pasojë e tyre kishte ardhur deri tek shpërthimi i luftës, ndërhyrja e NATO-s dhe instalimi edhe i vet Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Shembullin e këtij gjyqtari e kanë ndjekur edhe dy gjyqtarë të tjerë Agim Krasniqi e Hashim Qollaku, kurse si pasojë e këtij kundërshtimi të njëjtit ishin suspenduar nga puna për t'u rikthyer sërish por me ndryshimin e rregullores në fjalë (Haxhaj, 2008: 29).

Pas këtij reagimi të gjyqtarëve prizrenas kishte reaguar edhe Shoqata e Pavarur e Juristëve të Kosovës, kurse anëtarët shqiptar të Bordit Ekzekutiv të Këshillit të Përbashkët Legjislativ të UNMIK-ut me shkrim ishin kërcënuar, se nuk do ta pranojnë detyrën nëse nuk do të ndryshojë përcaktimi i z Kushner. Me këtë u krijuan parakushtet themelore për fillimin e punës në hartimin e legjislacionit të ri në Kosovë, ndërkohë që vakumin juridik do ta plotësonte legjislacioni i Kosovës, i cili ishte në fuqi deri në marrjen me dhunë të autonomisë në vitin 1989 (Stavileci, 2000: 336).

Në një gjendje të tillë PSSP nxori Rregulloren 1999/24 e cila anuloi Rregulloren 1999/1 dhe rivendosi Ligjet të cilat kanë qenë të aplikueshme në periudhën e ish KSA të Kosovës.

Sipas Rregullores 1999/24 (neni 1.1) Ligji në fuqi në Kosovë përfshin:

- Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to; dhe
- Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

Sipas kësaj rregulloreje në rast konflikti në mes këtyre dispozitave ligjore do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to. Rregullorja më tutje thotë se *“në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj* (http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/A1999regs/RA1999_24, neni 1.2, parë me 03/6/2013).

Në nenin 1.3 të kësaj rregulloreje thuhet se *“gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, të gjithë personat me detyra publike ose që mbajnë pozita publike duhet të respektojnë standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut”*.

Rregullorja po ashtu ndalon çdo formë të diskriminimit nga ana e personave që mbajnë pozita publike në dëm të ndonjë personi tjetër për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjes politike ose bindjeve të tjera, origjinës kombëtare, etnike apo sociale, shoqërimit me një komunitet kombëtar, pasurisë, lindjes ose të ndonjë statusi tjetër. Me këtë rregullore është paraparë se i pandehuri në procedurën penale përfiton nga dispozita më e favorshme e ligjit në fuqi që nga data 22 mars 1989 deri në ditën e nxjerrjes së kësaj rregulloreje. Për herë të parë me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 në Kosovë hiqet dënimi me vdekje (http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/A1999regs/RA1999_24, neni 1.5, parë më 03/6/2013).

Shikuar sipas kësaj rregulloreje në Kosovë janë katër burime të mundshme të ligjit të aplikueshëm:

- Rregulloret e UNMIK-ut;
- Ligji në Kosovë deri më 22 mars 1989;
- Ligji i zbatueshëm në Kosovë midis 22 marsit 1989 dhe 12 dhjetorit 1999

(data kur Rregullorja 1999/24 ka hyrë në fuqi) nëse ky është më i favorshëm për të pandehurin në procedurën penale apo përmbushë ndonjë vakum juridik ku nuk e mbulon ligji para 22 marsit 1989;

- Standardet dhe ligjet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Sa i përket asaj se cili ligj kishte përparësi në aplikimin e tij, bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24, Rregulloret e UNMIK-ut kishin përparësi në krahasim me ligjin e aplikueshëm para 22 marsit 1989. Ndërkaq standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut kishin epërsinë e tyre ndaj ligjeve vendore, edhe pse kjo çështje nuk është bërë e qartë me Rregulloren 1999/24. Këtë çështje PSSP e ka bërë të njohur vetëm në letrën e datës 14 qershor 2000 dërguar Kryetarit të Odës së Avokatëve në Beograd, në të cilën thuhet ndër të tjera se” gjyqtarët nuk duhet të zbatojnë ato dispozita të Ligjit vendës që nuk përputhen me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (OSBE- Misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë 1999-2006: 20).

Ndërtimi i legjislacionit në këtë mënyrë ku para gjykatave u gjenden një konglomerat i tërë i rregulloreve, pastaj ligjeve, konventave udhëzimesh administrative e të tjera të pa sistemuara e vunë në pozitë të vështirë aplikuesin e ligjit në Kosovë. Në anën tjetër edhe aplikimi i ligjeve të cilat ishin në fuqi në vitin 1989 nuk përkonte me realitetin

në të cilin po kalonte në këtë kohë shoqëria kosovare. Në shumë raste në dispozitat juridike të këtyre ligjeve që duhej të gjenin aplikimin e tyre, kishte relikte të së kaluarës së një skeme shtetërore që kishte perënduar kaherë edhe për vetë ata popuj që e kishin krijuar.

Në nenin 3 al.3 të Ligjit mbi procedurën kontestimore që ka të bëjë me disponimin e kërkesave që palët i ushtrojnë gjatë procedurës ndër të tjera thuhej:

“ Gjykata nuk do të aprovojë disponimet e palëve :

- *që janë në kundërshtim me dispozitat imperative mbi të drejtat vetëqeverisëse të punonjësve, mbi disponimin e mjeteve shoqërore dhe me dispozitat e tjera imperative;*
- *që janë në kundërshtim me rregullat e moralit të shoqërisë vetëqeverisëse socialiste”.*

Dispozita dhe relikte të tilla për kohën përmbante edhe ligji penal i RSFJ dhe ai KSA të Kosovës. Po ashtu edhe gjatë kualifikimeve të veprave penale apo të zbatimit të normave procedurale para hyrjes në fuqi të dy kodeve penale, duke zbatuar ish ligjet penale të RSFJ-së para 22 marsit 1989, gjykatat u vunë në pozitë të vështirë për arsye se në shumë raste, personat të cilëve u ishin shqiptuar sanksionet penale, shfaqnin averzionin e tyre ndaj normave të tilla ligjore. Kjo ka bërë që në një farë mase të kontribuojë në zbehjen e punës së gjyqësorit para qytetarëve sepse ishte krijuar mendimi i përgjithshëm se gjykatat punojnë vetëm me ligjet e ish- Jugosllavisë.

Edhe pse me nxjerrjen e Rregullores 1999/24 e cila u ndryshua më vonë me atë 2000/54, shikuar nga aspekti formal-juridik megjithatë është bërë një shkëputje bukur e madhe nga rendi i vjetër juridik – rendi jugosllav, dhe janë vënë bazat për ndërtimin e

legjislacionit të ri, prapë se prapë në rendin juridik të Kosovës mbeti shumëçka për pa u ndërtuar në aspektin e legjislacionit.

Fillimi i punës së Institucioneve të Përkohshme të Qeverisjes (IPVQ) krijoi një situatë tjetër në aspektin e hartimit të ligjeve por edhe të miratimit të tyre. Ligjet e hartuara dhe të miratuara nga institucionet e zgjedhura në mënyrë demokratike siç janë Qeveria dhe Parlamenti kishin parë dritën vetëm pasi që UNMIK-u ka dhënë dritën e gjelbër. Shumë ligje edhe pse të miratuara kanë pritur një kohë të gjatë që të marrin dritën jeshile në Zyrën Ligjore të UNMIK-ut, të nënshkruhen nga PSSP apo edhe të kalojnë edhe në Zyrën Ligjore të OKB-së në Nju Jork. Kjo edhe ka marrë një kohë të gjatë në bërjen e ligjeve si dhe të mbulimit të fushave në të cilat në mënyrë të shpejtë kërkohej aplikimi i tyre dhe në këtë mënyrë edhe ka vështirësuar punën e sistemit gjyqësor në Kosovë. Kjo ka ndodhur sidomos me ligjet (kodet) e sponsorizuara nga UNMIK-u siç janë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/25 Për Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/26 Për Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale etj.

Jo rrallëherë ligjet e nxjerra nuk janë bërë edhe të njohura për qytetarët por edhe aplikuesit e ligjit. Këto ligje janë publikuar në Ueb-faqet zyrtare, çoftë të UNMIK-ut apo në atë të Parlamentit, kurse botimi i tyre në Gazetën Zyrtare dhe shpërndarja e saj shumë herë ka marrë edhe një kohë të gjatë. Gjatë praktikës në gjykata ka ndodhur që ato të mos jenë të informuara se një ligj i vjetër që ka qenë në zbatim është zëvendësuar me ligjin e ri. Kjo ka ndodhur për shkakun se në gjykatat e Kosovës rrjeti i internetit është instaluar me shumë vonesë apo edhe në ato ku ishte instaluar nuk ishte instaluar nëpër të gjitha zyrat e gjykatave. Sidoqoftë, nëse kuptohej nga ndonjëra prej gjykatave se një ligj i ri ka hyrë në fuqi, zbatuesit e ligjit (gjyqtarët) menjëherë informonin kolegët më të afërt dhe kështu ligji i

tillë fotokopjohej dhe gjyqtarët ia shpërndanin njëri tjetrit. Me gazetën zyrtare ai do të mbërrinte me shumë vonesë.

Kjo faktohet edhe më përvojën time:

Nga praktika në gjykatën ku punoja (Gjykatën Komunale në Klinë në vitin 2006) në mungesë të informimit me kohë ne si gjyqtarë kishim vazhduar që të aplikonin Ligjin e vjetër mbi Trashëgimin. Ligji i ri tashmë kishte hyrë në fuqi por ne ishim njoftuar vetëm nga një kandidat që kishte aplikuar për Provimin e Jurisprudencës! Duke menduar se ishim të vonuar ne kontaktua edhe me kolegët në Gjykatën e Qarkut në Pejë, mirëpo, as edhe ata nuk ishin në dijeni për hyrjen në fuqi të këtij ligji. Nuk kishin qenë në dijeni as edhe gjykatat e tjera të regjionit të Pejës, etj. Në këtë mënyrë, në gjykata kishte vazhduar që të aplikohesh një ligj që nuk ishte në fuqi, dhe kjo ishte bërë për të vetmen arsye se gjykatat dhe gjyqtarët nuk kishin qenë të njoftuar se ka hyrë në fuqi ligji i ri.

Vonesa në publikimin dhe shpërndarjen e ligjeve të nxjerra nga UNMIK-u ka shkaktuar probleme për profesionistët ligjor, për arsye se ligjet e zbatueshme nuk kanë qenë pranë tyre në kohën kur u duheshin që ti zbatonin ato (Jashari, 2007: 90). Kështu në një situatë të tillë në të njëjtën kohë në Kosovë nga një gjykatë mund të ndodhte që të zbatoheshin dispozitat e ligjit të ri cili kishte hyrë në fuqi dhe që kishte shfuqizuar dispozitat e ligjit të mëparshëm, kurse në ndonjë gjykatë tjetër, të vazhdonin që të zbatoheshin dispozitat e ligjit të vjetër.

Zhvillimi i IPVQ-ve dhe bartja graduale e kompetencave nga UNMIK-u tek IPVQ-të nxori në pah karakteristikat jo demokratike të rregulloreve të UNMIK-ut sepse ato nuk

ishin hartuar e as nxjerrë në mënyrë demokratike. Në këtë kohë Grupi Ndërkombëtar i Krizave raportonte se kjo çështje ka bërë që rregulloret e UNMIK-ut nga kosovarët të shiheshin më shumë si instrumente arbitrare se sa si një instrument ligjor për të mirën e tyre (Jashari, 2007: 91).

5.3.2. Procesi i hartimit të ligjeve gjatë Misionit të UNMIK

Procesi i hartimit të ligjeve përkatësisht rregulloreve ka kaluar nëpër dy linja gjegjësisht dy rrugëve të hartimit të tyre. Linja e parë paraqet fazën fillestare kur në Kosovë filloi procesi i hartimit të ligjeve, në këtë kohë hartimi i tyre bëhej vetëm nga trupat ligjdhënëse të UNMIK-ut. Ndërkaq linja e dytë, paraqet fazën kur pas ndërtimit të institucioneve të Kosovës filloi hartimi i draft ligjeve dhe miratimi i tyre në Parlament për t'u shpallur më pastaj nga kryeadministratori i Kosovës.

Procesi i hartimit të ligjeve në shumë raste është cilësuar si arbitrar, jo transparent dhe që në shumë raste edhe merrte kohë, apo edhe ka pasur raste kur koha e kaluar në procesin e hartimit është cilësuar edhe si humbje e kohës. Mund të këtë ndodhur që ekipet ndërkombëtare dhe lokale të ekspertëve me përkushtim dhe mund të përgatisnin draftin final të një rregulloreje, e cila më pastaj i është dërguar PSSP-së, por PSSP të këtë nxjerrë rregulloren në fjalë me shumë ndryshime dhe që në mënyrë të theksuar të anashkaloj draftin final të hartuar nga ekspertët (Jashari, 2007: 91).

Sa i përket procesit të hartimit të ligjeve nga IPVQ-të, ato shpesh kanë qenë të kritikuara për kualitetin e dobët të hartimit draftligjeve që kanë qenë të sponzoruara prej tyre dhe draftligjet shpeshherë kanë qenë të pakuptimta dhe konfuze. Si shkak i kualitetit të

dobët, në të shumtën e rasteve janë përmendur mungesa e eksperiencës së hartuesve të draftligjeve nga ana e ekspertëve të qeverisë, përkthimi i tyre nga ana e përkthyesve të pakualifikuar dhe që shpesh here rregulloret e tilla hapnin dilema me rastin e aplikimit praktik të tyre.

Rregullorja e UNMIK-ut nr.2003/12 , Mbrojtja kundër dhunës në familje ka hapur dilema tek përfaqësuesit ligjor. Ajo njëkohësisht përmend termet “i paditur” dhe “i pandehur” kurse fjala është për personin që ka kryer vepër të dhunës në familje. Në nenin 2 që ka të bëjë me Masat e urdhëresave për mbrojtje emergjente dhe urdhëresat për mbrojtje emergjente dhe urdhëresat për mbrojtje emergjente të përkohshme, gjithkund thotë se “Urdhëresa mund t’ia ndaloj të pandehurit...”, kurse në nenin 9.4 thotë se” Gjykata i thërret menjëherë personat sipas nenit 9.2, konform Ligjit mbi procedurën kontestimore”. Po ashtu në nenin 14.2 thuhet se “ Nëse ekziston dyshimi i bazuar se është kryer vepra që ka të bëjë me dhunën në familje, organet për zbatimin e rendit arrestojnë kryesin e supozuar dhe e paraburgin sipas ligjit të dispozitave kontestimore” (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/12 Mbrojtja kundër dhunës në familje).

Përdorimi i kësaj terminologjie në fillim ka shfaqur shumë dilema lidhur me aplikimin e saj. Ndonëse çështja duhej që të trajtohej sipas rregullave të natyrës civile në gjykata, vet termi i pandehur kishte bërë që lëndët e tilla në një numër gjykatash t’i aplikonin dispozitat e procedurës penale dhe lëndët e tilla të regjistroheshin nën shenjën e Regjistrave penal, kurse kryheshin nga gjyqtarët e Degës penale nëpër gjykata. Po ashtu kjo rregullore ndër mangësitë e tjera nuk e përcakton edhe çështjen e ankesës se cilës gjykatë duhej që ti parashtrohej ajo.

Për më tepër shih shënimin si më poshtë:

Nga diskutimet e shumta që janë mbajtur në Institutin Gjyqësor të Kosovës janë eliminuar këto mangësi dhe ka mbizotëruar mendimi se procedura duhet të zhvillohet sipas dispozitave të Procedurës Kontestimore dhe Gjykatat Komunale me në fund pas një kohe edhe kanë hequr dallimet lidhur me zhvillimin e kësaj procedure. Mangësi e Institutit Gjyqësor në këtë kohë ishte se në të shumtën e rasteve anëtarët e panelit të ligjërimit lidhur me këtë Rregullore ishin gjyqtarët e Gjykatave të Qarkut apo të Gjykatës Supreme të Kosovës e të cilët asnjëherë në procedurë nuk ishin ballafaquar me raste praktike të kësaj natyre.

Rregullorja po ashtu, nuk saktëson edhe emërtimet e pjesëmarrësve në procedurë gjë që ka bërë që të ketë emërtime të ndryshme nëpër vendimet e gjykatave, ku në disa prej tyre përdoren “paditës- i paditur”, “palë e mbrojtur- i pandehur”, “palë e mbrojtur – i paditur”, “ viktimë e dhunës familjare – i paditur “ etj.

Përveç këtyre që i cekëm më lartë, shumica e përkthyesve të ministrive të IPVQ-ve ishin të pa kualifikuar e veçanërisht u mungonte eksperiencia në terminologjinë juridike. Si rezultat i kësaj kjo kishte ndikim negativ edhe në punën e Parlamentit të Kosovës ku deputetët ballafaqoheshin me vështirësi të shumta që të nxirrnin domethënien e vërtetë të drafteve të propozuara (Jashari, 2007: 92). Vështirësitë shfaqeshin edhe me rastin e dërgimit të këtyre ligjeve tek autoritetet e UNMIK-ut, vetëm në gjuhën angleze dhe një gjë e këtillë në kushte të këtilla merrte edhe shumë kohë.

Për këtë arsye UNMIK-u në Gazetën Zyrtare ka vënë një klauzolë ku heq dorë nga përgjegjësia për përmbajtjen e rregulloreve që nxirren nga IPVQ-të.

“UNMIK-u është përgjegjës për botimin e rregulloreve dhe urdhëresave administrative të UNMIK-ut të shpallura me kompetencën e PSSP-së. UNMIK-u nuk mbanë përgjegjësi për cilësinë e teksteve të ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe të shpallura nga PSSP ose për saktësinë e përkthimeve të këtyre teksteve në gjuhët që kërkohen në paragrafin 9.1.51 të Kornizës kushtetuese (Rregullorja e UNMIK-ut nr.2001/9 e datës 15 maj 2001). UNMIK-u nuk është përgjegjës për çfarëdo pasoje që rezulton nga të mbështeturit në këto tekste apo përkthime”- thuhet në këtë klauzolë dhe e cila është e botuar çdo herë në fillim të çdo edicioni të gazetës zyrtare”.

Kjo ka qenë pasojë e punësimit të zyrtarëve ligjorë nëpër ministritë përkatëse pa ndonjë hulumtim të përgjithshëm të profesionalizmit të të nominuarve apo sipas preferencave politike. Në shumë raste ka ndodhur që pjesëmarrës të hartimit të drafteve të kenë qenë persona pa ndonjë eksperiencë në fushën për të cilën bëhej hartimi i një drafti të tillë. Këto gjëra identifikoheshin gjatë diskutimit të këtyre drafteve dhe shfaqnin pakënaqësi tek zbatuesit e ligjit.

Për më tepër shih shënimin si më poshtë:

Në një tryezë të organizuar në Prishtinë në nëntor të vitit 2007, nga UNDP dhe Shoqata e Gjykatësve të Kosovës lidhur me Draftin e Ligjit për Gjykatat, pjesëmarrësit adresuan aq shumë vërejtje në adresë të Ministrisë së Drejtësisë saqë u tha se drafti nuk rregullon as edhe 10 % të problematikës së gjykatave. Kishte edhe mendime se drafti ishte aq i mangët saqë nuk vlente as edhe të diskutohej për të. Mendime të këtilla

shfaqën edhe Gjyqtarët e edhe avokatët (Buletini i Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës, nr.15., 2007:3)

5.3.3. Implementimi i Rregulloreve të UNMIK-ut

Rregulloret e UNMIK-ut edhe pse janë nxjerrë në për një kohë shumë të shkurtër dhe janë treguar efikase në krijimin e shpejtë të infrastrukturës ligjore për shkak të mënyrës së nxjerrjes së tyre, kjo gjë nuk mund të thuhet edhe për implementimin e tyre. Në përgjithësi rregulloret e nxjerra kanë treguar vështirësi në implementimin e tyre sepse ato me vonesë janë bërë të njohura për zbatuesit e ligjit dhe publikun në përgjithësi dhe kjo për shkak të mos publikimit të tyre dhe të mos shpërndarjes në mënyrë adekuate.

Sa i përket problemit të publikimit UNMIK-u ka bërë të njohur një gazetë zyrtare në Ueb-faqen e tij në të cilën edhe ka publikuar rregulloret e nxjerra dhe udhëzimet administrative dhe kjo ka qenë e qasshme përmes internetit pa kufizime. Por shtrohet pyetja se a ka prodhuar kjo efektet e duhura në Kosovë? Përgjigjja do të ishte se megjithëse formë e avancuar teknologjike dhe lehtësisht e qasshme efektet e saja kanë qenë të pakta. Kjo për shkakun se, në kushtet e pas luftës në Kosovë përvojat dhe mundësitë e juristëve por edhe të publikut të gjerë me teknologjinë e internetit kanë qenë të vogla e po ashtu mund të thuhet se e njëjta gjë vlen edhe për kompjuterët personal pasi që ata në atë kohë paraqisnin një luks për shumicën e kosovarëve. Kështu, me gjithë ekzistimin e kësaj gazete zyrtare në internet, UNMIK-u ka dështuar që të tërheqë lexuesit dhe t'ua ofrojë atyre atë. Ato nuk kanë qenë të arritshme për personat që nuk kanë pasur qasje në internet (Raporti i Shtatë Vjetor i Ombudspersonit në Kosovë 2006-2007: 19).

Publikimi i gazetës zyrtare në gjuhën shqipe dhe serbe përveç asaj angleze, ka paraqitur problem tjetër dhe vonesat në publikimin e tyre nuk kanë qenë të pazakonta edhe tek rregulloret e publikuara në gjuhën angleze. Përfaqësuesit ligjor shpeshherë kanë shfaqur pakënaqësinë e tyre edhe për shkakun se përkthimet nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe në atë serbe shpeshherë nuk ka qenë korrekt dhe se rregulloret e caktuara nuk e kanë ndarë të njëjtën domethënie në të tria versionet gjuhësore dhe në shumë raste një dispozitë ka pasur një kuptim në gjuhën angleze e një tjetër domethënie në atë shqipe dhe serbe. Vonesat janë theksuar po ashtu edhe në rastet kur krahas Rregulloreve është dashur që të nxirren edhe Urdhëresat Administrative dhe nxjerrja e këtyre urdhëresave shpeshherë UNMIK-ut i kanë marrë kohë disa muaj apo edhe gati dy vite.

“ Raporti i Shtatë Vjetor i Ombudspersonit thekson se pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut 2001/4 mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë, gati katër vite pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje PSSP kishte shpallë Urdhëresën administrative nr. 2005/3. Qëllimi i kësaj urdhërese në mes tjerash ishte që të sqarojë përgjegjësitë e Koordinatorit për Ndihmë të Viktimave dhe të themelojë fondet për dhënien e ndihmës financiare dhe kompensimit për viktimat e trafikimit”(Raporti i Shtatë Vjetor i Ombudspersonit në Kosovë 2006-2007: 20).

Që të gjitha këto çështje që u theksuan më lartë kanë pasur reflektimet e tyre negative edhe në punën e gjyqësorit të Kosovës. Miratimi i dy Kodeve në prill të vitit 2004 (Kodit Penal dhe atij të procedurës) hapën dilema të mëdha në aplikim dhe një numër i madh i dispozitave u bënë vështirë të aplikueshme. Po ashtu krahas tyre nuk ishte formuar edhe infrastruktura përcjellëse për zbatimin e tyre, si p.sh. policia gjyqësore, ndërmjetësi i pavarur tek procedura e ndërmjetësimit etj. Gjithashtu në këtë kohë nuk mund të flitej për

sigurinë e dëshmitarëve në procedurë, apo një sërë çështjesh u lanë që të rregullohen me ndonjë rregullore tjetër apo Urdhëresë Administrative.

Për më tepër shih shënimin si më poshtë:

Mbrojtja e dëshmitarëve nga kërcënimet apo frikësimi ka qenë dhe mbetet një nga sfidat kryesore për autoritetet e drejtësisë në Kosovë. Përkundër kornizës ligjore dhe përdorimit të shtuar të masave për fshehjen e identitetit, me qëllim të mbrojtjes së dëshmitarëve në procedimet gjyqësore, numri i dëshmitarëve që janë treguar të gatshëm të dëshmojnë në gjykatë ende është mjaft i kufizuar (Raporti i OSBE, Siguria dhe mbrojtja e dëshmitarëve në Kosovë: vlerësim dhe rekomandime, nëntor 2007: 43).

Tek procedura penale ndaj personave me të meta mendore, sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, kjo procedurë është paraparë që të rregullohet me ligj të veçantë, ndërsa pas nxjerrjes së dy kodeve ky vakum juridik në këtë kohë është plotësuar me nxjerrjen e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/34,” Mbi procedurën penale ku përfshihen kryes me çrregullime mendore (Haxhaj, 2008:43).

Në sferën e Ligjit civil në këtë kohë po ashtu kishte probleme dhe nuk ishte bërë kompletimi i infrastrukturës ligjore konform nevojave që koha i kërkonte. Ligji i Procedurës Kontestimore i ish-federatës jugosllave i vitit 1977, vazhdoi të jetë i aplikueshëm edhe në periudhën e administrimit të Kosovës nga Kombet e Bashkuara. I tillë kishte mbetur edhe Ligji i procedurës jokontestimore edhe pse ishin nxjerrë ligjet e reja që bazoheshin në të, siç janë Ligji mbi trashëgimin dhe Ligji Për Familjen etj. Edhe pse është bërë nxjerrja e Ligjit për trashëgimin me këtë ligj nuk është rregulluar edhe procedura e

shqyrtimit të trashëgimisë. Këto çështje procedurale në këtë kohë edhe më tutje kanë vazhduar që të rregullohen me Ligjin (e vjetër) të procedurës jashtëkontestimore.

Me rastin e implementimit të ligjeve në Kosovë në raste të caktuara ka ndodhur që një ligj edhe pse i aprovuar të mos mund të zbatohet sepse institucionet për zbatimin e tij nuk kishin qenë të formuara ose janë formuar me shumë vonesë. Në mungesë të *vacatio legis* Rregulloret e UNMIK-ut dhe Ligjet e Kuvendit në këtë kohë hyjnë në fuqi pavarësisht kohës së miratimit në momentin e nënshkrimit nga PSSP. *Vacatio legis* është periudha e caktuar kohore në mes të shpalljes së ligjit dhe zbatimit të tij, që ka për qëllim t'i jap publikut dhe institucioneve kompetente për zbatimin e ligjit, mundësinë për t'u përshtatur dhe përgatitur për situatat e reja ligjore. Si pasojë e kësaj shumica e institucioneve nuk ishin të gatshme për to dhe institucionet e rëndësishme formoheshin disa muaj apo vite pas themelimit të tyre në letër. Raporti i Shtatë Vjetor i Ombudspersonit 2006-2007 përmend një varg rastesh ku ligji nuk mund të zbatohet për shkakun se nuk ishin formuar institucionet si p.sh. Rregullorja e UNMIK-ut 2001/4 Mbi ndalimin e trafikimit me njerëz ku gati katër vite me vonë PSSP nxjerr Urdhëresën Administrative nr. 2005/3 me të cilën sqaron kompetencat e Koordinatorit për Ndihmë të Viktimave, pastaj tek Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/36 e shpallur në qershor 2006 për dhënien e ndihmës juridike për të cilën mund të themi se për gati dy vite nuk ka filluar aplikimi në praktikë i saj (Raporti i Shtatë Vjetor i Ombudspersonit në Kosovë 2006-2007: 24).

“Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2004/34, Mbi procedurën penale ku përfshiheshin kryes me çrregullime mendore në pjesën ku bëhej fjalë për çështjet e ekzekutimit të masave për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik (me nenin 16) është përcaktuar organi i cili ishte i obliguar që t'i zbatoj këto masa të cilat i ka shqiptuar Gjykata

ndaj kryesve të veprave penale me çrregullime mendore. Sipas rregullores këto masa të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim i ekzekuton institucioni i kujdesit shëndetësor që ndodhet në vendbanimin e përhershëm apo në vendqëndrimin e të pandehurit ose në institucionin më të përafërt me vendin ku i pandehuri e ka vendbanimin. Gjykatat në punën e vet janë të ballafaquara me këtë problem sepse Kosova në këtë kohë nuk kishte institucion të posaçëm shëndetësor për ekzekutimin e këtyre masave, sidomos, masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim. Në një gjendje të këtillë gjykatat kanë qenë të shtrënguara që këto masa të ia besojnë Klinikës së Psikiatrisë pranë Qendrës Klinike Universitare në Prishtinë”.

Në Gjykatën Komunale në Klinë, ndaj një personi me çrregullime mendore gjykata ka shqiptuar masën Trajtim i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor (trajtim i detyrueshëm psikiatrik me ndalim) dhe personi ishte dërguar në Klinikën e Psikiatrisë në Prishtinë. Këta persona liroheshin vetëm pas dy apo tri ditësh. Në këtë kohë edhe gjykatat e tjera ballafaqoheshin me probleme të kësaj natyre (Gjykata Komunale në Klinë, Rasti gjyqësor P.nr.306/2006).

Që të gjitha këto kanë shkaktuar vështirësi në implementimin e ligjit në Kosovë dhe kanë pasur reflektimet e tyre në punën e gjykatave dhe procesit të rregullt gjyqësor në përgjithësi.

5.3.4. Problemet lidhur me zbatimin e ligjeve të aplikueshme në

Kosovë para Marsit 1989 dhe pas Marsit 1989

Ligjet e aplikueshme në Kosovë para 22 marsit 1989 dhe pas marsit 1989 paraqitën problem të veçantë në punën e sistemit gjyqësor të Kosovës gjatë kohës së administrimit të UNMIK. Data e 22 marsit 1989 shënon datën kur Kosovës i është marrë me dhunë autonomia nga ana e Serbisë. Pas heqjes së autonomisë, pushteti okupues serb nxori një varg ligjesh diskriminuese.

Po të shikohen ligjet e ish RSFJ-së ato kishin për qëllim që t'i shërbenin sistemit socialist vetëqeverisës të Jugosllavisë, si në aspektin teorik e po ashtu edhe në aplikimin praktik të tyre (Jashari, 2007: 96). Në kushtet e tilla të zbatimit të ligjit në Kosovë ka ngjarë që një ligj edhe pse në situata të caktuara ka qenë i aplikueshëm, institucioni të cilit i referohet dispozita nuk ekziston fare, apo as që ka institucione të ngjashme me to.

Ligjet e tilla bartin në vete terminologji të emërtimeve të institucioneve që kanë qenë funksionale për kohen të cilës i referoheshin këto ligje siç janë Organizatat e Punës së Bashkuar (OPB), Bashkësitë Vetëqeverisëse të Interesit (BVI-te), Organizatat Shoqëroro-Politike (OSHP) etj, të cilat emërtime për aplikuesit e ligjit të cilët edhe kanë punuar para heqjes së autonomisë së Kosovës kanë qenë të njohura por që për aplikuesit ligjor të pas kësaj kohe janë çështje vështirë të kuptueshme dhe si të tilla këto dispozita kanë paraqitur vështirësi që të përshtaten për aplikim. Që të aplikoheshin ato në mënyrë të suksesshme duhej që të zhvisheshin nga çdo gjë që ishte e lidhur me socializmin.

“Edhe me tutje në fuqi vazhdoi që të jetë Ligji i marrëdhënieve të detyrimeve (LMD)

tek i cili në nenin 103 par 1- nuliteti i kontratave, thuhej: 1) Kontrata që është në

kundërshtim me parimet e përcaktuara me kushtetutë të rregullimit shoqëror, e dispozitat e detyrueshme apo me moralin e shoqërisë vetëqeverisëse socialiste, është nul, në qoftë se qëllimi i rregullës së shkelur nuk përcjell ndonjë funksion tjetër apo në qoftë se ligji në rastin e caktuar nuk parashikon diçka tjetër...”.

Edhe ligjet e aplikueshme të pas marsit 1989 po ashtu paraqitën vështirësi për aplikim. Në radhë të parë Ligjet e tilla për popullatën shumicë të Kosovës ato bartin stigmën e kohës së Milosheviqit dhe për botëkuptimin e krijuar në Kosovë ato ende kujtojnë shijen e hidhur për të cilën gjë edhe shoqëria kosovare ka shfaqur kundërshtimin e fortë të këtyre ligjeve. Dispozitat e këtyre ligjeve, po ashtu, janë parë me rezervë dhe gjyqtarët kanë shfaqur hezitimin e tyre në aplikimin e dispozitave të këtilla. Madje edhe kur ato kanë qenë të favorshme për palët në procedurë në disa raste janë shfaqur dilema për vetë kohën nga e cila duhet të aplikohen.

“Me Ligjin mbi marrëdhëniet themelore pronësore - juridike (Gaz. Zyr.e RSFJ 6/80 në nenin 29 thuhej se mbi sendin në pronësinë shoqërore e drejta e pronësisë nuk mund të fitohet me parashkrimin fitues. Mirëpo, me ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji (Gaz.Zyr. e RFJ 29/96 me nenin 16 të këtij ligji është fshirë neni 29, çka nënkupton se në bazë të këtij ligji (të ndryshuar), e drejta e pronësisë në pronën shoqërore mund të fitohet edhe me parashkrimin fitues. Problemet lidhur me aplikimin e këtij ligji të ndryshuar aplikuesit e ligjit i ka ndarë në dy qasje lidhur me aplikimin e ligjit. Disa mendonin se aplikimi i kësaj dispozite duhet të bëhet në atë mënyrë që llogaritja e kohës së parashkrimit fitues të bëhet nga koha kur kjo dispozitë ka hyrë në fuqi (viti 1996), ndërkaq pjesa tjetër mbronte mendimin se dispozita në fjalë duhet të aplikohet në mënyrë të pa kufizuar dhe atyre poseduesve

të pronës shoqërore (patundshmërive) të cilët me kalimin e afatit kohor të paraparë t'u njihej e drejta e pronësisë (Ligji mbi marrëdhëniet themelore pronësore – juridike, neni 28 par 2)''.

Për më tepër shih shënimin si më poshtë:

Sipas nenit 28 par 2 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore pronësore - juridike mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm mbi të cilin tjetri e ka të drejtën e pronësisë, e fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 10 vite (parashkrimi relativ), kurse sipas nenit 28 par 4 të të njëjtit ligj mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm mbi të cilin tjetri e ka të drejtën e pronësisë, e fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vite (parashkrimi absolut). Për të fituar të drejtën e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues (mbajtjes) duhet që të plotësohen në mënyrë kumulative tri kushte themelore: ndërgjegjshmëria, posedimi dhe kalimi i kohës së caktuar (fides, possessio dhe tempus).

Kështu me rastin e aplikimit të këtyre ligjeve, në këtë kohë nuk ekzistonte ndonjë listë e qartë se cilat ligje ishin diskriminuese ose jo. Gjyqtarëve u kishte mbetur që vetë të vlerësojnë se cilat ishin diskriminuese dhe të mos bëjnë aplikimin e tyre. Nga shumë dispozita të tyre shihet qartë se ligjet e tilla ishin të destinuara që të përmbushnin interesat qoftë të RFJ (Federatës, Serbi-Mali i Zi) apo të Serbisë për Kosovën, sesa të vetë shoqërisë kosovare.

5.3.5. Gjyqtarët ndërkombëtar në gjyqësorin e Kosovës nën administrimin e UNMIK dhe ndikimi i tyre në procesin e rregullt

Përfshirja e gjyqtarëve ndërkombëtar në sistemin gjyqësor të Kosovës në fillim ishte konsideruar arritje e madhe e UNMIK-ut. Gjykatësit ndërkombëtar ishin angazhuar në rastet që përfshijnë krimet e luftës, krimin e organizuar, dhunën ndëretnike, korrupsionin etj. Ky mekanizëm në gjyqësorin e Kosovës u përcoll me nje sërë mangësish.

Angazhimi i tyre ishte i dëmshëm për pavarësinë e gjyqësorit për disa arsye: E para, gjyqtarët ndërkombëtarë nuk punuan si staf i gjykatës në të cilën ata u angazhuan, por si staf i UNMIK-ut dhe në njëfarë mënyre ata përbënin stafin extra-gjyqësor të caktuar nga UNMIK-u. Kjo edhe nënkuptonte se ata i përgjigjeshin UNMIK-ut e jo edhe gjykatës në të cilën ata ishin të angazhuar. E dyta, gjyqtarët ndërkombëtar gëzonin imunitet nga juridiksioni dhe ligjet e Kosovës dhe kjo u mundësonte atyre që të kenë një pozitë shumë të favorshme në krahasim me stafin tjetër vendor të gjykatës. Në këtë mënyrë ata nuk mund të merreshin në përgjegjësi qoftë për shkelje profesionale apo etike dhe nuk ekzistonte ndonjë mekanizëm për këtë çështje. E treta gjyqtarët ndërkombëtar janë emëruar nga UNMIK-u dhe vazhdimi i kontratave të tyre varej nga UNMIK-u përkatësisht nga dega ekzekutive e UNMIK-ut që ishte Departamenti i Drejtësisë dhe përfundimisht nga PSSP-ja. Kjo ka ndikuar në ndikimin e ekzekutivit në pavarësinë e gjyqësorit.

Në shkurt të vitit 2002, OSBE-ja kishte rekomanduar një sistem përmes të cilit një organ i pavarur do të vendoste mbi zgjatjen e kontratave për gjyqtarët ndërkombëtarë, kjo zgjatje e kontratave duhej që të bëhej jashtë autoritetit të Departamentit të Drejtësisë dhe

PSSP-së dhe duhej që ti dorëzohej Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës (KGJPK). Po ashtu gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar duhej që të jenë objekt i të njëjtit mekanizëm të llogaridhënies dhe llogaridhënia lidhur me procedurën disiplinore duhej që t'i dorëzohej KGJPK-së (OSBE- Misioni në Kosovë, *Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë 1999-2006*: 59). Në anën tjetër që çështja e emërimit të gjyqtarëve ndërkombëtar duhej të ishte edhe më transparente ka mendime se kjo çështje do të duhej që të përfshijë jo vetëm PSSP-në, por edhe një organ tjetër të pavarur të jashtëm siç është Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, siç ka qenë e përfshirë në procedurën e riemërimit të Panelit Këshillëdhënës për të drejtat e njeriut pranë UNMIK-ut. Po ashtu duhet të ekzistojë një organ i specializuar i pavarur i cili do të merrej me ankesat në lidhje me Sjelljet e Pahijshme të gjykatësve ndërkombëtar (Raporti i Shtatë i Ombudspersonit në Kosovë 2006-2007: 26).

Kur jemi te çështja e vazhdimit të kontratave, në një numër të rasteve gjyqtarët ndërkombëtarë kishin lëshuar misionin para përfundimit të gjykimeve të filluara. Në rastet e tilla ose është dashur që të bëhet ndërrimi i trupit gjykues ose gjykimet është dashur që të bëhen nga fillimi. Kjo ka vënë në komprometim administrimin e drejtësisë, ka shkaktuar vuajtje të panevojshme për dëshmitarët të cilët është dashur që të dëshmojnë sërish në gjyq dhe përfundimisht ka ndikuar në të drejtën e të pandehurit për një gjykim të drejtë (Raporti i Shtatë i Ombudspersonit në Kosovë 2006-2007: 60)

Një çështje tjetër në të cilën janë vërejtur mangësi tek angazhimi i gjyqtarëve ndërkombëtarë është mungesa e kriterëve transparente në procedurat për caktimin e rasteve gjyqësore. Kështu, në mungesë të këtij mekanizmi lëndët u caktoheshin gjyqtarëve ndërkombëtar nga Departamenti i Drejtësisë, pas miratimit të PSSP-së. Në rastin e caktimit

të lëndëve nuk veprohej sipas garancive procedurale të parapara me ligjin vendor përfshirë këtu edhe dispozitat për përjashtim të gjyqtarit nga procesi i caktuar gjyqësor dhe evitimin e njëanshmërisë. Gjyqtarët ndërkombëtarë edhe pse është pritur që tek vendësit të bartin përvojat e tyre, kjo gjatë Misionit të OKB-së në Kosovë nuk është arritur. Përpos rasteve në kolegjet e përbashkëta të gjykimit, nuk është vërejtur një bashkëpunim ndërmjet ndërkombëtarëve dhe vendorëve. Tek vendorët në disa raste ekziston mendimi se përkundër ekzistimit të profesionistëve të mirë nga ndërkombëtarët, gjatë këtij misioni kishte edhe të atillë që në biografinë e tyre nuk reflektonin ndonjë arritje të dukshme profesionale dhe se nga shtetet e ndryshme, në Kosovë nuk ishin dërguar nga më të mirët përfaqësues ligjor e me këtë edhe nga gjyqtarët. Në këtë aspekt më së miri tregon rasti i Bedri Zyberajt i cili edhe pse i ishte shqiptuar dënimi prej 7 vitesh heqje lirie nën akuzat për krime lufte më datën 10.08.2006 nga ana e një trupi gjykues të përbërë nga gjyqtarë ndërkombëtar, atij nuk i ishte përpiluar aktgjykimi me shkrim edhe pse ndodhej në vuajtje të dënimit dhe kishte mbajtur veç dy të tretat e tij (Gazeta ditore, *Infopress*, 2008- Artikulli “*Antidrejtësia*”, 17 janar).

5.3.6. Gjyqtarët vendor në gjyqësorin e Kosovës nën administrimin e UNMIK dhe ndikimi i punës së tyre në procesin e rregullt

Sistemi i gjykatave të rregullta në Kosovë nën administrimin e UNMIK-ut, përbëhej nga 25 gjykata komunale, 5 gjykata të qarkut, Gjykata Ekonomike e Qarkut dhe Gjykata Supreme. Për sa i përket gjykatave të kundërvajtjeve Kosova kishte Gjykatën e Lartë për

kundërvajtje dhe 25 gjykata komunale për kundërvajtje. Në këto gjykata sipas të dhënave statistikore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për muajin korrik 2007 në gjyqësi ishin 322 pozita gjyqësore me 301 gjyqtarë në detyrë dhe atë 13 gjyqtarë në Gjykatën Supreme, 4 gjyqtarë në Gjykatën Ekonomike, 5 gjyqtarë në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje, 49 gjyqtarë në gjykatat e qarkut, 141 në gjykatat komunale dhe 89 gjyqtarë në gjykatat për kundërvajtje (ABA Rule of Law Initiative, *Indeksi i Reformës Gjyqësore në Kosovë*, Vëllimi III, 2007: 7).

Figurën e gjykatësit vendor në sistemin gjyqësor nën administrimin e UNMIK-ut e ka përcaktuar Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë e cila përcakton se “ *Gjykatësit e të gjitha gjykatave të Kosovës do të jenë juristë të dalluar me karakterin e lartë moral, me kualifikimet përkatëse. Anëtarësia e gjyqësorit do të reflektojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës*”(Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 *Për Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë*, pika 9.4.7).

Pas përfundimit të periudhës së Sistemit Emergjent Gjyqësor është formuar Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës i cili bënte propozimin e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të cilën listë e miratonte Kuvendi i Kosovës e më pastaj kandidatët emëroheshin nga PSSP.

Urdhëresa administrative nr. 2006/20 Mbi Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr.2005/52 Mbi Themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka paraparë dispozita lidhur me kompetencën e Këshillit Gjyqësor që të shpallë Kodin e Etikës për Gjyqtarë dhe Gjyqtarë porotë, dispozita lidhur me hetimin disiplinor si dhe procedurat para Njesisë së Inspektimit Gjyqësor dhe Komisionit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor. Kjo Urdhëresë

administrative ka përcaktuar edhe sjelljen e pahijshme të një gjyqtari apo gjyqtari porotë dhe ajo ishte:

- Kryerja e një vepre penale ose kryerja e një kundërvajtje që nuk ishte në përputhje me detyrimin e gjyqtarit apo gjyqtarit porotë të ruajë standardet e larta morale dhe integritetin etik;
- Mospërfillja e funksioneve gjyqësore;
- Veprimi i papërshtatshëm me detyrimin e gjyqtarit për të qenë i pavarur dhe i pa anshëm;
- Çdo shkelje e Kodit të mirësjelljes;
- Mosveprimi në përputhje me vendime e urdhra të nxjerrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2005/52 Mbi Themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; ose
- Dhënia e informatave të rrejshme, mashtruese apo jo të plota për çdo çështje brenda kompetencës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përfshirë edhe një aplikacion për t'u emëruar si gjyqtar apo gjyqtar porotë, gjatë kërkesës për avancim apo në kontekst të çështjeve disiplinore (Urdhëresa Administrative nr. 2006/20 Mbi Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/52 Mbi Themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës).

Pozita e gjyqtarëve vendor në Sistemin Gjyqësor nën administrimin e Kombeve të Bashkuara dallonte shumë nga ajo e gjyqtarëve ndërkombëtar. Ndonëse në fillim u mendua se megjithë proklamimet për investime të mëdha në gjyqësi, gjyqësori do të ketë pozitë më të avancuar, kjo gjë nuk ndodhi. Edhe pse si kompetencë e rezervuar, pozita materiale e gjyqtarëve nga ndërkombëtarët u trajtua si çështje e vendorëve, kurse nga vendorët si

kompetencë tejet e rezervuar e UNMIK-ut. Gjyqtarët vendor u trajtuan si edhe të gjithë shërbyesit e tjerë civil të thjeshtë të Kosovës dhe patën edhe një pozitë shumë më të dobët se sa punonjësit e tjerë të Qeverisë apo të Kuvendit të Kosovës. Gjyqtarët përveç pagës së tyre ishin të privuar nga çdo e ardhur tjetër që buronte nga puna e tyre dhe ishin të privuar edhe nga kushtet e tjera si nuk u sigurohej udhëtimi deri në vendet e tyre të punës, pagesa e ushqimit, pastaj kushtet në punë etj. Si pasojë e kësaj gjyqtarëve edhe u ka ndodhur që gjatë kthimit për në shtëpi pas kryerjes së seancës gjyqësore të udhëtojnë në të njëjtin mjet udhëtimi urban të qytetit me të pandehurin që më parë e kishte pasur në seancën gjyqësore. Rasti ka ndodhur në vitin 2006 në Prishtinë kur një gjyqtarë i Gjykatës së Qarkut gjatë kthimit për në shtëpi pas mbarimit të orarit të punës ishte ndodhur në të njëjtin mjet udhëtimi urban me të pandehurin.

Pagat e gjyqësisë ishin më të ulëta se sa pagat e zyrtarëve të lartë të degës së legjislativit dhe të ekzekutivit edhe pse formalisht thuhej se këto dy tri pushtete janë të barabarta. Pagat e gjyqtarëve në këtë kohë mbesin më të ulëta se pagat e juristëve të zakonshëm në cilëndo ndërmarrje publike apo edhe dy here më të ulëta se sa një përkthyes i thjeshtë në UNMIK, OSBE, e edhe dyfish më të ulëta se të një punëtori me përgatitje të mesme shkollore të punësuar në ndërmarrjet publike si KEK-u, Aeroporti, Postë-Telekomi etj. Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Shoqata e Gjykatësve të Kosovës në këtë kohë kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me nevojën për të rritur pagat me qëllim të tërheqjes dhe mbajtjes së gjyqtarëve të kualifikuar. Puna në sektorin privat është parë si shumë më dobiprurëse se sa emërimet e tyre në gjyqësi. Ato nuk ishin rritur që nga viti 2002 kurse gjyqtarët pagat e tyre i shihnin si pasqyrim i mungesës së respektit të shoqërisë për gjyqësi (ABA Rule Initiative, *Indeksi i Reformës Gjyqësore në Kosovë, 2007: 34*). Ndonëse

gjyqtarët konsiderohen në këtë kohë si “person zyrtarë i lartë”, në të cilin emërtim përfshihen edhe Presidenti i Kosovës, Kryeparlamentari, Kryeministri, ministrat, zëvendësministrat, sekretarët permanent të ministrave etj, gjyqtarët nuk u konsideruan si persona të lartë zyrtarë edhe në barazimin në paga me këto kategori e as të paktën as edhe me përafrimin e tyre me to.

“Çështja e pagesës së drejtë dhe adekuate është me rëndësi, për arsye se mund të ndihmojë t’i tërheqë për pozitën e gjykatësit, personat e kualifikuar dhe gjithashtu mund t’i bëjë gjykatësit më të qëndrueshëm ndaj përpjekjeve për t’i korruptuar apo edhe ndikimeve politike ose ndikimeve të tjera të papërshtatshme. Në disa vende pagat e gjykatësve janë të mbrojtura nga ulja e tyre. Aty ku ekzekutivi dhe legjislativi kontrollojnë buxhetin e gjyqësorit, mund të ekzistojë një rrezik potencial për pavarësinë e këtij të fundit”(HUMAN RIGHTS IN THE ADMINISTRATION OF JUSTICE: A Manual on Human Rights for Judges, Prosecutors and Lawyers, 2002: 130).

Sa i përket **imunitetit të gjyqtarëve** ndonëse ligji në fuqi i vitit 1977 e që ishte në fuqi në këtë kohë, parashikonte një imunitet të kufizuar duke përcaktuar se “ një gjyqtar nuk mundet të thirret në përgjegjësi për shkak të mendimit të dhënë në marrjen e vendimit gjyqësor” (Ligji mbi Gjykatat e Rregullta, Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës 21/78 - neni 11), ligjet që u nxorën në këtë kohë ofronin pak udhëzime për të mos thënë aspak përkitazi me imunitetin gjyqësor. Kjo çështje nuk është paraparë as me Kornizën Kushtetuese nuk është paraparë me asnjë rregullore të UNMIK-ut e as në mënyrë specifike nuk është paraparë as me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës.

Siguria e gjyqtarëve në këtë kohë ishte nën çdo nivel. Mund të bëhej fjalë për një lloj sigurie të gjyqtarit sa ishte në vendin e tij të punës, por assesi nuk mund të bëhej fjalë për të pas kryerjes së orarit të punës apo edhe për familjet e gjyqtarëve. Rasti i punonjësve të Gjykatave të Mitrovicës kur çdo here duhej që të shkonin nën përcjellje të forcave të sigurisë deri në punë dhe me rastin e kthimit nga puna dhe rasti i mësipërm i gjyqtarit nga Prishtina e ilustron në mënyrën më të mirë këtë çështje. Gjyqtarët jo rrallëherë janë bërë objekt i kërcënimeve e në disa raste kanë qenë edhe objekt i rrahjeve apo kërcënimit të pasurisë së tyre. Incidentet mund të ndodhnin brenda objektit të gjykatës, në rrugë, gjatë udhëtimit me autobus, mund të bëheshin përmes telefonit dhe mund të vënë në cak gjyqtarin apo anëtarin e familjes së tij (Shih ABA Rule of Law Initiative, *Indeksi i Reformës Gjyqësore në Kosovë*, 2007:35).

“ Rasti i parë i sulmit fizik ndaj gjyqtarit kishte ndodhur në Prizren në vitin 2003 kur fizikisht ishte sulmuar kryetari i atëhershëm i Gjykatës së Qarkut në lokalet e gjykatës. Rasti i grushtimit të gjyqtarit të Gjykatës Komunale në Vushtrri pas shpalljes së Aktgjykimit në zyrën e tij, më datën 14 prill 2008 në mënyrën më të qartë e pasqyron pozitën e gjyqtarit vendor në Kosovë në kushtet e administrimit ndërkombëtar nga ana e UNMIK. Në gjykata ekzistonin punëtorët e sigurimit por në të shumtën e rasteve ata ishin tejet të pa përgatitur për punën e tyre sa që fare nuk ishin në gjendje që t’i ofronin siguri personit zyrtar nga ndonjë e keqe e tillë dhe puna e tyre ishte reduktuar në udhëzimin e palëve për në zyrat përkatëse. Me këtë rast edhe punësimi i personave të sigurimit ishte bërë në suaza të nepotizmit. Nëse gjyqtari mund të sulmohet brenda objektit të gjykatës, atëherë cila është siguria e tij pas përfundimit orarit të punës. Sulmi fizik që i ishte bërë gjyqtarit të Gjykatës

Komunale në Vushtrri mu në zyrën e tij, pas shpalljes së aktgjykimit lidhur me një kontest pronësor. Gazeta Express në një artikull të saj lidhur me sigurinë e gjyqtarëve shkruante se gjyqtarët nuk kanë siguri- vetëm zoti i ruan (Gazeta Express, 2008: "Babë e bir grushtojnë gjyqtarin", 16 prill).

Mandati i gjyqtarëve gjatë Misionit të OKB-së ishte i lidhur me kohëzgjatjen e administratës së UNMIK-ut, me sjelljen e mirë të tyre në punë dhe kryerjen e detyrave të punës si dhe me pensionimin e detyrueshëm në moshën 65 vjeçare. Pas kësaj moshe ish-gjyqtarin e devotshëm dhe ekspertin shumëvjeçar e priste një pension jo i dinjitetshëm. Gjyqtarët në punë kishin një pasiguri për të ardhmen e tyre pasi gjatë tërë kohës së fundit flitej për procesin e riemërimit i cili edhe do të ndodhte më vonë me rastin e përfundimit të Misionit të UNMIK.

Çështjet e **avancimeve** në gjyqësi gjatë kësaj periudhe kanë qenë shumë të paqarta. Në Udhëzimin Administrativ nr.2001/17 për zbatimin e Rregullores së Këshillit Prokurorial Gjyqësor parashihte vlerësimin i cili ishte kryer me qëllim të shikimit të mundësive nga ana e PSSP-së për avancime të gjyqtarëve. Kryetarët e Gjykatave bënë vlerësimin e gjyqtarëve në gjykatat e tyre ndërkaq, kryetarët e gjykatave të shkallës më të lartë bënë vlerësimin kryetarëve gjykatave të shkallës më të ulët. Në këto kushte për shumë gjyqtarë ekziston një mendim se avancimi në gjyqësi nuk është bërë në bazë të përvojës dhe arritjeve profesionale të tyre (ABA Rule of Law Initiative, *Indeksi i Reformës Gjyqësore në Kosovë*, 2007: 40)

Të anketuarit kanë shfaqur pakënaqësi të mëdha për pozitën e gjyqtarit në kohën nën administrimin e Misionit të Kombeve të Bashkuara. Kishte edhe mendime se gjatë

kësaj periudhe kjo pozitë do të kishte qenë edhe shumëfish më e vështirë po të lihej në duart e vendorëve dhe po të veprohej në bazë të preferencave politike siç edhe ka ndodhur me dy pushtetet e tjera (Nga intervista e zhvilluar me gjyqtarët e Gjykatës Komunale dhe ata të Gjykatës së Qarkut në Pejë, qershor, 2012).

5.3.7. Gjykatat paralele në Kosovë gjatë kohës së administrimit të UNMIK

Dështimet e UNMIK-ut dhe IPVQ-ve që të shtrijnë funksionimin e tyre efikas në tërë territorin e Kosovës si dhe të bëjnë shpërbërjen e strukturave paralele të Serbisë në pjesët e ndryshme të Kosovës, mundësoi që edhe në lëmin e gjyqësisë të paraqiten paralelizma. Këto gjykata vepronin nëpër enklavat serbe, drejtoheshin nga serbët etnik dhe vazhduan që të veprojnë pa autorizimin e UNMIK-ut. Në këtë mënyrë në Kosovë u lejua që të veprojë një sistem ku këto gjykata paraqiteshin si gjykata të shkallës së parë kurse vendimet e tyre mund të apeloreshin vetëm në gjykatat më të larta të Serbisë. Gjykatat e Serbisë kanë shqyrtuar rastet të cilat janë në kompetencë territoriale të Kosovës dhe përfshinin serbët e Kosovës (ABA Rule of Law Initiative, *Indeksi i Reformës Gjyqësore në Kosovë*, 2007: 8). Këto gjykata punonin kryesisht me ligje të Serbisë. Banorët serbë të Kosovës, kërkesat e tyre mundoheshin që t'i realizonin edhe nëpër të ashtuquajturat gjykata të Kosovës të instaluar në Serbi, p.sh Gjykata Komunale e Ferizajt e vendosur në Leskovc të Serbisë, Gjykata Komunale e Lipjanit e vendosur në Nish, etj (Sahiti, 2003: 52, b).

Paralelizmi i këtyre gjykatave ka qenë gjithnjë pengesë për funksionimin efikas të gjykatave vendore dhe dëmtonte funksionimin e sistemit unik gjyqësor. Kështu këto gjykata bënë vërtetimin e kontratave lidhur me shitblerjet që bëheshin në këtë pjesë të qytetit të Mitrovicës, e ku si shitës ishin shqiptarët, boshnjakët etj e që këto pasuri bliheshin me mjete të qeverisë së shtetit të Serbisë. Kështu, përkundër zotimit të vazhduar politik të administratës ndërkombëtare që çështja e strukturave paralele do të zgjidhej, realiteti në terren dëshmon të kundërtën. Pjesa veriore e Mitrovicës dhe tri komunat e populluara me shumicë të popullatës serbe në veri të Kosovës, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë bastione të administratës paralele të përkrahura nga Beogradi qysh nga vënia e vijës ndarëse përgjatë Lumit Ibër në verë të vitit 1999 (Gazeta, *Koha Ditore* 2008 : “Komunat në pjesën veriore bastione të administratës paralele”, 31 janar).

Ekzistimi i këtyre gjykatave ishte pengesë edhe për vetë pranimin e integritetit të pakicës serbe në sistemin gjyqësor të Kosovës. Indeksi i Reformës Gjyqësore i ABA Rule of Law Initiative (Shoqata e Avokatëve Amerikanë në Kosovë) vlerësonte se ata të cilët pranojnë që të veprojnë në sistemin gjyqësor të Kosovës, ballafaqohen me presione nga familja dhe komuniteti si dhe frika nga kërcënimet. Pjesëtarë nga komuniteti serb që punonin nëpër gjykatat e Kosovës shpesh shiheshin si tradhtarë nga ana e familjes dhe e miqve dhe shpesh mund të kërcënoheshin edhe me ndëshkime. Gjithashtu, serbët që punonin nëpër këto gjykata paralele ishin më të stimuluar financiarisht se sa ata që punonin në gjykatat e UNMIK-ut ngase pagat e gjyqtarëve në Serbi ishin më të mëdha dhe gëzonin edhe pension më të arsyeshëm se sa në sistemin gjyqësor të Kosovës.

Vendimet e këtyre gjykatave nuk njiheshin nga gjykatat e Sistemit Gjyqësor të Kosovës. Ekzistimi i këtyre gjykatave ishin të dëmshme edhe për vetë serbët pasi që ata

detyroheshin që të kalojnë në procedura të dyfishta gjyqësore në gjykatat e Kosovës dhe në gjykatat paralele serbe. Këto çështje në shumicën e rasteve kishin të bënin me çështjet e zgjidhjes së lëndëve në procedurën gjyqësore civile.

Për më tepër shih shënimin si më poshtë:

Ekzistimi i këtyre gjykatave (paralele) ishin të dëmshme edhe për vetë serbët pasi ata detyroheshin që të kalojnë në procedura të dyfishta gjyqësore në gjykatat e Kosovës dhe në gjykatat paralele serbe. Gjykatat paralele në këtë kohë më tepër ishin të angazhuara në kryerjen e çështjeve të lëndëve civile dhe kanë më tepër karakter politik (Intervistë e kryetarit të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës në këtë kohë z Kapllan Baruti, Gazeta Infopress 2008, 17 maj).

5.3.8. Ndërhyrjet në proceset gjyqësore gjatë Misionit të UNMIK

Njëra ndër përgjegjësitë kryesore të Misionit ndërkombëtar në Kosovës ishte ”mbrojtja dhe afirmimi i Lirive dhe të Drejtave të Njeriut”. Korniza Kushtetuese e Kosovës ka përcaktuar se “ të gjithë personat në Kosovë gëzojnë, pa diskriminim të asnjë lloji dhe në barazi të plotë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe se institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes respektojnë dhe sigurojnë standardet e pranuar në arenën ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive të njeriut.”Korniza kushtetuese përcaktonte se IPVQ-të (Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes) respektojnë standardet e pranuar në arenën ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë ato të drejta dhe liri të parashtruara në: Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën Evropiane për

Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e Saj, Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike të Njeriut dhe Protokollet e saj, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Konventën për të drejtat e Fëmijëve, Kartën Evropiane të Gjuhëve Rajonale dhe Minoritare, Kornizën e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare. Edhe Rregullorja e UNMIK-ut mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë ka inkorporuar standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut si të zbatueshme në Kosovë dhe të cilat siç është theksuar edhe më lartë kanë epërsinë e tyre ndaj ligjeve vendore.

Aplikimi i konventave ndërkombëtare për Sistemin Gjyqësor të Kosovës nën administrimin ndërkombëtar ishte një fillim i mbarë drejt një të arriture në respektimin e lirive dhe të të drejtave të njeriut dhe ngritjes së një sistemi gjyqësor drejt përafrimit të sistemeve të përparuara gjyqësore të vendeve demokratike. Ç'është e vërteta, aplikimi i këtyre standardeve fillimisht paraqiti vështirësi për zbatuesit e ligjit qoftë në të kuptuarit qoftë në aplikimin e tyre, kjo për faktin se shumica e gjyqtarëve që filluan të punojnë menjëherë pas krijimit të Sistemit Gjyqësor të cilët kishin punuar edhe më parë në sistemin e kaluar gjyqësor i cili në masën më të madhe kishte bërë kufizimin dhe shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Mirëpo me kalimin e kohës lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut në sistemin gjyqësor u organizuan trajnime mbi zgjerimin e njohurive të përfaqësuesve ligjor në fushën e të drejtave të njeriut dhe kjo në masë të madhe ka ndikuar në vetëdijesimin dhe në heqjen e dilemave rreth mënyrës së aplikimit të këtyre standardeve ndërkombëtare. Si

rezultat i njohurive të tilla edhe në gjykata nxirren vendimet e para të cilat veç bazohen në Konventat ndërkombëtare.

“Gjykata e Qarkut në Prizren në Aktgjykimin e saj Ac.nr.90/2006 të datës 02.03.2007 kishte aplikuar nenin 17 par 1 dhe 2 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut të miratuar dhe shpallur nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën 217 A (III), më 10 dhjetor, 1948. Edhe gjykatat e tjera në Kosovë i kanë mbështetur vendimet e tyre në Konventat ndërkombëtare,” (Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac.nr.90/2006 i datës 02.03.2007).

Gjithashtu në vitet e pasluftës në Kosovë mungonte edhe infrastruktura e përgjithshme për aplikimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Shumë të arrestuarve u janë shkelur të drejtat e tyre nga policët ndërkombëtarë të cilët vinin nga vendet të cilat nuk kishin ndonjë traditë të respektimit të këtyre të drejtave. Gjendja e pas luftës në Kosovë, duke filluar që nga ndalimi i parë në dhomat e ndalimit në stacionet e policisë, të cilat nuk ofronin kushte të mirëfillta për mbajtjen e të ndaluarve, pastaj kushtet në të cilat kanë filluar që të punojnë gjykatat e deri tek vendet e vuajtjes së dënimit për të dënuarit, lënin shumë për të dëshiruar në aspektin e të drejtave të njeriut. Në të vërtetë edhe ligjet në fuqi të një sistemi të kaluar në fushën penale siç ishin Ligji Penal dhe ai i Procedurës Penale nuk mundësonin që të ketë ndonjë përparim të dukshëm në respektimin e të drejtave të njeriut. Këto ligje nuk njihnin të drejta themelore të të arrestuarve dhe të të akuzuarve. E drejta për mbrojtje efikase që nga ndalimi i parë me ligjet e këtilla nuk ishte parashikuar.

Me miratimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës në prill të vitit 2004, të drejtat e të arrestuarve evoluojnë dhe këta persona gëzojnë të drejtën e

rishqyrtimit të ligjshmërisë së paraburgimit si dhe të drejtën e paraqitjes tek gjyqtari brenda 72 orëve. Ligji kundër diskriminimit e bën gjykatën kompetente për të vendosur për rastet e lidhura me diskriminimin dhe ankesat nga rastet e paraqitura para organeve administrative, me kusht që mjetet juridike administrative më parë të jenë shterur (ABA Rule of Law Initiative, *Indeksi i Reformës Gjyqësore në Kosovë*, 2007: 25).

Përkundër këtyre dispozitave UNMIK-u dhe KFOR-i vazhduan që të kenë imunitetin penal dhe civil. Këtë gjë në Kosovë PSSP e kishte sanksionuar me Rregulloren nr. 2000/47 Për Statusin, Privilegjet dhe Imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe Personelit të tyre. Sipas kësaj rregulloreje KFOR-i, prona, fondet dhe pasuritë e KFOR-it, janë liruar nga çfarëdo procesi ligjor. Personeli i KFOR-it sipas rregullores do të respektojë ligjet në fuqi në territorin e Kosovës si dhe rregulloret e lëshuara nga PSSP për aq sa ato nuk janë në kundërshtim me përmbushjen e mandatit që i është dhënë KFOR-it me rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit. Edhe personeli vendës i rekrutuar i KFOR-it, ishte i liruar nga çfarëdo procesi gjyqësor lidhur me veprimet e kryera për siç thuhet gjatë përmbushjes së detyrave të lidhura ekskluzivisht me shërbimin e tyre për KFOR-in. Personeli i KFOR-it ishte i liruar nga juridiksioni i gjykatave vendore dhe personeli i këtillë ekskluzivisht në rast të shkeljes së ligjit do t'i nënshtrohej juridiksionit të shteteve të tyre përkatëse prej të cilave dërgohen. Personeli i KFOR-it ishte i liruar nga çfarëdo forme e arrestit apo e paraburgimit, ndërsa rregullorja parashihte se në rast të arrestimit të personave të këtillë ata menjëherë do të duhej që ti dorëzoheshin KFOR-it (Rregullorja nr. 2000/47 *Për Statusin, Privilegjet dhe Imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe Personelit të tyre*, http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2000regs/RA2000_4... 2013-04-14., nenet 2.1-2.4.)

Edhe UNMIK-u, prona e tij, fondet dhe pasuritë e tij, janë liruar nga çfarëdo procesi ligjor. Të gjitha privilegjet që vlenin për KFOR-in po ashtu me këtë rregullore ishin të sanksionuara edhe për UNMIK-un dhe personelin e tij. Kështu imuniteti dhe privilegjet që gëzonin KFOR-i dhe UNMIK-u së bashku me personelin e tyre në Kosovë nga kritikët janë cilësuar si cenim i pavarësisë së gjyqësorit (OSBE- Misioni në Kosovë, *Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, shtator 2001 – shkurt 2002*: 48).

Në janar të vitit 2005 Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka rekomanduar që UNMIK-u dhe KFOR-i në bashkëpunim me Këshillin e Evropës ta krijojnë Gjykatën për të drejtat e njeriut për Kosovë me kompetencë që të shqyrtojë shkeljet e supozuara të të drejtave të garantuara me KEDNJ duke përfshirë ndër të tjera edhe këto të cilat janë kryer nga KFOR-i dhe UNMIK-u, mirëpo një gjykatë e këtillë asnjëherë nuk është formuar (ABA Rule of Law Initiative, *Indeksi i Reformës Gjyqësore në Kosovë*, 2007: 25). Në mungesë të kësaj PSSP në mars të vitit 2006 themeloi të ashtuquajturin Panel Këshillëdhënës mbi të drejtat e njeriut brenda UNMIK-ut, në pajtueshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të drejtat e njeriut. Anëtarët e këtij paneli emëroheshin nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe emërohen nga PSSP-ja (Raporti i Shtatë Vjetor i Ombudspersonit 2006-2007: 37). Sado që shihet si një përparim në këtë fushë Paneli Këshillëdhënës për të drejtat e njeriut prapë se prapë ishte një organ këshillëdhënës brendapërbrenda UNMIK-ut dhe në fund të fundit si pjesë e UNMIK-ut nuk paraqiste një mekanizëm të pavarur.

Sa i përket gjyqësorit dhe raportit të vetë punës së tij me të drejtat e njeriut mund të thuhet se kishte edhe raste kur të drejtat e këtilla shkeleshin nga kolegjet ndërkombëtare, pastaj edhe kishte raste kur të drejta të këtilla shkeleshin edhe nga trupat gjykuese vendore.

Kjo në numrin më të madh të rasteve ndodhte në vonesën e caktimit të lëndëve për shkak të mbingarkesës me lëndë nëpër gjykata si dhe numrit të vogël të gjyqtarëve në krahasim me numrin e lëndëve apo edhe hartimit me shkrim të Aktgjykimit duke i mohuar kështu të drejtën e të dënuarve që të shfrytëzojnë mjetet përkatëse të ankimit.

“Bedri Zymberaj ishte gjykuar nga një trup gjykues ndërkombëtar në Gjykatën e Qarkut të Prizrenit me 7 vite burgim, nën akuzat për krime lufte. Shpallja e Aktgjykimit i ishte bërë më datën 10.08.2006 dhe i gjykuari ishte dërguar në Burgun e Dubravës (Istog) për vuajtje të dënimit. Të gjykuarit i ishte mohuar e drejta në ankesë kundër këtij Aktgjykimi pranë Gjykatës Supreme të Kosovës sepse nuk i ishte dorëzuar aktgjykimi i përpiluar me shkrim. Përveç të drejtës në ankesë atij i ishte mohuar edhe e drejta e parashtrimit të kërkesës për zbutje të dënimit sepse i kishte mbajtur dy të tretat e dënimit. Në një gjendje të këtillë i gjykuari i ishte drejtuar me një letër kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Prizren duke kërkuar nga ai që të zgjidhej problem i përpilimit me shkrim të Aktgjykimit. Në përgjigjen dërguar të gjykuarit Bedri Zymberaj, kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prizren pasi kishte deklaruar se me këtë rast janë shkelë dispozitat ligjore nga neni 395 të Kodit të Procedurës Penale (mbi përpilimin me shkrim dhe dorëzimin e Aktgjykimit) dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut(KEDNJ) për një gjykim korrekt dhe brenda një kohe të arsyeshme, kishte konstatuar se pavarësisht prej parashtrësës së të gjykuarit për të cilën i gjykuari kishte të drejtë sepse aktgjykimi nuk i ishte dorëzuar me kohë, edhe pse ai vetë si kryetar i gjykatës insiston që vendimet të përpilohen me kohë, në rastet që i menaxhojnë gjyqtarët ndërkombëtar nuk ka mundësi të mëdha për ndikim në këtë aspekt”(Letër-përgjigje e kryetarit të

Gjykatës së Qarkut në Prizren z. Ymer Hoxha, nr. I. Agj.nr.1/07 -125 e datës 23.11.2007 dërguar të gjykuarit Bedri Zymberaj në Burgun e Dubravës (Istog); Gazeta ditore "Infopress: 2008, 14 qershor).

Raste të vonesës së përpilimit me shkrim të aktgjykimit kishte edhe nga trupat gjykuese vendore.

"Në një rast lidhur me një kontest prone në një gjykatë komunale aktgjykimi ishte shpallur më datën 16 shkurt 2005 kishin kaluar shtatë muaj derisa palët në procedurë kishin pranuar aktgjykimin me shkrim. Kjo bie ndesh me nenin 337 të Ligjit të Procedurës Kontestimore i cili përcakton se një aktgjykim duhet të bëhet me shkrim brenda afatit prej tetë ditësh nga dita kur është shpallur", (Raporti i Shtatë Vjetor i Ombudspersonit 2006-2007: 12)

Ndër çështjet më të rëndësishme në lëmin e të drejtave të njeriut të cilat në gjyqësinë e Kosovës trajtohen edhe si cenim i pavarësisë së gjyqësorit janë Paraburgimi nga ana e KFOR-it të njohura si "Mbajtjet COMKFOR" si dhe zgjatja e paraburgimit në bazë të të ashtuquajturave *Urdhra ekzekutiv* të PSSP-së. Këto dy forma të paraburgimit konsiderohen se bëheshin pa bazë ligjore, përbënin shkelje të konventave ndërkombëtare dhe paraqisnin cenimi të pavarësisë së gjyqësorit. Kjo mënyrë e ndalimit, konsiderohet si ndërhyrje të ekzekutivit në punët e gjyqësisë. Në këtë kohë kanë ekzistuar edhe forma të nxjerrjes së akteve ligjore nga ana e legjislativit, me qëllim të ndryshimit të rrjedhës së çështjeve të cilat në procedurë gjyqësore e që njihen si ndërhyrje nga ana e këtij pushteti, në pavarësinë e gjyqësorit.

5.3.8.1.Paraburgimet nga KFOR-i

Rastet e paraburgimit nga ana e KFOR-it paraqisnin ato raste kur personat e caktuar mbaheshin në paraburgim jashtëgjyqësor në Qendrën e Paraburgimit në Bondstill (kampi ushtarak të forcave amerikane të KFOR-it në Ferizaj, Kosovë) pa kurrfarë baze ligjore dhe pa ndonjë mundësi të shqyrtimit të rastit të tyre të paraburgimit nga ndonjë organ gjyqësor. Si bazë për paraburgimet e tilla, KFOR-i konsideronte se është i autorizuar që të bëjë paraburgimin e personave në atë mënyrë që të mbështes një *“mjedis të sigurve”* në Kosovë, përderisa *“autoritetet civile nuk janë në gjendje apo nuk kanë vullnet për të marrë përgjegjësi për këtë çështje”*(Urdhëresa 42 e KFOR-it, Pjesa 4/a). Kriteri për mbajtje në paraburgimet e zgjatura nga KFOR-i, ishte se *“personi në fjalë paraqet kërcënim për një ambient të qetë dhe të sigurt”* dhe se KFOR-i beson se ka një fuqi ligjore në bazë të autorizimeve që i jepeshin me Rezolutën 1244, të ruan një ambient të qetë dhe të sigurt në Kosovë e po ashtu relevante në këtë kontekst ka qenë edhe Marrëveshja Tekniko-Ushtarake e vitit 1999 (OSBE- Misioni në Kosovë, *Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë 1999-2006: 40*).

Që të gjithë të paraburgosurit nga ana e KFOR-it mbaheshin në Bonstill të KFOR-it Amerikan, edhe kontingjentet e tjera të KFOR-it i transferonin të paraburgosurit në këtë kamp dhe ua dorëzonin KFOR-it amerikan. Kjo donë të thotë se KFOR-i zbatonte politikën e paraburgimit të personave si tërësi dhe jo vetëm nga KFOR-i Amerikan dhe se për këtë kishte edhe përkrahjen e Shtabit Suprem të Forcave Aleate në Evropë– SHSFAE. KFOR-i vlerësonte se kjo ishte e domosdoshme fillimisht për shkak të vështirësive të krijimit të sistemit gjyqësor dhe të policisë, si dhe për shkak të situatës në Luginën e Preshevës dhe në

IRJ të Maqedonisë (Në Letrën të cilën COMKFOR ia dërgon Shefit të Misionit të OSBE-së të datës 6 shtator 2001, përmend këto arsye; OSBE- Misioni në Kosovë, *Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë 1999-2006: 40*).

OSBE në raportin e saj Shqyrtimi Tematik i Gjyqësisë Penale në Kosovë –Tetor 2001 kishte theksuar se personat që mbaheshin në Bonstill ndaheshin në katër kategori. Së pari, ata janë persona për të cilët KFOR-i beson se kanë kryer vepra penale në Kosovë ose jashtë Kosovës, por, për të cilët KFOR-i mendon që sistemi gjyqësor i Kosovës nuk është në gjendje që t'i gjykoj drejtë dhe objektivisht (provat kundër tyre mund të jenë të ndjeshme). Së dyti, ata persona janë paraburgosur vetëm për arsye të qarta të parandalimit pasi që mund të paraqisnin kërcënim për paqen dhe sigurinë. Së treti, ata persona ishin të dyshimtë se kanë kryer vepra penale dhe të cilët eventualisht janë dorëzuar – ose menjëherë ose pas arrestimit ose më vonë, sistemit të gjyqësisë penale; dhe së katërti janë personat që mbaheshin në paraburgim gjyqësor dhe që për arsye sigurie ose për ndonjë arsye tjetër mbaheshin në kampin Bonstill.

Ndër arsyet tjera përveç atyre të cekura më lartë për paraburgim nga ana e KFOR-it ishin edhe ato se sistemi gjyqësor në Kosovë në këtë kohë ende nuk ishte i aftë që të merrej me llojet e rasteve që kërkonin paraburgimet nga ana e KFOR-it dhe se informatat ushtarake dhe inteligjenca nuk mund të shkonin së bashku me zyrtarët e sistemit gjyqësor qofshin ata edhe ndërkombëtar. KFOR-i mendonte se më rastet e inteligjencës ushtarake e cila shërben si bazë për paraburgim mund të merren vetëm ata zyrtarë të cilëve u jepet drita e gjelbër nga ana e NATO-s.

Në këto raste që u theksuan me lartë mendojmë se personave të paraburgosur nga KFOR-i u ishin bërë shkelje të të drejtave nga neni 5 i KEDNJ : e drejta për të qenë i informuar me arsyet e paraburgimit që nga momenti i arrestimit, si dhe e drejta për t'u sjellë sa më parë para gjykatës si dhe nenit 9 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike (PNDKP) i cili përcakton të drejtën e një individi për t'u sjellë menjëherë para gjyqtarit apo ndonjë zyrtari i cili është i autorizuar me ligj për të ushtruar pushtetin gjyqësor dhe gjithashtu përfshinë të drejtën e individit që të iniciojë procedurë gjyqësore para Gjykatës, në mënyrë që ajo të vlerësojë ligjshmërinë e paraburgimit, dhe të vendos lirin nga paraburgimi nëse ky ka qenë jo i ligjshëm (OSBE- Misioni në Kosovë, *Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë 1999-2006*:56;*Përmbledhje materialesh për Provimin e gjyqtarit për kundërvajtje – Dokumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, janar 2002*: 3).

Përveç çështjeve të cekura më lartë Urdhëresa 42 e KFOR-it i jepte të drejtën edhe Komandantit regjional të KFOR-it pushtet për të paraburgosur personat deri në 72 orë, pa pasur nevojë që për këtë çështje ta informojnë Komandën e KFOR-it, përpos nëse koha e paraburgimit kalonte 72 – orë. Pas kalimit të këtij afati, lidhur me çështjet e paraburgimit dhe kohëzgjatjen e tij vendoste komanda qendrore e KFOR.

\

5.3.8.2.Zgjatja e paraburgimit në bazë të Urdhrave

Ekzekutiv të PSSP-së

Urdhrat Ekzekutiv me të cilat PSSP u bënte zgjatjen e paraburgimit personave të caktuar paraqesin raste më flagrante të ndërhyrjes së ekzekutivit në punët e gjyqësorit. Kjo mënyrë e zgjatjes së paraburgimit u aplikua nga PSSP edhe pse personat që përfshiheshin në paraburgimet e këtilla kishin kaluar nëpër procedurat gjyqësore dhe tashmë ishin liruar. Këtë autoritet ekzekutiv PSSP mund ta ushtronte për të zgjatur paraburgimin e personave të caktuar kur të gjitha rrugët ligjore ishin shteruar.

Që të bëhej lëshimi i urdhrit ekzekutiv duhej që PSSP të vlerësonte:

Së pari, *pesha e rastit* duhej të ishte mjaft e fuqishme dhe kërkonte informata apo dëshmi për mbështetjen e një vendimi të këtillë.

Së dyti, *ekzistimi i bazës* në të cilën duhej të vlerësohej se lirimi i personit të caktuar nga paraburgimi do të shkaktonte rrezik për sigurinë publike duke pasur parasysh peshën e rëndë të veprës për të cilën akuzohej.

Së treti, *baza për të besuar* se intervenimi ekzekutiv është i domosdoshëm për të përmirësuar apo parandaluar manipulimin në ndjekjen penale të rastit nga ana e zyrtarëve të gjyqësisë dhe të tjerëve, e cila mund të sillte deri te shpërdorimet gjyqësore, për shkak të anshmërisë gjyqësore, keqpërdorimit apo problemeve të sigurisë (OSBE- Misioni në Kosovë, *Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë 1999-2006:24*).

Nëse analizohen këto tri çështje atëherë padyshim vihet në përfundim se urdhrat e tillë mbështeteshin në paragjykime të rasteve, çka bie në kundërshtim me parimet që

gjqësori të ndërtohet dhe të veprojë i pavarur jashtë çdo ndikimi nga organet e ekzekutivit. Nëse policia e UNMIK-ut dhe prokuroria e më në fund edhe gjykata nuk gjenin fakte të mjaftueshme që ndaj personave të tillë të ushtronin aktet akuzuese, të mbeteshin në paraburgim etj, atëherë mbetet e pa qartë se si dhe në mbështetje të cilave fakte ose informata PSSP mund të urdhëronte paraburgimin jashtëgjyqësor. Mbetet e pa qartë se cili ishte kriteri matës që personat e tillë do të shkaktonin rrezikimin e sigurisë publike, dhe çka vlerësohej si siguri publike në këto raste. Nëse mund të thuhet se këto urdhra mund të lëshoheshin për të përmirësuar apo parandaluar manipulimin në ndjekjen penale të rastit nga ana e zyrtarëve të gjyqësisë dhe të të tjerëve e cila mund të sillte shpërdorimet gjyqësore, për shkak të anshmërisë gjyqësore, atëherë vërehej se PSSP në këto raste domosdo duhej që të gjente një shkas që të bëjë zgjatjen e paraburgimit. Kjo për faktin më bindës se në rastet e tilla hetimet bëheshin nga policia ndërkombëtare dhe prokuroria ndërkombëtare. E vërteta se lidhur me paraburgimin vendosnin edhe gjyqtarët ndërkombëtar, atëherë vetvetiu del përfundimi se në këto raste PSSP ose UNMIK-u nuk kishte besim të plotë edhe në personelin të cilin vet e emëronte. Në anën tjetër, se sa kishte mbështetje e dhëna se duhej që të parandalohej çfarëdo keqpërdorimi dhe anshmërie nga ana e gjyqësorit atëherë është fare e pakuptimtë që kolegjet ndërkombëtare të kenë fare anshmërie ndaj personave për të cilët ekzistonte dyshimi se mund të ishin kryes të veprave të tilla penale.

Urdhrat ekzekutiv të PSSP-së për zgjatjen e paraburgimit të cilët zakonisht vinin pas vendimit gjyqësor për lirim të personave ndaj të cilëve më parë ishte caktuar paraburgimi, paraqesin shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP). Neni 5 i KEDNJ dhe neni 9 i

PNDKP kanë përcaktuar se një person mund të privohet nga liria e tij ose saj vetëm nën kushtet e përcaktuara me ligj. Urdhrat ekzekutiv nuk kishin mbështetje as në ligjin vendor e as në atë ndërkombëtar. Nuk ka dispozita ligjore të cilat autorizojnë dhe as dispozita ligjore të cilat kufizojnë pushtetin e PSSP-së për të urdhëruar paraburgime të këtilla dhe bazueshmëria e këtyre paraburgimeve nuk është e qartë dhe në anën tjetër nuk mund të kundërshtoheshin me ankesë.

Po ashtu, karakteristike ishte se për paraburgimet e caktuara në këtë mënyrë nuk kishte procedura të cilat në rrugë gjyqësore do të shqyrtoheshin këto paraburgime. Ndërhyrja e ekzekutivit në rastet kur lidhur me personat e tillë gjykata urdhëronte lirimin e tyre nga paraburgimi e PSSP urdhëronte që personat e tillë të paraburgoseshin, ishte një precedent jo i mirë edhe në aspektin e promovimit të respektimit të sundimit të ligjit në Kosovë. Kjo aq më tepër kur me asnjë dokument zyrtar në mënyrë të qartë nuk është përcaktuar se cilat janë arsyet për përdorim të kësaj kompetence të këtij lloji të PSSP-së, dhe cilat janë kufizimet për aplikimin e paraburgimeve të tilla. Nëse thuhej se "PSSP ushtron autoritetin e vet ekzekutiv në rastet kur beson se në të kundërtën një dëm i veçantë apo një padrejtësi mund të pasoj ", atëherë përkufizimi i bërë në këtë mënyrë ishte mjaft i përgjithësuar dhe në vete lente të kuptonte se një urdhër i tillë mund të aplikohet në të gjitha situatat kur PSSP vlerësonte se urdhri mund të aplikohet.

" Rasti i katër të dyshuarve për sulmin me bombë në autobusin e Nish - Expresit më 18 shkurt 2000, ilustron mënyrën më të cilën urdhrat ekzekutiv të PSSP-së ndërhyjnë në punën e gjykatave. Rasti ishte përshkruar si sulm dhe akt terrorizmi me synim pastrimin etnik të serbëve ndërsa trupat Britanike të KFOR-it nga mesi i marsit të këtij viti kishin arrestuar katër persona (F. E, A. B, Ç. G. dhe J. V.) Më

27 mars pas hetimeve të kryera nga një gjykatës ndërkombëtar i caktuar në këtë lëndë në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2000/64, Kolegji i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë i përbërë ekskluzivisht nga gjykatës ndërkombëtarë vendosi që të liroi të dyshuarit për mungesë të provave për veprën të cilën ngarkoheshin ata. Vendimi i gjykatës kurrë nuk u ekzekutua dhe paraburgimi i të dyshuarve kishte vazhduar në bazë të Urdhrit ekzekutiv të PSSP-së së pari për 30 ditë e më pastaj duke lëshuar edhe gjashtë urdhra të tjerë (OSBE- Misioni në Kosovë, Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2001- 2002: 39; Arben Qirezi, Lirimi i tre shqiptarëve të dyshuar për vrasje tregon mangësitë e sistemit të drejtësisë në Kosovë -Instituti për raportim në Luftë dhe Paqe-IWPR, http://iwpr.net/?apc_state=henibcr2002&1=sq&s=f&o=250708, parë me 4/11/2013).

Lidhur me këtë praktikë kishin reaguar edhe organizatat e ndryshme dhe vetë Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë dhe për të riparuar një gjendje të këtillë PSSP më Rregulloren e UNMIK-ut 2001/18 në gusht të vitit 2001 kishte themeluar Komisionin për rishqyrtimin e paraburgimeve jashtëgjyqësore të bazuara në urdhrat ekzekutive. Kjo rregullore nuk krijonte bazë ligjore për shfrytëzimin e urdhëresës ekzekutive për paraburgim dhe e vetmja arsye në bazë të së cilës Komisioni për rishqyrtim mund të miratonte paraburgimin jashtëgjyqësor, është përshkruar në nenin 6.1 i cili thotë:

6.1. Komisioni mund të përcaktoj se paraburgimi jashtëgjyqësor i bazuar në urdhër ekzekutiv është i arsyeshëm në rastet kur komisioni konsideron se ka baza të arsyeshme të dyshohet se një person ka kryer një vepër penale, dhe

- Identiteti i tij nuk mund të verifikohet ose nëse ekzistojnë rrethana të tjera që sugjerojnë mundësi të madhe të arratisjes;
- Ka baza të arsyeshme për dyshim se ai mund t'i shkatërroj gjurmët e veprës penale ose rrethanat e posaçme tregojnë se ai do t'i pengoj hetimet, duke ndikuar në dëshmitarët, bashkëpjesëmarrësit ose personat që janë dukë fshehur veprën penale ose gjurmët e asaj vepre;
- Rrethanat e posaçme e arsyetojnë frikën se vepra penale do të përsëritet ose vepra penale në tentativë mund të kryhet, ose kërcënimi për vepër penale mund të realizohet (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/18 për Themelimin e një Komisioni për Shqyrtimin e Paraburgimeve Jashtëgjyqësore të bazuara në Urdhra ekzekutivë- neni 6.1).

Siç shihet nga këto që u thanë më lartë Rregullorja nuk siguronte rishqyrtimin e pavarur gjyqësor të paraburgimeve. Ky komision përbëhej nga tre anëtarë të cilët i emëronte PSSP për një periudhë kohore të kufizuar dhe të cilët ishin në varësi të PSSP-së dhe të cilët duhej që të shqyrtonin lëndë për paraburgime të cilat vetë PSSP i kishte urdhëruar. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në disa raste ka mbajtur qëndrimin se varshmëria e këtij trupi nga ekzekutivi përjashton mundësinë për të qenë i pavarur (OSBE-Misioni në Kosovë, *Shqyrtimi i Sistemit të Gjyqësisë Penale në Kosovë, tetor 2001*: 37). Ombudspersoni në Kosovë në raportin e tij special në shtator të vitit 2001 lidhur me Rregulloren 20001/18 kishte theksuar se rregullorja nuk i sjellë urdhëresat ekzekutive në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (Raporti special nr. 4 i Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë 2004: 34).

Një nga arsyet shitesë nga ana e UNMIK-ut për aplikimin e urdhrave ekzekutiv nga ana e PSSP-së ishte se përdorimi i pushtetit ekzekutiv për paraburgim është i justifikueshëm pasi që të drejtat e njeriut në kohë emergjence mund të kufizohen. Kjo bindesh me Ligjin ndërkombëtar pasi i njëjti përmban dispozita me të cilat në raste emergjente të drejtat e njeriut mund të kufizohen në kohë të emergjencës publike, por kufizimet e tilla dhe devijimet prej shumë standardeve të të drejtave të njeriut duhet që të jenë të rregulluara shprehimisht me ligj. Sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut që të ketë kufizime të tilla duhet që: së pari emergjenca të jetë e shpallur në mënyrë publike, dhe se në çfarë mase duhet bërë devijimin prej standardeve të të drejtave fundamentale dhe arsyetimin se përse duhej që të bëhej një gjë e tillë; së dyti masat e marra domosdo duhet që të jenë në mënyrë strikte konform nevojave të gjendjes së krijuar. Në kohën të cilën këta urdhra u aplikuan në Kosovë nuk kishte të shpallur kurrfarë gjendje e tillë.

Ndonëse Rregullorja 2001/18 e ka sqaruar në njëfarë mase qëllimin e urdhërësës ekzekutive për zgjatjen e paraburgimit ajo nuk e ka bërë të qartë se përse kjo çështje duhej të bëhej jashtë sistemit gjyqësor. Ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut ka paraparë që rishqyrtimi gjyqësor i paraburgimit është një e drejtë e cila në asnjë mënyrë nuk mund të anulohet, madje edhe në gjendje të emergjencës (Misioni në Kosovë, *Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, shtator 2001 – shkurt 2002*, fq.56). Për kohën kur këto urdhëresa gjetën zbatim në Kosovë sistemi gjyqësor veç ishte i konsoliduar andaj edhe nuk kishte kurrfarë arsye që zgjatja e paraburgimit të bëhej jashtë sistemit gjyqësor.

5.3.8.3. Ndërhyrjet e Legjislativit në pavarësinë e gjyqësorit

Përveç ndërhyrjes së ekzekutivit, gjyqësori i Kosovës nën administrimin e KB ka provuar edhe formën e ndërhyrjes së legjislativit në punën e tij. Kjo formë e ndërhyrjes është treguar të jetë shumë e dëmshme për punën e gjyqësorit dhe në masë të madhe tek publiku ka ngritur shkallën e humbjes së besimit tek organet gjyqësore. Cenimi i pavarësisë funksionale të gjyqësisë nga ekzekutivi bëhet në ato momente kur legjislativi ndërhyr për të ndryshuar situatën ligjore lidhur me rastin e caktuar i cili është në shqyrtim e sipër para gjykatës dhe cenon pavarësinë gjyqësore në rastet kur vetë shteti është palë.

Rasti i nxjerrjes së Rregullores së UNMIK-ut 2001/18 Për Themelimin e një Komisioni për Shqyrtimin e Paraburgimeve Jashtëgjyqësore të bazuara në Urdhrat Ekzekutiv paraqet shembullin e ndërhyrjes me të cilën ndryshohet statusi ligjor i lëndës penale që është në shqyrtim para gjykatës duke ndërhyrë në funksionet e gjykatës. Formimi i Komisionit për shqyrtimin e paraburgimeve jashtëgjyqësore paraqiste uzurpim të kompetencave të gjyqësorit. Kjo për faktin se funksionet dhe përbërja e këtij komisioni nuk ishin në kuadër të sistemit të rregullt gjyqësor. Ata emëroheshin nga PSSP dhe kishin për detyrë që të shqyrtonin vetë urdhrat ekzekutive që i jepte vetë PSSP-ja. Në këtë mënyrë ky komision assesi nuk mund që të konsiderohet si gjykatë në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së (E drejta për proces të drejtë) dhe as të Parimit 5 të Parimeve Themelore mbi Pavarësinë e Gjyqësisë.

Neni 6 pika 1 i KEDNJ-së thotë se “*Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të ndonjë akuze penale kundër tij, çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e pa anshme, e krijuar sipas ligjit...*”. Po ashtu edhe Parimi 5 flet për atë se “*tribunalet të cilat nuk do të përdorin procedurat e duhura të proceseve gjyqësore nuk do të formohen për të bartë tek to kompetencat të cilat u takojnë gjykatave të rregullta apo tribunaleve gjyqësore*” (Gomien, 2000: 31); OSBE- Misioni në Kosovë, *Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2001 – 2002*: 42).

Në frymën e parimeve të pavarësisë së gjyqësorit në këto raste vetëm gjykata e pavarur e themeluar me ligj do të garantonte gjykim të drejtë dhe do të mundësonte që ligjshmëria e paraburgimeve të tilla të zgjidhej vetëm brenda sistemit gjyqësor. Sa i përket ndërhyrjes së Kuvendit të Kosovës në pavarësinë e gjyqësorit në këtë fazë nuk vërehet ndonjë ndërhyrje, ndonëse nuk vërehet edhe ndonjë gatishmëri për të ndihmuar dhe bashkëpunuar me gjyqësorin.

5.4.Procesi i rregullt gjyqësor gjatë Misionit të EULEX

EULEX filloi misionin e tij në rrethana më të favorshme se sa ai i UNMIK-ut. Misioni që tanimë kishte bekimin e një organizimi tjetër, atij të BE-së, gjeti pothuajse një infrastrukturë të gatshme ligjore, të logjistikës dhe kapaciteteve njerëzore. Gjeti infrastrukturë ligjore sepse Kuvendi i Kosovës tashmë kishte miratuar Ligjin mbi veprimin e EULEX – Ligji 03/L-053. Logjistika ishte pothuajse e gatshme sepse EULEX u vendos gati në të njëjtat kapacitete dhe filloi që ti adaptojë për nevojat e tij. E sa i përket

kapaciteteve njerëzore shumë prej tyre qoftë personel vendor apo i huaj vetëm e ndërruan petkun e misionit dhe kishin përvojën e mëparshme në procedurat gjyqësore në Kosovë.

Megjithatë, EULEX trashëgoi problematikën e madhe që la pas misioni i UNMIK siç ishin shumësia e lëndëve të pa proceduara e që binin në kompetencën e këtij misioni, shumë raste të filluara por të pa përfunduara në të gjitha instancat gjyqësore, fillimin me vonesë të reformës në gjyqësor, ekzistimi edhe më tutje Gjykatave paralele dhe mosfunksionimi i gjyqësorit në Mitrovicën Veriore etj. Përveç kësaj gjyqësori si edhe në kohën e UNMIK vazhdoi që të punoi në raste të natyrës së rëndë por që gjyqtarët nuk i përgjigjeshin gjykatës ku punonin por misionit nga i cili ishin emëruar. Nga kjo mund të konkludojmë se problematika e cila karakterizoi gjyqësorin e Kosovës në këtë kohë kishte dy komponente kryesore: komponentën vendosëse dhe komponentën organizative. Që të dy këto komponenta kanë rëndësinë e tyre në respektimin e të drejtës për proces të rregullt gjyqësor.

Ndër problemet më të theksuara në këtë periudhë konsiderojmë se duhet që të trajtojmë çështjet si më poshtë:

- Caktimi dhe përdorimi i paraburgimeve;
- Kërkesat për caktimin e paraburgimit dhe seancat e dëgjimit;
- Kryerja e dobët e mbrojtjes nga ana e avokatëve;
- Kohëzgjatja e paraburgimit në pritje të gjykimit;
- Vonesat në hartimin dhe dërgimin e vendimeve gjyqësore;
- Procedura e dhënies së Urdhrit ndëshkimor pa dëgjim para gjykatës;
- Vazhdimi i ekzistimit të gjykatave paralele në pjesën veriore të Kosovës;
- Dështimi në mbrojtjen e dëshmitarëve;

- Menaxhimi jo i mirë i lëndëve gjyqësore;
- Procesi i riemërimit dhe transferimit të gjykatësve dhe numri i madh i lëndëve të prapambetura;
- Pavarësia e gjyqësorit;
- Shqyrtimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut jashtë institucioneve gjyqësore-Paneli për shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut-PSHDNJ;
- Kompensimi i personave në rast të gabimit gjyqësor, etj.

5.4.1. *Caktimi dhe përdorimi i paraburgimeve*

Të gjitha paraburgimet e cenojnë një të drejtë themelore të njeriut: të drejtën për liri dhe siguri të personit (Neni 9(1), PNCP; neni 5(1), KEDNJ, neni 12(1) KPPK, Neni 29 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës). Është qenësore që çdo person të gëzojë lirinë personale. Pasi është kështu, atëhere çfarëdo kufizimi i lirisë do të duhej të ishte gjithmonë përjashtim, i arsyetuar në mënyrë objektive, dhe sa më i shkurtër që është e mundur. Këtij fakti Kushtetuta e Republikës së Kosovës i ka kushtuar rëndësi shumë të madhe, duke përcaktuar se: *“Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente..”*. Kushtetuta ka shkuar edhe më tej duke i përcaktuar edhe rastet kur mund të bëhet një gjë e tillë:

- Pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;
- Për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar

kryerjen e një veprë tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjyqimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;

- Për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm;
- Për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë;
- Pas hyrjes së paligjshme në Republikën e Kosovës ose urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim (Kushtetuta e Republikës së Kosovës- Neni 29).

Në Kosovë, korniza ligjore ku përmbahet e drejta për liri përbëhet nga standarde ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë, si dhe nga legjislacioni vendor përkatës. Ndërkaq PNDKP përcakton që çdo privim nga liria duhet të bëhet në pajtim me procedurën që përcaktohet me të drejtën vendore, KEDNJ kërkon që privimi i lirisë të jetë në pajtim me ligjin, dhe vetëm për qëllimet e përcaktuara me ligj (Neni 9(1) i PNDKP, neni 5(1) i KEDNJ).

Kodi i Procedurës Penale (KPK) i zbatueshëm në Kosovë përcakton në mënyrë të ngjashme që *“Askujt nuk mund t’i hiqet liria, përpos rasteve dhe procedurave të parapara me ligj”*. Kodi procedural vendor po ashtu ka përcaktuar që paraburgimi mund të urdhërohet brenda 48 orëve nga koha e arrestimit, vetëm pasi të jetë mbajtur seanca e dëgjimit në prani të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, vetëm pasi të jenë plotësuar këto kushte:

- Ekziston dyshimi i bazuar që personi ka kryer veprë penale;
- Kur përmbushet njëri nga kushtet e mëposhtme:

- kur ai fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se ekziston rrezik i ikjes së tij;
- kur ka arsye për të besuar se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale, duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit ose në bashkëpjesëmarrësit;
- kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale, tregojnë rrezikun se ai mund të përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryej veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej;
 - Kur masat më të buta të sigurimit të pranisë së të pandehurit të parapara me këtë Kod, do të ishin të pamjaftueshme për të siguruar praninë e personit të tillë, të parandalojnë përsëritjen e veprës penale dhe të sigurojnë zbatimin e suksesshëm të procedurës penale (Neni 187 i KPK dhe neni 29(2) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës) ;

Garanci tjetër, e rëndësisë së veçantë, është se vendimet lidhur me paraburgimin duhet që të përmbajnë arsyetim të hollësishëm përse është i nevojshëm privimi i lirisë në rrethana specifike të lëndës që është objekt trajtimi para gjykatës. Ligji inkorporon parimin *“jo më gjatë se që është e nevojshme”*, duke përcaktuar që, *“çdo heqje lirie, e sidomos paraburgimi në procedurë penale, duhet zvogëluar në kohën sa më të shkurtër që është e*

mundshme” dhe se “paraburgimi duhet të hiqet menjëherë posa të pushojnë shkaqet për të cilat është caktuar”.

Është e domosdoshme të thuhet që masa e arrestit shtëpiak, ndonëse e ndryshme nga paraburgimi paraqet kufizim të lirisë dhe duhet që të zbatohet duke i respektuar të njëjtat standarde procedurale. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin *Vachev kundër Bullgarisë*, ka theksuar se *“Arrestet shtëpiake përbëjnë privim lirie dhe prandaj do të duhej të zbatohen në pajtim me të gjitha garancitë që i përmban neni 5 i KEDNJ-së”*(OSBE-Misioni në Kosovë, *“Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë: Shqyrtim dhe analizë e brengave të mbetura*, 2009: 6).

5.4.2. Kërkesat për caktimin e paraburgimit dhe seancat e dëgjimit

Sipas KEDNJ-së *“Çdo person i arrestuar apo i paraburgosur [...] sillet shpejtë para gjyqtarit”*(Neni 5(3) i KEDNJ). Konventa nuk e definon termin *”shpejtë”*, dhe ia lë caktimin e afateve specifike kohore ligjit vendor. Lidhur me këtë çështje në Kosovë deri në dhjetor 2008 ekzistonte një mospërputhshmëri në mes të Kodit të Procedurës Penale dhe Kushtetutës. Kushtetuta kishte hyrë në fuqi në qershor 2008, dhe në nenin 29(2), ka përcaktuar se *“Çdokush që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës, brenda 48 orësh duhet të dërgohet para gjyqtarit, i cili vendosë për paraburgimin ose lirimin, jo më vonë se 48 orë nga moment kur personi i privuar është sjellë para gjykatës”*. Në anën tjetër në Kodin e Procedurës Penale ky afat vazhdoi që të jetë i përcaktuar prej 72 orësh. Deri në dhjetor

2008 kur u bënë ndryshimet e duhura, Policia e Kosovës, gjyqtarët dhe prokurorët nuk ishin të sigurtë se cilin rregull duhet të zbatojnë: rregullin 48 orësh të përcaktuar me kushtetutë apo rregullin 72 orësh të përcaktuar me kodin e procedurës. Në këtë kohë kishte një praktikë jo unike lidhur me këtë çështje sepse disa prokurori dhe gjykata respektonin afatin prej 48 e disa afatin prej 72 orësh.

Ndonëse shkurtimi i afatit të ndalimit policor ishte mirëseardhur në kuptimin e të drejtave të njeriut, në praktikë ka pasur raste që është vepruar në kundërshtim me këtë rregull dhe kjo ka qenë si rezultat i komunikimit të dobët në mes të gjyqtarit të procedurës paraprake, prokurorit dhe avokatit mbrojtës.

“ Në një lëndë penale që ishte proceduar në një gjykatë nga rajoni i Prizrenit në vitin 2008, avokati mbrojtës së pari ishte njoftuar nga prokurori se rasti do të procedohej në procedurë të rregullt, domethënë pa paraburgim. Më pas prokurori kishte ndryshuar mendimin, kishte vendosur që të kërkoj paraburgimin, por që me sa duket nuk e kishte informuar për këtë avokatin mbrojtës. Kur ishte bërë caktimi i seancës së dëgjimit lidhur me paraburgimin gjyqtari i procedurës paraprake kishte ftuar avokatin por që ai gjendej në një komunë tjetër dhe iu nevojiten dy orë për të arritur në gjykatë. Kjo jo vetëm që ishte kohë e humbur nga gjyqtari i procedurës paraprake, por në ndërkohë kishte rezultuar edhe në kalimin e kohës së arrestit policor. Urdhri për paraburgim ishte zbatuar me një orë e gjysmë pas kalimit të periudhës maksimale të mbetjes maksimale në polici”(OSBE-Misioni në Kosovë “Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë: Shqyrtim dhe analizë e brengave të mbetura, 2009: 7).

Fakti që kjo periudhë e kalimit ishte relativisht e vogël nuk ka shumë rëndësi, meqë GJNDNJ në rastin *K-F. kundër Gjermanisë* kishte gjetur shkelje të së drejtës për liri madje edhe kur personi është mbajtur në ndalim vetëm 40 minuta pasi paraburgimi ishte bërë i paligjshëm për shkak të skadimit të periudhës kohore të paraburgimit të caktuar me ligj (OSBE-Misioni në Kosovë, *Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë: Shqyrtim dhe analizë e brengave të mbetura*, 2009:7). Në rastet e tilla autoritetet përgjegjëse për paraburgimin, duhet që t'i rregullojnë të gjitha formalitetet administrative me shpejtësi, dhe duhet të përkujdesen të sigurojnë që të mos bëhet tejkalimi i kohëzgjatjes së lejuar të paraburgimit.

Një problematikë tjetër që ka shoqëruar fazën e paraburgimit ka qenë vonesa e policisë për ngritjen e kallëzimeve penale lidhur me paraburgimin. Kjo ka ndikuar që koha e prokurorit për hartimin dhe arsyetimin e kërkesës për paraburgimin të jetë shumë e shkurtër dhe e pamjaftueshme për shqyrtimin e dosjes. Si pasojë e kësaj, edhe kërkesat për paraburgim nga ana e prokurorëve nuk mund të ishin të nivelit të kërkuar profesional, përveç se një formë standarde me parafrzim të bazës ligjore dhe me arsyeime abstrakte. Vonesat e tilla kanë ndikuar që gjyqtarët e procedurës paraprake të kenë kohë fare të pamjaftueshme për mbajtjen e një seance kualitative dëgjimore dhe hartimit të një vendimi të arsyetuar mirë, lidhur me paraburgimin.

“Raporti i sipërcituar vlerëson se në një rast para Gjykatë së Qarkut në Pejë, policia kishte ndaluar një të dyshuar për veprën penale të vrasjes. Policia kishte dërguar kallëzimin penal në zyrën e prokurorit vetëm dy orë para skadimit të afatit të ndalimit. Prokurori kishte hartuar me shpejtësi kërkesën për paraburgimin por

që gjykatësit të procedurës paraprake i ishte dashur që brenda vetëm prej 30 minutave të mbajë seancën e dëgjimit dhe të hartojë vendimin lidhur me caktimin e paraburgimit”

Dërgimi me vonesë i kallëzimeve penale në prokurori por edhe marrja me vonesë e vendimeve për fillimin e hetimeve nga ana e prokurorëve nganjëherë ka ndikuar edhe në dhënien e drejtësisë selektive lidhur me paraburgimin nga ana e gjykatës. Vendimi për fillimin e hetimeve duhej që të ishte në formë të shkruar dhe duhej që të shoqëronte kërkesën për caktimin e paraburgimit. Kjo ka ndikuar në masë të madhe edhe në zbehjen e besimit të gjyqësorit në sytë e publikut.

“ Në një rast dëgjimi lidhur me paraburgimin në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë për veprën penale të vjedhjes, për katër persona të dyshuar prokuroria dhe policia nuk kishte sjellë më vete dosjen complete për të gjithë të pandehurit. Në rast kishin qenë të përfshirë 24 persona. Prokurori i çështjes nuk kishte marrë me vete kopje të mjaftueshme të vendimeve lidhur me fillimin e hetimeve për të gjithë të dyshuarit, kurse policia për katër prej tyre arsyetohej se i kishte harruar vendimet e tilla në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan. Megjithatë koha ishte shumë e shkurtër për të skaduar paraburgimi i ligjshëm prej 48 orëve, gjyqtari i procedurës paraprake urdhëroi që katër të dyshuarit të mos futen në sallën e dëgjimit dhe si pasojë këta edhe u liruan nga ana e policisë. Ndaj njëzet të tjerëve gjyqtari kishte caktuar masën e paraburgimit. Në sytë e publikut lirimi i këtyre personave u pa si ndërhyrje e dikujt në drejtësi ”(Rast nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në vitin 2010).

Në rastet kur prokurori publik ngriste të ashtuquajturën aktakuzë direkte pa fazën hetimore dhe kur në këto raste kërkohej paraburgimi, këtë masë e caktonte kolegji prej tre gjyqtarësh pa mbajtur fare seancën dëgjimore. Përveç kësaj edhe vendimet e tilla për caktim të paraburgimit nuk ishin të arsyetuara dhe mbi baza që nuk sigurohen me ligj.

“ Në një lëndë kur një i pandehur dyshohej për veprën penale lëndim i rëndë trupor në maj të vitit 2008, prokurori publik ka ngritur një akatakuzë që ka përmbajtur edhe kërkesën për caktimin e paraburgimit. Kolegji prej tre gjyqtarësh kishte miratuar kërkesën për caktimin e paraburgimit duke e arsyetuar, inter alia, që paraburgimi ka qenë i nevojshëm “për shkak të aktakuzës së ngritur kundër tij”(OSBE-Misioni në Kosovë “Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë: Shqyrtim dhe analizë e brengave të mbetura, 2010: 19).

Një arsyetim i tillë jo vetëm që nuk ka mbështetje në ligj, por është qartazi në kundërshtim me kërkesën për mbikqyrje efikase mbi të gjitha aktet e prokurorisë, të cilat ndikojnë mbi të drejtat fundamentale të personit.

Është shumë me rëndësi që të vihet në pah se caktimi i paraburgimit si masa më e rëndë që siguronte praninë e të pandehurit në procedurë, bëhej duke mos arsyetuar shkaqet e mos caktimit të masave të tjera alternative që ishin arresti shtëpiak, lajmërimi në stacionin policor, dorëzania e masa të tjera të parapara me Kodin e Procedurës Penale. Arsyetime të tilla pothuajse të shablonizuara përdorehin edhe me rastin e vazhdimit të masës së paraburgimit. Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë lidhur me vazhdimin e paraburgimit, gjykata kishte parafrazuar nenet e ligjit pa dhënë asnjë arsye konkrete se cila

është arsyeja që e bën gjykatën që të bindet se të pandehurit do t'i shmangen thirrjeve të gjykatës dhe do të ikin, apo cilat ishin mundësitë e ndikimeve të tyre në dëshmitarët, apo në përsëritjen e veprës penale. Gjykata vetëm kishte theksuar në vendimin e saj se “të gjitha këto rrethana paraqesin shkaqe të parapara ligjore me nenin 281 par.1, nënpar.1 dhe 2 pika (i), (ii) dhe (iii) të KPPK, për vazhdimin e paraburgimit (Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, GJPP.nr.45/2010, dt. 17.11.2010).

Gjatë hulumtimit të bërë me përfaqësuesit e ligjit mbizotëronte mendimi se masa e paraburgimit nga ana e gjykatësve vendor caktohet, pothuajse në të gjitha rastet kur kjo kërkohet nga prokurori i shtetit. Kërkesat e prokurorëve për caktimin e masës së paraburgimit janë të karakterit stereotip dhe janë vetëm përshkrim i dispozitave ligjore sipas të cilave kërkohet caktimi i një mase të tillë. Profesionistët ligjor kanë mendimin se seancat e dëgjimit për paraburgimin në të shumtën e rasteve janë të karakterit formal. Aktvendimet e gjykatësve në këto raste, gjithashtu, nuk tejkalojnë parafrazimin dhe citimin e dispozitave ligjore lidhur me rrethanat për caktimin e paraburgimit.

Lidhur me këto që u thanë më lartë, mund të përfundohet se procesi i rregullt gjyqësor kërkon që prokurorët të kërkojnë caktimin e paraburgimit vetëm kur ligji dhe rrethanat specifike të rastit e kërkojnë aplikimin e kësaj mase kufizuese dhe në këto kërkesa të përmbajnë arsyet relevante dhe të mjaftueshme për një gjë të tillë. Gjithashtu procesi i rregullt gjyqësor do të respektohej në këto çështje, vetëm atëherë kur gjyqtarët do të

caktojnë paraburgimin vetëm atëherë kur rrethanat e rastit e kërkojnë një masë të tillë kufizuese. Gjyqtarët në këto raste duhet të japin arsye relevante dhe të mjaftueshme në të gjitha vendimet për caktimin e paraburgimit në përputhje me ligjin vendor dhe ndërkombëtarë. Në veçanti gjyqtarët duhet që të citojnë faktet relevante, rrethanat e veçanta faktike që bëjnë që paraburgimi të caktohet. Gjyqtarët në vendimet e tyre lidhur me paraburgimin duhet të sqarojnë se përse masat e tjera alternative ndaj paraburgimit janë të pamjaftueshme.

5.4.3. Kryerja e dobët e detyrave nga ana e avokatëve mbrojtës në procedurën penale dhe atyre përfaqësues në procedurën civile

E drejta që i dyshuari të ketë mbrojtësin e tij, në përgjithësi është respektuar në proceset gjyqësore në Kosovë. Kjo e drejtë në proceset penale fillon që nga ndalimi në polici dhe fillimi i marrjes në pyetje. Shikuar nga ky aspekt në proceset gjyqësore gjatë Misionit të EULEX ka një evoluim të dukshëm dhe është rezultat mjaft i kënaqshëm në përgjithësi. Megjithatë aplikimi i mbrojtjes në praktikat gjyqësore në shumë raste ka shfaqur edhe anën e errët të medaljes. Në një numër rastesh të pandehurve nuk u është ofruar mbrojtje adekuate. Në rastet penale menjëherë pas arrestimit, mbrojtës të ndryshëm janë ftuar nga ana e policisë për të siguruar mbrojtjen e të pandehurve. Në këto raste përmbushja e kushtit ligjor që i pandehuri të ketë mbrojtës gjatë të gjitha fazave të procedurës nuk ka përmbushur edhe kushtin tjetër që mbrojtja të jetë adekuate. Policia nuk kishte një listë të cilës do të duhej që t'i përmbahej një rendi dhe rregulli që të ftohen

mbrojtësit në këtë fazë. Oda e Avokatëve të Kosovës ndonëse hartonte dhe dërgonte listën e mbrojtësve të cilët ishin në kujdestari javore dhe duhej që të ftoheshin në rastet e tilla, kjo gjë nuk bëhej nga ana e organeve të rendit. Nga ana e policisë ftoheshin mbrojtës jashtë kësaj liste. Kjo ndodhte për dy arsye. E para, disa mbrojtës duke shkelur rregullat e Kodit Etik kishin arritur që të krijojnë favore tek organet e rendit (Nga hulumtimi i zhvilluar me avokatët në Prishtinë), E dyta, vetë mbrojtësit nuk respektonin kohën e të qenit në listën e kujdestarisë. Krijimi i kontaktit të parë më të pandehurin për mbrojtësin kishte rëndësi të madhe sepse mundësonte dhënien e autorizimit nga ana e tij dhe përfaqësimin e mëtutjeshëm në fazat e gjatë gjithë procedurës. Në këto raste jo rrallëherë të pandehurit ose familjarët e tyre janë gjetur para kushtëzimeve që shërbimet të kryhen përkundrejt pagesave shumë të mëdha dhe shpesh edhe të pa përballueshme.

Një çështje tjetër që meriton trajtim në këtë kontekst është edhe ofrimi jo adekuat i mbrojtjes në rastet sipas detyrës zyrtare. Në rastet e tilla avokatët nuk bënin kundërshtimin e propozimeve të prokurorëve për paraburgim me argumente të arsyetuara. Argumentet e avokatëve në këto raste përbëheshin vetëm nga kërkesat drejtuar gjyqtarëve që të mos caktojnë paraburgimin ndaj klientëve të tyre, por të pa mbështetura në arsye bindëse.

Një ndër arsyet ishte se në disa raste avokatët ishin caktuar nga gjykata vetëm pak kohë para seancës së dëgjimit dhe koha e kufizuar që avokati të përgatitej për seancën e dëgjimit kishte ndikimin e saj në ofrimin e mbrojtjes adekuate. Ka ndodhur që në një seancë dëgjimi lidhur me paraburgimin, aty për aty u është shpërndarë mbrojtësve aktvendimi për fillimin e hetimeve së bashku me kërkesën për paraburgim (OSBE-Misioni në Kosovë *“Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë: Shqyrtim dhe*

analizë e brengave të mbetura, 2009: 12). Ky afat kohor vështirë se ua ka mundësuar avokatëve mbrojtës që të përgatiten dhe të paraqesin mbrojtjen adekuate.

Mbrojtje jo adekuate nga ana e mbrojtësve është ofruar edhe në procedurën gjatë shqyrtimit kryesor gjyqësor. Kjo është vërejtur edhe në punën e shkruar të tyre gjatë procedimeve gjyqësore. Në shumicën e rasteve shkresat e drejtuara gjykatës nga mbrojtja e ofruar sipas detyrës zyrtare kishin përmbajtje më të dobët se sa ato që ishin nga mbrojtja e ofruar me pagesë nga ana e mbrojtësve të klientëve. Një gjë e tillë vërehej edhe lidhur me mjetet ankimore (OSBE në raportin e cituar thekson se mesatarisht avokatët e caktuar nga gjykata kanë pasur një performancë më të dobët se avokatët mbrojtës të zgjedhur nga të pandehurit). Kjo bie ndesh me Kodin e Etikës profesionale të Avokatëve i cili thekson se avokatët gjithmonë duhet që të bëjnë përpjekje që ta mbështesin interesin e klientëve të tyre dhe duhet t'i ushtrojnë detyrat e tyre profesionale me përgjegjësi dhe me zell (Kodi i Etikës Profesionale të Avokatëve, Oda e Avokatëve të Kosovës-nenet 6 dhe 8).

Në anën tjetër në procedurat civile edhe pse përfaqësimi është çështje disponibile, problematika është shfaqur tek procedura e caktimit të avokatëve në cilësinë e përfaqësuesve të përkohshëm dhe tek ndihma juridike falas. Në procedurat civile caktimi i avokatëve për përfaqësues të përkohshëm në shumicën e rasteve bëhej në gjykimet *in absentia*, pra në rastet kur vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur kurse i padituri nuk ka përfaqësues me prokurë, në qoftë se i padituri ose përfaqësuesi ligjor i tij nuk kanë përfaqësues me prokurë, ndodhen jashtë shtetit, kurse dërgimi i shkresave nuk ka mundur të bëhet ndërsa mos vazhdimi i procedurës do të lindte pasoja të dëmshme për njërin palë ose për të dy palët.

Sipas Ligjit për Procedurën Kontestimore nëse gjatë zhvillimit të procedurës në gjykatën e shkallës së parë tregohet se procedura e zakonshme rreth të caktimit të përfaqësuesit ligjor për të paditurin do të zgjaste shumë, kështu që për këtë arsye do të mund të lindnin pasoja të dëmshme për njërën apo për të dy palët, gjykata do t'i caktojë të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm. Po sipas këtij ligji gjykata do t'i caktojë të paditurit përfaqësuesin edhe në rastet kur i padituri nuk ka zotësi procedurale, ndërsa nuk ka përfaqësuesin ligjor (prindi, kujdestari), në qoftë se ekzistojnë interesa të kundërta në mes të paditurit dhe të përfaqësuesit ligjor të tij, në qoftë se të dy palët ndërgjyqës kanë të njëjtin përfaqësues ligjor (neni 79.2). Ligji ka përcaktuar se gjykata do t'i caktoj palës së paditur përfaqësuesin e përkohshëm edhe në rastin kur: vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur kurse i padituri nuk ka përfaqësues me prokurë, në qoftë se i padituri ose përfaqësuesi ligjor i tij nuk kanë përfaqësues me prokurë ndodhen jashtë shtetit, kurse dërgimi i shkresave nuk ka mundur të behët”(Ligji për Procedurën Kontestimore -neni 79.1).

Nga praktika dhe nga rastet e shumta gjyqësore që kishim për studim, në Kosovë aplikimi i caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm në shumicën e rasteve bëhej në procedurat lidhur me çështjet pronësore sipas padive kundër personave të shpërngulur pas luftë së fundit në Kosovë (Raste të tilla për studim u morën nga Praktika e Gjykatës Komunale në Klinë, Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë). Këtë e kishte determinuar edhe moskomunikimi ndërshtetëror ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe sigurimi i palës së paditur në procedurë ishte shumë i vështirë. Sipas ligjit caktimi i përfaqësuesit bëhet nga radha e avokatëve kurse shpenzimet e procedurës në këto raste i deponon paditësi. Ajo që vërehej në procedurën e zhvilluar në shumicën e rasteve

përfaqësuesi i përkohshëm i caktuar e kundërshtonte padinë vetëm në parim dhe rezervonte të drejtën që të deklarohej në fjalën përfundimtare. Ka pasur raste që në fjalën përfundimtare kërkesa e përfaqësuesit të përkohshëm njëjtësohej me atë të përfaqësuesit të paditësit. Në pothuajse të gjitha rastet këta përfaqësues nuk kanë ushtruar mjetin e ankesës kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë.

Një çështje tjetër që ka rëndësinë e saj lidhur me gjykimin e drejtë është fakti se njoftimi lidhur me caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm bëhej në shumicën e rasteve në shtypin ditor dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës. Shpallja kishte efekt me të cilin i padituri mund të njoftohej se kundër tij është duke u zhvilluar një kontest gjyqësor në gjykatë. Shpallja në shtypin ditor bëhej në shtypin në gjuhën shqipe dhe këto shpallje nuk ishin aspak të qasshme për palët e shpërngulura nga Kosova. Rastet e shpallura në gjuhën serbe kanë qenë fare të pakta kurse ka pasur raste që lidhur me këto janë bërë edhe kërkesa për përsëritjen e procedurës dhe pas bërjes së kësaj çështja rrënjësisht ka ndërruar rrjedhën e saj dhe rasti pas mbajtjes së sërishme të procedimit gjyqësor është kthyer tërësisht në favorin e të paditurit (Rasti gjyqësor C.nr.129/2005, në Gjykatën Komunale në Klinë). Këto raste kanë ndikimin e tyre në procesin e rregullt gjyqësor. Palët e paditura nganjëherë me shumë vonesë kanë kuptuar se është bërë ndërrimi i statusit juridik lidhur me patundshmëritë e tyre, ndonëse ata nuk kishin ndërmarrë asnjë veprim lidhur me shitjen e tyre. Këtë ua kishte shitur krejt dikush tjetër dhe persona të cilët nuk kishin pasur autorizim për të bërë një gjë të tillë.

Caktimi i përfaqësuesit të përkohshëm në procedurën civile që gjente aplikim në rastet gjyqësore para gjykatave, bëhej edhe në rastet e kërkesave (pasive) për zgjidhjen e martesës kur palë e paditur ishte personi i cili kishte vendbanimin apo vendqëndrimin

jashtë Kosovës. Gjykatat në këto raste bënin caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm pa bërë asnjë veprim me të cilin do të shihej se ka bërë përpjekje për njoftimin e palës për në seancën e caktuar gjyqësore (Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Klinë, C.nr. 48/04, dt. 02.04.2009).

Avokatia luan rolin e saj si në procesin penal- me qëllim garantimin e së drejtës për një gjykim të drejtë, ashtu edhe në procesin civil, kjo duke u bazuar në vetë karakterin që ai prezanton: *Së pari*, gjykata vihet në lëvizje në bazë të kërkesës së palëve. Janë ato që vendosin për fillimin apo pushimin e gjykimit, janë po ata, që përcaktojnë objektin dhe shkakun e padisë. *Së dyti*, gjykimi zhvillohet mbi bazën e provave që palët paraqesin në gjyq dhe vendimi përfundimtar jepet i bazuar në këto prova dhe ligj (Latifi, J., *Instituti i Avokatit-Roli i tij për një proces gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm*, Revista Shqiptare për Studime Ligjore-ajls, Volumi 2, nr. 1, 2008: 5).

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka theksuar në një sërë vendimesh të saj që procesi i rregullt kërkon që: “një palë në gjykim të ketë mundësi reale për t’ju drejtuar gjykatës një mundësi të barabartë për të paraqitur çështjen e vet. Kjo përfshin të drejtën për t’u përfaqësuar nga një avokat i aftë që mund të merret me çështjet e ndërlikuara ligjore”(Latifi, J., *Instituti i Avokatit-Roli i tij për një proces gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm*, Revista Shqiptare për Studime Ligjore-ajls, Volumi 2, nr. 1, 2008: 6).

Nga hulumtimi i bërë rezulton se avokatët, gjithashtu nuk janë në nivel të detyrës jo ndoshta vetëm për fajin e tyre, por në angazhimin e tyre ka ndikuar edhe vetë sjellja e gjyqtarëve, të cilët, sikur nuk kanë durimin që avokatit të i jepet koha në dispozicion që të bëhet elaborimi i kundër argumenteve. Grupi në fokus vlerëson se

kjo gjë është më e theksuar tek gjykatësit vendor, përderisa gjykatësit ndërkombëtar në këtë aspekt janë më të durueshëm për të dëgjuar argumentet dhe këndvështrimin e avokatëve. Nga hulumtimi doli edhe e dhëna se një numër i avokatëve janë të pa përvojë dhe marrin përsipër që të përfaqësojnë raste që nuk shkojnë përshtat me përgatitjen e tyre profesionale.

Mbrojtja e të drejtave të individit, zhvillimi i një procesi gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm, përbëjnë sfidë për sistemin gjyqësor në Kosovë. Reformimi i sistemit të drejtësisë është i lidhur ngushtë edhe me vendin dhe rolin që duhet të luaj instituti avokatisë në këtë reformim. Reformimi duhet të përfshijë edhe sistemin arsimor për avokatët dhe kriteret për licencimin e tyre. Krejt kjo në kuadër të përmirësimit të sistemit gjyqësor dhe ligjor dhe mundësive të përafrimit të tyre me *acquis comunitare*.

5.4.4. Kohëzgjatja e paraburgimit në pritje të gjykimit

Konventa parasheh që “çdokush që arrestohet apo mbahet në ndalim ka të drejtë të gjykimit brenda një kohe të arsyeshme apo të lirohet në pritje të gjykimit”(Neni 5(3) i KEDNJ). Ngjashëm me këtë dispozitë të Konventës, edhe Kodi i Procedurës Penale i Kosovës ka përcaktuar se ”Çdo heqje lirie, e sidomos kohëzgjatja e paraburgimit në procedurë penale, duhet zvogëluar në kohën sa më të shkurtër të mundshme”. Kodi gjithashtu kërkon që çdo paraburgim të ndërpritet kur arsyet që kanë kërkuar atë pushojnë së ekzistuari, apo të zëvendësohet me masa më të buta nëse kushtet për këtë gjë janë plotësuar. Bazuar në nenin 5(1) të KEDNJ-së paraburgimi është i ligjshëm vetëm nëse është

në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi në Kosovë. Neni 5(1) parashikon se një shtet mund të ndalojë ligjërisht një individ për motive të mbështetura në të drejtën penale ose civile. Neni 5 (1) (a) dhe neni 5 (1) (c) kanë të bëjnë me të drejtën penale kurse neni 5 (1) (b) (d) (e) dhe (f) mbulojnë ndalimin në kontekstin e të drejtës civile (Gomien, D., Udhëzues i shkurtër për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 2000: 22).

Kodi i Procedurës Penale i Kosovës ka vendosur kufizime strikte mbi kohëzgjatjen e paraburgimit. Aktvendimi i parë mund të urdhërojë caktimin e paraburgimit për të pandehurin më së shumti një muaj nga dita kur ai apo ajo është arrestuar. Kodi gjithashtu kufizon kohëzgjatjen maksimale të paraburgimit para ngritjes së aktakuzës deri në katër muaj kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me më pak se pesë vjet burgim, si dhe në tetë muaj për rastet kur procedura penale zbatohet për vepër penale të dënueshme më shumë se pesë vjet (Neni 190 (2) i KPP i Kosovës). Vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, këto afate maksimale mund të zgjaten deri në katër muaj sipas rastit (Neni 190 (3) i KPP).

Megjithëse ka një rregullim ligjor të avancuar, kohëzgjatja e paraburgimit në pritje të gjykitimit është stadi procedural në të cilin gjyqësia kosovare ka çaluar më së shumti. Në praktikë janë vërejtur shkelje të kohëzgjatjes së paraburgimit të lejuar me ligj si në vendimet e para mbi paraburgimin, por edhe në vendimet për zgjatjen e paraburgimit.

Në një vendim të Gjykatës Komunale në Prizren të dt., 7 janar 2008, gjykatësi i procedurës paraprake pas një seance jopublike të mbajtur në mungesë të të pandehurit dhe avokatit mbrojtës, kishte lëshuar një vendim mbi paraburgimin për një periudhë dy mujore edhe përkundër faktit se dispozitat e Kodit të Procedurës

Penale qartë kishin përcaktuar që vendimi fillestar mund të vendosë paraburgim për një periudhë maksimale prej një muaji.

Shkelje të tilla janë bërë edhe tek procedura e shkurtër të cilën Kodi i Procedurës Penale parasheh periudhën e paraburgimit prej 15 ditësh në rastet para ngritjes së aktakuzës. Ka pasur raste kur gjykata ka dështuar të vlerësoj se mbajtja në arrest shtëpiak duhet që të llogaritet po sikur edhe masa e paraburgimit. Në një rast para Gjykatës Komunale në Glllogovc të dt. 9 janar 2009, koha e mbajtur në paraburgim të pandehurve kishte kaluar afatin e lejuar në procedurë të shkurtër prej 15 ditësh para ngritjes së aktakuzës, apo në një rast para Gjykatës Komunale të Ferizajit, i pandehuri ndonëse në procedurë të shkurtuar, ishte mbajtur në arrest shtëpiak afër një muaj.

Për më tepër shih shënimin si në vijim:

Në këtë rast gjyqësor katër të pandehur janë vendosur në paraburgim më 9 janar 2009, ndërsa shtatë të tjerë në arrest shtëpiak (në data të ndryshme nga 9 deri më 14 janar 2009). Të gjithë të pandehurit janë mbajtur në paraburgim/arrest shtëpiak deri më 5 shkurt 2009. Në këtë rast paraburgimi/arresti shtëpiak kishte tejkaluar afatin maksimal prej 15 ditësh (OSBE-Misioni në Kosovë “Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë: Shqyrtim dhe analizë e brengave të mbetura, 2009: 12).

Qëndrimi i të pandehurve në paraburgim në pritje të gjyqimit, përbënte një problem në vete si gjatë kohës së misionit të UNMIK e po kështu vazhdoi që të jetë

problematike edhe gjatë kohës së misionit të EULEX. Qëndrimet e gjata në pritje të gjykit vinin si pasojë e numrit të pamjaftueshëm të gjykatësve në krahasim me numrin gjithnjë në rritje të lëndëve gjyqësore, pastaj menaxhimi jo i mirë i rasteve gjyqësore, menaxhimi jo i mirë i administrimit të gjyqësisë, mungesa e llogaridhënies së mjaftueshme nga bartësit e funksioneve të administrimit të drejtësisë, mungesa e profesionalizmit nga ana e inspektionit gjyqësor etj.

Në fundin e gushtit të vitit 2013 numri i personave që ishin në paraburgim dhe që nuk kishin aktakuzë ishte 399 persona. Numri i atyre ndaj të cilëve ishte ngritur aktakuza dhe ishin në pritje të gjykit përbënte shifrën prej gjithsejtë 205 persona, ndërsa afati kohor i pritjes ishte nga 2 - 50 muaj. Siç vërehet, edhe koha në pritje të plotfuqishmërisë së vendimit ishte mjaft e gjatë. Në fund të gushtit të vitit 2013, 66 persona të gjykuar ishin në privim nga liria në institucionet korrektuese në pritje të vendimit të plotfuqishëm. Kjo kohë e pritjes ishte nga 6 muaj deri në 3 vite e 3 muaj. Përfaqësuesit e këtij shërbimi kërkonin nga ministri i drejtësisë që të ngrisë këtë shqetësim te kryetarët e gjykatave dhe vet kryetarit të Gjykatës Supreme në mënyrë që të bëhet përsheptimi i procedurave gjyqësore në rastet e tilla (Raporti i Shërbimit Korrektues të Kosovës, i dt. 26.08.2013).

Tabela.1 – Personat e burgosur që kishin akatakuzë dhe që ishin në pritje të gjykimit dt. 26.08.2013									
Koha	2 muaj	3 muaj	4 muaj	5 muaj	6 muaj	7 muaj	8 muaj	9 muaj	10-50 muaj
Numri i perso- nave	2	18	11	18	20	7	17	17	95
							Gjithsej nr. i personave 205		

Nga numri i personave që kishin aktakuzë dhe që ishin në pritje të gjykimit për rastet me të vrazhda të kësaj natyre ku ishte bërë shkelja e të drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme ishin rastet P.nr.322/09 kundër H. K., i cili ishte në pritje të gjykimit për 4 vite e një muaj, pastaj rasti P.nr. 301/09 kundër A.I. i cili ishte në pritje të gjykimit për 4 vite e dy muaj, rasti P.nr.301/09 ishte në pritje të gjykimit për 4 vite e dy muaj, etj. Po kështu kishte raste ku koha e pritjes ishte mbi tri vite dhe këto ishin: rasti 59/10 kundër M.H., A.H. dhe XH.H., ishte në pritje të gjykimit për 3 vite e pesë muaj, rasti P.nr. 140/10 e cila ishte në pritje të gjykimit për 3 vite e një muaj, rasti P.nr. 17/10 kundër O.S që ishte në pritje të gjykimit për 3 vite e shtatë muaj, rasti P.nr.140/10 kundër H.K. ishte në pritje të gjykimit për 3 vite e një muaj, P.nr. 383/09 ishte në pritje të gjykimit për 3 vite etj. Përveç rastit të fundit i cili kishte të bëjë për veprën penale lidhur me narkotikët, që të gjitha rastet e tjera kishin të bëjnë me veprën penale të vrasjes së rëndë. Që të gjitha këto raste ishin raste

që ishin trashëguar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë e cila në momentin e ndodhjes së veprës penale ishte kompetente që të gjykojë në shkallë të parë. Pas fillimit të reformës në janar të vitit 2013 këto raste bien në kompetencën e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Rastet ku periudha e pritjes ishte mbi dy vite, ishin mbi 13 raste dhe gjithashtu kishin të bënin me vepra të rënda penale si vepra penale të vrasjes, vepra penale e grabitjes apo të vjedhjes grabitqare etj (Rastet që ishin në pritje të gjykimit para Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr. 86/11, P.nr.134/11, P.nr.134/11, P.nr.348/10, P.nr.170/11, P.nr.86/11, P.nr.170/11, P.nr.587/10, P.nr.134/12 etj. Shembuj të tillë kishte edhe nga rastet që ishin në kompetencën e Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.1662/12, P.nr.22/12 etj.)

“Personi Rifat Osmani për katër vite mbahej në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan. Ishte i dyshuar për veprën penale të vrasjes në bashkëkryerje që kishte ndodhur në vitin 2009 dhe për 4 vite nuk u tha në ishte fajtor apo jo. Në këtë çështje ishin ndërruar tre trupa gjykues por procedura edhe më tej nuk kishte përfunduar. Avokati mbrojtës kishte shprehur pakënaqësinë e tij dhe e kishte quajtur paraburgim maratonik dhe rast në të cilin gjykata është treguar neglizhente dhe që nuk di të i menaxhojë rastet që i merr përsipër. Mbrojtësi i të pandehurit kishte deklaruar se me vet faktin se nuk ka aktgjykim për katër vite lirisht mund të konsiderohet se ai është mbajtur për kaq kohë padrejtësisht në paraburgim”(Gazeta Telegraf 2013: Artikulli, Paraburgimi maratonik, 21 korrik).

Paraburgimi në pritje të gjykimit, në të shumtën e rasteve, zgjaste deri në ngritjen e aktakuzës dhe më pastaj vazhdohej nga kryetari i trupit gjykues apo nga trupi gjykues

deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor. Kjo ka ndodhur kështu edhe në rastet e cilësuara si të “ndjeshme” siç ishin Rasti “Kleçka” ku që të gjithë të pandehurit janë mbajtur tërë kohën në paraburgim apo në arrest shtëpiak, pastaj Rasti “Bllaca I”, Rasti “Grupi i Drenicës” etj. Caktimi i paraburgimit në të shumtën e rasteve nënkuptonte se i pandehuri duhet të priste tepër gjatë që të vinte deri tek caktimi seancës së gjykimit.

“Të pandehurit XH.H. i ishte ngritur aktakuza më dt. 05.04.2013. Ndonëse dispozitat ligjore parashohin se në rastet e tilla seanca e parë duhej që të caktohej brenda afatit prej 30 ditësh, kishin kaluar më se tetë muaj dhe ende nuk i ishte caktuar asnjë seancë gjyqësore (Rasti gjyqësor P.nr.807/13 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë).

Si përfundim i kësaj vlerësojmë se rastet e pritjes së lëndëve për procedim nuk ishin si pasojë e vetëm problematikës së cekur më lartë. Ato kishin edhe një problematikë tjetër e që ishte keq administrimi i drejtësisë. Nga tetë gjykatës (që në kohën e hartimit të këtij punimi 12.01.2014) punonin në Departamentin e Krimeve të Rënda në Gjykatën Themelore në Prishtinë, vetëm njëri prej tyre e kishte përvojën e mëhershme të të punuarit në këto raste. Gjykatësit e tanishëm vijnë nga një jo përvojë e mëhershme dhe as që kishin qenë më para në përbërje të trupave gjyqëse në rastet e tilla. Kjo ka ndodhur për shkak të mos pasjes parasysh të kësaj çështjeje me rastin e transferimeve për në Gjykatën e Apelit, kur disa nga gjykatës të këtyre çështjeve vazhduan që të punojnë në shkallën e dytë. Duke marrë shkas nga praktika e ime gjyqësore në rastet e tilla mendoj dhe vlerësoj se në asnjë mënyrë një gjyqtar i sapo ngritur në detyrë, që të punojë në rastet e krimeve të rënda së

paku do të duhej që të kishte qenë që më parë pjesëtarë i trupave të tilla gjykuese. Emërimi i gjykatësit nga procedura kundërvajtëse dhe detyrimi i tillë i të njëjtit që të punojë në Departamentin e Krimeve të Rënda domosdo ka sjellë si pasojë e mospërgatitjen dhe mosgatishmërinë e menjëhershme profesionale për t'u përballur me rastet e rënda gjyqësore.

5.4.5. Vonesat në hartimin dhe dërgimin e vendimeve gjyqësore

I tërë procesi procedural gjyqësor përfundon me vendimin e lëshuar nga ana e gjykatës me të cilin i pandehuri shpallet fajtor, lirohet nga aktakuza apo e njëjta refuzohet, në procedurën penale, apo paditësit i miratohet apo refuzohet padia në procedurat civile. Nxjerrja e vendimit gjyqësor dhe dërgimi i tij palëve ndërgjyqës shkakton edhe pasojat e mëpastajme procedurale për palët pjesëmarrëse në procesin gjyqësor. Sigurisht për shkak të rëndësisë që ka për pjesëmarrësit në procesin gjyqësor, ligjet kanë përcaktuar edhe afatet kohore për nxjerrjen e vendimeve gjyqësore. Kështu Kodi i procedurës Penale që ishte në fuqi deri më 31 dhjetor 2012 për hartimin e aktgjykimit kishte paraparë afatin 15 ditor nga shpallja e tij kur i akuzuari ishte në paraburgim, ndërsa brenda 30 ditë në raste të tjera. Nëse aktgjykimi nuk përpilohej brenda këtij afati, kryetari i trupit gjykues duhej që të njoftonte kryetarin e gjykatës për arsyet e mos përpilimit. Detyra e kryetarit të gjykatës ishte që të ndërmernte të gjitha masat e nevojshme për përpilimin sa më të shpejtë të aktgjykimit por jo më vonë se 30 ditë kur i akuzuari gjendej në paraburgim dhe 45 ditë në raste të tjera (Neni 395 par 1 i Kodit të Procedurës Penale i Kosovës - Ky kod u shpall me 6 prill 2004 dhe ishte në fuqi deri më 31.12.2012 kur hyri në fuqi kodi i ri i procedurës). Dispozitë të

ngjashme përmban edhe Kodi i ri i procedurës penale i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, por që ky i fundit del të jetë në disfavor të të pandehurve sepse afatin prej 30 ditësh që e përcaktonte kodi i mëparshëm për personat që ishin në paraburgim e ka rritur në 60 ditë brenda të cilit afat duhet bërë përpilimi i aktgjykimit. Nga hulumtimi ynë në praktikë vërehet se jo gjithëherë është respektuar ky afat.

“ Në çështjen penale P.nr.371/2010 kundër F.G. i akuzuar për krime të luftës është dënuar me 18 vite burgim. Përbërja e Kolegjit gjykues ishte nga dy gjyqtarë nga komponenta e EULEX dhe një gjyqtar vendor. Aktgjykimi është shpallur më 23 Nëntor 2011, ndërsa të pandehurit dhe mbrojtjes i është dorëzuar më 9 Maj 2012. Nga kjo shihet se data kur ka qenë dashur që të bëhet hartimi i këtij aktgjykimi është dashur që të jetë data 2 janar 2013. Në këtë rast aktgjykimi është hartuar me plot pesë muaj vonesë nga sa e parashohin dispozitat ligjore për rastet e ndërlikuara”(Rasti gjyqësor P.nr.371/2010 në Gjykatën e Apelit në Prishtinë).

Vonesa në hartimin dhe dorëzimin me shkrim të aktgjykimit kishte për pasojë edhe vënien në pozitë të vështirë të akuzuarin dhe mbrojtjen sepse vononte që ata të ndërmarrin veprimet lidhur me mjetet e ankimit dhe vështirësonte të drejtën për qasje në mjetet gjyqësore efektive sipas nenit 13 të Konventës. Edhe Ligji për procedurën kontestimore ka paraparë afatin kohor prej 15 ditësh nga dita e shpalljes, në mënyrë që të bëhet hartimi me shkrim i aktgjykimit. Edhe ky ligj ka përcaktuar se nëse gjyqtari e kalon këtë afat ka për detyrë që me shkrim ta njoftoj kryetarin e gjykatës për shkaqet e tejkalimit të tij (Ligji për procedurën kontestimore i Kosovës -Neni 153).

Në praktikë ka pasur edhe raste kur vendimet gjyqësore jo vetëm që janë vonuar që të nxirren nga ana e gjykatësve, por edhe nuk janë hartuar fare.

“Në çështjen civile Cnr. 3288/04 procedura kishte përfunduar më 21.10.2010. Vendimi gjyqësor nuk ishte hartuar asnjëherë. Lënda kishte të bënte me çështjen e lirit të banesës nga njerëzit dhe gjësendet. Gjykatësi i çështjes ishte lëvizur në detyrë më 01.01.2013 në një departament tjetër të gjykatës. Një gjykatës tjetër ishte ngarkuar me këtë lëndë më dt.11.01.2013 dhe brenda një kohe të arsyeshme kishte nxjerrë vendimin gjyqësor. Rasti ka kaluar pa u hetuar nga ana e Zyrës së Prokurorit Disiplinor dhe ndëshkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Nga praktika e deritanishme në gjyqësorin e Kosovës gjykatësit me rastin e lëvizjes në detyrë e kanë pasur të ndaluar që të dorëzojnë raste të përfunduara por pa nxjerrë vendimin gjyqësor. Kjo ka mundur që të ndodhë vetëm në raste të sëmundjes apo vdekjes së gjykatësit”.

Raste të vonesës së nxjerrjes së vendimit gjyqësor edhe pse ka përfunduar procedura, janë hasur edhe tek çështjet e natyrës urgjente. Sipas sistemit ligjor në Kosovë kontestet nga marrëdhënia e punës kanë përfaqësuar raste të natyrës urgjente. Në praktikë ka pasur raste kur edhe pse është bërë përfundimi i procedurës nuk është bërë shpallja e vendimit dhe hartimi me shkrim i të njëjtit. Vonesat në hartimin e vendimeve gjyqësore apo mos hartimi i tyre me shkrim kanë pasur ndikimin e tyre edhe në vonimin e parashtruesit të padisë apo palëve në kontest në arritjen e shpejtë të drejtësisë.

5.4.6. Dhënia e vendimit gjyqësor pa dëgjim para gjykatës

Dokumentet ndërkombëtare kanë përcaktuar të drejtën e secilit për dëgjim para një gjykate të pavarur të paanshme dhe të krijuar me ligj. Krijimi i mundësisë që i akuzuari në procedurën penale apo pala e paditur në procedurat civile të japë versionin e tij/saj mbi ngjarjen jetësore juridike që është në zhvillim para gjykatës, përbën standardin shumë të rëndësishëm për ofrimin dhe garantimin e një procesi të rregullt gjyqësor. Edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar se : “Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj”(Kushtetuta e Republikës së Kosovës- neni 31). Kushtetuta ka përcaktuar të drejtën e secilit të akuzuar për vepër penale që t’u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

Dhënia e mundësisë së barabartë që secilit nga palët në proces të paraqesë çështjen e vet dhe asnjëra të mos gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj kundërshtarit garanton respektimin e parimit të barazisë së armëve që njëkohësisht është njëra ndër parimet që garanton procesin e rregullt gjyqësor. Ndonëse parimi i barazisë së armëve përfshin nocionin se të dy palët në një proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet dhe argumentet e palës kundërshtare dhe se secila palë duhet që të ketë një mundësi të barabartë për t’ju përgjigjur palës tjetër, në disa procedura gjyqësore në Kosovë ka pasur devijime nga ky parim. Në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës është paraparë se:

“Për veprat penale për të cilat parashihet dënimi me gjobë ose burgimi deri në tri (3) vjet, për të cilat prokurori i shtetit është informuar në bazë të provave të besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do t’i shqiptojë dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor. Prokurori i shtetit mund të kërkojë shqiptimin e një ose më shumë masave vijuese: dënimin me gjobë, ndalim të drejtimit të automjetit, urdhër për publikim të aktgjykimit, konfiskim të sendit, vërejtje gjyqësore ose konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprë penale (Kodi i Procedurës Penale – neni 493).

Nga kjo shihet se prokurori i shtetit duke mos bërë dëgjimin e palës, duke mos e njoftuar atë për dyshimin e ngritur për kryerjen e veprës penale, bëhet anashkalimi i fakteve apo rrethanave që do të mund të ishin në favorin e mbrojtjes dhe as që mund të bëhët fjalë për shfrytëzimin e fakteve dhe provave eventuale që do të mund të shkonin në favorin e mbrojtjes së të pandehurit. Në rastet e tilla prokurori i shtetit fare nuk ka zhvilluar hetime, nuk e ka njoftuar të pandehurin lidhur me dyshimet në drejtim të kryerjes së veprës penale por aktin akuzues e ka ngritur duke u bazuar vetëm në deklaratimet e palës së dëmtuar. Ngjashëm me prokurorin e shtetit edhe gjykata në rastet kur ka bërë pranimin e kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, nuk e ka njoftuar fare palën për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij, pa mbajtur fare shqyrtim publik, dhe pa i dhënë të akuzuarit të drejtën që të bëjë kundërshtimin e akuzës, ka shqiptuar dënimet me gjobë dhe masat e parapara me ligj.

“Me aktgjykimin P.nr.1853/07 të dt.18.12.2008 Gjykata Komunale në Prishtinë ka pranuar kërkesën e Prokurorisë në Prishtinë PP.nr. 2717-8/2007 të dt. 05.12.2008 dhe i kishte shqiptuar të pandehurit dënimin me gjobë në lartësi prej 400 €, për veprën penale- Rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par 3 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Kosovës. Arsyetimi i vendimit ishte fare i shkurtër dhe ishte i bazuar vetëm në dokumentacionin shkresor që kishte ofruar prokurori. I pandehuri R.M. nuk kishte qenë i informuar dhe nuk i ishte dhënë mundësia e dëgjimit para gjykatës dhe ofrimit të fakteve që do të shkonin në favor të mbrojtjes (Lënda Penale P.nr.1853/07 në Gjykatën Themelore në Prishtinë).

Mosdhënia e mundësisë së deklarimit të pandehurit dhe nxjerrja e vendimit pa dëgjim para gjykatës e që përbëjnë shkelje parimit të barazisë së armëve kanë përshkuar edhe proceset gjyqësore të udhëhequra nga gjykatësit e EULEX. Në rastin gjyqësor të njohur si “Bllaca-I”, Urdhri për shpalljen e të pandehurit N.B si dëshmitar bashkëpunues nuk i ishte dorëzuar fare të pandehurit F.G., ndonëse një gjë të tillë e parashikonte neni 302 i Kodit Penal. Mbrojtja në ankesën kundër Aktgjykimit me të njëjtin numër të nxjerrë nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, ka potencuar se “mos dërgimi i vendimit të pandehurit F.G. për shpalljen e N.B. si dëshmitar bashkëpunues paraqet shkelje të ligjit në dëm të pandehurit, sepse të pandehurit dhe mbrojtjes i është mohuar e drejta që të bëjnë kundërshtimin e vendimit pasi me asnjë dispozitë të Kodit të procedurës nuk është e paraparë se ankesa ndaj këtyre vendimeve nuk është e lejuar (Rasti gjyqësor P.nr.371/2010 në Gjykatën e Apelit në Prishtinë)

Shkelje të tilla në të njëjtin rast janë vërejtur edhe në procedurën e konfirmimit të aktakuzës.

“Në procedurën e konfirmimit të aktakuzës bazuar në nenin 313 parag. 2 të Kodit Penal shprehimisht është përcaktuar se prokurori dhe i pandehuri duhet të jenë të pranishëm në seancën e konfirmimit. Në rastin e sipërcituar vendimi lidhur me konfirmimin e aktakuzës KA 371/2010 i dt.21.12.2010 është nxjerrë pa pjesëmarrjen e palëve në seancën për konfirmimin e aktakuzës dhe palës as që kanë qenë të njoftuara për këtë seancë. Mbrojtja në ankesë ka potencuar se konfirmimi i aktakuzës nuk ka mundur që të bëhet pa pjesëmarrjen e palëve dhe sipas mbrojtjes kjo ka qenë një arsye më shumë lidhur me marrjen e vendimit në dëm të pandehurit”.

Si përfundim i kësaj mund të bëjmë konstatimin se procedura për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor pa dëgjim para gjykatës sigurisht se ka rëndësinë e vet në efikasitetin e punës në gjyqësor dhe në ekonomizimin e procedurës penale, megjithatë, aplikimi në praktikë i kësaj procedure përbën shkelje të të drejtave të të pandehurve të cilët në pamundësi të paraqitjes së mbrojtjes vihen në situatë jo të favorshme përballë palës tjetër që është prokurori i shtetit, e që është në kundërshtim me njërin nga parimet shumë të rëndësishme të procesit të rregullt gjyqësor- parimin e barazisë së armëve. Gjithashtu, nxjerrja e vendimit në procedurën e konfirmimit të aktakuzës pa pjesëmarrjen e palëve në një proces të udhëhequr nga gjykatësit e EULEX, lidhur me krimet e luftës dhe peshën që kishte ky

rast gjyqësor në opinionin e Kosovës, jo vetëm që paraqet shkelje të parimit të barazisë së armëve por edhe cenim tejet të rëndë të procesit të rregullt gjyqësor.

5.4.7. Gjykatat paralele në Kosovë gjatë Misionit të EULEX

UNMIK dhe Institucionet e Përkohshme të Qeverisjes në Kosovë (IPVQ), nuk arritën që të shtrijnë funksionimin efikas në tërë territorin e Kosovës. Kjo u bë për shkakun se Serbia vazhdoi që të ndërtojë dhe përkrah institucionet e saj në brendësi të territorit të Kosovës duke cenuar kështu rendin juridik dhe realitetin juridik që ishte krijuar pas vënies së Kosovës nën administrimin ndërkombëtar. Sikurse në pjesët tjera të pushtetit, paralelizma u shfaqën edhe në pushtetin gjyqësor. Serbia përbrenda territorit të Kosovës formoi gjykatat të cilat vepronin në enklavat serbe dhe posaçërisht ndikimin e madh të tyre e kishin në pjesën veriore të Kosovës. Këto gjykata vepronin pa autorizimin e UNMIK dhe drejtoreshin nga serbët etnik të Kosovës. Në këtë mënyrë në Kosovë u lejua që të veprojë një sistem ku këto gjykata vepronin si gjykata të shkallës së parë kurse vendimet e tyre mund të apeloreshin vetëm në gjykatat më të larta të Serbisë. Kështu gjykatat e Serbisë kanë shqyrtuar rastet të cilat i përkisnin kompetencës territoriale të Kosovës. Këto gjykata punonin ekskluzivisht me ligjet e Serbisë dhe nuk njihnin ligjet dhe juridiksionin të cilit i përkiste Kosova (Haxhaj, 2008: 72).

Përveç këtyre strukturave gjyqësore të jashtëligjshme që vepronin brenda territorit të Kosovës, ka ekzistuar edhe një varg institucionesh paralele të gjyqësorit që emërtoreshin si gjykata të Kosovës dhe që vepronin nëpër qytete të ndryshme të Serbisë. Këto gjykata

vepronin në raste të ndryshme që kishin të bënin me serbët e Kosovës. Ka pasur raste që serbët e Kosovës kanë prezantuar vendime nga më të ndryshmet të nxjerra nëpër këto gjykata por që të cilat vendime nuk janë njohur dhe pranuar asnjëherë dhe nuk kanë pasur efekt juridik para institucioneve legjitime të Kosovës. Gjykata të tilla kanë vepruar si Gjykata Komunale e Ferizajit e vendosur në Leskovc, Gjykata Komunale e Lipjanit e vendosur në Nish etj.

Deri në nxjerrjen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Prill 2008), jeta institucionale në Kosovë rregullohej me Kornizën Kushtetuese të Kosovës (Rregullorja e UNMIK nr. 2001/9). Kjo kornizë ligjore kishte mbështetjen juridike në Rezolutën e KB 1244 e cila kishte autorizuar UNMIK si të vetmin autoritet legjitim me PSSP-në si autoritetin e fundit ligjor në Kosovë. Kjo kornizë ligjore përjashtonte ekzistimin e dualizmit të akëcilit pushtet shtetëror brenda territorit të Kosovës e aq më tepër pushteteve të imponuara nga jashtë territorit të Kosovës.

Në kohën kur Kosova e përkrahur nga bashkësia ndërkombëtare po bënte përgatitjet e fundit për dhënien fund të një administrimi i cili udhëhiqej nga Kombet e Bashkuara, presidenti Marti Ahtisari harton Propozimin Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Propozimi kishte parashikuar që Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të ketë pavarësi të plotë në kryerjen e funksioneve të tij me qëllim të sigurimit të një sistemi të integruar, të pavarur dhe profesional dhe të paanshëm të drejtësisë, sigurimit të qasjes në drejtësi për të gjithë personat në Kosovë dhe garantimit që sistemi i drejtësisë së Kosovës është gjithëpërfshirës dhe pasqyron plotësisht natyrën shumetnike të Kosovës (Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, 26 mars 2007 - neni 6.5). Lidhur me pjesëmarrjen e prestarëve të komuniteteve jo shumicë në gjyqësor, Propozimi përcaktonte

se së paku pesëmbëdhjetë përqind (15%) të Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, por në asnjë rast më pak se tre (3) gjyqtarë do të jenë nga komunitetet jo shumicë në Kosovë. Në gjykatën e shkallës së dytë kjo përqindje është parashikuar që të jetë e njëjtë por me ndryshimin se në asnjë rast jo më pak se dy (2) gjyqtarë do të jenë nga komunitetet jo shumicë.

Gjendja edhe më tepër në këtë pjesë të Kosovës (pjesën veriore) u rëndua kur në shkurt të vitit 2008 Kosova shpalli pavarësinë e saj. Serbët lokal pushtuan me dhunë dhe mbajtën për javë të tëra të okupuara ndërtesat e gjykatave shtetërore të Kosovës deri në ndërhyrjen e forcave të sigurisë. Që nga ajo kohë në këto ndërtesa punojnë me staf të pakët gjyqtar dhe prokuror ndërkombëtar nga misioni i EULEX, por që edhe më tutje qasja e prestarëve të nacionalitetit shumicë që janë shqiptarët mbetet ende larg nga ndarja apo marrja e drejtësisë nga këto institucione.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton barazi para ligjit, të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore pa diskriminim, mos diskriminim në asnjë mënyrë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar apo ndonjë statusi tjetër personal. Kushtetuta ka përcaktuar se parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë (Kushtetuta e Republikës së Kosovës- neni 24). Sa i përket Sistemit gjyqësor, Kushtetuta ka pranuar në tërësi normativën e propozuar në Propozimin e Ahtisarit (Kushtetuta e Republikës së Kosovës- nenet 102-108). Kosova vazhdoi me kryerjen e reformave në gjyqësi duke bërë nxjerrjen e ligjit të ri për gjykatat dhe duke bërë përshtatjen

e strukturës së gjykatave kushteve bashkëkohore, dhe lënien parapa të sistemit të kaluar lidhur me to.

Edhe pse Kushtetuta e Kosovës ofron garanci mjaft të avancuara për komunitetet jo shumicë dhe të drejtat e tyre, kjo nuk ka bërë që pjesëtarët e nacionalitetit serb të cilët jetojnë në pjesën veriore të mjaftohen me këto garanci kushtetuese. Edhe përkundër zotimit të vazhduar politik të administratës ndërkombëtare dhe liderëve udhëheqës të Kosovës që çështja e strukturave paralele të zgjidhet, realiteti në terren vazhdoi të dëshmojë të kundërtën. Mungesa e sistemit gjyqësor plotësisht funksional në pjesën veriore të territorit të Kosovës vazhdoi që të përbënte shkelje serioze të së drejtës për qasje në drejtësi, të drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, të drejtës për liri etj.

5.4.8. Dështimi në mbrojtjen e dëshmitarëve

Dëshmia është deklarim i personit fizik lidhur me perceptimet shqisore për faktet e rëndësishme nga e kaluara të dhëna në formë procedurale para organit kompetent. Duke dëshmuar dëshmitari shprehë perceptimet e veta lidhur me faktet të cilat janë më rëndësi për ndriçimin e çështjes (Sahiti, 2005: 164, c). Një sistem efektiv i drejtësisë penale që operon nën sundimin e ligjit, nuk mund të funksionojë si duhet pa prezantimin e dëshmive relevante në procedimet gjyqësore (OSBE- Misioni në Kosovë, *Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010*: 4). Çdo person i thirrur si dëshmitar duhet t'i përgjigjet thirrjes, e kur me Kodin e Procedurës Penale nuk është përcaktuar ndryshe, duhet edhe të dëshmojë (Kodi i Procedurës Penale - neni 124). Edhe pse qytetarët kanë për obligim qytetar dhe

obligim ligjor për të ofruar informata lidhur me aktivitetin kriminal dëshmitar të të cilit kanë qenë, ata në shumë raste hezitonin ta bënin këtë, nga frika se bashkëpunimi i tyre me zyrtarët e zbatimit të ligjit kërcënonte sigurinë e tyre dhe të anëtarëve të familjeve të tyre. Ndonëse korniza ligjore në Kosovë ka mundësuar që të ekzistojnë mundësitë si dëshmia anonime, dëgjimet nga distanca, dëgjimet jo-publike, ndarja fizike e të pandehurit nga dëshmitari etj., dëshmitarët shumë shpesh refuzonin që të paraqiteshin me informacione. Në shumicën e rasteve dëshmitarët fillimisht jepnin deklaratata para policisë, më vonë ndërronin deklaratën e tyre apo nuk ishin të gatshëm që të dëshmojnë gjatë gjykimit. Ky ngurrim arsyetohet me atë se rastet e frikësimit dhe lëndimit të dëshmitarëve ishin aq të shpeshta dhe nga më të ndryshmet.

“Në Gjykatën Komunale të Klinës në një çështje penale Prokuroria kishte ngarkuar një të pandehur për veprën penale të kanosjes. Një 65 vjeçar kishte kanosur një vajzë e cila kishte qenë dëshmitare në një vrasje për të cilën ngarkohej djali i tij. Vajza kishte kërkuar nga gjykata që rasti të mos procedohej sepse ndjehej e rrezikuar pasi mendonte se me procedimin e çështjes kërcënimet do të fillonin sërish ndaj saj. Ajo nuk kishte besim tek mbrojtja që mund t’i ofrohej (Rasti gjyqësor Prokuroria Komunale në Pejë kundër të pandehurit Gj.D.)”

Siguria fizike për dëshmitarët kërkonte mbrojtjen e dëshmitarëve dhe zhvendosjen e tyre para, gjatë dhe pas mbajtjes së gjykimit. Kjo siguri nënkuptonte edhe sigurinë fizike dhe zhvendosjen e edhe personave të afërm të dëshmitarit të cilët mund që të ndjeheshin të rrezikuar si pasojë e dëshmisë së dhënë nga ana e familjarit të tyre. Mbrojtja e dëshmitarëve

dhe inkurajimi i bashkëpunimit ka rezultuar si një gjë e vështirë për t'u realizuar në Kosovë për disa arsye. Së pari, ndër pengesat që janë vërejtur në mbrojtjen praktike të dëshmitarëve ka paraqitur territori i vogël që ka Kosova dhe lidhjeve të ngushta familjare që ende ruhen në Kosovë. Si pasojë e kësaj një numër relativisht i lartë i personave mund që të njihet nga një rreth i gjerë i personave dhe nga kryesit e supozuar apo nga publiku. Së dyti, të dëshmuarit në disa raste sidomos në rastet e supozuara për krime të luftës konsiderohej si një “tradhti ndaj Kosovës”, dhe mundësia që t'i ekspozohet frikësimit por edhe lëndimit fizik ishte mjaft e lartë. *Në Rastin gjyqësor kundër të pandehurit S.L. dhe të tjerëve në një qytet të Kosovës, nga ana e personave të panjohur ishin ngjitur posterë të cilët kishin zbuluar identitetin e dëshmitarit të mbrojtur. Zbulimi i identitetit të dëshmitarit të mbrojtur në një rast tjetër gjyqësor ishte zbuluar nga mediet të cilat aso kohe nuk kishin qenë në gjendje të kuptonin rolin e tyre gjatë raportimeve nga seancat gjyqësore.* Në këtë kontekst zhvendosja e tyre brenda territorit të Kosovës nuk paraqiste mjet efektiv për garantimin e sigurisë së tyre. Së treti, krijimi i besimit tek shumica e banorëve të Kosovës se shumë nga kryesit potencial janë të lidhur me figurat me ndikim në politikën kosovare apo gëzojnë përkrahjen e tyre dhe kur kësaj i shtohet tërë ajo që kanë përjetuar nën regjimin totalitar të mëparshëm, i ka bërë ata mosbesues ndaj qeverisë dhe gjyqësisë në përgjithësi dhe ngurrues për të shërbyer si dëshmitarë në rastet penale. Së katërti, në çështjet penale në Kosovë është vërejtur një nivel tejet i ulët i gatishmërisë së vetë personave pjesëmarrës në aktet kriminale që të jenë të gatshëm të bashkëpunojnë. *Deri më tani janë të njohura vetëm dy raste në Kosovë për të cilat është zhvilluar shqyrtim gjyqësor ku të akuzuarit kanë pranuar që të bashkëpunojnë. Rasti i parë është Rasti “Bllaca-I, II” me dëshmitarin bashkëpunues N. B. dhe rasti i dytë është Rasti “Kleçka” dhe dëshmitari “X”.*

Gjithashtu ka pasur raste kur vetë dëshmitari ka kërkuar vetë që të zbuloj identitetin e tij dhe ka bërë edhe ndërrimin e deklaratës.

“Në Rastin kundër Grupit të Drenicës dëshmitari “L” që më parë kishte qenë dëshmitar i mbrojtur, vetë kishte kërkuar që të zbulohet identiteti i tij dhe kishte bërë ndërrimin e deklaratës ndonëse kishte qenë i paralajmëruar nga ana e kryetarit të trupit gjykues lidhur me pasojat ligjore”.

Në të shumtën e rasteve ndërrimi i deklaratës është bërë kur dëshmitarit i është premtuar mbrojtje me zhvendosjen e tij dhe të anëtarëve të familjes jashtë Kosovës. Meqenëse një gjë e tillë nuk është bërë, ai e ka ndjerë vetën të rrezikuar.

Dështimi në mbrojtjen e dëshmitarëve në Kosovë ka arritur kulmin në rastin e dëshmitarit “X”.

“Dëshmitari X- A. Z. ishte përfshirë në një program për mbrojtje të dëshmitarëve. Ai kishte qenë dëshmitar kyç në një rast për krime të luftës në Kosovë. Ai ishte gjetur i vdekur në një park të Gjermanisë, më dt. 28.09.2011. EULEX nuk jep detaje për rrethanat e vdekjes së dëshmitarit X. Vdekja e tij kishte ndodhur vetëm pak javë para se të filloj procesi gjyqësor në Prishtinë” (www.lajme.shqip.com).

Si përfundim mund të themi se mbrojtja e dëshmitarëve ka qenë dhe mbetet një nga sfidat kryesore për autoritetet e drejtësisë në Kosovës. Sipas precedentit të Gjykatës

Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), jeta liria apo siguria e dëshmitarëve nuk duhet të “rrezikohet në mënyrë të pajustificuar” (OSBE- Misioni në Kosovë, *Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë, 2007 – 2010*: 6). Autoritetet publike kanë për detyrë të mbrojnë dëshmitarët dhe të afërmit e tyre të ngushtë para gjatë dhe pas gjykimit. Mbrojtja efektive e dëshmitarëve është vendimtare për funksionimin e sistemit ligjor. Mirëfunksionimi i sistemit ligjor krijon mundësi edhe për procesin e rregullt gjyqësor, për të cilin mendojmë se roli i dëshmitarëve është i pa zëvendësueshëm në arritjen e një drejtësie të mirëfilltë.

5.4.9. Menaxhimi jo i mirë i lëndëve gjyqësore

Menaxhimi i lëndëve gjyqësore përfshin aspektin administrativ dhe aspektin e marrjes së vendimeve. Qëllimi qenësor i menaxhimit të lëndëve është që të mundësohet arritja e drejtësisë në kohë të duhur dhe në mënyrë të drejtë në të gjitha rastet (Programi për Mbështetjen e Drejtësisë në Kosovë, USAID, NCSC, Prishtinë 2009). Gjykatat duhet të bëjnë menaxhimin e lëndëve të tyre në mënyrë që të bëhet evitimi i padrejtësive, ruajtja e pavarësisë së gjyqësorit, të avancohet respektimi i ligjit, të bëhet dekurajimi i krimit, të ngritët besueshmëria në gjyqësor dhe të bëhet evitimi i vetëgjyqësisë, të bëhet inkurajimi i rritjes ekonomike dhe investimeve ekonomike etj.

Numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve, mungesa e stafit mbështetës, mungesa e hapësirës për punë, mungesa e sallave të gjykimit, por edhe mungesa e organizimit të mirë të kryerjes së lëndëve janë disa nga shkaqet e menaxhimit jo të mirë të lëndëve që profesionistët ligjor i apostrofojnë në këtë kohë. Për menaxhim jo të mirë të lëndëve

kritikohet edhe përbërja ndërkombëtare. Grupi në fokus thekson edhe përgjegjësinë e vet gjykatësve dhe personelit administrativ në gjykata. Ka raste kur një rast penal mundet që të përfundoj brenda një periudhe të shkurtër (4-5 seanca gjyqësore), kurse i njëjti zgjatë me muaj e ndoshta edhe një vit e më shumë (Nga hulumtimi i kryer me avokatët e Prishtinës).

“ Avokati mbrojtës kishte ushtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjyimit të dhënë në shkallë të parë dhe atij të dhënë në shkallë të dytë. Rasti kishte qenë duke u trajtuar nga gjykatësit e EULEX. Kërkesa ishte deponuar në ish Gjykatën e Qarkut në Prishtinë në fund të vitit 2012. Në fillim të vitit 2013 është bërë riorganizimi i gjykatave dhe shkresa kishte mbetur nëpër sirtarë të gjykatës. Të pandehurit i ishte shkaktuar vonesë në shqyrtimin e pretendimeve të tij nga ana e gjykatës më të lartë”.

Menaxhim jo i mirë i rasteve është vërejtur edhe në rastet kur lëndët duhej që të përfundoheshin me prioritet, ndërsa ky prioritet nuk respektohej. Ka pasur raste që këto procedura nuk janë respektuar edhe në raste shumë të ndjeshme siç kanë qenë rastet në procedurat e mbrojtjes kundër dhunës në familje e të cilat raste sipas ligjit paraqesin procedura ku gjykata duhej të vepronte në një afat shumë të shpejtë.

“ Në rastin D.K. gjykata kishte dështuar që të shqiptojë urdhrin mbrojtës. Lënda ndonëse kishte qenë e tillë e cila sipas ligjit do të duhej që të trajtohej me prioritet në të njëjtën ishin ndërruar tre gjykatës. Pala e cila kishte kërkuar mbrojtje kundër dhunës në familje, nuk kishte fituar mbrojtje nga gjykata. Personi përgjegjës në

mungesë të një urdhri të tillë kishte kryer aktin e vrasjes së D.K. Rasti kishte shkaktuar pakënaqësi dhe kundërshtime nga organizatat për mbrojtjen e gruas si dhe tek qytetarët dhe shoqëria civile në Kosovë.”

Rastet e menaxhimit jo të mirë të lëndëve gjyqësore përveç se në shkallën e parë, janë vërejtur edhe në procedurat pranë Gjykatës së Apelit si gjykatë e shkallës së dytë. Lëndët me prioritet prisnin që të zgjidheshin më gjatë se sa limitet që kishin vënë dispozitat ligjore. Këto raste përbënin raste për të cilat gjykata nuk do të duhej që të kishte asnjë justifikim.

“Në rastin C.nr. 2421/14 Gjykata Themelore në Prishtinë kishte shqiptuar Urdhrin mbrojtës me të cilin palës përgjegjëse i ishte ndaluar kryerja apo kërcënim i se do të kryej ndonjë vepër të dhunës në familje. Gjykata e shkallës së parë bazuar në dispozitat ligjore kishte caktuar seancën e dëgjimit të vërtetimit të këtij urdhri pas tetë ditësh (seancën për arsyshmërinë apo jo të lënies në fuqi, apo zgjatjen e kohës së vazhdimit të urdhrit). Kundër këtij vendimi pala përgjegjëse kishte ushtruar ankesë brenda tre (3) ditësh. Lënda në afatin optimal ishte dërguar në gjykatën e shkallës së dytë me sqarimin se duhej që të vendosej brenda afatit sa më të shpejtë sepse ishte e caktuar seanca e dëgjimit të urdhrit brenda tetë ditësh siç u sqarua më lartë. Gjykata e shkallës së dytë jo vetëm që nuk kishte vendosur brenda këtij afati por që as në afatin prej një muaji”.

Rastet e menaxhimit jo të mirë të lëndëve janë vërejtur edhe në procedurat e njohjes së të drejtës së pronësisë, procedurat nga marrëdhënia e punës etj. Menaxhimi jo i

mirë i rasteve gjyqësore ka ndikimin e tij në procesin e rregullt gjyqësor. Një menaxhim jo i mirë shkakton vonesa në arritjen e drejtësisë. Vonesa në arritjen e drejtësisë bie ndesh me parimin e procesit të rregullt i cili kërkon që ky proces të bëhet brenda një kohe të arsyeshme.

5.4.10. Pavarësia e gjyqësorit

Parimi i pavarësisë së gjyqësorit është i drejtpërdrejtë; ai kërkon që gjykatat të jenë të paanshme në vendosje të çështjeve, të jenë pa kufizime, ndikim të pavend, shtytje, trysni, kërcënime apo ndërhyrje (OSBE-Misioni në Kosovë, *Pavarësia e gjyqësorit në Kosovë: Dimensionet Institucionale dhe Funksionale*, 2012: 5). Ballafaqimi i gjyqësorit me një mori sfidash komplekse dhe serioze kanë bërë që gjyqësori të jetë nën trysni të jashtëzakonshme. Numri i madh i lëndëve, krimi i organizuar i rrënjosur, kontestet pronësore të ndërlikuara, trashëgimi i një ndikimi të fuqishëm të ekzekutivit, krime ndëretnike, pretendimet për korrupsion, ngarkesat me rastet e krimeve të luftës dhe infrastruktura e dobët përmenden disa nga sfidat që shoqëruan gjyqësorin e që kanë të bëjnë në mënyrë direkt me pavarësinë e tij. Komisioni Evropian në raportin e tij ka vërejtur një varg sfidash: “Krahas sfidave si korrupsioni dhe nepotizmi, ndërhyrja vazhdueshme politike në nivele dhe forma të ndryshme në një numër rastesh, përfshirë këtu edhe punën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përbën shqetësim serioz” (Raporti i Progresit për Kosovë i Komisionit Evropian, SEC(2010) 1239, 2010: 11).

Procesi i riemërimit dhe transferimit të gjykatësve në Kosovë gjatë kësaj kohe u karakterizua me ndërhyrje të mëdha. Ky proces ishte tejet i gjatë, merrte shumë kohë dhe

krijonte problem në plotësimin e vendeve vakante. Në anën tjetër mosplotësimi shkaktonte shtimin e lëndëve të prapambetura nëpër gjykata. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kompetencat lidhur me riemërimin e gjykatësve kaluan në misionin e udhëhequr nga Bashkimi Evropian. Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial- KPGJP ishte trup autonom i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Është interesante se i tërë rekrutimi dhe procedurat lidhur me riemërimin e gjykatësve dhe prokurorëve i zhvillonin komponenta ndërkombëtare, ndërkaq Këshilli Gjyqësor ishte ai që nga lista e të përzgjedhurve nga ndërkombëtarët, bënte edhe një përzgjedhje dhe ia dërgonte presidentit të Kosovës për dekretim. Ajo çka është e qartë është se në secilën fazë kuadri gjyqësor i cili rekomandohej nga KPGJP –ja nuk ishte ai që përfundimisht emërohej dhe kishte një refuzim nga ana e presidentit pa dhënë ndonjë arsye dhe pa ndonjë transparencë të duhur. Standardet ndërkombëtare kërkojnë “kritere meritore dhe objektive” të cilat duhet të jenë referenca e secilit vendim në lidhje me karrierën profesionale të gjyqtarëve. “Ndërhyrja politike në procesin e riemërimit të propozimeve të dhëna nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës janë çështje vërtetë shqetësuese”- thuhej në Raportin e Progresit 2010 të Komisionit Evropian.

Megjithatë në praktikë janë vërejtur edhe raste në të cilat më rastin e riemërimit të gjykatësve, kandidatura të personave ndonëse të propozuar dhe vlerësuar lartë nga KPGJP nuk janë marrë parasysh dhe pa dhënë asnjë arsye nuk janë dërguar nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës- KGJK për dekretim tek presidenti. Krijimi i grupeve të caktuara të interesit edhe përbrenda vetë gjyqësorit dhe KGJK-së në këtë fazë, kanë bërë që të shfaqen me këtë rast edhe dallime dhe preferenca për kandidatë të caktuar që janë dërguar për t’u dekretuar. Kandidatë të gjetur në një gjendje të tillë nuk kishin mekanizma tek të cilat do të mund të ankoheshin. Kishte pasur raste kur personat e dëmtuar në këtë mënyrë kishin

kërkuar sqarim nga KPGJP por që kishin marrë përgjigjen se tanimë çështja ndodhej në duart e KGJK dhe ajo ishte kompetente për dërgimin e mëtutjeshëm për dekretim tek presidenti. Në disa raste kandidatë të dëmtuar nga ky proces kishin qenë të detyruar që përmes një letre të i drejtoheshin vetë presidentit dhe të sqaronin pozitën e tyre dhe dëmin që po u shkaktohej që pa asnjë arsye personave që kishin kaluar të gjitha procedurat e verifikimit nuk dërgoheshin për dekretim (Ankesa e gjykatësit drejtuar Presidentit të Republikës së Kosovës, e datës 16 qershor 2010 dhe Shkresa Nr. Prot: 235/1, datë 18.08.2010 Presidenti kishte njoftuar ankuesin se çështja është adresuar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës për shqyrtim të mëtejshëm). Ndër arsyet e veprimit në këtë mënyrë brenda për brenda vetë Këshillit Gjyqësor veçojmë të dhënë se Këshilli në këtë kohë kishte në përbërje edhe avokatë të cilët sigurisht që kishin interesa të caktuara që në sistem të kishin gjyqtarë të cilët i njihnin dhe kishin pasur që më parë afërsi me ta, por edhe gjyqtarët e parë që u angazhuan në këtë kohë në Këshill me punën e treguar kanë shfaqur preference në drejtim të gjykatësve që vinin nga gjykatat ku kishin punuar më parë vetë anëtarët e këshillit ose nga rajonet që përfaqësonin ata. Siç edhe është vërejtur përveç ndërhyrjeve që u apostrofuan më lartë ka pasur edhe një siç do ta quaja “ndërhyrje në ndërhyrje”, brenda për brenda vetë anëtarëve të Këshillit Gjyqësor.

Edhe procesin e transferimit të gjykatësve me rastin e kalimit në sistemin e reformuar të gjykatave në janarin e vitit 2013 e karakterizuan të meta të mëdha. Përgatitja e procesit të transferimit të gjykatësve u bë në maj të vitit 2012 kur edhe u bë përzgjedhja e gjykatësve për në Gjykatën e Apelit. Në listën prej 32 gjykatësve të propozuar nga Komisioni përzgjedhës dhe të aprovuar nga Këshilli Gjyqësor më se 7 gjykatës nuk kishin përmbushur as edhe tri vite në përvojën e tyre si gjykatës ndërkohë që ligji kërkonte që të

kenë përvojën e tyre mbi 7 vjeçare në gjyqësi(Komisioni Mbikëqyrës që kishte bërë përzgjedhjen e gjykatësve kishte rekomanduar një „listë të pritjes” prej tre (3) gjykatësve, të cilët mund të zëvendësojnë kandidatin që mund të tërhiqet nga kjo listë me dëshirën e tij. Ndonëse ekzistonte lista e pritjes Këshilli gjyqësor bëri anashkalimin e edhe të kësaj liste duke zgjeruar listën e të përzgjedhurve edhe me dy gjykatës të tjerë e që botërisht ka të dhëna për implikim të politikës në përzgjedhjen e tyre). Disa nga ankesat e të mbeturve jashtë kësaj liste, ndonëse kishin performancën e pakontestueshme dhe përvojën e duhur, u refuzuan me arsyetimin se “përvoja e tyre e punës në gjyqësor nuk plotëson minimumin e përvojës që kërkohet me ligj” (Vendimi i Komisionit të ankesave i datës 30 korrik 2012 e që përmban firmën e Kryesuesit të Asamblesë së gjykatësve të EULEX, Francesco Florit) . Në këtë kohë Komisioni i ankesave përbëhej nga dy gjyqtarë të gjykatës Supreme dhe ishte i kryesuar nga Kryesuesi i Asamblesë së Gjykatësve të EULEX, ndonëse vetë EULEX në raportin e tij vjetor për vitin 2011, vetë kishte pranuar se “ndërrhyrja politike në riemërimin e gjykatësve dhe prokurorëve ende konsiderohet si një rrezik i prekshëm” (Raporti i EULEX për vitin 2011: 34).

Ndërrhyrjet në gjyqësor nga “politika”, kanë shfaqur tendencën e tyre edhe me rastin e tentimeve të hapjes së debatit në Parlament për raste të caktuara gjyqësore që ishin në zhvillim e sipër ose që kanë përfunduar, si dhe tendencat që të diskutoheshin vendimet gjyqësore (Në Parlamentin e Kosovës gjatë vitit 2012, ishte tentuar që të diskutohet për rastin “Kiçina”). Ndërrhyrjet në gjyqësor janë shfaqur edhe në atë se gjyqësori në Kosovë nuk ka linjë buxhetore të veçantë dhe me këtë rast edhe nuk ka pasur mundësinë e rritjes së numrit të stafit mbështetës që në këtë kohë është aq i nevojshëm për gjykatat dhe domosdo ka edhe ndikimin e tij në procesin e rregullt gjyqësor. Mungesa e stafit mbështetës në

numër të nevojshëm dhe të specializuar ka qenë njëra ndër kërkesat e vazhdueshme të gjykatësve që nga koha e pasluftës. Grupi në fokus i gjykatësve të anketuar për qëllimet e hulumtimit këtë fakt e ka potencuar në mbi 90% të përgjigjeve të dhëna.

“Gjykatësit kanë shfaqur pakënaqësitë e tyre lidhur me pozitën e tyre. Gjykatësit kanë shprehur brengën e tyre se pozita e tyre nuk është e barabartë me zyrtarët e tjerë të lartë gjyqësor sepse pagat e tyre janë shumë më të ulëta se sa zyrtarët e tjerë të lartë të rangut të njëjtë dhe janë në pozitë shumë më të ulët se sa zyrtarët-juristët që punojnë në Kompanitë e ndryshme publike. Ata nuk janë të barabartë në pikëpamje të pagës as edhe me prokurorët e të njëjtit rang dhe kanë pozitë më të ulët se këta të fundit. Gjykatësit nuk gëzojnë beneficione të tjera për punën jashtë orarit, punën në ditët e pushimit javor, kujdestaritë apo kompensimet shtesë të cilat i kanë zyrtarët e tjerë shtetëror. Gjykatësit vlerësojnë se norma mujore që kërkohet për lëndët e përfunduara është tejet e lartë dhe duhet që të rishikohet sidomos në lëndët e natyrës civile në instancën e parë (gjykatat themelore) dhe në Gjykatën e Apelit. Gjykatësit vlerësojnë se numri i lartë i rasteve që sipas normës së përcaktuar kërkohen që të përfundohen nuk lë hapësirë për kreativitet dhe cilësi të duhur në vendimet gjyqësore. Gjykatësit normën e lartë të zgjidhjes së rasteve e kanë parë edhe si pengesë me rastin e shqyrtimit të performancës dhe avancimin e vetë gjykatësit” (Nga hulumtimi i zhvilluar me gjykatësit e Gjykatës së Apelit dhe gjykatësit e Gjykatës Themelore në Prishtinë, nëntor 2014).

Gjykatësit kanë shfaqur pakënaqësitë edhe sa i përket imunitetit, për të cilin shumica e të anketuarve janë shprehur se nuk respektohet nga institucionet tjera e veçmas nga prokuroritë. Përveç kësaj gjykatësit vlerësojnë se imuniteti është i garantuar me Kushtetutë por mungojnë dispozitat përkatëse ligjore për rregullimin e çështjeve të tjera lidhur me imunitetin.

“Gjykatësit mendojnë se mungojnë dispozitat përkatëse ligjore lidhur me imunitetin siç janë kohëzgjatja e imunitetit, mënyra e heqjes së imunitetit, mekanizmat mbrojtës në rast të cenimit të imunitetit etj. Gjykatësit kanë theksuar se përkundër asaj se imuniteti është i garantuar me Kushtetutë, në bazë të kërkesës së palës së pakënaqur me vendimin gjyqësor, gjykatësit që kanë nxjerrë këtë vendim i nënshtrohen procedurës hetimore në prokurori, vetëm se ekziston dyshimi i palës se gjykatësi ka nxjerrë vendim të kundërligjshëm. Sipas tyre me këtë rast shkelen dy parime themelore: parimi i pavarësisë dhe parimi i dyshkallsisë”(Nga pyetësi në të cilin janë përgjigjur gjykatësit e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëntor 2014).

Gjyqtarët kanë shfaqë brengën e tyre se imuniteti i paraparë me Kushtetutë dhe ekzistimi i veprës penale “Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore” në Kodin Penal të Kosovës janë dy gjëra që nuk shkojnë së bashku.

“ Neni 432 i Kodit Penal [Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore]

Gjyqtari i cili me qëllim të përfutimit të kundërligjshëm të çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër ose për t'i shkaktuar dëm personit tjetër, nxjerr vendim të

kundërligjshëm, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Derisa në Kodin Penal është e përfshirë vepra penale “Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore”, gjykatësit nuk kanë imunitetin dhe nuk mund të bëhet fjalë për pavarësinë dhe paanësinë e gjykatësve”(Nga pyetësi në të cilin janë përgjigjur gjykatësit e Gjykatës Themelore në Prishtinë, nëntor 2014).

Ekzistimi i kësaj vepre në Kodin Penal në mënyrën se si është emërtuar nuk është në përputhje me përshkrimin ligjor dhe është emërtim i gabuar, ngase çdo vendim që anulohet nga gjykata e një instance më të lartë, është vendim i kundërligjshëm, sepse, po të mos ishte i tillë nuk do të anulohet (nga gjykata e shkallës së dytë), së dyti, dispozitivi përshkrues i veprës penale është ndërtuar gabimisht dhe në kundërshtim me qëllimin që ka kjo normë ligjore inkriminuese (Hasani, F., 2014: 1261).

Gjatë kësaj kohe në punë e sistemit gjyqësor janë vërejtë edhe një varg ndërhyrjesh e të cilat ndërhyrje kanë cënuar rëndë pavarësinë e gjykatave. Prioritet e caktuara në mënyrë administrative lidhur me atë se cilës natyrë të lëndëve duhet dhënë përparësi janë ndër cënimet e kësaj natyre. Në caktimin e këtyre prioriteteve kishin ndikim qoftë faktorë të ndryshëm ndërkombëtar, qoftë këtë e kërkonte “momenti politik” në të cilin gjendej Kosova, e nganjëhere edhe për shkak të “dhënies së kontributit në imazhin e Kosovës para faktorit ndërkombëtar”. Si prioritete të natyrës së parë e në të cilat kishin ndikim “miqët ndërkombëtar”, ishin lëndët ku si palë paraqiteshin minoritetet. Lëndët ku pala paditëse në procedurë ishte nga minoritetet procedohej me përparësi dhe monitorohej nga organizmat monitorues ndërkombëtar deri në përfundimin e saj. Si lëndë të cilat “do të kontribuonin në imazhin e Kosovës para faktorit ndërkombëtar” ishin lëndët që kishin të bënin me

korupsionin dhe lëndët lidhur me “keqpërdorimet” gjatë procesit zgjedhor dhe ato që kishin të bënin me Agjencinë Kosovare të Pronës. Vlenë të theksohet se të gjitha këto prioritete caktoheshin dhe listoheshin nga organizmat jo gjyqësor por që Këshilli Gjyqësor nuk hezitonte aspak që të bëjë miratimin e tyre pa ndonjë analizë paraprake dhe pa ndonjë kosto të vetë procesit. Prioritetet e caktuara në vendosjen e lëndëve në këtë mënyrë, mendojmë se përbëjnë prioritete administrative të cilat nuk përkojnë me dispozitat kushtetuese të cilat kanë përcaktuar *barazinë para ligjit* as me Praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në të cilën është paraparë se *është vetë gjykata e cila përcakton kohën dhe mënyrën e kryerjes së veprimeve procedurale*. Në anën tjetër dhënia prioritet e zgjidhjes së çështjeve të caktuara në gjykatë duke vendosur në mënyrë administrative se cilat çështje duhet që të procedohen gjithsesi ka lënë prapa çështje shumë të ndjeshme e që ligji u ka dhënë prioritetin që të bëhet procedimi i tyre përpara lëndëve të tjera. Ndër lëndët gjyqësore që përbënin prioritet ligjor ishin çështjet lidhur me paraburgimin, çështjet e divorcit, çështjet tjera statusore lidhur me atësinë, amësinë, ushqimin ligjor, masat e sigurimit, çështjet lidhur me procedurën përmbarimore etj.

Edhe në çështjet që kishin të bënin me rastet kur si palë e paditur në procedurë paraqiteshin institucionet e shtetit dhe të cilat raste kishin implikime buxhetore, kishte një cenim të rëndë të barazisë së palëve dhe të të drejtave të tyre në procedurë si dhe me këtë edhe vetë pavarësisë së gjykatës. Ligji për menaxhimin e financave publike në këto raste kërkonte që gjykata të bëjë ndërprerjen e procedurës në afat prej 180 ditësh gjë që shkaktonte vonesa të shumta në drejtim të arritjes së drejtësisë (Ligji për Menaxhimin e Financave Publike në Kosovë - 2005/02-L-16, neni 68).

Përdorimi i medieve për qëllime gjyqësore dhe ndërhyrje në punën e gjykatës, ka shënuar raste të shumta në Kosovë në këtë kohë. Gjykatësit të cilët kanë qenë të kyqyr në rastet gjyqësore e që raste të tilla kanë cenuar interesa të grupeve të caktuara të interesit shpeshherë në media të shkruara dhe elektronike janë etiketuar dhe është bërë përpjekje që të paraqiten si jo kredibël dhe jo denjë për të ushtruar detyrën e gjykatësit. Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka shfaqë gatishmërinë që t'u dal në mbrojtje gjykatësve. Këtë e ka bërë vetëm në një rast uke theksuar se mediumi në fjalë (si pushtet i katërt) ka shkelur kështu një nga parimet bazë të punës së gazetarisë, deri aty sa ka lejuar të shndërrohet në armë hakmarrjeje ndaj individëve që ndajnë drejtësi.

Për më tepër shih shënimin:

“Është për të ardhur keq që një medium lejon interesat e ngushta personale të keq informojnë dhe të manipulojnë opinionin publik në dëm të së vërtetës, duke shkelur kështu një nga parimet bazë të punës së gazetarisë si pushtet i katërt, e madje lejon të shndërrohet në armë hakmarrjeje ndaj individëve që ndajnë drejtësi. Pavarësisht rolit të saj madhështor në funksion të mirinformimit, mediet nuk duhet abuzuar me lirinë e të shprehurit, e posaçërisht nëse ky abuzim tjetërsohet në ndikim në punën, pavarësinë dhe paanësinë e gjyqësorit- thuhej në Komunikatën për media të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (<http://www.kgjk-ks.org/> 02.11.2014).

5.4.11. Shqyrtimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut jashtë institucioneve gjyqësore

Procesi i shqyrtimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut jashtë institucioneve gjyqësore është një metodë që u trashëgua nga misioni parardhës ndërkombëtar-Misioni i UNMIK. Që në atë kohë organizma të shumtë vendor dhe ndërkombëtar kishin vënë në thumb të kritikës një mënyrë të tillë të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut pasi që në fund të fundit panelet e krijuara nga vet misioni dhe që i përgjigjeshin të njëtit nuk mund të paraqisnin mekanizma të pavarur. Paneli për shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut-PShDNJ (*Human Rights Review Panel-HRRP*) vazhdon që të ekzistoj edhe gjatë kohës së Misionit të EULEX. Paneli është themeluar nga Bashkimi Evropian më 29 tetor 2009 kurse është bërë operativ në qershor të vitit 2010. Cilësohet si mekanizmi i parë dhe i vetëm i pavarur që merret me shkeljet e dyshuara të të drejtave të njeriut nga një Mision i Politikës së Përbashkët i Bashkimit Evropian për Siguri dhe Mbrojtje (Raporti vjetor i PShDNJ (HRRP) -2012: 5).

Veprimtaria e Panelit kishte mbështetje ligjore në **Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i dt.4 shkurt 2008 lidhur me Misionin Evropian për sundimin e Ligjit në Kosovë- EULEX**. Veprimi i përbashkët i Këshillit është burim i autoritetit dhe i kompetencës së misionit të EULEX-it në Kosovë. Ai përcakton mandatin e EULEX-it, dhe ndër të tjera, saktëson llogaridhënien e tij lidhur me të drejtat e njeriut në nenin 3 (i): *“siguron se të gjitha aktivitetet e saj respektojnë standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore”*. Elementi i dytë i kornizës rregulluese të panelit është **Koncepti i llogaridhënies i EULEX-it në Kosovë- Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave**

të Njeriut, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, i dt. 29 tetor 2009. Koncepti i llogaridhënies përcakton mandatin e Panelit për të shqyrtuar ankesat e parashtruara nga secili person, i cili pretendon se është viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it, gjatë kryerjes së mandatit ekzekutiv të EULEX në Kosovë. Sipas dispozitave të Konceptit Llogaridhënës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat sipas këtyre instrumenteve të të drejtave të njeriut:

- Deklarata e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut (1948);
- Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore (KEDNJ, 1950);
- Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racor (KEDR, 1965);
- Pakti Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike (PNDKP, 1966);
- Konventa Ndërkombëtare për të drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (KDESHK, 1966);
- Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas (KEDG, 1979);
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese (KKT, 1984);

Konventa Ndërkombëtare mbi të drejtat e Fëmijës (KDF, 1989), (Raporti vjetor i PShDNJ (HRRP) -2012: 6).

Procedura para panelit ishte e përcaktuar në atë mënyrë që ankesa mund të parashtrohet para panelit nga vetë viktimat, apo përfaqësuesi i autorizuar i saj. Ankesa

duhej që të parashtrohej me shkrim, dhe shkeljet e dyshuara duhet të kenë ndodhur në Kosovë pas datës 9 dhjetor 2008. Pasi ankesa të konsiderohej e pranueshme, Paneli kërkonte që shefi i Misionit të EULEX të ofroj përgjigje. Paneli më pastaj kishte për kompetencë që të formulojë gjetjet lidhur me shkeljen e dyshuar të të drejtave të njeriut, i publikonte ato në një vendim, dhe i cili vendim përfshinte rekomandime jo detyruese që i ofroheshin shefit të Misionit. Se çfarë masash korrigjuese do të duhej të ndërmerreshin varej nga shefi i Misionit.

Ndonëse themelimi i PShDNJ nga ndërkombëtarët ishte parë si shprehje e e të kuptuarit se EULEX nuk mund të shihet se shmanget llogaridhënies për shkak të imunitetit të tij, puna e këtij paneli nuk ka pasur efektet e duhura në praktikë dhe në sytë e vendorëve nuk kishte dhënë ndonjë rezultat që do të mund të shënohej si sukses nga ana e tij.

“Në hulumtimin që zhvilluam për qëllimet e këtij punimi me elitën e avokatëve në Prishtinë, mbi 80% e tyre u shprehën se nuk kanë pasur rastë apo nuk kishin njohuri mbi punën e këtij paneli. Kishte edhe te tillë që dhanë mendimin se puna e këtij paneli nuk shtrihet përtej punës së institucioneve të tjera në Kosovë duke menduar në shkallën e ultë të përgjegjshmërisë, apo se puna e këtij paneli nuk ka kapërcyer atë se ka një faqe interneti ku mund të shihet se si mund të parashtrohet kërkesa, ku mund të parashtrohet dhe cilat janë kompetencat e këtij paneli (Hulumtimi me avokatët, nëntor 2014).

Si përfundim i kësaj do të theksonim se shqyrtimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut jashtë institucioneve gjyqësore, nuk paraqet mbrojtje adekuate të këtyre të drejtave. Së këndejmi llogaridhënia para të njëjtit Mision nuk mund të konsiderohet pavarësi dhe pa ndikim nga vet strukturat e këtij Misioni. Në fund të fundit Paneli me punën e tij vetëm se ka rritë transparencën për punën e Misionit të EULEX, por nuk mund të thuhet se ka arritur misionin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga shkeljet eventuale të pjesëmarrësve të trupës ndërkombëtare që ishte nën petkun e këtij misioni.

5.4.12. E drejta për kompensimin e burgimit të padrejtë

E drejta për kompensim në rast të gabimit gjyqësor në mënyrë të qartë, parashihet në Paktin Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike. Në nenin 14(6) thuhet:

“Kur një person është dënuar përfundimisht për një vepër penale dhe pastaj dënimi i tij është ndryshuar apo atij i është kërkuar falje, për arsye se faktet e zbuluar rishtazi kanë treguar bindshëm se ka ndodhur një gabim gjyqësor, personi i cili ka vuajtur dënimin, duhet të kompensohet në bazë të ligjit, përveç nëse dëshmohet se mos zbulimi i fakteve të panjohura me kohë, i atribuohet në mënyrë të pjesshme apo të plotë vetë atij”.

Në bazë të Paktit Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike, një person ka të drejtë në kompensim në rast të dëshmisë përfundimtare se ai apo ajo ka qenë viktimë e gabimit gjyqësor. Viktima në këtë rast nuk duhet të ketë ndihmuar gabimin e gjyqësisë (HUMAN

RIGHTS IN THE ADMINISTRATION OF JUSTICE: A Manual on Human Rights for Judges, Prosecutors and Lawyers, 302).

Në anën tjetër ligji vendor ka paraparë të drejtën për kompensimin e dëmit të personave të dënuar ose arrestuar pa arsye dhe personave në rast të heqjes së lirisë pa bazë. Bazuar në Kodin e Procedurës Penale i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, të drejtë në kompensim dëmi për dënim të paarsyeshëm ka personi kundër të cilit është shqiptuar sanksion penal në formë të prerë ose që është shpallur fajtor dhe është liruar nga dënimi por që më vonë sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, procedura e rishikuar është pushuar në formë të prerë ose me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar, përveç në këto raste:

- Kur pushimi i procedurës ose aktgjykimi me të cilin akuza është refuzuar ka ndodhur për arsye se në procedurën e re i dëmtuari është tërhequr si rezultat i marrëveshjes me të pandehurin;
- Kur në procedurën e rishikimit me aktvendim është refuzuar akuza për shkak të jo kompetencës së gjykatës, paditësi i autorizuar e ka ndërmarrë ndjekjen në gjykatën kompetente.

Sipas Kodit i dënuari nuk ka të drejtë në kompensim dëmi në qoftë se me pohimin e tij të rremë ose në mënyrë tjetër ka shkaktuar dënimin e tij, përveç kur për këtë ka qenë i detyruar. Kodi ka përcaktuar se në rast të dënimit për vepra penale në bashkim, e drejta në kompensim dëmi ekziston për veprën penale për të cilën plotësohen kushtet për njohjen e kompensimit. Rregullimi ligjor ka përcaktuar se para se të paraqesë padinë në gjykatë për kompensim dëmi, i dëmtuari kërkesën e tij ia drejton organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore për arritjen e marrëveshjes për ekzistimin e dëmit, llojin dhe lartësinë e kompensimit. Ky organ ishte vetë organi më i lartë për administrimin me gjyqësorin që

paraqiste Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK). Kur kërkesa për kompensim dëmi nuk miratohej ose Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe i dëmtuari nuk arrinin marrëveshje brenda tre (3) muajsh nga dita e paraqitjes së kërkesës, i dëmtuari mund të paraqiste padinë për kompensim dëmi në gjykatën kompetente. Padia për kompensim dëmi paraqitej kundër organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore respektivisht, Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Kodi i Procedurës Penale- neni 527).

E drejta për kompensim dëmi parashkruhet tri (3) vjet pas formës së prerë të aktgjykimit të shkallës së parë me të cilin i akuzuari është liruar nga akuza ose me të cilin është refuzuar akuza, apo nga forma e prerë e aktvendimit me të cilin hidhet aktakuza ose pushohet procedura. Në rastet kur për një ankesë vendosë gjykata e shkallës më të lartë, e drejta për kompensim parashkruhet pas tri (3) vitesh nga dita e marrjes së vendimit nga gjykata e tillë. Trashëgimtarët trashëgojnë të drejtën e personit të dëmtuar vetëm për kompensim dëmi material. Nëse i dëmtuari ka paraqitur kërkesë, trashëgimtarët mund të vazhdojnë procedurën vetëm në kufijtë e kërkesës së paraqitur për kompensimin e dëmit material. Pas vdekjes së të dëmtuarit, trashëgimtarët e tij mund ta vazhdojnë procedurën për kompensim dëmi apo ta fillojnë procedurën nëse personi i dëmtuar ka vdekur para kalimit të afatit të parashkrimit dhe nëse nuk ka hequr dorë nga kërkesa për kompensim.

Sa i përket heqjes së lirisë pa bazë sipas kodit të procedurës e drejta për kompensim dëmi i takon gjithashtu:

- personit i cili është mbajtur në paraburgim e kundër tij nuk është filluar procedurë penale ose procedura është pushuar me aktvendim të formës së prerë ose ai me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza apo akuza është refuzuar;

- personit i cili ka mbajtur dënimin me heqje lirie dhe me rastin e rishikimit të procedurës penale ose kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë i është shqiptuar dënimi me burgim më të shkurtër nga dënimi të cilin e ka mbajtur, apo i është shqiptuar sanksion penal pa heqje të lirisë ose është deklaruar fajtor dhe është liruar nga dënimi;
- personit i cili për shkak të gabimit ose veprimit të paligjshëm të një organi është arrestuar pa arsye ose është mbajtur një kohë në paraburgim apo në një institucion korrektues për mbajtjen e dënimit ose masës së shqiptuar; dhe
- personit i cili në paraburgim ka kaluar kohë më të gjatë se dënimi me burgim për të cilin është gjykuar.

Lidhur me kompensimin e dëmit personave të dënuar ose arrestuar pa arsye dhe personave në rast të heqjes së lirisë pa bazë, në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës funksiononte Komisioni i cili trajtonte rastet e kompensimit dhe kërkesat e këtyre personave. Ky komision gjatë periudhës 2008-2014 ka trajtuar 602 raste apo kërkesa për kompensim të dëmit.

Tabela nr.2 – Numri i kërkesave për kompensim dëmi të trajtuara nga Komisioni për Kompensimin e Dëmit në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë Misionit të EULEX	
Viti	
2008	68
2009	80
2010	64
2011	77
2012	105
2013	101
2014	
	Gjithsej 602 kërkesa

Ndonëse në shikim të parë numri i rasteve të trajtuara është tejet i madh në krahasim me numrin e rasteve ku palët nuk kanë pranuar që të pranojnë lartësinë e kompensimit të ofruar nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, shikuar nga këndvështrimi i procesit të rregullt gjyqësor përgjatë Misionit të EULEX, shkalla e gabimit gjyqësor shihet se është tejet e lartë. Kjo shkallë prej 602 rasteve për periudhën 2008-2014 paraqet edhe një shkallë të lartë dështimi karshi procesit të rregullt gjyqësor që dmth se brenda një viti shifra e rasteve në të cilat ka ndodhë gabimi gjyqësor nuk ka qenë më e vogël se 100 raste. Ky numër prej 100 rasteve brenda një viti sikur nuk i shkon për shtat një misioni ndërkombëtar që vepron në një vend dhe qëllimin kryesor ka sundimin e ligjit dhe aq më tepër një misioni që vinte nga Bashkimi Evropian.

Numri i rasteve të cilat kishin të bënin me kompensimin e dëmit dhe që ishin në procedurë para gjykatave në këtë kohë kapte shifrën prej 19 raste. Këto përbënin ato raste kur palët nuk ishin pajtuar që të pranonin kompensimin e ofruar nga Komisioni për Kompensim i themeluar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Edhe këto raste nuk janë trajtuar çdo here njësoj.

Me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr. 65/2004 të dt. 12.10.2009 gjykata ka vendosur që të detyrohet i padituri Këshilli Gjyqësor i Kosovës që për shkak të caktimit të kundërligjshëm të paraburgimit personit Afrim Zeqiri nga Gjilani, për periudhën kohore prej 20.05.2000-11.02.2002, përkatësisht për 617 ditë, t'ia kompensojë dëmin material në vlerë prej 3.681,00 €, dhe dëmin jo material në vlerë prej 100.000,00 €, me kamatë prej 3.5% në vit nga dita e marrjes së Aktgjykimit e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës prej 1.365 €. Gjykata e Qarkut në Prishtinë si gjykatë e shkallës së dytë kishte vërtetuar (lënë në fuqi), vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së dytë mjetet ankimore të natyrës së jashtëzakonshme i kishin parashtruar Prokurori i Shtetit me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe pala e paditur edhe për shkak të shkeljeve thelbësore të ligjit procedural.

Në këtë rast Gjykata Supreme e Kosovës në vendimin e saj ka gjetur se e paditura Këshilli Gjyqësor i Kosovës është organ i administratës shtetërore dhe rrjedhimisht nuk mundet që të jetë palë në procedurë para gjykatës në kontestet juridiko-pronësore. Gjykata më tutje ka theksuar se organi i administratës që në këtë rast ka

cilësinë e të paditurit, nuk e ka cilësinë e personit juridik dhe fizik. Sipas gjykatës dispozita e nenit 73 par 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) parasheh që palë në procedurë mund të jetë çdo person fizik dhe juridik. Me paragrafin 2 të këtij neni të të njëjtit ligj është parashikuar se me dispozitat e veçanta caktohet se kush tjetër përveç personave fizik dhe juridik mund të jenë palë në procedurë. “Andaj, me pa mëdyshje dhe qartazi rezulton se i padituri Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk e ka cilësinë e personit fizik dhe juridik e po kështu me dispozitat e veçanta nuk është parashikuar që i padituri mund të jetë palë në kontestet në procedurën juridiko-pasurore”- përfundon mendimi juridik i Gjykatës (Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës MLC.Rev.nr.57/2013, i dt. 30.07.2013).

Mendojmë se ky vendim i Gjykatës Supreme të Kosovës përbën në vete jo vetëm një vendim gjyqësor sipas të cilit është shkelur rëndë e drejta për proces të rregullt gjyqësor e personit Afrim Zeqiri, por vendimi si i tillë është i përfshirë me gabime elementare profesionale. Gabimet profesionale mendojmë se shprehen në jo profesionalizimin e duhur të anëtarëve të panelit gjykues kur thirren në atë se “*me dispozitat e veçanta nuk është parashikuar që i padituri mund të jetë palë në kontestet në procedurën juridiko-pasurore*”. Mendojmë se në këtë çështje dispozitë të veçantë paraqet neni 527 i Kodit të Procedurës Penale (Padia për kompensim) në të cilën është përcaktuar se “*Kur kërkesa për kompensim bëhet nga dëmtuari ose organi publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore dhe i dëmtuari nuk arrijnë marrëveshje brenda tre (3) muajsh nga dita e paraqitjes së kërkesës, i dëmtuari mund të paraqesë padinë për kompensim në gjykatën kompetente...*”. Është fakt notor se *organi publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore* është vetë Këshilli

Gjyqësor i Kosovës dhe kjo dispozitë ligjore i jep legjitimacionin procedural që të paraqitet si palë e paditur në procedurat lidhur me kompensimin në rast të gabimit gjyqësor. Në kohën e marrjes së vendimit në fjalë nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës kjo dispozitë ligjore ishte në fuqi dhe mendojmë se paraqet një precedent jo të mirë në lëminë e sigurisë juridike. Në fund të fundit Gjykata Supreme në Kosovë paraqet autoritetin më të lartë gjyqësor dhe ndër të tjera përcakton qëndrimet parimore dhe mendimet juridike për çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës (i Kushtetuta e Republikës së Kosovës- neni 103 dhe Ligji për Gjykatat - neni 22). Një “gabim” i tillë gjyqësor gjithsesi në këtë rast ka cenuar rëndë të drejtën e personit për proces të rregullt.

Kur flasim për kornizën ligjore që mbulon këtë element shumë të rëndësishëm të procesit të rregullt që në këtë kohë mbretëron në Kosovë ajo është e shpërndarë në disa ligje, dhe nuk është e përfshirë në një ligj të vetëm ashtu siç është paraparë në vendet e tjera, p.sh. në Republikën e Shqipërisë (Ligji Nr.9381, datë 24.4.2005 Për kompensimin e Burgimit të Padrejtë). Një çështje shumë e ndjeshme dhe që nuk ka gjetur rregullimin e saj me ligj në Kosovë është çështja e rikthimit në punë ose në detyrë të personave të cilët kanë vuajtur paraburgimin ose arrestin në shtëpi dhe për këtë shkak është larguar nga puna ose liruar nga detyra që kishte përpara vendosjes së këtyre masave. Në një varg rastesh kur është vendosur pushimi i çështjes ose është dhënë pafajësi në favor të tij, sepse nuk ka kryer veprën që akuzohet, fakti nuk ekziston, fakti nuk përbën vepër penale ose fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, personat nuk janë kthyer edhe në vendet e punës ose në detyrën që ishin më parë. Paditë e këtyre personave për rikthim në punë ose detyrë janë hedhur poshtë ose refuzuar nga ana e gjykatave civile me arsyetimin se kanë lëshuar afatin

prekluziv për kthim në vendin e punës e i cili afat sipas Ligjit të Punës parashihte kohën prej 45 ditësh që personi të cilit i janë shkelë të drejtat nga marrëdhënia e punës të ketë të drejtën që t'i drejtohet gjykatës. Ndërkaq në anën tjetër punëdhënësit shfrytëzonin këtë shkak që t'u ndërprisnin marrëdhënien e punës.

“ M.A. kishte qenë i punësuar në njërën nga bankat e Kosovës në detyrë si zëvendësdyrëtor në kohë të pacaktuar sipas kontratës së datës 22.01.2002, e më vonë më datën 03.12.2003 dyrëtor i përgjithshëm për kredi dhe depozita me mandate katërvjeçar me mundësi të rizgjedhjes. Për shkak të inicimit të procedurës penale M.A. këtë detyrë ka pushuar ta ushtroi prej datës 13.03.2007 e deri në përfundimin e procedurës hetimore. M.A nga punëdhënësi nuk kishte pranuar asnjëherë vendimin me shkrim, me të cilin vendim do të njoftohej se i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Në vend të vendimit M.A më datën 28.11.2007 kishte pranuar një njoftim me shkrim me të cilin Këshilli Dyrëtor i bankës i kishte ndërprerë marrëdhënia e punës me arsyetimin se i ka skaduar mandati si Dyrëtor Gjeneral. Në njoftim mungonte udhëzimi juridik lidhur me të drejtën për ankesë si mjet i rregullt juridik. Ligji në fuqi në këto raste kërkonte që me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës duhet lëshuar vendimi me shkrim dhe është paraparë mundësia e ankesës. M.A në janar të vitit 2011 fiton pafajësinë dhe menjëherë kërkon nga përgjegjësit e bankës që të kthehet në detyrat e punës dhe meqë kjo nuk ishte realizuar kishte ushtruar menjëherë padi në gjykatë. Me padi kërkonte kthimin në detyrë dhe pagesën lidhur me të ardhurat që do të mund të kishte realizuar gjatë kësaj kohe që kapin shumën prej 341.880,06 €. M.A. në gjyq kishte theksuar se kjo e drejtë buron nga çështja se NJOFTIMI sipas të cilit i është

pushuar mandati i drejtorit e me këtë edhe marrëdhënia e punës nuk ka efekt juridik dhe pasoja juridike për të për faktin se me këtë njoftim nuk i është dhënë mundësia e ankesës. Pala e paditur- punëdhënësi kishte ushtruar prapësimin procedural me të cilin kishte kërkuar nga gjykata që të hedhë poshtë padinë për shkak të pa afatshmërisë së saj me arsyetimin se veprimet për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të tija i ka ndërmarrë tek pas tri viteve. Gjykata në vendimin e saj ndonëse thekson se i padituri-punëdhënësi ka pasur për obligim që në njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës sa i përket të drejtëve të tija, ka vlerësuar se në rastin konkret meqë paditësi nuk ka ushtruar ankesë ndaj NJOFTIMIT, ai ka lëshuar përdorimin e mjeteve juridike të brendshme për mbrojtjen e të drejtave të tija subjektive, te i padituri”(Dosja gjyqësore C.nr.1925/13 në Gjykatën Themelore në Prishtinë).

Vlerësojmë se në të ardhmen Kosova duhet të ketë ligj të veçantë që do të saktësoj legjitimitetin se kush do të duhej që të paraqitet si palë e paditur në rastet lidhur me kompensimin e dëmit të personave të dënuar ose arrestuar pa arsye dhe personave në rast të heqjes së lirisë pa bazë, pastaj duhet që të jenë të qartësuara kriteret lidhur me kompensimin e këtyre personave, si dhe do të duhej të sanksionohej me ligj çështja e kthimit në detyrë ose në vendin e punës pas fitimit të pafajësisë në procedurën penale.

KAPITULLI VI: Procesi i rregullt gjyqësor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës

6.1. Ankimi individual kushtetues dhe procesi i rregullt gjyqësor

Procesi i rregullt ligjor e me këtë edhe procesi i rregullt gjyqësor nuk është thjeshtë vetëm një e drejtë. Ai sot trajtohet më shumë si një parim kushtetues që shtrihet ndaj disa të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ai ka si funksion dhe qëllim mbrojtjen e individit nga ndërhyrjet e paligjshme të autoriteteve publike. Kontrolli që e ushtron gjykata kushtetuese, kur individi pretendon cenimin e këtij parimi, i cili shfaqet edhe në formën e një të drejte themelore në vetvete, bëhet i mundur nëpërmjet ankimit individual kushtetues (Vorpsi, 2011: 13).

Çështja e funksionimit të këtij mekanizmi dhe kohëzgjatja e tij do të mateshin me nevojën e ekzistimit të kontrollit që ushtron gjykata kushtetuese dhe mbrojtja që ofron ajo në këto raste. Se a duhet ose jo që të ekzistojë vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të gjyqësorit nga ana e gjykatës kushtetuese, një gjë të tillë e determinon ekzistimi i një gjyqësori funksionimi i të cilit do të duhej që të jetë në përputhje me standardet e një gjyqësori të pavarur dhe të paanshëm. Në të kundërtën mungesa e ankimit kushtetues do të ishte një e metë që një shoqëri do ta mbante larg të qenit një shoqëri demokratike ku respektohen standardet e procesit të rregullt gjyqësor.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës parashikon se ndër mekanizmat për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese është edhe ajo e ankesës individuale. Neni 113 par. 8 i Kushtetutës përcakton se individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo

vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Kështu, ky instrument apelues i mundëson secilit individ të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje kushtetuese në rast se, pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik. E drejta e ankesës individuale kushtetuese mund të realizohet vetëm sa i takon të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë (Bajrami, 2011: 346). Kjo natyrisht se prekë atë çfarë në Kushtetutën e Kosovës përfshihet në Kapitullin 2 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë gjithashtu ka paraparë se ndër mekanizmat për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese është edhe ajo e kërkesës individuale. Në nenin 131/f dhe 134/g përcaktohet se individët janë subjekte që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese :

- pretendojnë se ndaj tyre nuk është zhvilluar një proces i rregullt ligjor;
- pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e tjera juridike të parashikuara me ligj për mbrojtjen e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, pra si një shkallë gjyquese përfundimtare.

Kjo do të thotë që individi në Republikën e Shqipërisë nuk mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave apo lirive të tjera themelore të tij, përveçse për mbrojtjen e njërës prej tyre, asaj për një proces të rregullt ligjor (Zaganjori, 2011: 84).

Tabela nr. 3.- Rastet e shqyrtuara në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës në vitin 2009-2013											
Viti 2009				Viti 2011		Viti 2012		Viti 2013		Gjithsej	
79 raste		132 raste		164 raste		139 raste		189 raste		703 raste	
Vendim i gjykatave	tjetër	Vendim i	tjetër	Vendim i gjykatave	tjetër	Vendim i gjykatave	tjetër	Vendim i gjykatave	tjetër	Vendim i gjykatave	tjetër
48 raste	31 raste	93 raste	39 raste	139 raste	25 raste	101 raste	38 raste	212 raste	21 raste	593 raste	110 raste
60.76 %	39.24 %	70.45 %	29.55 %	84.76%	15.24 %	72.66 %	27.34 %	90.99 %	9.01%	84.35%	15.65%

6.2. Kushtet formale për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për proces të parregullt gjyqësor

Legjitimiteti i kërkuar nga pikëpamja formale përfshin tri aspekte: *së pari*, qënien e tij individ, *së dyti*, paraqitjen e kërkesës brenda *afatit kohor*, së treti *shterrimin e mjetëve të tjera juridike* para ushtrimit të ankimit individual.

6.2.1. Subjektet kërkuese

Kushtetuta ka përcaktuar se individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale. Ekzistojnë dy supozime kryesore të cilat përshkruajnë se kur e drejta individuale konsiderohet e cenuar, mbi bazën e të cilës individi i prekur mund të autorizohet në mënyrë legjitime që të parashtrojë ankesën individuale në Gjykatën Kushtetuese. Një e drejtë mund të konsiderohet e cenuar ose nga një akt i një organi publik që drejtpërdrejtë kufizon/cenon të drejtën e garantuar me kushtetutë (shkelje e drejtpërdrejtë), ose nëse akti që prek të drejtën është i bazuar mbi një ligj apo akt nënligjor të cilin, për ndonjë arsye, Gjykata Kushtetuese e vlerëson si jokushtetues (shkelje derivative), (Hasani, E., 2012: 11).

Nga kjo mund të argumentohet se neni 113.7 i Kushtetutës ofron mundësinë e vetme ku qytetarët mund t'i qasen dhe të paraqiten para Gjykatës Kushtetuese. Ky juridiksion i specializuar e bën Gjykatën Kushtetuese të veprojë si organ i pastër gjyqësor, pasi duhet të gjykojë *in concreto* në një rast individual që është gjykuar tashmë nga gjykatat e rregullta (Hasani, E., 2012: 11).

Qartësimi i kuptimit të termit “individ” përbën domosdoshmëri të dorës së pare, pasi që nga kjo do të mund të qartësohej se cilat janë ato subjekte që në fakt mund të shfrytëzojnë juridiksionin e vlerësimit *in concreto* të Gjykatës Kushtetuese. Marrë në kuptimin fillestar, termi “individë” në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47 të Ligjit Për Gjykatën Kushtetuese na bën të mendojmë se i referohet vetëm personave fizikë. Por situata ndryshon nëse i referohemi nenit 21(4) të Kushtetutës : “*Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme*”. Sqarimi i pozicionit të personave juridikë përballë gjykatës Kushtetuese

është i nevojshëm për arsyen e thjeshtë se ato persona që nuk gëzojnë të drejtat themelore nuk mund as t'i kërkojnë ato në rrugë procedurale para Gjykatës Kushtetuese (Vorpsi, 2011: 79).

Gjykata Kushtetuese ka heqë dilemat lidhur me paqartësitë në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese në rastin Universiteti AAB kundër Qeverisë së Kosovës, në të cilin rast ka vendosur që termi “individë” në nenin 113.7 duhet të kuptohet si përfshirje edhe e personave juridikë (Rasti 41/09, *Universiteti AAB sh.p.k. Kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, Buletini i Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese 2009-2010: 50). Paqartësi gjithashtu paraqitet edhe në çështjen se a konsiderohen individë sipas nenit 113.7 të Kushtetutës vetëm personat privatë kundër atyre publikë-juridikë, ose edhe personat privatë dhe ata publikë juridikë. Në një rast të tillë Gjykata Kushtetuese ka vendosur në Rastin KI 25/10, Agjencia Kosovare e Pronës kundër Gjykatës Supreme, ku ajo kishte vendosur që të gjithë atyre organeve publike që kanë subjektivitet juridik i njihet e drejta për të shfrytëzuar juridiksionin e nenit 113.7, dhe në këtë njihen si persona juridikë në kuptimin e nenit të fundit (Hasani, E., 2012: 13).

Bazuar në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës edhe personat fizikë edhe juridikë shihet se janë të autorizuar të parashtrojnë ankesa në Gjykatën Kushtetuese, për të vlerësuar kushtetutshmërinë e akteve publike në kuptimin e mbrojtjes kushtetuese të të drejtave të njeriut.

6.2.2. Afati kohor

Ligji Nr.03/L-121 Për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parashikon, veç të tjerave, edhe procedurat e veçanta të gjykimit para kësaj Gjykate. Në Kreun III Procedurat e Veçanta parashikohet se afati kohor për paraqitjen e kërkesave individuale është katër (4) muaj. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor me të cilin individi mendon se i është bërë shkelje e ndonjë të drejtë të mbrojtur me Kushtetutë. Sipas ligjit në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi (Ligji Nr.03/L-121 Për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës -neni 49).

Në Shqipëri afati kohor për paraqitjen e kërkesave individuale për pretendimet për një proces të rregullt ligjor, është jo më shumë se dy (2) vjet nga konstatimi i shkeljes. Kur në bazë të ligjit individi mund të i drejtohet një organi tjetër, ai mund të paraqesë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe në këtë rast afati i paraqitjes së kërkesës është dy (2) vjet nga data e njoftimit të vendimit të organit përkatës shtetëror (Vorpsi, 2011: 88).

Vlerësojmë se afati kohor prej katër (4) muajsh për paraqitjen e kërkesave individuale i shërben më mirë sigurisë juridike për palët në gjykim dhe stabilitet në vendimmarrje. Në Kosovë nuk ka pasur (të paktën deri më tani) ndonjë debat për zgjatjen e këtij afati.

6.2.3. Shterimi i mjeteve juridike

Në praktikë kërkesat që janë paraqitur nga individët para Gjykatës Kushtetuese lidhur me kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të rregullta përbëjnë përqindjen më të madhe të numrit të përgjithshëm të tyre. Gjykata Kushtetuese në pjesën më të madhe të tyre ka qenë e detyruar që të mos i kalojë në gjykim duke qenë se ato nuk i plotësonin kushtet për shqyrtimin kushtetues. Vetëm gjatë vitit 2013 më se 89.55% e rasteve të parashtruara në Gjykatën Kushtetuese, përbënin papranueshmëri. Rastet më të shumta janë ato, kur nuk janë shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion kërkesë kjo që e pengon Gjykatën Kushtetuese për të ushtruar kontroll mbi vendimin e atakuar.

Siç përcaktohet më nenin 113.7 të Kushtetutës, individët mund të parashtrojnë kërkesa në Gjykatën Kushtetuese, vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit. Gjykata Kushtetuese në shumë vendime të saj e racionalizon këtë parim kushtetues me argumentin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që së pari duhet mundësuar që institucionet e rregullta të shtetit e veçanërisht gjykatat të korrigjojnë shkeljen, para se rasti të arrijë në Gjykatën Kushtetuese (Rasti KI 139/11 Ali Latifi, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për riemërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, Nr. 01/118-658, të 27, 28 tetorit 2010*; Rasti KI 114/10, *Badivuku kundër Këshilli Gjyqësor i Kosovës* i 18 majit 2011). Rasti para se të ketë mundësi të parashtrohet para Gjykatës Kushtetuese, bazuar në kornizën ligjore në Kosovë, duhet të kalojë disa nivele gjyqësore.

Ligji i Kosovës për Gjykatat vendos gjykatat themelore si mekanizma gjyqësorë të instancës së parë në Kosovë, për çështjet civile, penale, ekonomike, administrative dhe çështje tjera të përgjithshme. Gjykata Themelore e Prishtinës ka kompetencë të centralizuar

lidhur me vlerësimin juridik të akteve administrative, pastaj, të vendosë lidhur me çështjet që bien në kompetencën e Departamentit Ekonomik dhe atij fiskal, si dhe ka kompetencë të centralizuar të vendosë në çështjet lidhur me Rrëmbimin ndërkombëtar të fëmijëve.

Rastet e vendosura njëherë në gjykatë themelore më pastaj mund të apelojnë në Gjykatën e Apelit të Kosovës e cila është gjykatë e centralizuar dhe vepron në shkallë të dytë. Ligji për Gjykatat ka reduktuar në maksimum mjetet remonstrative të goditjes së vendimeve gjyqësore, duke ia atribuuar në tërësi këtë kompetencë Gjykatës së Apelit, e sidomos ato lidhur me çështjet e paraburgimit, për të cilat para hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatat në janar të vitit 2013, vendosnin vetë gjykata të cilat e bënin caktimin e paraburgimit vetëm se nga një kolegji tjetër i gjyqtarëve.

Pasi të kalojë Gjykatën e Apelit, vendimi bëhet i formës së prerë dhe nuk mund të ankimohej më me mjete të rregullta juridike. Që rasti të parashtrahet në Gjykatën Kushtetuese individët duhet që të shterojnë jo vetëm mjetet e zakonshme, por edhe mjetet e jashtëzakonshme juridike. Mjetet e jashtëzakonshme ushtrohen kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme të Kosovës. Vetëm pasi rasti të ketë kaluar edhe mekanizmin shqyrtues të Gjykatës Supreme dhe të jetë vendosur në mënyrë meritore ashtu që të mos jetë i kthyer rasti në rishqyrtim pranë Gjykatës së Apelit apo edhe në atë themelore, atëherë mund të parashtrahet në Gjykatën Kushtetuese, brenda juridiksionit të caktuar me nenin 113.7 të Kushtetutës. Bazuar në këto që u thanë më lartë shihet që rasti duhet të kalojë tri instanca gjyqësore, me anë të mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike, para se të konsiderohet që mjetet efektive juridike janë shteruar dhe që të krijohen mundësitë ligjore që të të parashtrahet para Gjykatës Kushtetuese.

Ndonëse në literaturë mund të haset pikëpamja se mjetet juridike të jashtëzakonshme nuk konsiderohen si mjete juridike efektive, dhe se kjo gjë duhet konsideruar me një masë elasticiteti, *rregulli në fjalë duhet aplikuar me fleksibilitet*- Lehtinen kundër Finlandës, *rregulli i shterimit nuk është as absolut e as automatik, si dhe duhet gjykuar në dritën e secilit rast individual*- Van Ostervijck kundër Belgjikës, apo se duhet të merret parasysh realisht jo vetëm ekzistenca e mjeteve formale në sistemin ligjor të Palës Kontraktuese, por edhe konteksti i përgjithshëm juridik dhe politik në të cilin ato funksionojnë dhe rrethanat personale të parashtruesve -Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë, (Hasani, 2012: 15), kjo gjë nuk mbetet e dyshimtë për praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Gjykata Kushtetuese e Kosovës zakonisht i konsideron mjetet juridike të jashtëzakonshme si mjete juridike efektive në pikëpamje të juridiksionit konkret të nenit 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, ndonëse edhe në këtë çështje ka pasur ndonjë përjashtim.

*“ Në Rastin KI 99/14 dhe KI 100/14 Gjykata vëren se dispozitat e ligjit në fuqi, Ligjit Nr. 03/ L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nuk parashikojnë asnjë mjet juridik kundër vendimeve të kontestuar nga parashtruesit e kërkesës. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës janë të obliguar t'i shterin" [. . .] mjetet juridike që janë të qasshme, për te siguruar kompensim lidhur me ankesat dhe që ofrojnë mundësi të arsyeshme për sukses. Baza e mjetit juridik në te drejtën vendore duhet te jete e qarte" (Rasti Scavuzzo-Hager dhe te tjerë kundër Zvicres, Kërkesa nr. 41773/ 98, GJEDNJ, 7 shkurt 2006). Megjithatë, **Gjykata vëren se, edhe ne qoftë se ka mjete juridike, në rastin e parashtruesit nuk janë***

dëshmuar si efikase. Për më tepër, duke marrë parasysh specifikën e procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe domosdoshmerinë që kjo të bëhet në kohën e duhur, Gjykata është e mendimit që nuk ka mjete juridike për shterim”(Rasti KI 99/14 dhe KI 100/14 në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës).

Mjetet e ankimit para gjykatave të zakonshme duhet të shteren para ngritjes së një ankimi kushtetues. Shterimi nënkupton që kërkuuesi duhet të i ketë shfrytëzuar të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës. Mjetet shterojnë kur rregullat procedurale në rastin konkret nuk parashikojnë mjete të mëtejshme ose të gjitha mjetet e tjera ligjore janë haptazi të palejueshme. Ankimi kushtetues është konceptuar si siguri ndihmëse ose plotësuese (subsidiare) krahas mjeteve të tjera ligjore, për këtë arsye ai mund të ushtrohet vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e parashikuara me ligj për të fituar një të drejtë (Vorpsi, 2011: 88).

6.3. Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës shikuar nga aspekti i nenit 113.7 të Kushtetutës, paraktika e deritanishme e saj dhe rregullativa ligjore (Ligji Nr. 03/L-121 Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës), shihet se dallon nga ai i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë nuk merr përsipër të rishikojë edhe njëhere interpretimin e *së drejtës së zakonshme* nga gjykatat apo vlerësimin e provave nga ana e tyre. Ajo përqendrohet thjeshtë në respektimin e garancive kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Në rastet e vlerësimit të gabuar të provave apo gabimeve të

ndryshme juridike që mund të cenojnë të drejtat themelore të individit, për këto raste Kushtetuta ka parashikuar se këto mund të “riparohen”, brenda sistemit të zakonshëm gjyqësor. Në rastet kur asaj i është kërkuar rivlerësimi i disa fakteve dhe provave, mbi të cilat është mbështetur gjykata e zakonshme për marrjen e vendimit të kundërshtuar para Gjykatës Kushtetuese, ajo ka argumentuar se *“bërja e një analize apo vlerësimi të ri nga ana e Gjykatës Kushtetuese të një prove të administruar në dosjen gjyqësore, që në rastin konkret lidhet me aktekspertimin e vlerës së objektit të padisë dhe kundërpadisë, do ta deformonte procesin kushtetues dhe do ta shndërronte atë në një proces gjykimi të zakonshëm”* (Vorpsi, 2011: 99).

Në anën tjetër në rastin e Kosovës bazuar në atë se neni 113.7 autorizon Gjykatën Kushtetuese të vendosë mbi përputhshmërinë e akteve të autoriteteve publike me secilën të drejtë të njeriut të përcaktuar me Kushtetutë, nuk ka kufizim të të drejtave mbi të cilat Gjykata është e obliguar të vendosë. Kjo do të thotë se Gjykata, në bazë të vlerësimit të saj *in concreto*, të merret përveç anës procedurale edhe me anën substanciale të akteve të tilla. Kjo ngase Kushtetuta ofron edhe të drejta procedurale (si e drejta për t’u dëgjuar, e drejta për gjykim të drejtë), si dhe të drejta të natyrës substanciale (si e drejta për pronë ose e drejta për arsim). Në rastin *Ibrahimi dhe të tjerët kundër Gjykatës Supreme*, Gjykata Kushtetuese jo vetëm që kishte gjetur që Gjykata Supreme kishte shkelur të drejtën për proces të rregullt, por kishte vendosur edhe që Gjykata Supreme kishte dështuar në garantimin e të drejtës për pronë për parashtruesit.

Gjykata Kushtetuese duke bërë një vlerësim të tillë, ka instaluar praktikën e kthimit në rigjykim të çështjeve tek gjyqësori i zakonshëm dhe kishte urdhëruar që gjykata e

rregullt të veprojnë në mënyrë të caktuar në lidhje me meritumin e vendimit, si dhe procedurën e gjykimit të saj. Nga kjo del se Gjykata Kushtetuese angazhohet për ri trajtimin e meritumit nga gjykata më e ulët, për aq sa ka të bëjë me të drejtën kushtetuese, si dhe konsideron të pamjaftueshme të merret vetëm me pjesën procedurale të vendimit.

Kjo praktikë nuk ka qenë më parë e njohur në Kosovë. Pikërisht kjo e fundit ka bërë që në Kosovë të bëhet vlerësimi kushtetues i vendimeve të gjykatave dhe që të shfaqen përplasje kompetencash ndërmjet dy gjykatave më autoritare në vend, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme të Kosovës.

Në Rastin KI 40/09 Imer Ibrahimimi dhe 48 ish-punëtor të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 49 Aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Gjykata Kushtetuese bëri kthimin në rigjykim të vendimeve të Gjykatës Supreme, Gjykata Kushtetuese në pikën I., të vendimit të saj kishte shpallur kërkesën Të papranueshme në 12 raste, Pjesërisht të pranueshme në 5 raste, Të pranueshme-Kërkesën në lidhje me parashtruesit e listuar nën numrat 18-49. Në pikën II., Gjykata ka gjetur se ka pasur shkelje të Nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në ndërlidhje me Nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për rastet e listuara nga 13-49 dhe se ka pasur shkelje të Nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me Nenin 6 të Konventës. Gjykata Kushtetuese më tutje në pikën III., të këtij vendimi ka shpallur si të pavlefshme 36 Aktgjykime të Gjykatës Supreme, në pikën V., këto Aktgjykime rikthehen në Gjykatën Supreme për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

Në rastin në fjalë parashtruesit kanë kërkuar nga gjykatat e rregullta të miratojnë paditë e tyre lidhur me pagesën e pensioneve pasi KEK (Korporata Energjetike e Kosovës) kishte pasur marrëveshje me punëtorët që të u paguaj këto pensione derisa të bëhet themelimi i Fondit të Sigurimit Pensional Invalidor i cili nuk është themeluar në Kosovë edhe sot e kësaj dite dhe nuk është nxjerrë ndonjë ligj për formimin e tij. Gjykata Supreme kishte refuzuar paditë e tilla duke vlerësuar se pala e paditur KEK ka përmbushur obligimet e saj sipas marrëveshjes që është kompensimi i pagave sipas periudhës së specifikuar deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit të Sigurimit Pensional Invalidor me hyrje në fuqi prej 1 janarit 2004 (Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 57/2009, dt., 11 shkurt 2009). Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se ka pasur shkelje të Nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me Nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Buletini i Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, 2009-2010).

Ky rast ka shfaqur dilemat e para në jetën juridike në Kosovë lidhur me atë nëse Gjykata Kushtetuese ka kompetencën ligjore të kthimit në rigjykim të vendimeve të gjykatave. Kjo edhe ka ndarë në dysh mendimet e ekspertëve ligjor në Kosovë. Në grupin e parë bëjnë pjesë ekspertë të përfaqësuar në Gjykatën Supreme dhe ish anëtar të Gjykatës Kushtetuese të ish-Jugosllavisë të cilët vlerësojnë se me këtë veprim Gjykata Kushtetuese e merr përsipër rolin e një gjykate të shkallës së katërt, dhe të cilët vlerësojnë se kjo gjë nuk është e mbuluar me bazë ligjore dhe shihet edhe si zbehje e kompetencës së vet Gjykatës Supreme të Kosovës e cila në raste të tilla po e humbë rolin e saj si shkalla e fundit e

vendosjes së drejtësisë. Në grupin e dytë përfaqësohen ekspertë të përfaqësuar nga vetë Gjykata Kushtetuese të cilët vlerësojnë se Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e shkallës së katërt, por që me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimeve të gjykatave ndikohet që të bëhet korrektimi i të drejtës dhe garantimi i procesit të rregullt gjyqësor (Gazeta Koha Ditore 2012: “*Supremja dhe kushtetuesja në luftë për kompetenca*, 1 gusht.). Ekziston edhe grupi i tretë i teoricienëve të të drejtës kushtetuese i cili përbëhet nga profesor universitar dhe të cilët nuk kanë shfaqur dëshirën që të marrin pjesë të paktën publikisht në debatin lidhur me këtë çështje.

Pas këtij rasti kundërshtim i ashpër është shfaqur në mes të këtyre dy institucioneve me rastin e përmbarimit të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës Për Shërbimin Civil-KPMSHC. Gjykata Kushtetuese kishte kthyer në rigjykim rreth 200 vendime të gjykatave. Gjykata Supreme kishte nxjerrë që më parë një Qëndrim Parimor sipas të cilit Vendimet e KPMSHC nuk paraqesin titull përmbarimor. Kulmi i këtyre mospajtimeve është arritur me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në Rastin KI04/12 të parashtruesit Esat Kelmendi lidhur me Vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac.nr. 647/2011, të 30 nëntorit 2011.

*Në rastin KI04/12 Gjykata Kushtetuese kishte shpallë të pavlefshëm Vendimin Ac.nr. 647/2011 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të 30 nëntorit 2011, i cili shkelë nenet 24, 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenin 6 në lidhje me nenin 13 të KEDNJ. Gjykata Kushtetuese në pikën III., të vendimit kishte vendosur që të kthejë Vendimin Ac.nr. 647/2011, në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë **për rishqyrtim në pajtim** me Aktgjykimin e kësaj gjykate, në përputhje me Rregullin 74(1) të Rregullores së Punës. Në pikën IV., Gjykata e Qarkut në Prishtinë duhet të i*

dorëzojë Gjykatës Kushtetuese informata lidhur me masat e ndërmarra për të zbatuar këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese.

Ky rast ka vënë në pozitë të vështirë gjykatësit e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë pasi ata ishin gjetur në pozitë shumë të papërshtatshme ndërmjet papajtueshmërisë së Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me këto veprime të Gjykatës Kushtetuese nga njëra anë (Gazeta Koha Ditore, dt.01.08.2012), dhe detyrueshmërisë që këtë rast ta "rishqyrtojë në pajtim" me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese. Gjyqtarët e Gjykatës së Qarkut edhe përkundër mospajtimit të Gjykatës Supreme kishin vendosur sipas "udhëzimeve" të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Ndonëse në shumë vendime të saj Gjykata Kushtetuese ka theksuar faktin se ajo nuk është gjykatë e "shkallës së katërt" dhe "nuk gëzon juridiksionin e apelit", prapëseprapë kjo gjykatë nuk ka arritur që të mbajë këtë vijë dhe të ruaj "kujdesshmërinë e skajshme", që të mos interferojë në vendimet e gjykatave të rregullta, dhe vendimet e saj të mos kuptohen në publikun e gjerë si gjykatë e instancës së katërt.

Në rastin KI 78/12 duke vendosur lidhur me Vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pkl. Nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012, Gjykata Kushtetuese pasi kishte konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Panshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E Drejta për proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me shumicë votash kishte shpallur të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, dhe e kishte kthyer në rivendosje në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Supreme. Gjykata

kishte lejuar masën e përkohëshme deri në kohën kur Gjykata Supreme e Kosovës të vendosë për çështjen si ratio decidendi të Gjykatës Kushtetuese.

Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se aktgjykimi i Gjykatës Supreme ka shkeluar të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Panshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E Drejta për proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 10. Përveç kësaj, parashtruesi ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese të vendosë masë të përkohëshme që parashtruesi deri në vendosje të këtij rasti nga ana e Gjykatës Supreme të mos privohej nga liria.

Në këtë rast Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar se mënyra në të cilën janë trajtuar provat në rastin e parashtruesit (nga ana e Gjykatës Supreme), demonstroi një kompleks vendimesh, të cilat reciprokisht përforcojnë ndikimin e tyre mbi drejtësinë e gjyimit të parashtruesit. Së pari, gjykatat e rregullta në vazhdimësi kanë refuzuar të autorizojnë një ekspertizë plotësuese për faktorët që ndikuan aksident (aksidentin e komunikacionit vër.jona, dhe së dyti, gjykatat e rregullta e justifikuan këtë refuzim në bazë të asaj se situata ishte mjaft e qartë për ta, në bazë të raportit ekzistues të ekspertëve. Megjithatë, raporti i ekspertit në fjalë ishte i bazuar në raportin e Policisë, në skica dhe foto, pa ndonjë procedurë nga eksperti për të verifikuar nga ai vet, me përpjekje individuale, informatat e përmbajtura në raportet policore. Vlefshmëria e raporteve të Policisë, gjithashtu, nuk ishte vërtetuar në asnjë fazë të procedurës nga ndonjë zyrtar i autorizuar gjyqësor ose nga ndonjë gjykatë. Është e diskutueshme ajo se deri në çfarë mase ishte në pozitë

parashtruesi të kontestonte përmbajtjen e raporteve të Policisë, edhe në qoftë se ai ishte në gjendje të kontestonte raportin e ekspertit bazuar në këto raporte policore (Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KI 78/12 i dt., 24.01.2013).

Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese nga përfaqësuesit e gjyqësorit është cilësuar si vendim i gjykatës së instancës së katërt, por edhe si ndërhyrje e politikës në vendimet e Gjykatës Kushtetuese (Gazeta Kosova Sot 2013 "Raporti i Progresit pritët me shqetësim-As Gjykata Kushtetuese nuk u ka shpëtuar kritikave", 12 tetor). Një vendim i tillë nuk i ka shpëtuar mospërfshirjes së tij në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën: "Në shqyrtimin e një çështje penale (që përfshin një kryetar komune) në janar, Gjykata Kushtetuese, duke marrë përsipër rastin dhe duke e referuar atë rast përsëri në Gjykatën Supreme për rishqyrtim, gabimisht sugjeroi se ajo mund të merr përsipër të veprojë si gjykatë (shitesë) e shkallës së fundit" thuhet në pjesën lidhur me Sistemin gjyqësor në këtë raport (Raporti i Progresit Për Kosovën i Komisionit Evropian, 2013).

Përplasjet në mes të dy gjykatave më të larta në vend dhe qasjet e ndryshme për të njëjtën çështje kanë krijuar paqartësi dhe për një moment është krijuar përshtypja se ekzistojnë dy lloj të drejtësisë në të njëjtin sistem juridik në Kosovë. Çështja e urdhërimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese për gjykatat e rregullta që të vendoset në pajtim me vendimin e vet Gjykatës Kushtetuese sikur e humb rëndësinë e të mbajturit të sërishëm të procesit gjyqësor në gjykatën më të ulët. Nga praktika është parë se kjo ka reflektuar në

paragjykim të rastit dhe në njëfarë mënyre ka pasur ndikim edhe në vet procesin e rregullt ligjor.

Baza të cilës i referohet Gjykata Kushtetuese në procesin e rishikimit dhe shfuqizimit të vendimeve të Gjykatës Supreme, ka të bëjë kryesisht me dështimin e Gjykatës Supreme në ruajtjen e besueshmërisë dhe integritetit të përgjithshëm të procedurës, e cila kishte shkaktuar edhe shkeljen e të drejtës kushtetuese për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç është parashikuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe neni 6 të KEDNj. Gjithashtu Gjykata Kushtetuese e Kosovës është e autorizuar të kontrollojë disa akte të caktuara individuale në kuptimin e përputhshmërisë së tyre me Kushtetutën. Një juridiksion specifik i Gjykatës është që të kontrollojë aktet e autoriteteve publike që nxirren në raste individuale, për përputhjen e tyre me katalogun kushtetues të të drejtave të njeriut. Kjo mbetet ndoshta prej juridiksioneve më të rëndësishme *in concreto* të Gjykatës, si dhe e vetmja hapësirë e saj për të kontrolluar kushtetutshmërinë e të drejtave individuale të njeriut që rrjedhin nga rastet individuale që parashtrohen normalisht në gjykata të rregullta (Hasani, 2012: 9).

Vlen të përmendet se edhe në Shqipëri kishte pasur ide që Gjykata Kushtetuese ta shohë të drejtën për një proces të rregullt ligjor edhe në aspektin substancial, pra ta dimensionojë atë për të analizuar edhe vetë të drejtën themelore që është prekur përgjatë një procesi adresimi të një çështje përgjatë proceseve të zbatimit të ligjit apo zgjidhjes së konfliktit. Por, nga ana tjetër kishte pasur edhe aso idesh që kjo mund të konsiderohet si një përplasje juridiksioni të Gjykatës Kushtetuese me Gjykatën e Lartë (Zaganjori, 2011: 84).

Teoricienë të së drejtës kushtetuese në Kosovë, Gjykatës Kushtetuese si tribunal specifik i atribuojnë edhe marrjen përsipër të rolit të trajtimit të shkeljes së të drejtave në

nivel shtetëror. Kjo pasi që Kosova nuk është palë në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e personat nga Kosova nuk mund të paraqiten *ratione personae* dhe *ratione loci* para Gjykatës në Strasburg. Sipas tyre kjo është e kuptueshme pasi që Kushtetuta e Kosovës obligon gjykatat dhe të gjitha autoritetet tjera publike të Kosovës që të ndjekin praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, si dhe i jep kompetencë specifike Gjykatës Kushtetuese për të shërbyer si tribunal subsidiar për të kontrolluar përputhshmërinë e akteve publike me ligjet e të drejtave të njeriut. Kështu Gjykata Kushtetuese mbetet mekanizëm zëvendësues për të zëvendësuar rolin që normalisht GjEDNj luan në një shtet anëtar të Këshillit të Evropës (Hasani, E., 2012: 30).

Vlerësojmë se, roli i Gjykatës Kushtetuese duhet që të jetë analog me atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: nuk vepron si gjykatë e “instancës së katërt” dhe nuk zëvendëson interpretimet e saj ligjore me ato të gjykatave të zakonshme. Gjykata Kushtetuese duhet kufizuar vetëm në atë nëse ” gjykata e instancës më të ulët ka respektuar të drejtat kushtetuese të parashtruesve të kërkesave, siç është e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës).

6.4. Efekti juridik i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

Kushtetuta e Kosovës në nenin 116 të saj ka përcaktuar se “vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës (Kushtetuta e Republikës së Kosovës-neni 116). Neni 132 i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon se “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Gjykata Kushtetuese ka vetëm të drejtën

e shfuqizimit të akteve që i shqyrton. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që ligji ose akti tjetër normative të shfuqizohet në një datë tjetër” (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë- neni 132). Sipas Rregullit 56 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Gjykata nxjerr aktgjykime (kur vendos në bazë meritore për një kërkesë); aktvendime (kur vendos për pranueshmërinë e një kërkesë), vendime (kur vendos në lidhje me kërkesat për masë të përkohshme). Gjykata mund të nxjerr edhe vendime administrative, sa herë që vendos në seancë administrative për çështje administrative dhe urdhra të tjerë të atillë që kohë pas kohe konsideron si të duhur (Rregullore e Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 185/1/2010, dt. 23 Nëntor 2010).

Efekti juridik i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, gjegjësisht çështja e zbatimit të vendimeve të kësaj gjykate nuk ka kaluar pa problematika. Kjo ngase efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese varen në mënyrë të konsideruar nga disa faktorë siç janë tipi ose llojet e procedurave kushtetuese, natyra e kontestit kushtetues, i cili është objekt shqyrtimi para Gjykatës Kushtetuese, llojet e subjekteve që marrin pjesë në procesin e kontrollit kushtetues, natyra e normave juridike të cilat kundërshtohen në pikpamje kushtetuese si dhe vetë përmbajtja e vendimit të Gjykatës Kushtetuese (Morina, 2013: 113).

Në Kosovë nuk ka organ të posaçëm që merret me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Në dispozitat kushtetuese, dispozitat ligjore dhe rregullat procedurale të Gjykatës kushtetuese theksohet përveç fuqisë juridike të vendimeve (të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës), edhe koha e hyrjes në fuqi dhe momenti i të qenit i ekzekutueshëm i vendimit. Lidhur me kohën e hyrjes në fuqi Kushtetuta ka përcaktuar se “ Përveç nëse është

përcaktuar ndryshe me vendim të Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimi i ligjit, i aktit ose i veprimit hyn në fuqi në ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës” (Kushtetuta e Republikës së Kosovës- neni 116). Nëse i referohemi dispozitave ligjore vendimi hyn në fuqi ditën e shpalljes në gazetën zyrtare, përveç nëse Gjykata Kushtetuese është shprehur ndryshe në vendim (Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës-neni 20.5). Ndërsa me rregullat e procedurës është lënë në vlerësimin e gjykatës që të caktojë afatin dhe mënyrën e zbatimit të vendimit, dhe këtë ajo mund t’ë specifikojë në vendim (Rregulli 63.4 i Rregullorës së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës). E rregulluar në këtë mënyrë, kjo dispozitë i jep kompetencë Gjykatës Kushtetuese që të përcaktojë në mënyrë autonome edhe administrimin e efekteve juridike të vendimeve të saja, duke qenë se mund të përcaktojë kohën e hyrjes në fuqi dhe mënyrën e ekzekutimit (zbatimit) të vendimit të saj.

Rregullat e procedurës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në Pjesën e VII Dispozita të veçanta për procedura të caktuara sipas Nenit 113 të Kushtetutës, kanë detajuar edhe më tutje detyrimin e ekzekutimit të vendimeve, duke përcaktuar se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për:

- Të gjitha nivelet e gjykatave, brenda kornizës së kompetencave të tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj;
- Të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës;
- Të gjithë personat fizik dhe juridik

Rregullat e procedurës më tej, kanë precizuar që organi që është i ngarkuar me detyrimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, duhet të dorëzojë informacione, nëse kërkohet dhe ashtu siç parashikohet me vendim, për masat e ndërmarra në kuadër të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Në rast të mos zbatimit të

vendimit, Gjykata Kushtetuese mund të lëshojë një vendim në të cilin do të theksohet që vendimi nuk është zbatuar dhe të vendosë për botimin e atij vendimi në Gazetën Zyrtare, duke detyruar sekretariatin që, nën mbikëqyrjen e gjyqtarit i cili në pajtim me Rregullin 44 e ka hartuar vendimin (gjyqtarin relator), të mbikëqyrë ekzekutimin e vendimit, dhe sipas nevojës, do t'i raportojë dhe rekomandojë Gjykatës marrjen e masave të nevojshme për të bërë të mundur ekzekutimin e plotë të vendimit.

Edhe pse numër simbolik, megjithatë në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ka vendime të cilat nuk janë zbatuar apo që është bërë zvarritje e pa arsyeshme në ekzekutimin e tyre. Rasti më pikant është Aktgjykimi në Rastin nr. KI 08/09, ku Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtës për mjete efektive duke theksuar se vendimi përfundimtar dhe i detyrueshëm i Gjykatës Komunale në Ferizaj duhet të ekzekutohet nga ana e Qeverisë dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Gjykata kishte kërkuar nga këto organe që të dorëzonin në Gjykatë, brenda një periudhe gjashtë mujore, informacione lidhur me masat e ndërmarra për ekzekutimin e këtij Aktgjykimi (Aktgjykimi në Rastin nr. KI 08/09, Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut, IMK, në Ferizaj, e përfaqësuar nga z. Ali Azemi, kryetar i Sindikatës- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit C.nr.340/2001, të 11 janarit 2002, Nr.VMSP323/12, dt. 17 dhjetor 2010).

Në fakt kjo nuk kishte ndodhur në afatin e përcaktuar me Aktgjykim dhe Gjykata Kushtetuese kishte vendosur që të publikojë vendimin për mosekzekutim, për shkak se Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit në Kosovë, ende nuk kishte bërë ekzekutimin e aktgjykimit (Vendim për Mospërmbarim në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, të 17 dhjetorit 2010, në Rastin nr. KI 08/09, Sindikata e Pavarur e Punonjësve

të Fabrikës së Çelikut, IMK, në Ferizaj, e përfaqësuar nga z. Ali Azemi, kryetar i Sindikatës- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit C.nr.340/2001, të 11 janarit 2002, Nr.VMSP323/12, dt. 14 nëntor 2012, *Buletini i Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës 2012: 37*).

Pas kësaj Gjykata Kushtetuese bazuar në kompetencat e saj lidhur me atë që *autoritete publike duhet të ekzekutojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese*, dhe meqë ekzekutimi i vendimit edhe më tutje nuk po ndodhte i ka dhënë një afat shtesë prej gjashtë muajsh Qeverisë së Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit, që brenda një periudhe gjashtë mujore, të sillnin në Gjykatë informacione lidhur me masat e ndërmarra për ekzekutimin e aktgjykimit në fjalë. Në fakt kishin kaluar tri vite të plota që nuk ishte bërë ekzekutimi i vendimit dhe se autoritetet e ngarkuara me detyrimin e ekzekutimit të këtij vendimi nuk po ndërmerrnin asnjë veprim lidhur me këtë çështje.

Ndryshe nga rasti i Kosovës, në Shqipëri, ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Këshilli i Ministrave me anën e organeve përkatëse shtetërore. Gjykata Kushtetuese në Shqipëri mund të caktoj vetë një organ tjetër që ngarkohet me zbatimin e vendimit të saj, dhe kur është e nevojshme edhe mënyrën e ekzekutimit të tij. Ligji për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese ka përcaktuar se: “Personat që nuk zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese ose pengojnë zbatimin e tyre, kur veprimi nuk përbën vepër penale, dënohen me gjobë deri në 100 mijë lekë nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese, vendimi i të cilit është i formës së prerë dhe përbën titull ekzekutiv” (Ligji Nr.8577, datë 10.02.2000, Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë- neni 81). Neni 81 i ligjit nr. 8577, datë: 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë “, në

lidhje me çështjen e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese përcakton, se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim. Ky nen, synon të vendosë rregulla të prera në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, duke shkuar deri aty sa Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese i jepet e drejta që të gjobisë personat që pengojnë zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, kur ky vendim është i formës së prerë dhe përbën titull ekzekutiv.

Nga kjo dispozitë duket që sistemi i zgjedhur i ngjason atij të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg, ku organi që merret me ekzekutimin e vendimeve të kësaj Gjykate është Komiteti i Ministrave nëpërmjet strukturave të tij (Raporti i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë- Drejtoria e Studimeve, *Studim mbi procesin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese*, 2008: 53). Sado që neni 81 ofron zgjidhje të tillë, në fakt ky nen nuk ka gjetur zbatim në praktikë dhe Këshilli i Ministrave nuk ka një organ që të ndjekë zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu, edhe vetë Gjykata Kushtetuese, megjithëse ka të drejtën të caktojë vetë një organ tjetër për ekzekutimin e vendimeve të saj, madje edhe të përcaktojë mënyrën e ekzekutimit të vendimeve të saj, nuk ka realizuar asnjëherë këtë kompetencë (Raporti i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë- Drejtoria e Studimeve, *Studim mbi procesin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese*, 2008: 54).

Në bazë të asaj që u parashtrua më lartë lidhur me efektin juridik të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, në rastin e Kosovës nuk ekzistojnë mekanizma të posaçëm për ekzekutimin e vendimeve të kësaj Gjykate, ndërkohë që në rastin e Shqipërisë kushtetuta parasheh mekanizma por që nuk janë përdorur asnjëherë në praktikë. Për më tepër në Shqipëri nuk është parashikuar ndonjë mekanizëm ose procedurë e veçantë se si do të bëhet

ky ekzekutim. Në rastin e Kosovës përgjithësisht nuk janë shfaqur kundërshtime lidhur me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, ndonëse detyrueshmëria kushtetuese e ligjore e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe mundësia faktike për t'i ekzekutuar ato mund të mos përputhen gjithnjë. Një vendim të tillë paraqet Rasti nr. KI 08/09, Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut, IMK, në Ferizaj dhe ekzekutueshmëria e të cilit përbën një kosto shumë të lartë për buxhetin e Kosovës. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për praktikën në Shqipëri, për të cilën mund të thuhet se vendimet e Gjykatës Kushtetuese në përgjithësi janë zbatuar për shkak të karakterit të tyre detyrues si vendime përfundimtare dhe të formës së prerë (Raporti i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë- Drejtoria e Studimeve, *Studim mbi procesin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese*, 2008: 5).

Një çështje më me interes jo vetëm për Kosovën, por edhe për vendet e tjera është rasti i ekzekutimeve të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që kanë të bëjnë me shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme të kundërshtuara nga individët për shkelje të të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, apo shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë. Në këtë kontekst do të ishte me interes të shtrohet çështja se vendimet e Gjykatës Kushtetuese në Kosovë që shfuqizojnë vendimet e gjykatave të zakonshme kanë karakter detyrues të përgjithshëm apo ato janë të detyrueshme vetëm për kërkesën si të pranueshme, ka vendosur që të përsërisë procedurën për shkaqe të njëjta para palët në proces dhe jo për personat e tjerë ose organet shtetërore, të cilët nuk kanë dijeni për to. Ndonëse në teorinë juridike zgjidhjet gjenden varësisht nga sistemi ligjor dhe praktikat e vendosura, në rastin e Kosovës zgjidhja del nga vetë teksti i Kushtetutës, por edhe nga

statusi tipik i Gjykatës Kushtetuese si organ i veçantë dhe i specializuar për interpretimin e kushtetutës dhe mbrojtjen e kushtetutshmërisë.

Lidhur me këtë çështje në teorinë juridike shfaqen dy mendime. Disa autorë shprehen se vendimet e Gjykatës Kushtetuese që shfuqizojnë vendimet e gjyqësore nuk kanë fare karakter detyrues të përgjithshëm; ato janë të detyrueshme vetëm për palët në proces dhe jo për personat e tjerë ose organet shtetërore, të cilët nuk kanë dijeni për to, përndryshe do të cenohet siguria ligjore e gjithsecilit. Autorë të tjerë vlerësojnë se vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi detyruese të përgjithshme, dhe jo vetëm për palët që marrin pjesë në këtë proces (Raporti i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë- Drejtoria e Studimeve, Studim mbi procesin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, 2008: 7).

Mendojmë se vendimi i Gjykatës Kushtetuese i cili shfuqizon një vendim gjykate për proces të parregullt apo një të drejtë të mbrojtur me Kushtetutë, ka fuqi detyruese të përgjithshme, dhe jo vetëm për palët që marrin pjesë në këtë proces. Në rastin Imer Ibrahimit dhe 48 ish-punëtor të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 49 Aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Gjykata Kushtetuese bëri kthimin në rigjykim të vendimeve të Gjykatës Supreme, është bërë shkak për parashtrimin e shumë kërkesave për përsëritjen e procedurës. Një kërkesë të tillë Gjykata Supreme e ka pranuar me vendimin e saj PPC nr. 6/2012. Në këtë vendim Gjykata e Apelit pasi që ka theksuar se Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj KI 40/09 ka shpallur Gjykatës Themelore në Prishtinë (Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në Rastin KI 40/09).

6.5. Efektet e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar se: *“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:*

- a) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;*
- b) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;*
- c) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;*
- d) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;*
- e) Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;*
- f) Konventën për të Drejtat e Fëmijës;*
- g) Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese (Kushtetuta e Republikës së Kosovës- neni 22).*

Zbatimi i drejtpërdrejtë i akteve ndërkombëtare të cekura si më lartë e me këtë edhe i vetë Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj ka bërë që Kosova të ketë një Kushtetutë me një nivel mjaft të avancuar të respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Duke pasur për bazë parashtrimet e mësipërme është parë se në sistemin ligjor të Kosovës Konventa ka aplikim të gjerë dhe legjislacioni i Kosovës i ngarkon autoritetet shtetërore me detyrimin për zbatimin e të njëjtës. Gjithashtu në nenin 53 Kushtetuta ka përcaktuar se:

“ Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë,

interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut". Duke pasur parasysh se gjykatat kushtetuese të numrit më të madh të vendeve evropiane, nëpërmjet zbatimit dhe interpretimit të dispozitave kushtetuese për të drejtat e njeriut, në pajtim me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e kanë pranuar interpretimin e dispozitave për të drejtat e njeriut në pajtim me vendimet gjyqësore të kësaj Gjykate, prandaj edhe neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës e kërkon këtë me dispozitën e vet të përmendur (Hasani, E. 2013: 201).

Në Rastin KO 01/09 Qemajl Kurtishi kundër Kuvendi Komunal i Prizrenit Gjykata Kushtetuese e Kosovës është shprehur se: "Vendimet që dalin nga tribunalet që vendosin në bazë të këtyre Konventave, fillimisht Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut me seli në Strasburg, ndihmojnë dhe mbështesin jo vetëm të gjitha Gjykatat e Kosovës, por edhe organet tjera dhe zyrat publike mbi atë se si duhen interpretuar dhe aplikuar të drejtat dhe liritë themelore në Kosovë (Buletini i Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, 2009-2010: 86).

Në cilindo rast Gjykata Kushtetuese, në rastet që vendos, i referohet jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë mënyrë me arsye pritet që Kosova do t'i afrohet një doktrine të të drejtave të njeriut, çfarë e kërkon zbatimi dhe interpretimi i dispozitave kushtetuese për të drejtat e njeriut, që do të hapë rrugën e globalizimit të të drejtave kushtetuese të Kosovës dhe do të kontribuojë për mbrojtjen më të mirë të të drejtave të individëve në Republikë (Hasani, E. 2013: 201). Dispozita e përmendur lidhet me parimet e përgjithshme të parashikuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të cilat theksojnë se të drejtat dhe liritë themelore përbëjnë bazën e rendit juridik të Republikës së Kosovës, se këto të drejta vlejné për të gjithë personat dhe që të gjithë janë të

obliguar që t'i respektojnë ato, si dhe dispozitën e cila parashikon zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe të instrumenteve ndërkombëtare (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 21, 22). Nga kjo shihet që Kushtetuta e Republikës së Kosovës e garanton zbatimin e drejtpërdrejtë të të drejtave të njeriut, sipas mënyrës në të cilën këto të drejta edhe janë garantuar me rregulla të pranura përgjithësisht të së drejtës ndërkombëtare. Zbatimi i drejtë i dispozitave për të drejtat dhe liritë themelore dhe interpretimi në pajtim me të drejtën dhe praktikën ndërkombëtare të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, garantohej që dispozitat për të drejtat dhe liritë themelore, të interpretohen në dobi të përparimit të vlerave të shoqërisë demokratike. Kjo gjë do të kontribuonte edhe çështjet e harmonizimit të legjislacionit të Republikës së Kosovës me legjislacionin e Unionit Evropian (Hasani, E. 2013: 201).

Përderisa legjislacioni i Kosovës ka paraparë shprehimisht interpretimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në harmoni me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në rastin e Shqipërisë kjo gjë nuk është e përcaktuar shprehimisht me kushtetutën e këtij vendi. Vlera e Konventës dhe interpretimeve të Gjykatës për autoritetet shqiptare është e përcaktuar në nenet 5, 116, 122 (1) dhe në veçanti në nenin 17 (2) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Neni 5 i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon se : *“Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të”*. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut bën pjesë në kategorinë e traktateve ndërkombëtare dhe në bazë të Kushtetutës gjen zbatim në Republikën e Shqipërisë (Bianku, 2001: 49).

Bianku, vlerëson se me dispozita kushtetuese Republika e Shqipërisë parashikon jo vetëm pozicionime të qarta por edhe saktësime shtesë në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare dhe për pasojë edhe zbatimin e tyre brenda vendit. Sipas autorit Bianku,

neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se traktatet ndërkombëtare bëjnë pjesë në burimet normative të Republikës së Shqipërisë kur ato janë të ratifikuara dhe ky nen i kombinuar me nenin 121 paragrafi 1 (b), vijues të Kushtetutës dhe me praktikën shqiptare të përfundimit me anë të ratifikimit të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut bën pjesë në burimet normative të Republikës së Shqipërisë. Neni 122 i Kushtetutës ka përcaktuar se :“*Çdo marrëveshje e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik*”. Dispozita e paragrafit të 2 të tij marrëveshjeve ndërkombëtare i vendos në një rang më të lartë se sa ligjet duke u shprehur: “*Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit...*”. Përgjigjen përfundimtare në lidhje me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut e jep neni 17 (2) i Kushtetutës sipas të cilit : “ *Këto kufizime...në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut*” Ky paragraf çon në përfundimin që në zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të gjitha autoritetet vendore në Shqipëri duhet të kenë si pikë reference bazë dhe si dyshe standardizuese Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Pra, ata nuk mund t’i zbatojnë normat e tjera të brendshme ose edhe ndërkombëtare në kundërshtim me sa parashikon Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Bianku, 2001: 50). Sipas autorit Bianku “Republika e Shqipërisë i ka plotësuar procedurat e përfundimit të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, këtij traktati me karakter të veçantë ndërkombëtar, me nënshkrimin e saj me 13 korrik 1996, me ratifikimin e saj me anë të ligjit nr. 8137 të 31 korrikut 1996 dhe me depozitimin e instrumenteve të ratifikimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës më 2 tetor 1996”.

Në mënyrë përmbledhëse lidhur me këto problematika mund të thuhet se realiteti i tanishëm juridik në Kosovë është i tillë që Konventa ka aplikim të gjerë dhe është e akceptuar në shumë nene të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndërkaq nuk ekziston edhe mundësia e që shtetasit e Kosovës të gëzojnë mbrojtjen gjyqësore që e ofron juridiksioni i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Teoricienë të ndryshëm ndërkombëtar pohojnë se për t'iu bashkangjitur Konventës, shteti duhet që të jetë anëtar i Këshillit të Evropës. Që të arrijnë një gjë të tillë shtetet duhet të dëshmojnë jo vetëm përkushtimin e tyre ndaj vlerave të shoqërisë së hapur, gjithashtu edhe nevojën për përmbajtje institucionale të demokracisë. Për shtetet e reja që kanë dalë nga sistemet totalitare, anëtarësimi në Këshillin e Evropës nuk bëhet me automatizëm, mirëpo është diçka që duhet të fitohet (Merrills, J.G., 1999: 115; Azizi, 2010: 347).

Neni 1 i Konventës ka përcaktuar se: *“Palët e Larta kontraktuese i njohin çdo njeriu që ndodhet nën juridiksionin e tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Pjesën e parë të kësaj konvente”* (Gruda, 2001: 61). Në Kosovë ka autorë të cilët mendojnë se shtetasit e Kosovës megjithatë mund të bëhen pjesë e juridiksionit të Gjykatës në Strasburg. Iliriana Islami mendon se pikërisht paraqitja e padisë mund të bëhet në bazë të nenit 1 (një) të Konventës, i cili nen përcakton juridiksionin e shteteve pra përkufizon lidhjen që duhet të ekzistoj midis një personi dhe një shteti anëtar, me qëllim që të zbatohet Konventa. Sipas këtij neni personi në fjalë duhet të gjendet brenda “juridiksionit” të shtetit anëtar përkatës, dhe për më shumë Gjykata “juridiksionin nuk e përkufizon me elementin territorial” andaj edhe krijohet detyrimi i shteteve që respektojnë të drejtat e njeriut në territorin ku “ato ushtrojnë efektshëm pushtetin e tyre”. Ky detyrim nuk është i kufizuar vetëm në territorin e Palëve të Larta Kontraktuese, por, këto mund të bëhen përgjegjëse edhe për shkak të

veprimeve të autoriteteve të tyre, të kryera brenda ose jashtë kufijve kombëtar, që sjellin pasoja jashtë territorit të tyre. Lidhur me këtë rast autorja Iliriana Islami thotë se një interpretim i këtillë është bërë në rastin Loizdou kundër Turqisë (Islami, 2004: 929 dhe Islami, 2007:6). Deri më tani dy raste nga Kosova për herë të parë janë paraqitur para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg. Bëhet fjalë për rastet Behrami dhe Behrami kundër Francës dhe Saramati kundër Gjermanisë, Francës dhe Norvegjisë.

“Agim Behrami nga Shipoli i Mitrovicës ishte baba i dy fëmijëve të cilët derisa po luanin në kodrat e këtij fshati së bashku me disa fëmijë të tjerë, kishin gjetur bomba-kasetë të pa eksploduar, të cilat ishin hedhur gjatë bombardimeve të NATO-s në vitin 1999. Njëri fëmijë kishte vdekur ndërsa tjetri ishte lënduar shumë rëndë së bashku edhe me gjashtë fëmijë të tjerë. Në kohën e ngjarjeve (11 mars 2000) Mitrovica ishte e vendosur nën përgjegjësinë e një Brigade Shumëkombëshe të KFOR-it e drejtuar nga Franca dhe e mandatuar nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB, miratuar në qershor 1999. Përgjegjësia e KFOR-it qëndronte në faktin se KFOR-i ishte në dijeni për ekzistimin e këtyre bombave – kasetë dhe nuk kishte marrë asnjë veprim për të bërë çaktivizimin ose për të bërë sinjalizimin e vendit në të cilin gjendeshin ato. Në bazë të Rezolutës 1244 krijimi i një mjedisi të sigurt, sigurimi i rendit dhe qetësisë publike dhe de minimi parashikohet në paragrafin 9 (c,d,e). Në këtë rast KFOR-i kishte dështuar në “mbrojtjen pozitive” si bazë për interpretimin e Konventës. Këto raste njihen si rastet Behrami dhe Behrami kundër Francës...”(Islami, 2004: 929 dhe Islami, 2007:6).

“Ruzhdi Saramati (1950) nga Prizreni në prill të vitit 2001 ishte ndaluar nga policia e UNMIK-ut dhe i ishte caktuar më pas paraburgimi. Në maj 2001 i ishte ngritur aktakuza për veprat penale tentim vrasje, cenim i integritetit fizik, mbajtje pa leje të armëve dhe materieve plasëse etj, kurse pas paraqitjes së ankesës kundër mbajtjes në paraburgim ishte liruar. Më 13 korrik 2001 ishte ndaluar nga dy policë ndërkombëtar gjerman, kurse një pjesëtarë i KFOR-it gjerman e kishte njoftuar me gojë se ndalimi i tij po bëhej me urdhër të komandantit të KFOR-it (“COMKFOR”- një oficer norvegjez në atë kohë), kurse të nesërmen i ishte caktuar paraburgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh. Me 26 korrik 2001 në përgjigje të një letre të mbrojtësve të të paraburgosurit të cilët kishin kundërshtuar mbajtjen e mëtutjeshme në paraburgim dhe ligjshmërinë e paraburgimit, këshilltari juridik i KFOR-it kishte lëshuar njoftimin se KFOR-i kishte autoritetin për të ndaluar një person sipas Rezolutës 1244 të KS të KB në masën kur kjo ishte e nevojshme “për të krijuar një mjedis të sigurt” dhe për të mbrojtur trupat e KFOR-it dhe se KFOR kishte informata në lidhje me implikimin e z Saramati në grupet e armatosura që vepronin në zonën kufitare ndërmjet Kosovës dhe IRJM-së, dhe çmonte se ky person paraqiste një kërcënim për sigurinë e KFOR-it dhe banorët e Kosovës (Haxhaj, 2008: 55). Ruzhdi Saramati kishte qëndruar në paraburgim vazhdimisht ndërsa më 6 shtator 2001 dërgohet për gjykim para Gjykatës së Qarkut. Ky nga data 17 shtator 2001 deri më 23 janar 2002 mbrojtja vazhdimisht kishte kërkuar lirimin nga paraburgimi ndërsa përgjigjja e gjykatës ishte se paraburgimi ishte tërësisht nën përgjegjësinë e KFOR-it. Në tetor 2001 udhëheqjen e KFOR-it e merr një gjeneral francez. Në janar 2002 Ruzhdi Saramati ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar për

veprën penale tentim vrasje nga neni 30 al 2, pika 6 të Ligjit Penal të Kosovës lidhur me nenin 19 të Ligjit Penal të ish federatës Jugosllave dhe ishte dërguar nga qendra për paraburgime e KFOR-it në atë të UNMIK-ut në Prishtinë. Në tetor 2002 Gjykata Supreme e Kosovës kishte shfuqizuar vendimin e Gjykatës së Qarkut dhe kishte kthyer çështjen në rigjykim kurse të akuzuarit Saramati i kishte ndërprerë paraburgimin. Ruzhdi Saramati kishte paraqitur kërkesën e tij në Gjykatën e Strasburgut më 28 shtator 2001 dhe ishte ankuar në bazë të nenit 5 (E drejta e lirisë dhe sigurisë së personit) dhe nenit 13 (E drejta e një mjeti ligjor të efektshëm) të Konventës lidhur me ndalimin e tij nga KFOR-i që nga 13 korriku 2001 deri më 26 janar 2002). Ai gjithashtu ishte ankuar sipas nenit 6 par 1 (E drejta për proces të drejtë) dhe për më tepër sipas nenit 1 (Detyrimi për respektimin e të drejtave të njeriut) mosplotësimin nga Gjermania, Franca dhe Norvegjia të detyrimeve të tyre pozitive për t'u garantuar të drejtat e përcaktuara me Konventë personave banues në Kosovë” (Zyberi, 2007 “Përgjegjshmëria e institucioneve të Qeverisë së Kosovës në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut: Aktualiteti dhe e ardhmja”, ajls. org, Tiranë (volume 1). Shih përkatësisht Behrami v. Francë (Rasti Nr. 71412/01) dhe Saramati v. Francë, Norvegji dhe Gjermani (Rasti Nr. 78166/01) përpara Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj). Shih edhe Baku, 2007, *Kosovarët humbasin gjyqin në Strasburg-* www.peshkupauje.com, (parë më 8/2/2015).

Në vendimin e vet të shpallur më 31 maj 2007 për të dyja këto raste Gjykata e Strasburgut vendosi që nuk është kompetente që të njohë, vlerësojë apo gjykojë, çështje që kanë të bëjnë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara (Baku, 2007,

Kosovarët humbasin gjyqin në Strasburg- www.peshkupauje.com, (parë më 8/2/2015).

Është e një rëndësie të veçantë që edhe shtetasit e Kosovës të kenë të drejtën dhe mundësitë që të bëjnë ankimin para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Një gjë e tillë do të rriste edhe përgjegjësitë e institucioneve të Kosovës që të përmbushin standardet e pranura të vendeve të përparuara të perëndimit dhe do të ndikonte në përmirësimin e ambientit aktual të respektimit të të drejtave të njeriut brenda në Kosovë. Me këtë do të përshpejtohej edhe arritja e standardeve të pranueshme lidhur me ndërtimin e sistemit institucional shtetëror dhe ngritjen e shkallës së demokracisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut të parapara me Konventë dhe të mbrojtura me juridiksionin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

6.6. Elementet e procesit të rregullt gjyqësor sipas Gjykatës Kushtetuese të Kosovës

Ndonëse me një përvojë jo të gjatë në proceset e vendosjes, Gjykata Kushtetuese e Kosovës në praktikën e saj ka formësuar elementet e procesit të rregullt e me këtë edhe të atij të rregullt gjyqësor. Me praktikën e saj të vendosjes, Gjykata Kushtetuese ka arritur që të vejë në kornizat e nevojshme shumë procese gjyqësore të cilat kanë rezultuar me shkelje të së drejtës për proces të rregullt sidomos në rastet kur këto shkelje janë bërë nga ana e gjykatave të zakonshme. Elementet e procesit të rregullt gjyqësor të cilat i ka evidentuar praktika e Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Kosovës ndër më kryesoret e të cilat kanë qenë objekt shqyrtimi para Gjykatës do të përmendnim:

- E drejta për t'iu drejtuar gjykatës;
- E drejta për tu gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme;
- E drejta për jetë dhe për mjete juridike;
- Barazia e armëve (kontradiktoriteti);
- E drejta për siguri juridike për shkak të ekzistimit të vendimeve gjyqësore dhe administrative;
- Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, etj.

6.6.1. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës

E drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta për qasje në gjykatë, e drejta e aksesit në gjykatë) përbën një ndër të drejtat shumë të rëndësishme të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar se: *”Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave të tyre”* (Kushtetuta e Republikës së Kosovës-neni 31).

*Në rastin **KI 186/14** (të ushtruar më dt.23.01.2015) Parashtruesi i kërkesës kishte filluar që të punonte në policinë e Kosovës (atëherë Shërbimi Policor i Kosovës) si oficer policie. Pas një kallëzimi penal kundër tij, ndër të tjera, ndaj parashtruesit të kërkesës ishte iniciuar edhe procedurë e brendshme disiplinore në përputhje me aktet e brendshme disiplinore të policisë. Kallëzimi penal ishte hedhur poshtë nga Prokuroria Publike në Mitrovicë dhe parashtruesi i kërkesës ishte liruar nga procedura penale. Megjithatë Shërbimi Policor i Kosovës gjatë vitit 2005 merr vendim për largimin e parashtruesit nga*

detyra. Ky i fundit inicioi procedurë të brendshme të ankesës, e cila përfundimisht u refuzua nga Komisionari i Policisë së UNMIK në nëntor të vitit 2005 dhe vendimi për largimin e tij nga detyra u konfirmua.

Parashtruesi i kërkesës ushtroi padi për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të tij nga marrëdhënia e punës. Padia e tij u hodh poshtë nga gjykatat e zakonshme me arsyetimin se ishte paraqitur pas afatit të paraparë ligjor. Parashtruesi i kërkesës pretendonte se gjykatat gabimisht e konsideruan një rekomandim të Komisionit të Ankesave të Shërbimit Policor të Kosovës si vendim final të Komisionarit të Policisë, i cili vendim asnjëherë nuk iu dorëzua parashtruesit të ankesave. Sipas tij gjykatat e zakonshme e përfundimisht edhe Gjykata Supreme e Kosovës i kanë shkelur të drejtat kushtetuese për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut si dhe të drejtën për mjete efektive juridike të garantuara me nenin 32 dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 13 të Konventës.

Lidhur me **Çështjen Kushtetuese në Shqyrtim**, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të konstatojë nëse Aktvendimi i Gjykatës Supreme Rev.nr.153/2014, i dt. 17.06.2014 shkelë të drejtën e Parashtruesit të Kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut dhe nëse Aktvendimi i njëjtë shkelë të drejtën e Parashtruesit të Kërkesës për mbrojtje gjyqësore të të drejtave si dhe të drejtën për mjete efektive juridike të garantuar me nenin 32 dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 13 të Konventës.

Parashtruesi i kërkesës pasi ka theksuar se E drejta e parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë është shkelur nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës, pastaj se nga po e njëjta gjykatë është shkelur Parimi i Sigurisë Juridike dhe është shkelur edhe E drejta për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe për mjete juridike efektive dhe se kërkesa përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj, e që janë: a) shkelja e të drejtës nga ana e një Autoriteti Publik; b) shterimi i mjeteve juridike; dhe c) afati kohor (prej katër muajve). Ka theksuar se kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës që:

- I. Të shpallë se Kërkesa e Parashtruesit të Kërkesës është e pranueshme;*
- II. Të konstatojë se e drejta kushtetuese e parashtruesit të kërkesës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 6 të Konventës e ndërlidhur me të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe të drejtën për mjete efektive juridike e garantuar me nenin 54 të Kushtetutës është shkelur nga Gjykata Supreme e Kosovës përmes Aktvendimit Rev.nr.153/2014.*
- III. Të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës Supreme Rev.nr. 153/2014, të dt. 17.06.2014.*
- IV. Të përcaktojë dhe vendosë çfarëdo mase tjetër juridike që Gjykata Kushtetuese e vlerëson si të bazuar në Kushtetutë dhe në Ligj dhe e cila është e arësyeshme për rastin në fjalë.*

Vendimi dhe arsyetimi i Gjykatës

*Gjykata ka vendosur që kërkesa e parashtruesit përbën papranueshmëri. Gjykata më tutje ka vlerësuar se duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkues në lidhje me aplikimin e gabuar të së drejtës procedurale dhe material nga ana e gjykatave të rregullta, Gjykata ripërserit se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse juridike. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kryesisht nuk është i kënaqur me kualifikimin juridik të fakteve dhe të ligjit të zbatuar nga gjykatat e rregullta. Sipas Gjykatës parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi **prima facie** për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese. Gjykata me tutje ka theksuar se fakti i thjeshtë, se parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës në rastin e tij nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e Kushtetutës. Sipas Gjykatës parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që të paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit si të pasaktë, para Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme të Kosovës. Gjykata nuk gjen se procedurat përkatëse, në ndonjë mënyrë, janë të padrejta apo arbitrare. Krejt në fund Gjykata në vendimin e saj konsideron se nuk janë plotësuar kushtet për pranueshmëri. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të tregojë dhe të mbështesë me prova se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese (Aktvendimi për papranueshmëri në Rastin nr.KI 186/14 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës).*

Koment

Në këtë vendim Gjykata është shprehur ndër të tjera dhe ka mbajtur qëndrim se: “Edhe pse parashtruesi i kërkesës pretendon se të drejtat e tij janë shkelur me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta, ai nuk ka treguar se si këto vendime kanë shkelur të drejtat e tija kushtetuese”. Në anën tjetër parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese kishte theksuar: “Në këtë drejtim, fillimisht Gjykata Komunale në Prishtinë dhe më pas Gjykata e Apelit dhe përfundimisht Gjykata Supreme, duke kuptuar dhe interpretuar gabimisht rekomandimin e Komisionit të Ankesave të Shërbimit Policor të Kosovës në lidhje me ankesën e parashtruesit të kërkesës në procedurë të brendshme si vendim përfundimtar, i kanë mohuar të drejtën për qasje në gjykatë të parashtruesit të kërkesës si një prej elementeve të një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së” (Kërkesë e Sahit Kurtit, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës- Rev. Nr. 153/2014- Nr. Ref.130/15/rl- 23.01.2015, drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës).

Në hulumtimet e mëtejme, lidhur me këtë çështje del se në periudhën e administrimit të Kosovës nga ana e UNMIK e deri në transferimin gradual të kompetencave në institucionet vendore dhe përfundimisht me shpalljen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, Shërbimi Policor i Kosovës (tani Policia e Kosovës), ishte nën përgjegjësi të UNMIK dhe Komisionari i Policisë së UNMIK ishte autoriteti përfundimtar në SHPK. Në rast të largimit nga puna apo lidhur me çfarëdo mase tjetër disiplinore, oficerët e SHPK kishin të drejtë ankese që ishte përcaktuar në kornizën ligjore, që emërtohej si Parimet dhe Procedurat, i cili paraqiste një akt nënligjor të brendshëm dhe i cili u jepte të drejtë

ankuesve që të ankoheshin brenda një afati prej shtatë (7) ditësh në Komisionin për Ankesat e Punonjësve (Parimet dhe Procedurat, paragrafi III). Në përputhje me këtë parashtruesi i kërkesës ishte ankuar ndaj vendimit për largimin nga puna të dt. 04.08.2005 në Komisionin për Ankesat e Punonjësve i cili sipas rregullativës ligjore paraqiste funksion administrativ i Komisionarit të Policisë së UNMIK dhe kishte për detyrë që t'i përcillte Komisionarit një përmbledhje të informatave dhe rekomandimet specifike lidhur me ankesën (Parimet dhe procedurat, paragrafi D., fq.2 dhe paragrafi D., pika 5, fq.5). Komisionari i Policisë ose i emëruari i tij/saj duhet të marrë vendimin e fundit sa i përket kundërshtimit. Në këtë rast Komisioni për Ankesa kishte nxjerrë rekomandimin me të cilin i kishte rekomanduar konfirmimin e vendimit për largim nga puna. Komisioni për Ankesa nuk kishte marrë vendim, ngase nuk kishte autoritet dhe juridiksion në bazë të Parimeve dhe Procedurat. Gjykatat e gjyqësorit të zakonshëm dhe përfundimisht Gjykata Supreme përmes Aktvendimit Rev. nr. 155/2014 e interpretuan dhe konsideruan rekomandimin e Komisionit për Ankesa si vendim përfundimtar në procedurë të brendshme dhe nga data e dorëzimit të këtij rekomandimi e bëjnë llogaritjen e afatit prej kurë parashtruesi i kërkesës kishte të drejtë për mbrojtje gjyqësore të të drejtave e parapatë me Ligjin për Marrëdhëniet Themelore të Punës (i aplikueshëm në Kosovë sipas Rregullores së UNMIK Nr.1999/24), i cili ligj përcaktonte afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh brenda të cilit një punëtor i pakënaqur me vendimin përfundimtar të punëdhënësit kishte të drejtë që të kërkojë mbrojtjen gjyqësore të të drejtave.

Vlerësojmë se Gjykatat e gjyqësorit të zakonshëm dhe përfundimisht Gjykata Supreme në esencë, ka shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për të sjellë para gjykatës, për të iniciuar rastin e tij për mbrojtje gjyqësore që është edhe aspekti kryesor i

të drejtës për qasje në gjykatë si element i rëndësishëm i së drejtës së garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ. Edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese në mënyrën se si është dhënë, shpreh qartë se Kërkesa e parashtruesit nuk është e trajtuar në tërësinë e saj sepse pretendimet kryesore për shkeljen e të drejtave të parashtruesit për një proces të rregullt ligjor nuk janë shqyrtuar fare nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Përfundimisht vlerësojmë se ky rast shpërfaqë nevojën imediate që qytetarët e Kosovës të kenë mundësinë që të bëjnë adresimin e Kërkesave para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg.

Ndryshe, Gjykata Kushtetuese këtë të drejtë e ka përfshirë në disa pjesë të vendimeve gjyqësore të nxjerra nga ana e saj por kjo nuk ka përbërë çështjen kryesore (përveç në rastin për të cilin u bë fjalë më lartë) për të cilën gjë edhe është vendosur para gjykatës. Këto vendime në shumicën e rasteve janë ato me të cilat gjykata ka vendosur mbi pranueshmerinë e kërkesës (E drejta për t’iu drejtuar gjykatës nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës është cituar në vendimet gjyqësore të kësaj gjykate si: Rasti RK/10, KI 76/10, KI 82/10, KI 83/10, 102/10, KI 111/10, KI 122/10, KI 127/10, KI 11/11, KI 15/11, KI 18/11, KI 45/11, KI 47/11, KI 48/11, KI 50/11, KI 57/11, KI 60/11, KI 69/11, KI 71/11, KI 73/11, KI 75/11, KI 79/11, KI 170/09 etj).

6.6.2. E drejta për tu gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme

Parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe

elementin objektiv me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim (Zaganjori, 2012: 490, b).

Çështjet e paanshmërisë së gjykatës shtrohen edhe tek kujdesi i treguar lidhur me përbërjen e trupit gjykues në çdo shkallë të gjykimit. Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës E drejta për tu gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme është përfshirë në një numër të madh vendimesh të kësaj gjykate por në formë të përgjithësuar. Në mënyrë të veçantë lidhur me këtë të drejtë Gjykata (deri më tani) ka vendosur në dy raste. Në rastin e parë gjykata ka vendosur lidhur me shkeljen e kësaj të drejte kur bëhet fjalë për praninë e të njëjtit gjyqtar në shkallë të ndryshme të gjykimit, kurse rasti i dytë ka të bëjë lidhur me imunitetin dhe ndjekjen penale të gjykatësit lidhur me dhënien e një vendimi të padrejtë.

6.6.2.1. Prania e të njëjtit gjyqtar në shkallë të ndryshme të gjykimit

Kërkesa

Parashtruesi i kërkesës kishte kontestuar Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd.nr. 67/2011, të dt. 12 dhjetorit 2011, duke theksuar se gjyqtari që ishte kryetar i trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe kishte vendosur në rastin e tij, mori pjesë edhe në vendimin e Gjykatës Supreme lidhur me kërkesën e tij për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit. Përveç kësaj, parashtruesi pohonte që gjyqtari në fjalë është dashur ta njoftonte Gjykatën Supreme se i njëjti ishte kryetar i trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe se gjyqtari në fjalë është dashur të përjashtohej nga pjesmarrja në kolegjin e Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës konsideronte që gjyqtari i Gjykatës

Supreme ka shkelur nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për proces të rregullt] të KEDNJ-së (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës- Aktgjykim në Rastin Nr. KI 06/12, parashtruesi Bajrush Gashi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pzd.nr. 67/2011, të 12 dhjetorit 2011).

Rrethanat e çështjes

Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin P.nr.26/09, dt. 19 maj 2009, e shpalli parashtruesin fajtor për kryerje të veprës penale nga neni 138.6 lidhur me nenin 138.1 dhe nenin 328.2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe e kishte dënuar në 4 vjet e 4 muaj burg. Parashtruesi u ankua kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme për shkak të *“shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim- me propozim që aktgjykimin të ndryshohet në mënyrë që i pandehuri të lirohet nga aktakuza apo të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim”*. Prokurori publik u ankua kundër këtij aktgjykimi lidhur me pjesën që kishte të bënte me të bashkëpandehurin G.M.

Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Ap. Nr. 259/2009, datë 08.12.2010, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe ankesën e prokurorit publik dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut. Më tutje konstatoi që aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut është i bazuar në gjendjen faktike dhe gjykata e shkallës së parë e vërtetoi gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë, dhe gjykata e shkallës së parë gjithashtu ka dhënë arsyet ligjore për faktet vendimtare. Përveç kësaj, Gjykata Supreme vendosi që aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut nuk përmbante shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, siç pretendohet nga parashtruesi.

Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Pzd. Nr. 67/2011, datë 12.12.2011, e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit. Gjykata Supreme, duke marrë parasysh mendimin e Gjykatës së Qarkut, të prokurorit publik të qarkut dhe të prokurorit të shtetit, që kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ishte e pabazuar, vendosi që arsyet e parashtruesit për kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit nuk ishin të një natyre të tillë që do ta justifikonin zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të parashtruesit.

Gjykata Supreme informoi Gjykatën se:

“ ...

Është e vërtetë se në procedurën e shqyrtimit të kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit pranë kësaj Gjykate një anëtar i panelit ka qenë edhe kryetare e panelit në gjykatën e shkallës së parë, mirëpo kjo rrethanë nuk paraqet asnjë pengesë ligjore për këto arsye:

Në procedurën lidhur me zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit mund të merr pjesë gjyqtari që ka qenë kryetar i trupit gjykues apo anëtar i trupit gjykues edhe në procedurën në shkallën e parë. Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit i paraqitet gjykatës së shkallës së parë- kryetarit të trupit gjykues që ka kryesuar panelin në shkallë të parë apo që ka vepruar si gjyqtar i vetëm (neni 450 i KPPK), i cili ndërmerr disa veprime procedurale e pastaj lëndën, me propozim e të arsyetuar, ia dërgon Gjykatës Supreme, e cila vendos lidhur me kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore që në panele të marrë pjesë ndonjë anëtar apo të gjithë anëtarët që kanë marr pjesë edhe më parë në panele gjyqësore për çështjen e njëjtë.

Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme mund të paraqitet disa herë (nga i njëjti i dënuar), sa herë që konsideron se është paraqitur ndonjë rrethanë e re që ai e vlerëson me ndikim për zbutje të dënimit. Mirëpo, po ë përjashtoheshin anëtarët që kanë qenë të përfshirë në ndonjë fazë të procedurës, atëherë Gjykata Supreme s’do të kishte gjyqtar për të vendosur lidhur me kërkesën, kështu që kërkesat do të ngelnin të pashqyrtuara.

Te ky mjet i jashtëzakonshëm juridik bëhet fjalë për rrethana të reja, për të cilat gjyqtari, edhe po të ketë qenë pjesë e panelit të mëhershëm, nuk ka mundur që të krijojë paragjykime, (sepse kjo rrethanë shqyrtohet për herë të parë).

...”

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës konsideron që paanësia e një tribunali sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së duhet të përcaktohet sipas një testi subjektiv, pra në bazë të bindjes së lirë dhe sjelljes personale të një gjyqtari në një rast të caktuar, dhe gjithashtu sipas testit objektiv, pra konstatimit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për ta përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë drejtim. Sa i përket testit subjektiv, për shkak se procedura që ka të bëjë me zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit nuk parashikon procedurë publike, as parashtuesi e as avokati i tij nuk kanë mundur që të jenë në dijeni, derisa nuk e kanë marrë vendimin e Gjykatës Supreme, se e njëjta gjyqtare që ishte kryetare e trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prizren mori pjesë edhe në trupin gjykues të Gjykatës Supreme që vendosi për kërkesën e tij për zbutjen e dënimit. Prandaj, nuk mund të konkludohet që parashtuesi ka hequr dorë nga e drejta për caktimin e të drejtave të tij nga një “tribunal i paanshëm”. Në këtë drejtim, Gjykata

Supreme është dashur që gjyqtari në fjalë në pajtim me nenin 41 të KPPK- ta tërheq ose është dashur të tërhiqet *ex officio* nga procedura për shqyrtimin e dënimit.

Sa i përket testit objektiv, Gjykata vëren që duhet të përcaktohet nëse, ka fakte të vërtetueshme që mund të ngrenë dyshim se a mundet që një gjyqtar i caktuar të jetë i drejtë dhe i paanshëm në një rast të caktuar. Sipas gjykatës ajo që vihet në rrezik është besimi që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet që ta bartin tek publiku dhe mbi të gjitha tek i pandehuri lidhur me paanshmërinë në procedurat penale. Si rrjedhojë, cilido gjyqtar për të cilin ka arsye legjitime për të pasur frikë për mungesë të paanshmërisë duhet të tërhiqet nga vendosja në një proces të tillë gjyqësor.

Gjykata vëren që në rastin në fjalë frika për mungesë të paanshmërisë rrjedhë nga fakti se gjyqtari në fjalë si kryetar i trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prizren, e dënoi parashtruesin me dënim me burg. I njëjti gjyqtar gjithashtu ishte kryetar i kolegjit të Gjykatës Supreme kur ky kolegji vendosi se kërkesa e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ishte e pabazuar. Pasi ka theksuar se Gjykata vëren që nenet 40 dhe 41 të KPPK manifestojnë brengën e ligjvënësit për t'i hequr të gjitha dyshimet e arsyeshme sa i përket paanshmërisë së gjykatës, gjykata ka dhënë vlerësimin e saj se në rrethanat e këtij rasti, paanshmëria e Gjykatës Supreme mund të lejë vend për dyshime dhe se frika e parashtruesit në këtë drejtim mund të konsiderohet subjektivisht dhe objektivisht e arsyeshme.

Lidhur me argumentin e paraqitur nga ana e Gjykatës Supreme se sikur të përjashtoheshin të gjithë anëtarët që kanë qenë të përfshirë në ndonjë fazë të procedurës, atëherë Gjykata Supreme nuk do të kishte gjyqtarë për të vendosur lidhur me këto kërkesa, Gjykata konsideron që çështja nëse ka apo nuk ka numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve për

të vendosur për kërkesat për zbutje të dënimit është çështje krejtësisht nën juridiksion, dhe për diskutim, po që nevoja, ndërmjet gjyqësorit dhe Qeverisë. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese është shprehur se përgjegjësia primare për administrimin e mirëfilltë të drejtësisë i takon Qeverisë dhe çështjet organizative nuk mund të përdoren si arsye për mosrespektim të Kushtetutës.

Në këto rrethana, Gjykata konstaton që është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga një tribunal i pavarur, siç garantohet me nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së (Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës KI 06/12, dt. 27 qershor 2012).

Koment

Se Gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv, këtë qëndrim e ka ndarë edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. Gjykata ka vlerësuar se Parimi i paanshmërisë në gjykim edhe në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, pra edhe në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë. Sipas Gjykatës kjo donë të thotë, që gjyqtari i Gjykatës së Lartë nuk mund të jetë anëtar i një kolegji, nëse për të njëjtën çështje, ka marrë pjesë në dhënien e një vendimi në një shkallë të mëparshme të procedimit (Vendimi nr. 12, datë 13.04.2007 (V-12/2007-Prania e të njëjtit gjyqtar në shkallë të ndryshme gjykimi; Zaganjori, 2012 : 490-492, b).

Vlerësojmë se edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës edhe ai i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë janë në harmoni me standardet e vendosura nga Gjykata Evropiane për të drejtat e Njeriut në Strasburg (Hauschild kundër Danimarkës, aktgjykim i 24 majit 1989, Oberschlick kundër Austrisë, nr. 11662/85, dt. 23 maj 1991- vendime të dhëna nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut). Në rastin e Kosovës ky vendim i Gjykatës i ka prerë rrugën për vendosje nga i njëjti gjyqtar edhe në instancat tjera gjyqësore dhe ka shtuar vëmendjen e kryetarëve të gjykatave në mënyrë që të shmangin caktimin e gjyqtarëve në trupat e njëjta gjykuese ku edhe kanë vendosur në ndonjërin nga instancat e mëparshme të shqyrtimit gjyqësor. Gjykatat në rastet e tilla, arsyetoheshin me mungesën e numrit të mjaftueshëm të gjyqtarëve. Vlerësojmë po ashtu, që vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës ka vendosur një standard sipas të cilit, asnjë gjykatë nuk mundet që të shërbehet me arsyetime të tilla. Çështjet organizative nuk mundën që të shërbejnë si arsyetim për mosrespektim të Kushtetutës, është standardi më i lartë që është vendosur deri në këtë kohë në Kosovë. Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast në shoqërinë demokratike jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar i thjeshtë, si garancia më e lartë se të drejtat e secilit do të respektohen maksimalisht në proceset gjyqësore.

6.6.2.2. Imuniteti i gjyqtarit në rast të ndjekjes penale për dhënien e një vendimi të padrejtë

Imuniteti proceduralo-penal paraqet institutin juridik me ndihmën e të cilit bëhet përkufizimi i vlefshmërisë së ligjeve proceduralo-penale në lidhje me personat, esenca kuptimplote e të cilit sillet prej ndalimit të vënies në lëvizje dhe zhvillimit të procedurës penale ndaj një personi, deri te ndalesa e ndërmarrjes së disa veprimeve proceduralo-penale dhe ndalesa e ndërmarrjes së masave të heqjes apo kufizimit të lirisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi në Kosovë, imunitet gëzojnë edhe gjykatësit si persona të zgjedhur apo emëruar në funksione të pavarura. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton që gjykatësit kanë imunitet vetëm për veprimet apo mosveprimet e ndërmarra në kuadër të autorizimeve që rrjedhin nga funksioni i tyre.

Kërkesa

Parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesë në të cilën pohon se të drejtat e tij kushtetuese janë cenuar me vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilin ajo ka miratuar një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në favor të palës kundërshtare, e cila do të mundësojë që të zhvillohet procedurë penale kundër parashtruesit të kësaj kërkesë për lëshimin e supozuar të vendimit gjyqësor. Më 3 dhjetor 2009 parashtruesi parashtroi kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar shqiptimin e masës së përkohshme kundër zbatimit të vendimit të Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 120/08, të 1 shtatorit 2009, në bazë të asaj se Gjykata Supreme me marrjen e këtij vendimi e ka cenuar pavarësinë e gjyqësorit. Parashtruesi në kërkesë pohon se Vendimi në fjalë shkelë nenin 107.1 të Kushtetutës së Kosovës, i cili përcakton imunitetin e gjyqtarëve.

Ndër faktet që kishte përmbledhur Gjykata, ishin se: Prokuroria Publike Komunale e Prizrenit ngriti aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës, PP.nr. 2085/2008, të 27 gushtit 2008, për veprë penale të nxjerrjes së vendimit të paligjshëm gjyqësor nga neni 346 të Kodit Penal të Kosovës. Gjykata Komunale në Deçan, si gjykatë penale e shkallës së parë me vendimin KA.Nr.14/2009, gjithashtu të 27 gushtit 2008, hodhi poshtë aktakuzën e ngritur nga prokurori publik, për shkak se nuk kishte dëshmi të mjaftueshme për ta përkrahur dyshimin e bazuar se parashtruesi e kishte kryer veprën penale me të cilën ngarkohej. Me vendimin KA.nr. 14/2008, të 7 tetorit 2008, një trup gjykues i Gjykatës Komunale të Deçanit, vërtetoi këtë vendim dhe hodhi poshtë ankesën që e kishte paraqitur prokurori publik kundër vendimit origjinal të Gjykatës Komunale. Më 1 shtator 2009, Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar nga prokurori publik kundër atij vendimi, lëshoi Aktgjykimin PKL.nr.120108, me të cilin e shpall kërkesën për shqyrtim të ligjshmërisë të bazuar, dhe vlerëson se vendimi i kontestuar, i cili ishte në favor të parashtruesit, nuk ishte në pajtim me interpretimin adekuat të neneve 304 dhe 316 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Më 21 prill 2010, Gjykata Kushtetuese e Kosovës lëshoi një vendim me të cilin e refuzonte lëshimin e masës së përkohshme kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës pa paragjykuar asnjë vendim të mëtejshëm të cilin do ta merrte në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës në bazë të meritës së saj.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata në vendimin e saj është shprehur se arsyetimi për shterimin e mjeteve ligjore është që t'ua lejojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për

ta parandaluar ose korigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës (Vendim për papranueshmëri në Rastin KI 68/09 të parashtruesit Emrush Kastrati kundër Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl.Nr. 120/08, të 1 shtatorit 2009). Rregulli është bazuar në supozimin se rendi ligjor i Kosovës do të sigurojë një mjet efikas ligjor për shkeljen e të drejtave kushtetuese.

Gjykata është shprehur edhe lidhur me imunitetin e gjykatësit duke theksuar se parashtruesi ka një aktakuzë të ngritur para gjykatave të Republikës së Kosovës, që pret të zgjidhet dhe që ka të bëjë me sjelljen e parashtruesit në cilësinë e tij si gjykatës i Gjykatës Komunale të Malishevës. Gjykata është shprehur se qëllimi i dispozitës së nenit 107 të Kushtetutës është që të sigurohet se gjyqtarët nuk duhet që të kenë frikë për të ushtruar detyrat e veta gjyqësore në një shoqëri demokratike në të cilën ka sundim të ligjit. Megjithatë, thuhet në vendimin e gjykatës, imuniteti gjyqësor nuk është i pakufizuar. Neni 107.2 saktësisht përcakton që gjyqtarët nuk gëzojnë imunitet dhe se mund të shkarkohen nga funksioni kur të kenë shkelur ligjin me qëllim. Sipas Gjykatës, organi që mund të përcaktojë nëse ka pasur shkelje të tillë, nëse shkelja e tillë konsiderohet vepër penale, është gjykata përkatëse. Në këtë rast, është detyrë e gjykatës penale të përcaktojë fajësinë ose pafajësinë e tij, gjithmonë duke pasur parasysh se parashtruesi gëzon të drejtën e supozimit të pafajësisë lidhur me aktakuzën e ngritur dhe se ai ka të drejtë për gjykim të drejtë siç është përcaktuar në nenin 6 të KEDNJ.

Sipas Gjykatës, Gjykata Supreme ka vendosur që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruar nga prokurori publik ishte mirë e bazuar. Në ato rrethana, procedura penale duhet që të vazhdojë. Gjykata ka theksuar se do të ishte e parakohshme që Gjykata Kushtetuese të vendosë për kërkesë pa pasur vendim përfundimtar në procedurën

penale. Gjykata duhet të konkludojë që parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion, pasi aktakuza është ende në gjykatat e zakonshme, thuhet në vendimin e gjykatës.

Koment

Vlefshmëria e dispozitave të së drejtës së procedurës penale pasqyrohet në zbatimin e saj lidhur me territorin, kohën dhe personin. Për zbatimin e të drejtës së procedurës penale në hapësirë vlen parimi territorial që do të thotë se e drejta e procedurës penale zbatohet në tërë territorin e Kosovës. Sa i përket zbatimit të drejtës së procedurës penale lidhur me kohën në përgjithësi vlejné rregullat e përgjithshme të vlefshmërisë së ligjeve dhe shpalljes së tyre në gazetën zyrtare, me ndonjë specifikë të caktuar kur ligji përmban zgjidhje të reja mund të vendoset ndonjë *vacatio legis* më e gjatë. E drejta e procedurës penale e Kosovës aplikohet me rastin e zhvillimit të procedurës penale kundër çdo personi i cili, sipas të drejtës penale materiale përgjigjet për vepër penale. Megjithatë, ekzistojné disa kategori personash kundër të cilëve nuk mund të zhvillohet procedura, apo ajo mund të zhvillohet vetëm me leje të posaçme të organit të autorizuar. Personat e tillë gëzojnë të ashtuquajturin imunitet proceduralo-penal (Sahiti, 2005: 29, b). Imuniteti proceduralo-penal paraqet institutin juridik me ndihmën e të cilit bëhet përkufizimi i vlefshmërisë së ligjeve proceduralo-penale në lidhje me personat, esenca kuptimplote e të cilit sillet prej ndalimit të vënies në lëvizje dhe zhvillimit të procedurës penale ndaj një personi, deri te ndalesa e ndërmarrjes së disa veprimeve proceduralo-penale dhe ndalesa e ndërmarrjes së masave të heqjes apo kufizimit të lirisë.

Fjalorë të ndryshëm juridik imunitetin e konceptojnë si mbrojtje juridike e veçantë që iu garantohet personave me funksione të caktuara shtetërore apo si status juridik të veçantë edhe disa personave të zgjedhur apo emëruar në funksione të rëndësishme të pavarura (Fjalor i shprehjeve juridike-www.avokati.org, parë me 06.01.2015). Ka të tillë që imunitetin e përcaktojnë si mbrojtje nga arrestimi apo ndjekja penale (*Fjalor i shprehjeve parlamentare dhe ligjore*, OSBE- Misioni në Kosovë, 2005: 152). Ndërkaq fjalorë të tjerë imunitetin e përcaktojnë edhe si një e drejtë përkatësisht autorizim i individëve që të jenë të mbrojtur nga zbatimi i rregullave të caktuara, të cilat zbatohen rregullisht ndaj personave të tjerë (Gojani, 2013: 113).

Ndër kategoritë e sipërpërmendura bazuar në legjislacionin në fuqi në Kosovë, imunitet gëzojnë edhe gjykatësit si persona të zgjedhur apo emëruar në funksione të pavarura. Imuniteti ishte paraqitur në Angli shekuj më parë, në atë kohë ishte paraparë për të mbrojtur deputetët nga paditë penale dhe censurat e të shprehurit (Bajrami, 2011: 321, b). Kjo formë e “mbrojtjes” në Kosovë, ndonjëherë ndërlidhet me nevojën që gjyqtarët të ndjehen të pavarur nga ndërhyrjet dhe ndikimet e jashtme (pavarësia e gjykatësve), që ata për mendimin e dhënë dhe vendimin e marrë të mos jenë objekt i ndjekjes penale, padive civile apo shkarkimi nga funksioni. Në anën tjetër, po aq sa ata ndjehen të mbështjellë me imunitet sipas Kushtetutës, përkarshi këtij imuniteti në Kodin Penal ekziston e sanksionuar vepra penale e emërtuar si vepra penale “Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore”. Ekzistimi i një vepre penale të sanksionuar në këtë mënyrë e cila drejtpërsëdrejti iu dedikohet vetëm gjykatësve ka vënë në një pozitë tejet të palakmueshme pozitën e gjykatësve në Kosovë dhe ka cenuar sigurinë juridike të vetë zbatuesve të ligjit.

Çështja e imunitetit të gjykatësve gjen sanksionimin e saj në kapitullin e VII të Kushtetutës: Sistemi i Drejtësisë ku ka përcaktuar se: “Gjyqtarët, përfshirë edhe gjyqtarët porotë, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë” (Kushtetuta e Republikës së Kosovës- neni 107). Kushtetuta, gjithashtu ka përcaktuar edhe anën tjetër të që përbën anë të pambrojtur të gjykatësve nga imuniteti, duke sanksionuar që: “Gjyqtarët, përfshirë edhe gjyqtarët porotë, nuk gëzojnë imunitet dhe mund të shkarkohen nga funksioni, kur të kenë shkelur ligjin me qëllim” (Kushtetuta e Republikës së Kosovës- neni 107.1). Sipas Kushtetutës kur një gjyqtar akuzohet ose arrestohet, duhet të njoftohet pa vonesë Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Kushtetuta e Republikës së Kosovës- neni 107.2).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka sanksionuar zgjidhje tjetër nga ajo e Kosovës, kur bëhet fjalë lidhur me imunitetin. Në Shqipëri Gjyqtari i Gjykatës së Lartë mund të ndiqet penalisht vetëm me miratimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Sipas zgjidhjeve kushtetuese të këtij vendi gjyqtari i Gjykatës së Lartë mund të ndalohet ose të arrestohet vetëm në qoftë se kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij. Në këtë rast organi kompetent njofton menjëherë Gjykatën Kushtetuese. Kur Gjykata Kushtetuese nuk e jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të gjyqtarit të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë- neni 137). Nga përkufizimi kushtetues lidhur me imunitetin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në Shqipëri, shihet se pozita e tyre “e mbrojtur” është mjaft mirë e rregulluar dhe e sanksionuar ligjërish, kurse kjo zgjidhje ligjore (kushtetuese) e ngritë pozitën e gjyqtarit të kësaj gjykate në atë shkallë sa lidhur me ndjekjen e tij penale duhet që

të japë pëlqimin e saj një organ kredibel siç është Gjykata Kushtetuese. Zgjidhje përafërsisht të njëjtë jepet edhe për sa i përket imunitetit të gjyqtarëve të instancave të tjera gjyqësore, por që këta mund të ndiqen penalisht vetëm me miratimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Gjyqtari mund të ndalohet ose të arrestohet vetëm në qoftë se kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij. Organi kompetent njofton Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe në qoftë se ky këshill nuk e jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të gjyqtarit të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë- neni 137).

Nëse kthehemi edhe njëherë tek zgjidhjet ligjore që janë në Kosovë lidhur me imunitetin e gjyqtarëve, atëherë mund të thuhet se neni 107 i Kushtetutës vendos standardet e mbrojtjes së gjyqtarëve nga procedimet gjyqësore kundër tyre, si mënyrë e garantimit që ata të mund të ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrë të pavarur dhe jashtë çdo presioni apo ndikimi. Një përcaktim i tillë kushtetues ka një rëndësi të madhe në vendet e tranzicionit siç është rasti me Kosovën. Imuniteti shihet si garanci që gjyqtarët e të gjitha profileve nuk do të kenë pasoja për punën e kryer në kuadër të kushtetutës, ligjeve dhe rregullave të profesionit (Hasani, E, 2013: 511, b).

Neni 107.1 i Kushtetutës vendosë ndalimin që gjyqtarët, duke përfshirë edhe gjyqtarët porotë, të ndiqen penalisht, të paditën në procedurë civile dhe të shkarkohen nga funksioni për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur si dhe veprimet e tjera të ndërmarra brenda fushëveprimit të funksionit të tyre gjyqësor. Ky nen i Kushtetutës i vesh gjyqtarët vetëm me imunitet funksional, që nënkupton se ata janë të mbrojtur lidhur me ato që u thanë më lartë vetëm për veprimet apo mosveprimet e ndërmarra në kuadër të autorizimeve që rrjedhin nga funksioni i tyre. Ky ngushtim i imunitetit në këtë aspekt lejon

që ata të ndiqen penalisht, të paditen apo edhe shkarkohen për veprimet apo mosveprimet e tyre jashtë funksionit të tyre gjyqësor. Ndërkaq neni 107.2 i Kushtetutës përcakton që gjyqtarët nuk gëzojnë imunitet dhe mund të shkarkohen nga funksioni nëse e kanë shkelur ligjin me qëllim. Ky paragraf, prandaj, vendos standardin që gjyqtarët të mund të shkarkohen për shkelje ligjore vetëm nëse këtë e kanë bërë me qëllim. Enver Hasani, mendon se “qëllimi” për të shkelur ligjin nga ana e gjyqtarit, sado e vogël te këtë qenë shkelja, i zhvesh gjyqtarët nga imuniteti i dhënë me nenin 107.1 të Kushtetutës (Enver Hasani në këtë kohë ushtronte detyrën e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës).

Nga ato që u theksuan më lartë, mund të nxjerrim konkludimin se në Shqipëri gjyqtarët janë të veshur me imunitet mjaft të gjerë dhe nuk ka kufizim ligjor as edhe lidhur me atë se vepra e supozuar penale është kryer në lidhje me punën e gjyqtarit apo jo. Përveç kësaj ekziston edhe korniza ligjore (kushtetuese) se organe të caktuara kredibile duhet që të japin pëlqimin e tyre lidhur me ndjekjen penale të gjykatësit apo jo. Në rast të mos dhënies apo heshtjes për të dhënë një pëlqim të tillë, organi kompetent është i detyruar që gjykatësin ta lirojë nga ndalimi. Ndërkaq nga korniza ligjore (kushtetuese) që ekziston në Kosovë gjyqtarët gëzojnë imunitet mjaft të kufizuar dhe kjo mbrojtje ligjore ekziston vetëm për veprimet apo mosveprimet e ndërmarra në kuadër të autorizimeve që rrjedhin nga funksioni i tyre. Në Kosovë nuk ekziston ndonjë organ që duhet të japë pëlqimin lidhur me arrestimin ose mos arrestimin e gjyqtarit. Nëse në Shqipëri këtë kompetencë e ka Gjykata Kushtetuese në rastet kur bëhet fjalë për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, apo Këshilli i Lartë i Drejtësisë në rastet kur bëhet fjalë për gjyqtarët e niveleve më të ulëta, shikuar në lidhje me Kosovën

një kompetencë të tillë nuk e kanë as Gjykata Kushtetuese e as Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Nga zgjidhjet ligjore që u theksuan më lartë, në Kosovë gjykatësit kanë imunitet vetëm për veprimet apo mosveprimet e ndërmarra në kuadër të autorizimeve që rrjedhin nga funksioni i tyre. Megjithatë ky imunitet sado që i kufizuar që është, prapëseprapë në praktikë gjen përplasjen e saj, ka paqartësi lidhur me këtë çështje dhe dispozitat kushtetuese lidhur me imunitetin janë vështirë të zbatueshme. Këtë e vështirëson edhe me shumë, një vepër penale e cila ekziston e sanksionuar në Kodin Penal të Kosovës si vepra penale “nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore”. Hulumtimi në lidhje me këtë problematikë, tregon se gjykatësit kanë shfaqur pakënaqësitë e tyre sa i përket imunitetit. Shumica e të anketuarve janë shprehur se imuniteti i gjykatësve nuk respektohet nga institucionet tjera e veçmas nga prokuroritë. Përveç kësaj gjykatësit vlerësojnë se imuniteti është i garantuar me Kushtetutë por mungojnë dispozitat përkatëse ligjore për rregullimin e çështjeve të tjera lidhur me imunitetin (Nga hulumtimi i bërë me gjykatësit e Gjykatës Themelore në Prishtinë si dhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit me seli në Prishtinë. Me organizimin e gjyqësorit sipas reformës së vitit 2013, Kosova ka shtatë (7) Gjykata Themelore me degët e tyre të organizuara sipas parimit territorial dhe një (1) Gjykatë të Apelit me seli në Prishtinë në nivelin e tërë Kosovës).

Gjykatësit mendojnë se mungojnë dispozitat përkatëse ligjore lidhur me imunitetin siç janë kohëzgjatja e imunitetit, mënyra e heqjes së imunitetit, mekanizmat mbrojtës në rast të cenimit të imunitetit etj. Gjykatësit kanë theksuar se përkundër asaj se imuniteti është i garantuar me Kushtetutë, në bazë të kërkesës së palës së pakënaqur me vendimin gjyqësor, gjykatësit që kanë nxjerrë këtë vendim i

nënshtrohen procedurës hetimore në prokurori, vetëm se ekziston dyshimi i palës se gjykatësi ka nxjerrë vendim të kundërligjshëm. Sipas tyre me këtë rast shkelen dy parime themelore: parimi i pavarësisë së gjykatës dhe parimi i dyshkallësisë (Nga pyetësi në të cilin janë përgjigjur gjykatësit e Gjykatës së Apelit në Prishtinë).

Gjyqtarët kanë shfaqë brengën e tyre se imuniteti i paraparë me Kushtetutë dhe ekzistimi i veprës penale “Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore” në Kodin Penal të Kosovës janë dy gjëra që nuk shkojnë së bashku dhe bien në kundërshtim me njëra tjetrën.

Neni 432 i Kodit Penal [Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore]

Gjyqtari i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër ose për t’i shkaktuar dëm personit tjetër, nxjerr vendim të kundërligjshëm, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. Derisa në Kodin Penal është e përfshirë vepra penale “Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore”, gjykatësit nuk kanë imunitetin dhe nuk mund të bëhet fjalë për pavarësinë dhe paanësinë e gjykatësve (Nga pyetësi në të cilin janë përgjigjur gjykatësit e Gjykatës Themelore në Prishtinë).

Ekzistimi i kësaj vepre në Kodin Penal në mënyrën se si është emërtuar nuk është kompatibël me përshkrimin ligjor dhe është emërtim i gabuar, ngase çdo vendim që anulohet nga gjykata e një instance më të lartë, është vendim i kundërligjshëm, sepse, po të mos ishte i tillë nuk do të anulohet (nga gjykata e shkallës së dytë), së dyti, dispozitivi

përshkrues i veprës penale është ndërtuar gabimisht dhe në kundërshtim me qëllimin që ka kjo normë ligjore inkriminuese (Hasani, F., 2014: 1261).

Përfundim

Është e kuptueshme se imuniteti garanton që gjyqtarët e të gjitha profileve nuk do të kenë pasojë për punën e kryer në kuadër të kushtetutës, ligjeve dhe rregullave të profesionit. Në Kosovë sanksionimi i imunitetit me Kushtetutë fiton peshë të madhe kur kihet parasysh fakti se Kosova ka pasur një histori tragjike në zhvillimin e saj kushtetues në njëzet vitet e fundit para shpalljes së pavarësisë 17 shkurt 2008. Në kushte të tilla shumë gjyqtarë jo rrallë janë përndjekur nga organi i akuzës dhe individët privat, për punët e tyre të kryera brenda rregullave të tyre të profesionit, të normave kushtetuese dhe ligjeve në fuqi në atë kohë. Edhe përkundër këtij sanksionimi kushtetuese në praktikën e tanishme në Kosovë, gjykatësit kanë dilema të shumta se në të vërtetë gëzojnë apo nuk gëzojnë imunitetin e garantuar me kushtetutën e vendit. Arsye për këtë është ekzistimi i veprës penale “nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore”, e cila vepër dhe sanksionimi i saj në Kodin Penal të Kosovës ka vënë në pozitë tejet të palakmueshme gjykatësit kosovar. Një fakt tjetër që e ka bërë të pazbatueshëm në praktikë imunitetin është edhe mosnjohja e çështjeve dhe procedurave civile nga ana e prokurorëve si dhe mosekzistimi tek këta të fundit i guximit profesional që në rastet e cënimit të imunitetit të bëhet hudhja e kallëzimeve të tilla penale. Ata kanë mbajtur nën hetim një kohë të gjatë gjykatësit të cilët janë vënë nën suspendim nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, dhe janë ndjerë të stigmatizuar nga media dhe publiku.

Imuniteti i gjykatësve në kushte të tilla në Kosovë duhet të qartësohet, duhet që mekanizmat ligjor lidhur me imunitetin të plotësohen duke përcaktuar kohëzgjatjen e imunitetit, mënyrën e heqjes së tij dhe organin që do të vendos për heqjen e imunitetit. Gjithashtu, duhet që të vendosen dhe qartësohen mekanizmat mbrojtës në rast të cenimit të imunitetit.

Praktika në Kosovë ka treguar se individët kanë keqpërdorur me të madhe çështjen e ekzistimit të veprës penale “ nxjerrja e vendimeve gjyqësore të kundërligjshme”. Kjo vepër penale duhet të gjejë riformulimin e saj sa më shpejt që është e mundur dhe të bëhet rishikimi i Kodit Penal në këtë pjesë në mënyrë që në kushtet e ekzistimit të saj në mënyrë të saktë të qartësohet se në cilat raste gjykatësit do të duhej të i nënshtroheshin këtij sanksionimi ligjor. Meqë edhe janë vërejtur mangësi të mëdha në punën e organit të akuzës lidhur me këto çështje atëherë mendojmë se kjo vepër penale do të duhej që të gjejë zbatim edhe në sanksionimin e punës së prokurorëve, të cilët, më pastaj me siguri se do të shfaqnin kujdes më të madh karshi rasteve të cilat do të implikonin gjykatësit dhe ku do të cenohej imuniteti i tyre.

Nga kjo mund të konkludojmë se, ekzistimi i problematikave të tilla, e bëjnë të nevojshëm të ekzistojë edhe më tutje, imunitetin e gjykatësve në Kosovë. Në kushte të tilla, shtrohet nevoja e qartësimi kushtetues dhe ligjor për imunitetin. Imuniteti për gjykatësit në asnjë mënyrë nuk duhet që të mos respektohet nga mekanizmat e tjerë shtetëror. Megjithatë, kjo mbrojtje ligjore në asnjë mënyrë, nuk duhet që t’i amnistojë edhe vetë gjykatësit, lidhur me veprimet e tyre jo të mira.

6.6.3. E drejta për jetë dhe e drejta për mjete juridike- Rasti KI 41/12, Parashtrues Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykata Komunale në Prishtinë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në praktikën e saj ka mbajtur qëndrimin se e drejta për jetën është e drejta më e rëndësishme e të gjitha qenieve njerëzore. Është e drejtë nga e cila rrjedhin të gjitha të drejtat e tjera. Sa i përket të drejtës për mjete efektive juridike Gjykata i është referuar nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës që përcakton se : *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e caktuar me ligj”*. Gjykata i është referuar edhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] që thekson se: *“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”*. Gjithashtu, Gjykata i është referuar edhe nenit 13 të KEDNJ-së që thekson: *“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”*. Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila në raste të ngjashme, ka pranuar kërkesa individuale nga individët që konsiderohen si viktimat të tërthorta, kur ekziston një lidhje personale dhe specifike ndërmjet viktimës dhe parashtruesit.

Kërkesa

Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Komunale e Prishtinës, me mosveprimin e saj në përputhje me obligimet e saj kushtetuese dhe ligjore për ta trajtuar

kërkesën për urdhër për mbrojtje emergjente, ka cenuar të drejtat individuale të D. K.-së dhe, tërthorazi, të parashtruesve të kërkesës, të garantuara me nenin 25, me nenin 31, me nenin 32 dhe me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenin 2, me nenin 6 dhe me nenin 13 të KEDNJ-së.

Parashtruesit janë prindërit e D.K, e lindur më 18 shkurt 1984, në Prishtinë, e cila u privua nga jeta më 18 maj 2011. D. K. ka jetuar me familjen e saj deri më 10 shkurt 2000. Më 26 prill 2011, si pasojë e kërcënimeve të vazhdueshme të pretenduara nga A.J. në drejtim të D.K.-së dhe në drejtim të vajzës së tyre, D. K. paraqiti kërkesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë për lëshimin e urdhrit për mbrojtje emergjente, bazuar në nenin 15 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Nr. 03/L182. Më 18 maj 2011, D. K. vdiq pasi mori plagë në qafë nga armë zjarri, e shkrepur nga A. J.

Parashtruesit e kërkesës pohojnë se Gjykata Kushtetuese duhet të adresojë këtë çështje, me qëllim të parandalimit të rasteve të njëjta tragjike në të ardhmen, si dhe me qëllim të vetëdijesimit të opinionit publik për ngritjen e efikasitetit të gjykatave të rregullta. Më tej, parashtruesit theksojnë se “ Gjykata Komunale e Prishtinës ka pasur obligim që të veprojë brenda njëzetekatër (24) orësh nga moment kur D. K. ka paraqitur kërkesë për urdhër për mbrojtje emergjente. Ajo gjykatë nuk ka vepruar fare në këtë rast. Shqyrtimi i legjislacionit përkatës tregon se sa i përket mjeteve juridike në rastet e veprimit nga Gjykata Komunale e Prishtinës, kur ajo duhet të veprojë siç i obligon neni 19 i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, nr. 03/L-182, mund të konstatohet se nuk ekzistojnë mjet e juridike, të cilat mund të përdorë viktimat në rastin e mosveprimit të Gjykatës Komunale”.

Parashtruesit, gjithashtu, theksojnë se “neni 19 i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Nr. 03/L -182, parasheh vetëm procedurat ankimore kundër vendimeve gjyqësore për urdhër për mbrojtje, mirëpo nuk parasheh mjete juridike për paraqitësit e kërkesave për mbrojtje në rastet kur gjykata nuk vepron fare”. Sipas Parashtruesve, “po ashtu, Ligji për Procedurën Kontestimore, nr. 03/L-006, parasheh një mori mjetesh juridike- duke përfshirë ankesën, revizionin, përsëritjen e procedurës dhe mbrojtjen e ligjshmërisë- mirëpo, të gjitha këto mjete juridike, nuk adresojnë rastin kur shkeljet e pretenduara kushtetuese janë pasojë e mosveprimit të autoritetit publik (mosekzistimit të vendimit gjyqësor). Njësoj, edhe Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Nr. 03/L-223, në nenet 33-49, parasheh vetëm iniciimin e procedurës disiplinore dhe sanksionet kundër gjyqtarëve ose gjyqtarëve porotë për sjellje të pahijshme. Mirëpo, ky ligj nuk parasheh mjete juridike për rrethanat aktuale, kur Gjykata nuk vepron në mbrojtjen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare” (Kërkesa e G. K. dhe M. K e parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, dt. 17 prill 2012).

Parashtruesit insistojnë që, “në këtë rast, jo vetëm që shterimi i mjeteve juridike nuk është efektive, por është e pamundshme, pasi që, në fakt, mjetet juridike nuk ekzistojnë fare”. Ata pretendojnë se “vetë mungesa e mjeteve juridike, teorike dhe praktike, në këtë rast, mund të cilësohet si shkelje e të drejtave individuale. Neni 13 i KEDNJ-së dhe neni 32 i Kushtetutës garantojnë të drejtën për mjete juridike. Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, nr.03/L182, nuk parasheh fare mjete juridike për paraqitësit e kërkesave për urdhër për mbrojtje nga dhuna në rastet kur gjykata nuk vepron fare. Prandaj, pamundësia e qasjes në mjete juridike në rastin e cekur më lartë, në vetvete nënkupton shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe konventa”. Në shtjellimin e pretendimit të tyre për shkelje të

nenit 25 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të KEDNJ-së, parashtuesit i referohen edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Parashtuesit i referohen praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) duke theksuar se” kjo gjykatë, në rastin Osman v. The United Kingdom, ka vlerësuar se personi që pretendon se i është cenuar e drejta në jetë duhet të dëshmojë se (1) autoriteti e ka ditur ose është dashur ta dijë në atë kohë për ekzistimin e një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e një personi ose personave të identifikuar nga veprat kriminale.

Për më tepër, parashtuesit pohojnë se “ GJEDNJ-ja shkon edhe një hap më tutje dhe gjykon se një person, që të mbajë shtetin përgjegjës për shkelje të së drejtës për jetë, duhet vetëm të dëshmojë se autoriteti nuk ka bërë të tërën që mund të pritet nga ai brenda arsyes që të parandalojë një rrezik real dhe të menjëhershëm ndaj jetës për të cilin kanë ose duhet të kenë pasur njohuri”.

Parashtuesit theksojnë se “ekziston një mori rastesh ku GJEDNJ-ja ka gjykuar se autoriteti publik ka cenuar të drejtën për jetë në rrethana kur ka dështuar të veprojë në mbrojtje të personit, pra në rrethana shumë të përafërta me ato të D.K.-së. Parashtuesit kanë përmendur rastin Kontrova v. Slovakia (në të cilin GJEDNJ ka gjetur se ka patur shkelje të të drejtës për jetë- v.j), dhe rastet tjera si: Branko Tomašić and others v. Croatia dhe Opuz v. Turkey (në të cilin GJEDNJ ka gjetur se ka pasur shkelje të të drejtës për mjete juridike- vër.jona)

Pranueshmëria e kërkesës

Vlerësojmë se në rastin konkret është më rëndësi që të theksohet se si Gjykata e bëri vlerësimin paraprak të pranueshmërisë së kërkesës. Gjykata pasi u referohet nenit 113.7 të Kushtetutës i cili parashikon se: *”Individët janë të autorizuar që të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*, si dhe nenit 47 të Ligjit, i cili përcakton se: *“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individual eta garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik”*; dhe se *“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*, vlerëson se parashtguesit mund të konsiderohen palë e autorizuar në pajtim me nenet e sipërcituara.

Gjykata me këtë rast i është referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila, në raste të ngjashme, ka pranuar kërkesa individuale nga individët që konsiderohen si viktimat të tërthorta, kur ekziston një lidhje personale dhe specifike ndërmjet viktimës dhe parashtguesit. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja, në një rast, ka pranuar si palë të autorizuar bashkëshorten e të ndjerit –*Mc Cann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 18984/91, Aktgjykimi i 27 shtatorit 1995*, ndërsa, në një rast tjetër, nipit të të ndjerit i ka pranuar statusin e palës së autorizuar - *Yasa kundër Turqisë, nr. 63/1997/847/1054, Aktgjykim i 2 shtatorit 1998*. Duke marrë parasysh se parashtguesit e kërkesës janë prindërit e të ndjerës, Gjykata konstaton se parashtguesit mund të konsiderohen si palë e autorizuar në këtë rast.

Sa i përket shterimit të mjeteve juridike, Gjykata ka konsideruar se ky rregull duhet të zbatohet me një shkallë fleksibiliteti dhe pa formalizëm të tepruar. GJEDNJ - ja, më tej, pranoi që rregulli i shterimit të mjeteve juridike nuk është as absolute e as në gjendje që të zbatohet në mënyrë automatike. Me rastin e shqyrtimit, nëse ai është zbatuar, është me rëndësi të merren parasysh rrethanat e posaçme të secilit rast individual. Kjo do të thotë, ndër të tjera, se ai duhet të ketë parasysh jo vetëm ekzistimin e mjeteve zyrtare juridike në sistemin e vendit në fjalë, por edhe kontekstin e përgjithshëm ligjor dhe politik në të cilin veprojnë, si dhe rrethanat personale të parashtruesit të kërkesës (Aktgjykimi i GJEDNJ-së në rastin Akdivar kundër Turqisë, cituar sipas Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në Rastin KI 41/12, Parashtrues Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës).

Arsyetimi i Gjykatës

Pasi ka bërë vlerësimin kushtetues të kërkesës gjykata ka vendosur që të shpallë kërkesën të pranueshme, të gjejë se ka pasur shkelje të të drejtës për jetë, të paraparë me nenin 25 të Kushtetutës dhe me nenin 2 të KEDNJ-së, dhe të gjejë se ka pasur shkelje të së drejtës për mjete juridike, të paraparë me nenin 32 e me nenin 54 të Kushtetutës dhe me nenin 13 të KEDNJ-së.

I. Sa i përket të drejtës për jetë

Gjykata i është referuar nenit 25 të Kushtetutës i cili thekson: “*Secili individ gëzon të drejtën për jetën*”, e gjithashtu i është referuar edhe nenit 2 të KEDNJ-së, i cili thekson se: “*E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t’i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një*

krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj”. Gjykata Kushtetuese thekson se e drejta për jetën është e drejta më e rëndësishme e të gjitha qenieve njerëzore. Është e drejtë nga e cila rrjedhin të gjitha të drejtat e tjera.

Gjykata Kushtetuese rikujton se, në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës, është detyrim i saj kushtetues që interpretimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut ta bëjë në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Gjykata i është referuar praktikës së GJEDNJ-së e cila thekson se është detyrim i organeve shtetërore që jo vetëm të përmbahen nga marrja e qëllimshme dhe e paligjshme e jetës, por gjithashtu të ndërmarrin hapat e duhur për mbrojtjen e jetës së individëve brenda juridiksionit të tyre- *L. C. B. kundër Mbretërisë së Bashkuar, 9 qershor 1998*). Kjo nënkupton detyrimin parësor të shtetit që të sigurojë të drejtën për jetë, duke vendosur dispozita penale efektive për të penguar kryerjen e veprave penale kundër individit, të mbështetura nga mekanizmat e zbatimit të ligjit për parandalimin, për ndëshkimin dhe për shuarjen e shkeljeve të dispozitave të tilla. Po sipas praktikës së GJEDNJ-së, në rrethana të përshtatshme, zgjerohet gjithashtu një detyrim pozitiv për autoritetet që të marrin masa parandaluese operative për të mbrojtur një individ, jeta e të cilit është në rrezik nga veprat penale të një individi tjetër- *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar, 28 tetor 1998, Kontrova kundër Sllovakisë, 24 shtator 2007, dhe Opuz kundër Turqisë, 9 qershor 2009*).

Në vazhden e kësaj, Gjykata i është referuar gjithashtu praktikës së GJEDNJ-së se për t’u ngritur një detyrim pozitiv, duhet të vërtetohet nëse autoritetet kanë ditur apo është dashur të dinë, në kohën e ekzistimit të një rreziku real dhe të menjëhershëm, për jetën e një individi të identifikuar nga veprat kriminale të një pale të tretë dhe që kanë dështuar të ndërmarrin masa brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre që, gjykuar arsyeshëm, do

të mund të pritej ta mënjanonin atë rrezik. Sipas Gjykatës, dokumentacioni i deponuar në Gjykatë, mund të konstatohet që autoriteti përgjegjës, në këtë rast Gjykata Komunale në Prishtinë, është dashur të dijë për rrezikun real që ka ekzistuar me rastin e dorëzimit të kërkesës për lëshim të urdhrit për mbrojtje emergjente, pasi D. K.-ja ka shpjeguar në mënyrë kronologjike përkeqësim të marrëdhënieve ndërmjet tyre, duke specifikuar edhe kërcënimet me vdekje nga ish – partneri dhe duke ofruar dëshmi për raportimin paraprak në organet policore për kërcënimet e pranuar. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se Gjykata Komunale në Prishtinë ishte përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve të parashikuara me Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, dhe se mosveprimi i saj paraqet shkelje të detyrimeve kushtetuese që rrjedhin nga neni 25 i Kushtetutës dhe nga neni 2 i KEDNJ-së.

II. Sa i përket të drejtës për mjetet efektive juridike

Gjykata i është referuar nenit 32 të Kushtetutës [E Drejta për Mjete Juridike] që thekson se: *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”*, dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] që thekson se: *“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”*. Gjithashtu, Gjykata i është referuar nenit 13 të KEDNJ-së që thekson: *“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi*

kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

Gjykata Kushtetuese, në Aktgjykimin e 30 tetorit 2010, në rastin KI 06/10, Valon Bislimi kundër Ministria e Punëve të Brendshme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë, ka trajtuar çështjen e mjeteve juridike efektive, me ç’rast ka theksuar: “...që sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 13 i Konventës garanton disponueshmërinë (në nivel kombëtar) të një mjeti juridik për ta zbatuar substancën e të drejtave dhe lirive të parapara me Konventë, në çfarëdo forme që mund të ndodhin për të qenë i siguruar në rendin ligjor të vendit. Qëllimi i nenit 13 është të kërkojë sigurimin e një mjeti juridik vendor për ta trajtuar substancën e një „prëndimi të diskutueshëm’ sipas Konventës dhe për të ofruar mbrojtje përkatëse juridike”.

Gjykata në të njëjtin Aktgjykim ka theksuar se : “Përmasa e obligimit sipas nenit 13 të Konventës ndryshon varësisht nga natyra e ankesës së parashtruesit të kërkesës; megjithatë, mbrojtja përkatëse juridike që kërkohet me nenin 13, duhet të jetë “efektive” në praktikë dhe në ligj. “Efektiviteti” i një “mjeti” juridik brenda kuptimit të nenit 13 nuk varet nga siguria e një rezultati të favorshëm për parashtruesin e kërkesës. As “autoriteti” i përmendur në atë dispozitë nuk është medoemos e thënë të jetë autoritet gjyqësor, por nëse nuk është, kompetencat e tij dhe garancitë që i ofron janë përkatëse për të përcaktuar nëse mjeti juridik para tij është efektiv. Gjithashtu, edhe nëse një mjet i vetëm juridik nuk i kënaq në tërësi kriteret e nenit 13, tërësia e mjeteve juridike të parapara me ligjin e vendit mund ta bëjnë një gjë të tillë (Në këtë pjesë Gjykata është bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin *Silver* dhe të tjerët kundër aktgjykimit

të Mbretërisë së Bashkuar, i 25 marsit 1983, Seria A, nr. 61, p.42 para.113). Gjithashtu, duhet theksuar se i njëjti aktgjykim shpjegon se” *Rregulli i shterimit të mjeteve juridike bazohet në supozimin e pasqyruar në nenin 13 (me të cilin ka lidhje të ngushtë) se ekziston një mjet efektiv juridik në dispozicion për sa i përket shkeljes së supozuar të të drejtave të individit të parapara me Konventë* (në këtë pjesë Gjykata është bazuar në Aktgjykimin e GJEDNJ në rastin *Kudla kundër Polonisë, 26 tetor 2000).*

Në këtë drejtim, Gjykata vëren se legjislacioni në fuqi : Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nuk ofrojnë mjete efektive juridike për mbrojtjen e të drejtave të parashtruesve. Sipas Gjykatës, në njëërën anë, Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje nuk parasheh masa për adresimin e mosveprimit të institucioneve përgjegjëse në ato raste kur janë të detyruara të veprojnë. Në anën tjetër, mund të shihet nga Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, parashtruesit nuk kanë mundësi tjetër përveç ankesës drejtuar Zyrës së Prokurorit Disiplinor e cila ka për kompetencë që të hetojë shkeljet etike të gjykatësve të gjyqësorit të zakonshëm në procedurat para gjykatave.

Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se mosveprimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, në kërkesën e të ndjerës D.K. për lëshimin e urdhrit për mbrojtje emergjente, si dhe praktika e zhvilluar nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për adresimin e mosveprimit të gjykatave të rregullta atëherë kur duhet të veprojnë, ka penguar viktimën e parashtruesit të kërkesës në realizimin e të drejtave të tyre për mjete efektive juridike, të parapara me nenin 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe me nenin 13 të KEDNJ-së.

III. Sa i përket nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së

Gjykata nuk ka konsideruar të nevojshme trajtimin e pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës, duke pasur parasysh që Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 25, të nenit 32 dhe nenit 54 të Kushtetutës; të nenit 2 e të nenit 13 të KEDNJ-së; dhe për faktin se nuk është zhvilluar ndonjë dëgjim apo seancë gjyqësore për rastin në fjalë.

Koment

Rasti KI 41/12 me Parashtrues Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykata Komunale në Prishtinë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, paraqet rastin e parë ku Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka gjetur se ka pasur shkelje të së drejtës për jetën e paraparë me nenin 25 të Kushtetutës dhe me nenin 2 të KEDNJ-së.

Gjykata ka bërë njohjen e të drejtës së parashtruesve që të konsiderohen si *viktima të tërthorta*, në rastet kur ekziston *një lidhje personale specifike* ndërmjet viktimës dhe parashtruesit. Kjo gjë, për mendimin tonë do të paraqesë një rast tejet me rëndësi për parashtrimet që do të bëhen në rastet e ngjashme para gjyqësorit të zakonshëm dhe do të zgjerojë gamën e personave me të drejtë të ushtrimit të padive në gjykatë.

Në këtë rast, Gjykata ka vënë gjithashtu, edhe një standard më tepër që palëve tu njihet e drejta që t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese në rastet kur për shkakun e mosveprimit të organit, në këtë rast të Gjykatës Komunale në Prishtinë, nuk kanë pasur mjete në dispozicion dhe efektive që do të mund t'i ushtronin. Gjykata ka konkluduar se mosveprimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, në kërkesën e të ndjerës D.K. për lëshimin e urdhrit për mbrojtje emergjente, si dhe praktika e zhvilluar nga ana e Këshillit Gjyqësor të

Kosovës për adresimin e mosveprimit të gjykatave të rregullta atëherë kur duhet të veprojnë, ka penguar viktimën e parashtruesit të kërkesës në realizimin e të drejtave të tyre për mjete efektive juridike, të parapara me nenin 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe me nenin 13 të KEDNJ-së.

6.6.4. Barazia e armëve (kontradiktoriteti), Rasti Adije Iliri kundër Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Ac.nr. 95/2011, datë 8 dhjetor 2011

Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka vendosur që të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së. Gjykata ka vendosur që të shpallë të pavlefshme vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës PPC.nr. 33/2011, të 23 gushtit 2011, dhe Ac.nr. 95/2011, të 8 dhjetorit 2011. Gjithashtu, Gjykata ka vendosur që të urdhërojë Gjykatën e Qarkut në Prizren që të përsërisë procedurat e 9 dhe 13 korrikut 2009 dhe të ftojë parashtruesen për të marrë pjesë në ato procedura.

Kërkesa

Parashtruesja ka kontestuar vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Ac.nr. 95/2011, të 8 dhjetorit 2011. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme nga Gjykata Kushtetuese, vendim me të cilin parashtruesja pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 6 (E Drejta për një Proces të Rregullt) të KEDNJ.

Parashtruesja pretendon se Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren (I. Agj. nr. 2/2009, i 19 janarit 2010), Vendimi i Gjykatës Supreme (PPC.nr.33/2011, i 23 gushtit 2011) dhe Vendimi i Gjykatës Supreme (Ac. nr.95/2011, i 8 dhjetorit 2011) janë nxjerrë duke shkelur nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 6 (E Drejta për një Proces të Rregullt) të KEDNJ- së, sepse as parashtruesja dhe as Prokurori Publik nuk janë ftuar të marrin pjesë në procedurë. Në veçanti, parashtruesja pretendon se *“nga aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren I. Agj. nr. 2/2009-16, dt. 19.01.2010, dhe nga procesverbali i shqyrtimit kryesor, pa mëdyshje rezulton se parashtruesja dhe prokurori publik i Qarkut në Prizren as që janë thirrur, e as kanë marrë pjesë në gjykim, megjithëse pjesëmarrja e tyre ka qenë e detyrueshme sipas dispozitave të nenit 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2004/29 për mbrojtje kundër rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”*. Kjo rregullore sipas parashtrueses *“është mbështetur ekskluzivisht në Konventën për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, të 25 tetorit 1980”*.

Parashtruesja më tej pretendon se *“me dispozitën e nenit 4.2 të Rregullores parashikohet se prokurori publik i Qarkut, ku është gjetur fëmija, është kompetent për të ndërmarrë veprimet juridike në emër të parashtrueses. Por, asaj (në cilësinë e mbikëqyrëses dhe kujdestares së fëmijëve të saj sipas nenit 1 para 1, nënparagrafi c), i Rregullores), e as prokurorit publik të Qarkut (neni 4, para 1, nënparagrafi 2 i Rregullores) nuk iu është mundësuar pjesëmarrja në shqyrtimin kryesor sipas kësaj rregulloreje dhe rrjedhimisht nenit 31 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe nenit 6, par 1, të KEDNJ-së”*. Për më tepër, parashtruesja pretendon se, sipas nenit 4.2 të rregullores së UNMIK-ut 2004/29, *“Gjykata e Qarkut ia përcjell kërkesën Prokurorit*

publik të Qarkut, i cili ka juridiksionin në territorin ku është gjetur fëmija. Prokurori publik i Qarkut është kompetent për të ndërmarrë hapa në emër të parashtrueses përkitazi me kërkesën”.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata vëren se parashtruesja ekskluzivisht ankohet se nga Gjykata e Qarkut në Prizren i janë cenuar të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së, pasi kjo gjykatë nuk kishte ftuar Prokurorin Publik në Prizren dhe parashtruesen në seancën gjyqësore të 19 janarit 2010, ku kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Austrisë për kthimin e tre fëmijëve të saj të mitur në vendbanimin e përhershëm në Austri, ishte refuzuar me Vendimin I. Agj. nr. 2/2009-16. Parashtruesja po ashtu ankohet se vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës PPC. nr.33/2011, i 23 gushtit 2011, dhe Ac.nr. 95/2011, i 8 dhjetorit 2011, me të cilat ishte refuzuar, herën e parë nga Gjykata Supreme dhe pastaj sipas ankesës, propozimi i avokatit të saj për përsëritje të procedurës në gjykatën e Qarkut në Prizren, në mënyrë që Prokurori Publik dhe vetë ajo të merrnin pjesë në atë procedurë.

Ne veçanti, parashtruesja pretendon se “nga aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren I.Agj. nr. 2/2009-16, të 19.01. 2010 dhe nga procesverbali i shqyrtimit kryesor, pa mëdyshje rezulton se parashtruesja dhe Prokurori Publik i Qarkut në Prizren as që janë ftuar dhe as nuk kanë marrë pjesë në gjykim, megjithëse pjesëmarrja e tyre ka qenë e detyrueshme, në pajtim me dispozitat e nenit 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/29 për Mbrojtje Kundër Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve. Kjo rregullore është

mbështetur ekskluzivisht në Konventën Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, të 25.10.1980”.

Në lidhje me meritat e kërkesës, Gjykata konstatoi se prania e bashkëshortit të saj dhe avokatit të tij në procedurën në Gjykatën e Qarkut në Prizren e ka vënë parashtruesen në pozitë substancialisht të pafavorshme përballë bashkëshortit të saj, pasi që ajo nuk ka pasur mundësi që të paraqesë argumente dhe prova dhe t’i kontestojë parashtruesat e bashkëshortit të saj gjatë rrjedhës së procedurës. Përveç kësaj, Gjykata konstatoi se duke mos qenë e pranishme në procedurat gjyqësore, parashtruesja nuk kishte mundësi ta hedhë poshtë deklaratën e bashkëshortit të saj dhe të palëve të tjera të interesuara dhe i ishte privuar mundësia të bindë Gjykatën e Qarkut që fëmijët duhen kthyer në vendin e tyre të banimit të përhershëm në Austri, në përputhje me Konventën e Hagës. Në këtë rast, Gjykata i është referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, sipas së cilës një nga aspektet e të drejtës për gjykim të drejtë është parimi i barazisë së armëve, që nënkupton se secilës palë duhet t’i ofrohet mundësia e arsyeshme për të paraqitur rastin e tij/saj në kushte që nuk e vënë atë në pozitë substancialisht të pafavorshme përballë kundërshtarit të tij/saj (Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në Rastin Nr. KI 52/12, Parashtrues Adije Iliri, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Ac.nr. 95/2011, të 8 dhjetorit 2011). Në këtë kontekst Gjykata i është referuar rastit *Dombo Behar N.V. kundër Holandës*, kërkesa nr. 14448/88, Aktgjykimi i GJENDJ-së i 27 tetorit 1993.

Koment

Gjykata Kushtetuese me këtë rast ka nxjerrë në pah rëndësinë e parimit të barazisë së armëve në procedurë, për palën të cilës kjo e drejtë i ishte mohuar fillimisht nga Gjykata e Qarkut në Prizren dhe që një “mohim” i tillë ishte përligjur me vendimin e vetë Gjykatës Supreme të Kosovës, që sipas Kushtetutës paraqet autoritetin më të lartë gjyqësor në Kosovë (Kushtetuta e Republikës së Kosovës- neni 103.2).

Gjykata me të drejtë ka dhënë verdiktin e saj se mosdhënia e mundësisë palës që të paraqesë argumentet e saj, në rastet kur pala kundërshtare ka qenë e pranishme së bashku me avokatin e saj, paraqet shkelje të parimit të barazisë së armëve që është një nga aspektet e gjykimit të drejtë. Duke Urdhëruar Gjykatën e Qarkut në Prizren që të përsërisë procedurat e 9 dhe 13 korrikut 2009 dhe të ftojë parashtruesen që të marrë pjesë në ato procedura, Gjykata i ka dhënë mundësinë që rasti të ri procedohet dhe që të bëhet eliminimi i këtyre mangësive procedurale para gjyqësorit të zakonshëm dhe në të cilën procedurë kanë prezantuar avokatët e të dy palëve pjesëmarrëse në procedurë. Bazuar në Ligjin Ligji Nr. 03/L-238, dt.28 tetor 2010, Për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve i cili i Gjykatën Themelore në Prishtinë e bën kompetente që të vendosë në nivel të tërë Kosovës, rasti është riproceduar para Gjykatës Themelore në Prishtinë. Kështu, me Aktvendimin C.nr. 2955/13 të dt 08.01.2014 Gjykata Themelore në Prishtinë ka vendosur që të bëjë miratimin e propozimit të propozueses Adije Iliri dhe të urdhërojë kthimin e fëmijëve të mitur në vendbanimin e tyre të përhershëm në Austri. Ky vendim i gjykatës së shkallës së parë është pranuar dhe lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit në Prishtinë me vendimin Ac.nr 984/2014 të dt. 07.04.2014. Në vendimin e saj Gjykata e Apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë, ngase qëllimi i Ligjit për

Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve dhe i Konventës së Hagës është sigurimi i kthimit të shpejtë të fëmijës që largohen apo mbahen pa të drejtë, në shtetin e vendqëndrimit si dhe sigurimi i kthimit të shpejtë të fëmijës që largohen apo mbahen pa të drejtë në shtetin e vendqëndrimit. Në rastin konkret fëmijët e kërkuar nga propozuesja, kanë pasur vendbanimin e përhershëm në Austri, gjersa nga kundërpropozuesi (bashkëshorti i kërkueses) tani mbahen në mënyrë të padrejtë dhe të kundërligjshme tek prindërit e kundërpropozuesit në fshatin Studençan të Suharekës (Aktvendimi Ac.nr.984/2014, i dt 07.04.2014 i dhënë nga Gjykata e Apelit në Prishtinë).

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese kishte gjetur se, ka pasur shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe ka bërë që çështja të përsëritet para gjykatës së shkallës së parë. Në këtë mënyrë parashtrueses përkatësisht avokatit të saj i ishte dhënë mundësia që të paraqesë parashtrimet e veta në procedurë, dhe që më pastaj gjykata e shkallës së parë kishte gjetur se fëmijët ishin larguar dhe mbajtur në mënyrë të padrejtë nga bashkëshorti i propozueses, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve i Kosovës dhe i Konventës së Hagës - Konventa për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve e 25 tetorit 1980. Ky vendim ishte përligjur edhe nga Gjykata e shkallës së dytë, përkatësisht Gjykata e Apelit në Prishtinë. Me këtë vendim Gjykata Kushtetuese ka vënë standardin që, është e domosdoshme pjesëmarrja e personave në procedurat gjyqësore, jo vetëm që të kenë njohuri se po zhvillohet procedura ndaj tij, por edhe për të parashtruar argumentet dhe provat gjatë rrjedhës së procedurës (Rasti KI 108/10- Fadil Selmanaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ac.nr. 170/2009, dt. 25 shtator 2009).

6.6.5. E drejta për pronë dhe e drejta për siguri juridike për shkak të ekzistimit të dualitetit të vendimeve gjyqësore dhe administrative

Gjykata Kushtetuese ka dhënë vendimin e saj në rastin nr. KI 104/10, parashtrues Drazha Arsiq- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan Ac.nr. 78/2010, të 7 qershorit 2010, një rast ky në të cilin është shfaqur dualizmi për shkak të ekzistimit të njëhershëm të vendimeve gjyqësore dhe administrative.

Kërkesa

Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se me aktgjykimet C.nr.36/2000 të Gjykatës Komunale në Kamenicë, të 26 shtatorit 2000; Ac.nr 10/2001 të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, të 23 prillit 2001; Rev.nr.141/2003 të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, të 30 dhjetorit 2004, si dhe vendimet në vijim C.nr.36/2000 të Gjykatës Komunale në Kamenicë, të 11 janarit 2010 dhe Ac.nr. 10/2001 të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, të 7 qershorit 2010 i është cenuar e drejta për të gëzuar pronën personale si dhe e drejta për siguri juridike për shkak të ekzistimit në të njëjtën kohë, edhe të vendimeve gjyqësore dhe atyre administrative.

Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që të vërtetojë vendimet nr. HPCC/D/194/2005/C të 18 qershorit 2005 dhe HPCC/REC/66/2006 të 15 korrikut 2006, të cilat i ka nxjerrë Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore- DÇPB (HABITAT-i) janë të formës së prerë dhe të obligueshme dhe si të tilla ato duhet të njihen. Parashtruesi pretendon se me aktgjykimet e përmendura i cenohen të drejtat për të gëzuar pronën personale dhe e drejta për siguri juridike.

HABITAT- ishte emërtimi i Drejtorisë për Çështjet Pronësore, Banesore e themeluar nga UNMIK dhe e cila vazhdoi edhe gjatë Misionit të EULEX në Kosovë. Përbën një Agjencion që ka për kompetencë që të vendoste lidhur me posedimin e të drejtave pronësore dhe banesore. Vendimet e këtij Agjencioni, sipas legjislacionit në fuqi nuk mund të rishqyrtohen nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ.

Parashtruesi i kërkesës ka konsideruar se janë shkelur neni 46 (Mbrojtja e pronës) i Kushtetutës së Kosovës dhe neni 1 (E drejta e pronës) i Protokollit 1 të KEDNJ-së.

Arsyetimi i Gjykatës

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkesa e parashtruesit është e pranueshme. Gjykata është e mendimit se Vendimi HPCC/REC/66/2006 i 15 qershorit 2006 është i formës së prerë në përputhje me nenin 2 paragrafin 7 të Rregullores së UNMIK/1999/23, dhe rrjedhimisht nuk i nënshtrohet rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrative në Kosovë. Vendimi i Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore- DÇPB (HABITAT), i 15 korrikut 2006 u bë *res judicata* më 4 shtator 2006, parashtruesi i kërkesës e ka gëzuar të drejtën e posedimit të pronës, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, dhe se çdo ndërhyrje në këtë të drejtë, nga cilado gjykatë apo organ administrative, do të duhej konsideruar shkelje e të drejtave të parashtruesit (Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr.ref: AGJ 221/12, dt. 23 prill 2012, *Buletini i Praktikës Gjyqësore 2012*, i Gjykatës Kushtetuese, Vëllimi I, fq.505).

Gjykata konkludoi gjithashtu, se ka pasur shkelje të të drejtave të parashtruesit të kërkesës, se Vendimi i Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore- DÇPB (HABITAT), i 15 korrikut 2006 u bë *res judicata* më 4 shtator 2006 dhe se rrjedhimisht kishte pasur shkelje të të drejtës së pronës e paraparë me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së. Gjykata në fund konkludon se gjykatat si dhe organet administrative në fjalë ishin përgjegjëse që të merrnin parasysh në mënyrën e duhur procedurat e zhvilluara në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 pranë DÇPB dhe i Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore në të cilat ishte i përfshirë parashtruesi i kërkesës, dhe që të zbatonin vendimet e tyre.

Koment

Rasti i parashtruar para Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht mënyra se si Gjykata vendosi lidhur me këtë rast, përbën edhe një rast lidhur me të cilin Gjykata ka konsideruar se është bërë shterimi i mjeteve juridike, pasi çështja është ngritur në mënyrë implicite ose substanciale. Rregullativa ligjore të cilës i referohet Gjykata, se është bërë shterimi i mjeteve juridike përjashton juridiksionin e gjykatave vendore. Ligj i aplikueshëm në kohën e ngjarjeve që përbëjnë bazën e ankesës ishte Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/23 për themelimin e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB) dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore (KKPB), dhe Rregullorja e UNMIK-ut, 2000/60 mbi kërkesat pronësore dhe banesore dhe rregullat e procedurës e të provave të Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore si dhe të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, e 31 tetorit 2000.

Neni 1.2 i Rregullorës së UNMIK-ut 1999/23, *inter alia*, parashikon që: “Si përjashtim nga juridiksioni i gjykatave lokale, Drejtoria (DÇPB vër.jona) merr dhe

regjistrin kategoritë e mëposhtme të kërkesave që kanë të bëjnë me pronën banesore, duke përfshirë këtu edhe pronën e shoqëruar me të; [...] Ankesat e personave fizikë të cilët kanë qenë pronarë, posedues ose që kanë pasur të drejtën e banimit në pronën banesore para datës 24 mars 1999, e që tani nuk e kanë atë pasuri në posedim, dhe kur e drejta e pronësisë nuk është transferuar vullnetarisht”. Për më tepër neni 2.5 i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 përcakton se: “Si përjashtim nga juridiksioni i gjykatave lokale, komisioni ka kompetencë ekskluzive për të zgjidhur kategoritë e kërkesave të theksuara në paragrafin 1.2 të kësaj Rregulloreje [...]. Ndërsa neni 2.7 përcakton se “Vendimet përfundimtare të Komisionit janë të detyrueshme për t’u zbatuar dhe nuk janë subjekt i rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrative në Kosovë”.

Vlerësojmë se në këtë rast standardi i vënë nga Gjykata është se në rastet e ekzistimit të vendimeve administrative për të cilat është i përjashtuar rishqyrtimi nga gjykatat vendore apo cilido organ tjetër në Kosovë konsiderohen si *res judicata*, dhe në këtë rast po ashtu konsiderohet se është bërë shterimi i mjeteve juridike gjë që e bën të pranueshme kërkesën para gjykatës.

Vlerësojmë gjithashtu, se juridiksioni i vendosjes brenda të të njëjtit organ edhe në shkallën e parë edhe në shkallën e dytë në procedurë administrative, pa pasur mundësi që të bëhet rishqyrtimi gjyqësor i vendimeve administrative e që ka ekzistuar në Kosovë në sferën e vendosjes lidhur me çështjet që ka marrë në shqyrtim fillimisht Drejtoria për Çështje Pronësore e Banesore e me vonë Agjencia Kosovare e Pronës, që nga viti 1999 deri në vitin 2016 nuk përmbush standardet e një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm. Ky trend i kësaj mënyre vendosjeje është përfunduar në dhjetorin e vitit 2014 dhe është bërë edhe përfundimi i punës së Komisionit për Kërkesa Pronësore e Banesore, kurse ankesat nga kjo

kohë adresohen në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (www.kpaonline.org., parë më 19.04.2015).

Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj në këtë rast nuk është shprehur fare për pjesën e dytë të kërkesës *e drejta për siguri juridike për shkak të ekzistimit të dualitetit të vendimeve gjyqësore dhe administrative*. Duke pasur parasysh se “Siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës” në vendimin e dhënë, nuk ka ndonjë arsyetim nëse është shqyrtuar apo jo kjo pjesë e kërkesës dhe nëse është refuzuar apo jo, çka për mendimin tonë është dashur që Gjykata të ketë vlerësimin e saj për këtë çështje.

6.6.6. Liria e lëvizjes dhe e drejta për mjete efektive – Rasti Valon Bislimi kundër Ministria e Punëve të Brendshme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë

Gjykata Kushtetuese ka gjetur shkelje të nenit 35 të Kushtetutës, që garanton lirinë e lëvizjes (Zyberi, 2015: 186). Gjykata vendosi të shpallë kërkesën e pranueshme me arsyetimin se ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit për liri të lëvizjes ku konsideron se praktika e bazuar në memorandumin e lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë, kurrë nuk ishte shqyrtuar me mbrojtje dhe përpikëri të mjaftueshme procedurale nga autoritete përkatëse ku e pengoi parashtruesin që ta gëzonte të drejtën e tij për mjete efektive juridike e cila është në kundërshtim me nenin 54 të Kushtetutës dhe në lidhje me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në të njëjtën kohë, Gjykata ka vendosur të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit për masë të përkohshme (Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin KI 06/10, Valon Bislimi kundër Ministria e Punëve të Brendshme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë, Nr. Ref:AGJ 63/10, datë 30 tetor 2010).

Kërkesa

Parashtruesi paraqiti kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese, duke i kërkuar Gjykatës që të vlerësojë kushtetutshmërinë e shkeljes së pretenduar të së drejtës për t'u larguar nga vendi, pasi i është refuzuar lëshimi i pasaportës. Ai thekson se Gjykata Komunale në Prishtinë në mënyrë të padrejtë dhe të gabueshme i ka interpretuar dispozitat ligjore, pasi ka dështuar t'ia lëshoj certifikatën e cila është e domosdoshme për Ministrinë e Punëve të Brendshme për të lëshuar pasaportë. Më tej, parashtruesi ankohet se Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka kurrfarë baze juridike për t'ia privuar të drejtën e tij kushtetuese në mungesë të certifikatës që nuk është nën hetime, duke theksuar se kufizimi nuk është i bazuar në ligj, por sipas tij është çështje e interpretimit të gabuar të ligjeve dhe praktikës, përfshirë këtu keqinterpretimin e një memorandumit të mirëkuptimit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë. Në të njëjtën kohë, parashtruesi i kërkesës ka kërkuar vënien e masës së përkohshme për të shmangur diskriminimin e mëtejshëm dhe shkeljen e të drejtës së qytetarëve për liri të lëvizjes ku kushtëzohen me ndonjë procedurë penale në zhvillim e sipër.

Nga kjo mund të shihet se çështja e kërkesës së kësaj lënde është vlerësimi i kushtetutshmërisë së shkeljes së supozuar të lirisë së lëvizjes së parashtruesit të kërkesës të garantuar me Nenin 35 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Sipas parashtruesit të kërkesës, atij i është shkelur e drejta për t'u larguar nga vendi pasi i është refuzuar lëshimi i pasaportës, e cila kërkohet për të udhëtuar jashtë vendit. Parashtruesi i kërkesës më tej ka pohuar se në sistemin ligjor të Kosovës nuk ka mjete efektive juridike për ta ushtruar të drejtën e tij për t'u larguar nga vendi.

Arsyetimi i Gjykatës

i. Duke vlerësuar meritat e çështjes gjykata për **sa i përket të drejtës për liri të lëvizjes** i është referuar nenit 53 të Kushtetutës, që thotë: *“Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin. Secili person ka të drejtë të largohet nga vendi. Kufizimet e kësaj të drejte rregullohen me ligj, nëse ato janë të nevojshme për procedurën ligjore, zbatimin e vendimit të gjykatës ose për të përmbushur obligimin për mbrojtjen e shtetit.*

Gjykata Kushtetuese thekson që Neni 2 i Protokollit Nr. 4 të Konventës i garanton çdo personi të drejtën e për t’u larguar nga vendi dhe për të shkuar në vendin e zgjedhjes së personit në të cilin ai/ajo mund të pranohet. E drejta për t’u larguar nga vendi, përfshirë këtu vendin e vet, duhet të lexohet në përputhje me paragrafin 3 të Nenit 2, i cili parasheh kufizime të caktuara që mund të vendosen në ushtrimin e asaj të drejte në interes, ndër të tjera, të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike.

Duke u shprehur lidhur me atë se nëse kufizimi ka qenë “në përputhje me ligjin”, Gjykata vëren që me rastin e parashtruesit të kërkesës, Ministria e Punëve të Brendshme në mënyrë efikase ndalonte lëshimin e pasaportës për parashtruesin e kërkesës pa vendim të Ministrisë së Punëve të Brendshme ose të gjykatës për atë qëllim. Gjithashtu duhet të kihet parasysh që në përputhje me nenin 27 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit, organi kompetent, dmth. Ministria, ka të drejtë ta refuzojë kërkesën për pasaportë “ në bazë të vendimit të gjykatës” dhe “ nëse gjykata kërkon ndalesën e lëshimit të pasaportës “. Gjykata rikujton që, sipas parashtruesit të kërkesës, kufizimi i vendosur në të drejtën e tij për liri të lëvizjes nuk është i bazuar në ligj, por është çështje e interpretimit të gabuar të

ligjeve dhe praktikës në bazë të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Duke u shprehur lidhur me atë se nëse kufizimi ishte “ i domosdoshëm në një shoqëri demokratike”, Gjykata është shprehur se për sa i përket proporcionalitetit të kufizimit të vendosur për shkak të pranisë në procedurë penale, Gjykata rithekson që kjo justifikohet derisa të ekzistojë qëllimi legjitim. Gjykata vëren që praktika e mirëfilltë gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila thekson që një masë e shqiptuar, ndonëse e justifikuar në fillim, mund të bëhet disproporcionale dhe t’i shkelë të drejtat e individit nëse automatikisht zgjatet për një periudhë të gjatë kohore -*Aktgjykimi i GJEDNJ në rastin Luordo kundër Italisë, nr.32190/96, para. 96; Földes dhe Földesné Hajlik kundër Hungarisë, nr. 41463/02, para.35.* Praktika e GJEDNJ, poashtu, thekson që autoritetet janë të obliguara që të sigurojnë që shkelja e të drejtës së individit për t’u larguar nga vendi i vet është, prej fillimit e deri në fund të kohëzgjatjes së saj, e justifikuar dhe proporcionale më të gjitha rrethanat. Ato nuk mund t’i zgjasin për periudha të gjata kohore masat që e kufizojnë lirinë e lëvizjes së individit pa rishqyrtim të rregullt të justifikimit të tyre. Shqyrtimi i tillë duhet të kryhet, së paku në instancën e fundit, nga gjykatat pasi ato ofrojnë garancitë më të mira për pavarësinë, paanësinë dhe ligjshmërinë e procedurave. Përmasa e shqyrtimit nga Gjykata duhet t’i mundësojë t’i marrë parasysh të gjithë faktorët e përfshirë, përfshirë këtu faktorët që kanë të bëjnë me proporcionalitetin e masave kufizuese dhe kalimin e kohës - *Aktgjykimi i GJEDNJ në rastin Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës, 23 qershor 1981, para 60, seria A nr.43.*

Gjykata Kushtetuese vëren që procedura penale kundër parashtruesit të kërkesës priste të zgjidhej para Gjykatës Komunale të Prishtinës për më tepër se gjashtë vjet dhe që

parashtruesi i kërkesës më në fund u lirua. Gjykata gjithashtu vëren që në procedurën kundër parashtruesit të kërkesës, Gjykata Komunale nuk ka lëshuar asnjë vendim në përputhje me Nenin 271 të Kodit të Procedurës Penale. Në vend të kësaj, gjykata u përmbajt për ta lëshuar një certifikatë që ishte sipas praktikës së themeluar kriter i domosdoshëm për lëshimin e pasaportës, ndonëse ky dokument nuk ishte shënuar në Nenin 23.2 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit. Gjykata vlerëson që përmasa e e procedurës gjyqësore gjithashtu ka dështuar t'i përmbushë kriteret e Nenit 2 të protokollit Nr.4 të Konventës. Gjykata është gjithashtu e mendimit që organi administrativ nuk i ka marrë parasysh të gjitha informatat përkatëse për të siguruar që kufizimi i lirisë së lëvizjes së parashtruesit të kërkesës ishte i justifikuar dhe proporcional në dritën e rrethanave të rastit.

ii. Për sa i përket **të drejtës për mjete efektive juridike**, Gjykata pasi i është referuar Nenit 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 të Konventës (përmbajtja e të cilave është elaboruar më sipër), ka gjetur se ankesa e parashtruesit të kërkesës sipas Nenit 2 të protokollit Nr 4 të Konventës në lidhje me ndalesën efektive kundër largimit të tij nga Kosova ishte e diskutueshme. Prandaj, ankuesi kishte të drejtë për procedurë efektive ankimore sipas ligjit të Kosovës. Gjykata thekson që memorandumit vetëm mund ta ndihmojë zbatimin e Ligjit dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të përdoret si arsyetim për moszbatimin e Ligjit. Gjykata rikujton që në përputhje me praktikën e bazuar në memorandum, kërkesa e parashtruesit të kërkesës për pasaportë kurrë nuk ishte shqyrtuar me mbrojtje dhe përpikëri të mjaftueshme procedurale nga një autoritet përkatës. Sipas mendimit të Gjykatës, praktika e bazuar në memorandumin e mirëkuptimit të 21 gushtit 2008, e zbatuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Gjykatën Komunale e pengoi

parashtruesin e Kërkesës që ta gëzonte të drejtën e tij për mjet efektiv juridik në kundërshtim me Nenin 54 të Kushtetutës në lidhje me Nenin 13 të Konventës.

Komenti

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës më vendimin e sipërpërmendur ka shtruar nevojën e ekzistimit të procedurave efektive për mbrojtjen e të drejtave të kërkuesve në rastet kur u mohohen të drejtat ndërkohë që as organi gjyqësor e as organi administrativ nuk ofrojnë kushte për mjete efektive në rastet e mohimit të një të drejte.. Gjykata ka vënë standardin se memorandumet e mirëkuptimit vetëm mund ta ndihmojnë zbatimin e ligjit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të përdoren si arsyetim për mos zbatimin e ligjit. Vlerësojmë se edhe rasti në fjalë përveç cenimit të drejtës për lëvizje të lirë si kategori e mbrojtur me Kushtetutë dhe të drejtës për mjete efektive juridike, në rastin e njëjtë është cenuar edhe e drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm. Kërkuesi kishte gjashtë vite që ndaj tij kishte filluar procedura penale, por që më në fund ishte liruar.

KAPITULLI VII: Garancitë ligjore dhe institucionale për të siguruar të drejtën për proces të rregullt gjyqësor- nevoja për përmirësim

7.1. Reformimi i gjyqësorit

Ndryshimet ekonomike, shoqërore e politike që u bënë në Kosovën e pas luftës hapën rrugën për fillimin e reformës në gjyqësor. Në këtë sferë të rëndësishme të pushtetit shtetëror u desh që të punohet në dy drejtime. E para, Kosovës i duhej që të bënte shkëputjen nga një sistem i tejkaluar socialist dhe ndarjen njëherë e përgjithmonë nga juridiksioni i ish Jugosllavisë. E dyta, u desh që të bëhet ndërtimi dhe përshtatja e kushteve për atë që mundësonin rrethanat, drejt një sistemi dhe shoqërie të re që po ndërtohej në Kosovën e pas luftës.

Teoria e së drejtës reformën e përkufizon si ndryshim evolutiv që ndodh në shtet dhe në vet të drejtën. Reforma si një prej ndryshimeve evolutive është e përditshme dhe e përhershme sepse shoqëria që e pranon ecurinë dialektike gjithmonë është për reforma, pra për procese të reja në fusha të ndryshme të jetës, prandaj, reforma zbatohet vetëm në një fushë, si: arsim, shkencë, ekonomi, etj (Ismaili, 2007 :48).

Reforma në gjyqësorin e Kosovës filloi me shumë vonesë. Administrimi ndërkombëtar i UNMIK bëri që kompetencat lidhur me gjyqësorin të ishin të shpërndara në mes të Departamentit të Drejtësisë (Shtylla e Parë e UNMIK) dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe PSSP-së si autoritetin e fundit. Sigurisht që zvarritja e zgjidhjes së statusit final, ka pasur edhe ndikimet e veta në vonesën e fillimit të reformës në gjyqësor. Për vite me radhë struktura e gjykatave vazhdoi që të jetë ashtu siç ishte edhe gjatë sistemit të vjetër komunist, me emërtime të njëjta dhe me organizim territorial pothuajse të njëjtë. Që nga

vënia e Kosovës nën administrimin ndërkombëtar në vitin 1999 e deri më 01 janar 2013, struktura organizative e gjykatave dhe shtrirja territoriale e tyre bazohej në Ligjin mbi Gjykatat e Rregullta (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, 21/78) dhe në Rregullorën e UNMIK për Kornizën Kushtetuese 2001/9. Edhe organizimi funksional në masën më të madhe bazohej në Rregullat për veprimtarinë e brendshme të gjykatave (Gazeta Zyrtare e Kosovës 7/81).

Vetëm në vitin 2013 në Kosovë do të ndërmerren hapa konkret në fillimin e reformës dhe vendoset një strukturë e re organizative dhe funksionale e gjykatave si dhe do të bëhen ndryshime si për nga emërtimi, e po ashtu edhe për nga kompetencat e tyre. Sipas sistemit të ri të organizimit Sistemi Gjyqësor i Kosovës përbëhet nga Gjykatat Themelore, një Gjykatë Apeli dhe Gjykatën Supreme si instanca e fundit për vendosje. Megjithëse këtë proces reformimi e përcollën edhe procese të tjera si procesi i riemërimit të gjyqtarëve, prapë prapë në gjykatat më qendrore mbeti një sasi e madhe e lëndëve të prapambetura, është ndier mungesa e numrit të gjykatësve dhe mbeti edhe mënyra e vjetër e të punuarit në këto gjykata. Numri tejet i madh i lëndëve të prapambetura sidomos në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe në Gjykatën e Apelit vazhdojnë që të mbeten problem permanent dhe sfidë për gjyqësorin. Vonesa në zgjidhjen me kohë dhe brenda afateve ligjore të lëndëve gjyqësore, cenon të drejtën e pjesëmarrësve në procedurat gjyqësore që tu garantohet një proces i drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm. Për këto arsye nevojitet që të vazhdohet me reformën në gjyqësor në mënyrë që të gjenden forma dhe mundësi që të behët zvogëlimi i lëndëve gjyqësore dhe që niveli i të vendosurit të ngritët në shkallë sa më të lartë që është e mundur.

7.1.1. Propozim për përmirësim

Reformimi i gjyqësorit në Kosovë paraqet një rëndësi të lartë për ngritjen dhe zhvillimin e sistemit gjyqësor, e me këtë edhe të procesit të rregullt gjyqësor. Vlerësojmë se që të arrihet kjo gjë, është e nevojshme që të punohet në tri rrafshje dhe të bëhet reformë në sferën institucionale, ligjore dhe administrative. Kur bëhet fjalë për punën që do të bëhet në rrafshin institucional kjo pothuajse paraqet pjesën më të vështirë, sepse varet nga pjesa politike e institucioneve të shtetit se sa ajo do të ndërmerr veprime p.sh që të ndryshojë Kushtetutën në pjesë të caktuara, të bëjë ndryshimin e ligjeve që bëjnë rregullimin organizativ dhe funksional të gjyqësorit, pastaj sa ajo dëshiron që të heq dorë nga dëshira që të kontrollojë gjyqësorin p.sh. tek buxheti, apo tek ndërhyrja në emërimin e gjykatësve dhe pjesa administrative e gjyqësorit. Me këtë rast është më se e domosdoshme që të bëhet ndryshimi i Kushtetutës ku pjesa më e madhe e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor do të duhej që të zgjidheshin nga vetë gjykatësit dhe jo siç është deri më tani ku pjesa më e madhe e anëtarëve zgjidhen nga parlamenti. E gjithë kjo do të bënte që të reflektohej tek publiku se gjyqësori është i pavarur dhe i paanshëm dhe do të shtonte besimin e publikut tek gjyqësori.

Lidhur me punën që duhet të bëhet në aspektin ligjor, vlerësojmë se duhet që të bëhet hartimi dhe përditësimi i kornizës ligjore për zbatimin e pjesës së reformës institucionale. Ky përditësim ndonëse varet në masë të madhe nga vullneti politik (shtyrja përpara e ndryshimeve ligjore nga ana e qeverisë dhe miratimi i tyre në parlament), kërkon edhe kycje aktive të vet pjesës së gjyqësorit dhe shoqërisë civile në këtë proces. Pjesa administrative e gjyqësorit (Këshilli Gjyqësor) deri më tani në mungesë të ideve të qarta

dhe në mungesë të guximit për kundërvënie të pjesës politike jo rrallë here ka vepruar duke marrë anën e atyre që kanë hedhur vrer mbi gjyqësorin dhe në këtë mënyrë duke dështuar që të kryej funksionin e vet dhe detyrat për të cilat ishin mandatuar. Edhe roli i shoqërisë civile vlerësojmë se do të ishte shumë i rëndësishëm në këtë proces. Shoqëria civile është një zë i rëndësishëm në publik. Në anën tjetër ajo është përfituese e madhe e fondeve që organizmat ndërkombëtar kanë dhënë në emër të ndihmës për Kosovën. Roli i këtij organizimi të rëndësishëm e që vlerësohet në masë të madhe nga organizmat ndërkombëtar, vlerësojmë se do të duhej që të fokusohet jo në numërimin e dështimeve të gjyqësorit siç është bërë në numrin më të madh të rasteve, por do të duhej që të dilte me ide dhe propozime konkrete për atë se çfarë do të duhej që të ndryshohej për të mirë në gjyqësor.

Në gjyqësorin e Kosovës, vlerësojmë se është e domosdoshme që të bëhet reformë edhe në pjesën administrative. Kjo sipas mendimit tonë do të nënkuptonte reformën në kuptimin e menaxhimit. Një menaxhim më i mirë në gjyqësor do të mundësonte ofrimin e shërbimeve efikiente dhe do rriste transparencën. Me këtë rast vlerësojmë se duhet që të bëhet edhe një koordinim i trupave të tjera me gjyqësorin si prokuroria, policia etj. Kujtojmë me këtë rast rastin kur policia e EULEX kishte shkuar në shtëpinë e të dyshuarit që të bëjë arrestimin e personit të gjykuar, ndërsa tashmë ai ishte veç duke e vuajtur dënimin me burg (Gazeta Koha Ditore, 2015: 7 korrik). Kjo ka ndikuar mjaft shume që të humbet besimi në drejtësi.

7.2. Nevoja për hapje gjykate në nivel Themelor dhe në nivel Apeli nëpër qendra të tjera të Kosovës

Sigurimi i papenguar i qasjes në gjyqësor për qytetarët, mbetet një ndër sfidat e gjyqësorit dhe institucioneve të Kosovës në të ardhmen. Koncentrimi i të gjitha institucioneve gjyqësore në një vend të vetëm me qendër në periferi të qytetit të Prishtinës ka vështirësuar qasjen e qytetarëve në institucionet gjyqësore. Largësia nga qendra e qytetit dhe mos sigurimi i transportit për qytetarët në këtë fazë është parë si pengesë në qasjen e tyre në drejtësi. Përveç kësaj fillimi i ndërtimit institucional dhe ndryshimi i strukturës së gjykatave që filloi në vitin 20013, nuk solli hapje gjykate edhe në disa qendra të Kosovës. Edhe pas kësaj, në njësi administrative të tëra (komuna) si Fushë Kosova, Obiliqi etj., nuk u formuan gjykata të nivelit themelor. Pjesëtarët e këtyre komunave, qasjen në drejtësi vazhduan që ta kërkojnë në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Kërkimi i drejtësisë në Gjykatën Themelore në Prishtinë edhe për pjesëtarët e këtyre komunave, ka shkaktuar mbi ngarkesë të kësaj gjykate me raste gjyqësore. Prishtina edhe ashtu është qendra më e madhe në Kosovë, dhe vetëm për territorin e saj prapë se prapë do të kishte numrin më të madhe të lëndëve gjyqësore të prapambetura. Gjykata Themelore e Prishtinës edhe ashtu ka disa kompetenca shtesë për nivelin e tërë Kosovës që nuk i kanë edhe gjykatat e llojit të njëjtë në qendrat tjera të Kosovës. Kështu në këtë gjykatë përveç Departamentit të përgjithshëm në përbërjen e të cilit hyjnë Divizioni civil dhe ai penal, është i organizuar Departamenti Administrativ, Departamentin Ekonomik si dhe vendosë në procedurë civile lidhur me rrëmbimin ndërkombëtar të fëmijëve.

Në fund të vitit 2015 sipas statistikave të publikuara, një gjykatës në lëminë civile në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kishte në punë rreth 650 lëndë gjyqësore, kurse në këtë gjykatë në këtë sektor ishin të angazhuar 12 gjykatës. Një gjendje aspak më e mirë nuk mbretëronte as edhe në sektorin penal. Në Departamentin e Krimeve të Rënda, një gjykatës kishte të pranuar rreth 500 lëndë gjyqësore, ndërsa ishin të angazhuar në këtë sektor vetëm 5 (pesë) gjykatës. Gjykatësit në këtë gjykatë nuk kanë staf ndihmës, dhe nuk ndihmohen nga zyrtar të mjaftueshëm ligjor dhe staf tjetër i nevojshëm. Kjo gjendje nuk mbretëronte edhe në gjykatat e tjera të Kosovës (Nga statistikat e publikuara me 23.12.2015 nga Gjykata Themelore në Prishtinë).

Numri i madh i lëndëve të prapambetura ka bërë që të këtë shkelje të të drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme.

Një gjendje aspak më e mirë nuk qëndron edhe në nivelin e shkallës së dytë, në nivelin e Gjykatës së Apelit. Koncentrimi i vendosjes në nivelin e shkallës së dytë vetëm në një gjykatë të vetme, ka shkaktuar grumbullimin e rasteve dhe vonesa në vendosjen e çështjeve gjyqësore.

Në gjykatën e Apelit në Prishtinë në fund të vitit 2015, numri i lëndëve të prapambetura në lëmine civile, ishte rreth 8258 lëndë gjyqësore. Në këtë sektor ishin të angazhuar rreth 15 gjykatës. Numri i lëndëve për një gjykatës ishte rreth 560 raste, kurse norma dhe mundësia e zgjidhjes së lëndëve ishte rreth 22 lëndë gjyqësore në muaj. Në këtë kohë në këtë gjykatë në punë ishin lëndët nga viti 2013, duke i shtuar kësaj edhe lëndët që sipas ligjit ishin të natyrës urgjente. Në një

gjendje të tillë, Gjykata e Apelit e Kosovës, vitin 2016 ishte me rreth 3 vjet vonesë në vendosjen e rasteve gjyqësore (Nga statistikat e publikuara nga Gjykata e Apelit e Kosovës, më dt. 23.12.2015).

Një grumbullim i tillë i lëndëve të prapambetura dhe shkaktimi i vonesave të arritjes së drejtësisë, vlerësojmë se përbën cenim të të drejtës për proces të rregullt gjyqësor. Ndër shkaqet që kanë shkaktuar këtë shumësi lëndësh të pazgjidhura, vlerësojmë se janë grumbullimi i problemeve të shumta në kohën e pas luftës, mos definimi i çështjeve lidhur me pronësinë, numri i madh i kërkesave për rastet e ndodhura në aksidentet në trafik dhe aksidentet në punë, kërkesat gjithnjë në rritje për zgjidhjen e problemeve familjare dhe të pasurisë, problemet lidhur me çështjet e trashëgimit, kriza ekonomike permanente, normat e larta të interesit dhe rënia e mundësisë së likuidimit të kredive bankare etj.

7.2.1. Propozim për përmirësim

Për të përmirësuar sadopak këtë gjendje, vlerësojmë se është e nevojshme që të bëhet hapje gjykate në nivelin e Gjykatës Themelore me qendër në Fushë Kosovë e cila do të mbulonte edhe territorin për Komunën e Obiliqit. Kështu do të barteshin për vendosje në këtë gjykatë, një numër i konsiderueshëm i rasteve gjyqësore që për momentin gjenden e Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe presin për një kohë të gjatë që të merren në punë dhe që të vendosen. Në këtë mënyrë do të mundësohej qasje më e lehtë e qytetarëve në drejtësi, dhe gjithashtu edhe zgjidhje më të shpejtë të rasteve në kohë të arsyeshme.

Gjithashtu, vlerësojmë se është e nevojshme që të bëhet hapja e së paku edhe dy gjykatave (apo degëve të gjykatave), në nivel të gjykatës së apelit në qendra të tjera të Kosovës. Njëra gjykatë, do të duhej që të vendosej me qendër në qytetin e Gjilanit ose të Ferizajit dhe do të vepronte si gjykatë e shkallës së dytë për nivelin e Gjykatës Themelore të Ferizajt dhe degëve të saj në Kaçanik dhe Shterpcë, dhe për nivelin e Gjykatës Themelore në Gjilan dhe degëve të kësaj gjykate në Kamenicë, Viti dhe Novobërdë. Ndërsa, gjykata tjetër, do të duhej të vendosej me qendër në qytetin e Pejës ose të Gjakovës dhe do të vepronte si gjykatë e shkallës së dytë për Gjykatat Themelore të Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit dhe degëve përkatëse të këtyre gjykatave. Vendimet e pjesës tjetër të gjykatave themelore, shkallshmërinë në nivel Apeli do ta realizonin në kuadër të Gjykatës së Apelit me seli në Prishtinë.

Shtimi i numrit të gjykatave në nivel të Gjykatës së Apelit do të ndikonte që numri i rasteve gjyqësore të prapambetura të zvogëlohej në kuotë të arsyeshme, rastet të procedoheshin dhe zgjidheshin në kohë të arsyeshme dhe do të bënte që të respektoheshin standardet e procesit të rregullt gjyqësor. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në Rastin Nr. KO 4/11, Gjykata Supreme e Kosovës, Vlerësim i Kushtetutshmërisë së neneve 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësimin pronës së paluajtshme, Nr. 03/L-139, aktgjykim i marsit 2012, ishte shprehur se *“përgjegjësia primare për administrimin e mirëfilltë të drejtësisë i takon Qeverisë dhe çështjet organizative nuk mund të përdoren si arsyetim për mosrespektim të Kushtetutës”*.

7.3. Nevoja për hapjen e Gjykatës Administrative

Gjyqësia administrative nëpërmjet Gjykatave Administrative paraqet një ”formë e mënyrë shumë adekuate të mbrojtjes juridike, qoftë për shkak të profesinoalitetit, qoftë për shkak të pavarësisë së tyre organizative”, (Stavileci, 2011: 15). Ndonëse gjyqësia administrative në Kosovë është zhvilluar fillimisht në kuadër të Gjykatës Supreme (deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për Gjykatat në janar të vitit 2013), nuk mund të thuhet se ekziston ndonjë traditë e zhvilluar në këtë fushë të gjyqësorit.

Gjyqësia administrative në Kosovë është e organizuar në nivelin e Departamentit për Çështje Administrative, i cili funksionon në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe ka juridiksion për tërë territorin e Kosovës. Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore gjykon dhe vendos në konfliktet administrative (mosmarrëveshjet administrative) sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj (Ligji Nr.03/L-199 Për Gjykatat- neni 14). Në shkallë të dytë, ekziston edhe Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës së Apelit, kurse sipas mjeteve të jashtëzakonshme lidhur me këto çështje vendos Gjykata Supreme e Kosovës.

Esat Stavileci përmend katër përparësi të gjyqësisë administrative dhe ato janë: përparësia e gjyqësisë administrative në “demokratizimin e sistemit gjyqësor”, ndarja funksionale gjyqësisë administrative nga sistemi i gjykatave të kompetencës së përgjithshme, rritja e besimit të qytetarëve dhe opinionit publik në punën e ligjshme të administratës, dhe e fundit, mbrojtja e shtetasve nga “arbitrariteti i administratës”. (Stavileci, 2011: 17).

Në Departamentin për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në fund të vitit 2015 kishte të ngritura rreth 5300 procese gjyqësore, ndërkohë që ishin të angazhuar vetëm 7 gjykatës (Raporti statistikor i Gjykatës Themelore në Prishtinë 06.01.2016).

7.3.1. Propozim për përmirësim

Siç është thënë më lartë, gjyqësia administrative më parë ka qenë e organizuar në nivelin e Gjykatës Supreme, kurse pas kalimit të kompetencave në nivelin e Gjykatës Themelore, gjyqtarët që më parë punuan në këtë fushë, nuk erdhën së bashku me rastet e shumta gjyqësore që ishin në pritje që të vendoseshin. Krijimi i Gjykatës Administrative do të ndikonte në specializimin e gjyqtarëve dhe stafit ndihmës dhe kjo do të ndikonte në zgjidhjen e plotë të konflikteve (mosmarrëveshjeve) në fushën administrative. Kjo Gjykatë, gjithashtu do të mundësonte që të bëhej shuarja e një numri të agjencioneve dhe bordeve të cilat në Kosovë kanë marrë kompetenca të gjyqësorit. Bordi i pavarur për rishqyrtime tatimore dhe doganore, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, etj, janë vetëm disa nga këto organizma që veprojnë në çështje administrative, dhe që nuk garantojnë se do të bëhet respektim i procesit të rregullt ligjor. Kjo për shkakun se anëtarët e bordeve dhe agjencioneve të tilla emërohen nga ekzekutivi dhe parlamenti me një ndikim shumë të madh nga mazhoranca politike. Meqenëse objekt i konfliktit administrativ (mosmarrëveshjes administrative) është akti përfundimtar i nxjerrë nga organi i administratës, atëherë zvogëlohen edhe gjasat për një garantim të procesit të drejtë ligjor.

Ngritja e Gjykatës Administrative do të ndikonte që Kosova ti bashkohej numrit më të madh të vendeve të Bashkimit Evropian në të cilat veprojnë Gjykatat Administrative, si gjykata të specializuara. Avancimi nga niveli i departamentit që është në kohën e tanishme, në nivel të gjykatës domosdo do të krijonte mundësi për marrjen e fondeve buxhetore të veçanta gjë që do të bënte që të ngritën themelet e një gjyqësie të mirëfilltë administrative dhe e cila do të ndikonte që në shumë sektorë të jetës publike në Kosovë, të bëhet kontrolli gjyqësor i administratës. Në çështjen “Kraska kundër Zvicrës”, GJEDNJ ka arritur në përfundimin se një gjykatë, jo vetëm mund të shfuqizojë një vendim të një organi administrativ të kundërshtuar nga aplikanti, por mundet që në raste të veçanta të akordojë dhe autorizimin që aplikanti kërkon nëse ky i fundit i plotëson kriteret (Aplikimi nr.13942/88, Vendimi i vitit 1993, para 26, cituar sipas Mandia, 2011: 50). Po sipas gjykatës, gjyqtarët nuk janë të detyruar të pranojnë interpretimin e ligjit të bërë nga përfaqësuesit e pushtetit ekzekutiv, pra ata *“duhet të jenë të pavarur si nga ekzekutivi ashtu edhe nga palët”* (Rasti “Ringeisen kundër Austrisë”, 1971, nr.2614/65, para. 95, cituar sipas Mandia, 2011: 51).

Përfundimisht rëndësia që BE dhe faktori tjetër ndërkombëtar, i ka dhënë formimit të Gjykatës Administrative në rastin e Shqipërisë, do të duhej që pothuajse me të njëjtat shkaqe dhe arsye të shërbejnë edhe organizmat vendimmarrës në Kosovë. Vlerësojmë se Kosova në afatin sa më të shpejtë do të duhej që t’i hyjë punës për nuk duhet të pritët që për arsye të tilla të cilat do të mund të rregulloheshin me kohë, raportet lidhur me ecjen drejt integritetit të Kosovës në BE të mos jenë ato të duhurat, siç edhe ka ndodhur në rastin e mos dhënies së rekomandimit për liberalizim të vizave në fundin e vitit 2015.

7.4. Respektimi i pavarësisë së gjyqësorit

Respektimi i pavarësisë së gjyqësorit në Kosovë, është i ndërlidhur ngushtë me nevojën e vetëdijesimit të faktorit politik qoftë pozitiv, qoftë opozitiv se gjyqësori përbën pushtetin që duhet të jetë i barabartë dhe i pavarur nga dy pushtetet e tjera, ekzekutivin dhe legjislativin. Ky respektim i pavarësisë së gjyqësorit, vlerësojmë se ndërlidhet edhe me ngritjen e vetëdijes së opinionit publik se gjyqësori si i vetëm nuk mundet që të jetë rregullatori i vetëm në shtet, i cili ka në dorë të ndikojë në secilën fushë të jetës. Krahas gjyqësorit duhet që të japin kontributin e tyre edhe segmentet e tjera shtetërore dhe ato publike.

Në Kosovë të gjitha adresimet për dështim, i adresohen gjyqësorit dhe gjykatësve që punojnë në të. Ka ngatërime në të kuptuarit e asaj se çfarë ka në kompetencë që të bëjë prokuroria dhe çfarë kanë në kompetencë që të bëjnë gjykatat. Këtë ambient shumë të pafavorshëm për gjyqësorin dhe gjykatësit, në mënyrën më të mirë janë shfrytëzuar nga dy pushtetet e tjera, duke adresuar dështimet në punë e tyre si fajësim të gjyqësorit dhe duke adresuar kritika të pa kursyera drejt gjyqësorit.

Gjyqësori në shumë raste është përdorur si objekt për qëllime dhe debate politike. Në krizën e fundit politike në Kosovë që ka mbretëruar në fund të vitit 2015, gjyqësori nga ana e mazhorancës politike akuzohej për dënime të ulëta dhe jo adekuate ndaj shkelësve të ligjit, ndërkohë që nga ana e pjesës opozitare gjyqësori është akuzuar si i ndikuar nga klasa politike në pushtet për të disiplinuar opozitën.

Lidhur me një rast gjyqësor, një personi që kishte hedhur vezë apo mjete të metalta ndaj kryeministrit të Kosovës, dhe kur nga ana e gjykatës i ishte akorduar një gjobë

prej 150 €, i pari i ekzekutivit ishte shprehur në një mesazh për partitë opozitare ndër të tjera se "Ju siguroj se Gjykatat tona nuk do tu dënojnë, ato e kanë ulë çmimin e jetës dhe sigurisë së kryeministrit, sepse, ato janë aleatët tuaj", për të vazhduar se "çmimi më i lartë që do të paguani për jetën e kryeministrit është 150 €. Aq më tepër ky çmim është veresi, sepse gjykata ju pret, kurse ju mund të ankoheni. Kjo është fytyra e drejtësisë sonë. Turpi ynë", përfundon deklarimi i kryeministrit (lajmi.net: 2015, 7 tetor, parë me 07.01.2016).

Këto raste deklarimi, vlerësojmë se kanë peshë të madhe për opinionin publik, paraqesin mosrespektim të gjyqësorit, ndërhyrje në punën e gjykatës dhe janë një mesazh jo i mirë për pavarësinë e gjyqësorit. Ato, gjithashtu ndikojnë edhe në uljen e besueshmërisë së gjyqësorit tek publiku.

Kur jemi tek respektimi i pavarësisë së gjyqësorit, kjo pavarësi është cenuar edhe në rastet e akordimit të buxhetit për gjyqësorin, zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ngacmimi i gjykatësve dhe prokurorëve në media dhe përpjekja për të ndikuar qoftë në hetime, qoftë në rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor dhe vendimin përfundimtar etj. Që të gjitha këto në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi kanë ndikimin e tyre në procesin e rregullt gjyqësor.

7.4.1. Propozimi për përmirësim

Tashmë është e qartë se pavarësia e gjyqësorit, nuk mjafton që vetëm të jetë e deklaruar në Kushtetutë dhe ligjet përkatëse, por në Kosovë shfaqet nevoja e respektimit të kësaj pavarësie. Së pari, duhet që të ndryshohet neni 108 i Kushtetutës së Republikës së

Kosovës, sipas të cilit, tetë (8) nga gjithësejt 13 anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës zgjidhen nga ana e deputeteve të Kuvendit të Kosovës. Propozimi me këtë rast do të ishte që shumica e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor duhet të zgjidhen nga kolegët e tyre, në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias.

Sa i përket buxhetit lidhur me gjyqësorin, ky buxhet vlerësojmë se duhet që të jetë i rregulluar në mënyrë të ngjashme me atë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, përkatësisht me nenin 14 të Ligjit Nr.03/L-121 Për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Sipas këtij ligji Gjykata Kushtetuese përgatit propozimin e buxhetit vjetor dhe ia dërgon për miratim Kuvendit të Kosovës. As Qeveria apo ndonjë organizatë tjetër buxhetore nuk ka të drejtë të ndryshojë ose në çfarëdo mënyre tjetër të modifikojë ose të ndikojë në propozimin e përgatitur nga Gjykata Kushtetuese. Zgjidhja e tillë ligjore do të bënte në masë të madhe, gjyqësorin të pavarur nga ekzekutivi dhe legjislativi dhe do të ndikonte në pavarësinë e përgjithshme të vet gjyqësorit.

Mediet duhet që të kursehen nga ngacmimi i prokurorëve dhe gjykatësve dhe duhet që të heqin dorë nga tendenca për të ndikuar në rrjedhën e hetimeve apo vendimin përfundimtar të gjykatës. Këshilli Gjyqësor, duhet që të marrë masa të duhura për përgjigje efektive institucionale, pranë organizmave përkatës në rastet e tilla. Inicimi i procedurave pranë Këshillit të Pavarur për Media apo edhe dalja me deklarime zyrtare për raste të tilla, duhet që të jenë prioritet i Këshillit Gjyqësor në të ardhmen. Etiketimi i pjestarëve të gjyqësorit në media, qon në humbjen e besimit tek publiku. Presioni medial tek gjyqtarët dhe mos ofrimi i mbrojtjes institucionale për gjykatësit, do kenë ndikim në pavarësinë e tyre e me këtë edhe në vet procesin e rregullt gjyqësor.

7.5. Procesi i emërimit dhe ngritja profesionale e gjykatësve

Procesi i emërimit të gjykatësve paraqet një komponentë shumë të rëndësishme për procesin e rregullt gjyqësor. Gjyqtarët varësisht nga ekspertiza që përfaqësojnë, duhet që të jenë pjesë e gjykatës së shkallës së caktuar. Në Kosovë edhe më tutje, nuk është bërë e mundur evitimi i ndërhyrjeve nga segmente të caktuar, në procesin e emërimit dhe riemërimit të gjykatësve. Zgjatja e procesit të riemërimit dhe lëvizja nga njëra shkallë gjyqësore në tjetrën, shoqërohen me jo transparencë dhe kjo len për të dëshiruar se ndërhyrjet edhe më tutje mbeten të pashmangshme në këtë proces.

Dukuri tjetër jo e mirë për procesin, mbetet edhe më tutje çështja e grupimeve provinciale, nga anë të ndryshme të Kosovës dhe avancimi në këtë mënyrë i personave pa përfaqësim ekspertize për nivelin e caktuar gjyqësor. Është bërë e zakonshme që me rastin e avancimeve të prijnë persona nga rajone të caktuara varësisht prej mbështetjes që kanë brenda Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Këto dukuri janë vërejtur edhe me rastin e vlerësimit (poentimit) nëpër komisionet e ndryshme, ku ka pasur raste që janë bërë poentime të njëanshme dhe ka ndodhur që konkurrent të tjerë janë favorizuar, kur për çështje të njëjta janë notuar më lartë.

Gjatë hulumtimit tonë lidhur me procesin e emërimit për gjykatës të Gjykatës së Apelit, në një rast kemi evidentuar të dhënë ku ndonëse gjykatësi kishte pasur një performancë me lënie në fuqi të vendimeve të tij nga ana e Gjykatës së shkallës së dytë prej rreth 90%, kishte qenë i notuar me notën 3, d.m.th., dy here më të ulët nga sa e përcaktonin kriteret e ndërtuara për këto raste. Po ky gjykatës, kishte qenë i notuar në mënyrë lineare në të gjitha pyetjet dhe kriteret e vlerësimit me të njëjtën notë (3). Gjykatësi i përfshirë në

këtë rast, këtë e kishte parë si tendencë të qëllimshme për degradimin e tij, në garën për avancim në gjykatën e shkallës së dytë (Nga Ankesa drejtuar Komisionit për Vlerësim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, e dt. 24.04.2015).

Në raste të caktuara për shkak të garës së fortë, gjykatës të caktuar janë bërë objekt hapjesh të procedurave disiplinore, apo edhe objekt kritikash në shtypin ditor. Për shkak të rëndësisë që ka, jo rrallëherë ka qenë objekt i tendencave për të krijuar përshtypje se gjyqtarë të caktuar janë paraparë që të emërohen para se të fillojë vetë rekrutimi sipas konkursit.

Një çështje tjetër që meriton që të merret në analizë lidhur me gjykatësit është ngritja profesionale e tyre. Gjykatësve në Kosovë jo se u mungon ekspertiza sa u përket çështjeve të përditshme për të vendosur, por që edhe më tutje vazhdojnë që të mbeten shumë larg të aplikimit të Konventës dhe praktikës së GJNDJ. Ky përfundim i yni nxirret nga ajo se nga pothuajse të gjitha rastet që morëm në shikim për nevojat e këtij punimi, në asnjërin prej vendimeve gjyqësore nuk zë vend analiza dhe bazimi në ndonjërin nga vendimet e GJEDNJ. Kjo aq më tepër kur korniza ligjore, përkatësisht Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar se : *”të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vet vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

7.5.1. Propozime për përmirësim

Procesi i emërimit dhe riemërimit të gjykatësve duhet që në të ardhmen në Kosovë të bëhet pa asnjë ndërhyrje, qoftë nga pjesa e politikës, e qoftë nga grupet e interesit që mund të ekzistojnë jashtë gjyqësorit, apo edhe brenda vet gjyqësorit. Nevoja që procesi të jetë i mbrojtur përgjatë tërë procedurës, është imanente. Në radhë të parë vlerësojmë se, Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet që të bëjë hartimin dhe nxjerrjen e kornizës ligjore lidhur me procedurën e rekrutimit, mënyrën e vlerësimit, dhe dhënien e propozimeve për listën finale të personave të përzgjedhur për tu propozuar për dekretim. KGJK nuk duhet të përsërisë më gabimin e bërë, siç edhe ka ndodhur me rastin e emërimit të gjykatësve në Gjykatën e Apelit në vitin 2014, kur pasi ka përfunduar procedurën e përzgjedhjes ka marrë vendim që të ripërsëris konkursin edhe një here që nga fillimi.

Në gjyqësorin e Kosovës, duhet që sa më parë të hiqen reflektimet e rajonizimeve, kur më shumë shans kanë të emërohen dhe riemërohen gjykatësit që vijnë nga rajonet nga të cilat vijnë edhe anëtarët e Këshillit Gjyqësor. Segmentet e tjera si Zyra e Prokurorit Disiplinor dhe Komisioni Disiplinor pranë KGJK, duhet që të kenë kujdes me rastin e hapjes së procedurave disiplinore për gjykatësit të cilët janë kandidatë konkurrues për tu ngritur në karrierë. Përfundimisht emërimi dhe riemërimi i gjykatësve duhet të bazohet në kritere meritore dhe objektive të cilat duhet që të jenë referenca e secilit vendim lidhur me karrierën profesionale të gjykatësve. Me këtë rast vlerësojmë se është shumë me rëndësi të theksohet roli i Zyrës për Vlerësim dhe Verifikim Gjyqësor. Kjo Zyrë ka rolin kryesor në procesin e riemërimit të gjykatësve sepse është përgjegjëse për zbatimin e drejtë dhe korrekt të vlerësimit profesional dhe verifikimit të gjerë të biografisë së kandidatëve për

pozitat gjyqësore. Ky proces përfshin në vete mbledhje gjithëpërfshirëse të të dhënave në lidhje me njohuritë, aftësitë, performancën e tyre, evidencën penale, të hyrat, si dhe reputacionin që gëzon në vendin ku jeton dhe vepron kandidati. Zyra edhe me tutje funksionon në bazë të një kornize ligjore që ishte nxjerrë me rastin e procesit të riemërimit nga ish KPGJP-ja në vitin 2009. KGJK nuk ka nxjerrë rregullativën për fuqizimin e këtij mekanizmi shumë të rëndësishëm për gjyqësorin. Mandati i kësaj zyre duhet të jetë i përhershëm dhe duhet që të vazhdojë edhe pas riemërimit të gjykatësve. Emërimi i gjykatësve që përfaqësojnë ekspertizën e duhur, në pozitën e duhur, gjithsesi se do të ndikojë në avancimin e procesit të rregullt gjyqësor.

Një çështje shumë me rëndësi për ngritjen e gjyqësorit drejt standardeve të pranuara vlerësojmë se është edhe ajo se në gjyqësorin e Kosovës nevojitet që të bëhet edhe rivlerësimi dhe riemërimi i stafit mbështetës nëpër gjykata. Vetë fakti se me rastin e procesit të riemërimit të gjykatësve vetëm 40 për qind e gjykatësve kanë arritur që të riemërohen, ndërsa 60 për qind janë emëruar gjyqtarë të rinj, e bën të besueshëm atë se një proces i tillë duhet që të përfshijë edhe stafin mbështetës nëpër gjykata. Për këtë, vlerësojmë se duhet që së pari të bëhet ndryshimi i kornizës aktuale ligjore dhe roli dhe përvoja e Zyrës për Vlerësim dhe Verifikim do të ishte një gjë e pa zëvendësueshme.

Lidhur me ngritjen profesionale të gjykatësve, në Kosovë duhet që sa më parë të ndërmerren hapa të cilët do të mundësonin ngritjen e njohurive të gjykatësve lidhur me jurisprudencën e GJNDNJ. Posaçërisht është me shumë rëndësi që të bëhet ngritja e njohurive lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Në këtë pikë, mënyra e hartimit të vendimeve gjyqësore ka mbetur pothuajse ajo e mentalitetit të kaluar. Gjykatësit jo se nuk

kanë njohuri për Konventën, por hezitimi i aplikimit praktik të saj për gjyqësorin në Kosovë, mbetet edhe më tutje “thembër e Akilit”.

Trajnimet për Konventën, Praktikën e GJEDNJ dhe hartimin dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore, mbetën domosdoshmëri për të ardhmen. Kosova pretendon që të bëhet anëtare e Këshillit të Evropës që njëherazi do të i krijojë mundësinë që qytetarët të bëjnë apelimet e tyre në gjykatën e Strasburgut. Ekspertiza e tanishme e gjykatësve të Kosovës në këtë aspekt, jo vetëm që ka reflektime jo të mira në lëmin e procesit të rregullt gjyqësor dhe respektimin e drejtave të njeriut, por edhe do ta gjejë të pa përgatitur Kosovën që të jetë pjesë e këtyre zhvillimeve karshi vendeve të tjera që tashmë janë pjesë e Gjykatës.

Për gjyqësorin e Kosovës dhe procesin e rregullt gjyqësor në përgjithësi, është shumë me rëndësi që të bëhet unifikimi i praktikës gjyqësore. Edhe më tuje në mungesë të kësaj ka ndodhur që për çështje për afërsisht të njëjta të nxirren vendime të ndryshme nga kolegje e të njëjtës gjykatë. Që të evitohet kjo gjë është e nevojshëm që të bëhet ndryshimi i Ligjit për Gjykatat dhe të bëhet nxjerrja e vendimeve të unifikuara nga Kolegjet e Bashkuara qoftë në nivelin e Gjykatës së Apelit, qoftë në nivelin e Gjykatës Supreme të Kosovës. Vendimet e këtyre kolegjeve do të krijojnë siguri juridike dhe do të ndikojnë në vet avancimin procesit të rregullt gjyqësor.

Kosova duhet të ndërmarr hapa, në formimin dhe ngritjen e Shkollës së magistraturës. Kjo, shkollë duhet që të jetë e formuar në atë nivel që do të përfaqësojë ekspertizën e duhur dhe ngritja profesionale që do të marrin në këtë, gjykatësit e ardhshëm, prokurorët dhe avokatët, do të jenë një shtytje e madhe e gjyqësorit drejt arritjeve të standardeve të kërkuara bashkëkohore. Në Kosovë deri më tani, trajnimet për gjykatësit

kanë qenë të organizuara në kuadër të Institutit Gjyqësor të Kosovës, por që ekspertiza e fituar për gjykatësit fillestarë ka qenë e pjesehme, dhe më shumë ka përfaqësuar kriter për emërim se sa marrje ekspertize e kandidatit që të jetë i gatshëm të filloj me punën e gjykatësit. Gjyqësorin e Kosovës në të ardhmen duhet që ta karakterizojë një shkallë e lartë e etikës, duhet të bëhet publikimi i vendimeve gjyqësore, të ngritet në shkallë sa më të lartë niveli i monitorimit dhe llogaridhënies si dhe të punohet në ndërtimin e një mekanizmi të qëndrueshëm dhe profesional në procesin e disiplinimit të gjykatësve. Në Kosovë në të ardhmen kërkohet që krahas ndërtimit dhe forcimit profesional të organeve gjyqësore të bëhet edhe një reformë e thellë e avokatisë.

KAPITULLI VIII: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzione

Procesi i rregullt gjyqësor përbën tërësi të drejtash, lirish dhe garancish, të cilat duhet t'i sigurohen çdo personi i cili përballet me vet procesin gjyqësor. Kjo e drejtë zbatohet në çdo rast kur një subjekti të së drejtës i garantohet një e drejtë, qoftë materiale, qoftë procedurale, nga normat juridike në fuqi dhe nënkupton zhvillimin e gjykimit të mosmarrëveshjes lidhur me këtë të drejtë, sipas një procedure të drejtë. E drejta për proces të rregullt është një e drejtë themelore e të drejtave dhe lirive të njeriut. Kur shkelet kjo e drejtë, njerëz të pafajshëm deklarohen fajtor për kryerjen e krimit, burgosen, madje edhe ekzekutohen. Vetë sistemi i drejtësisë humbet kredibilitetin.

Procesi i rregullt gjyqësor është sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: "Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj". Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor dhe administrativ. Kushtetuta e Republikës së Kosovës të drejtën për proces të rregullt gjyqësor e ka sanksionuar në një varg dispozitash dhe i ka dhënë vendin e merituar si njëra nga të drejtat themeltare të njeriut. Sipas Kushtetutës "Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutën

ose me ligj, si dhe të drejtën për mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”. Për rëndësinë që ka procesi i rregullt, instancë e fundit për ushtrimin e ankesave për pretendimet për shkelje të procesit të rregullt është Gjykata Kushtetuese.

E drejta për proces të rregullt gjyqësor është me rëndësi themelore për gjithë Konventën, pasi ajo ndryshe nga të drejtat e tjera ka natyrë procedurale. Pra, ajo është garanci procedurale. Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore pa diskriminim. Njerëzit janë të barabartë në të drejta, detyra dhe gëzojnë mbrojtje të njëjtë para organeve shtetërore dhe organeve të tjera pa dallim kombësie, etnie, race, gjinie, gjuhe, feje, bindjeje politike apo bindjeje tjetër, arsimi, prejardhjeje sociale, gjendjeje materiale ose veti tjetër personale. Garancia e barazisë në kontekstin e procesit gjyqësor është shumëplanëshe. Ajo ndalon ligjet diskriminuese dhe përfshin të drejtën për qasje të barabartë para gjykatave dhe për trajtim të barabartë nga gjykatat. E drejta për dëgjimin e çështjes nënkupton të drejtën e çdo personi për t’iu drejtuar gjykatës. Aspekti më i rëndësishëm praktik i këtij parimi është **barazia e armëve**, që përfshinë idenë se secila palë në procedurë duhet të ketë mundësi të barabarta për të prezantuar rastin dhe se asnjëra palë nuk duhet të gëzojë ndonjë përparësi substanciale ndaj kundërshtarit të vet.

E drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme duhet të zbatohet në të gjitha kohërat dhe është një e drejtë që përfshihet në nenin 14(1) të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i cili parasheh që “gjatë përcaktimit të çfarëdo akuze ndaj tij, apo të drejtave dhe obligimeve të tij sipas ligjit, secili duhet të ketë të drejtë për një dëgjim të drejtë dhe publik nga një *tribunal i pavarur, kompetent dhe i paanshëm* i themeluar me ligj”. Garancia parësore institucionale për një gjykim të

paanshëm është që vendimet nuk do të merren nga institucionet politike, por nga gjykata e pavarur e paanshme e krijuar me ligj. Roli i gjykatave të pavarura dhe të panshme është një nga elementet themelore të sundimit të ligjit në kuadër të një sistemi juridik. Pavarësia e gjykatës është thelbësore për një gjykim të drejtë. Pavarësia e gjyqtarëve është një nga shtyllat e gjyqësisë së pavarur dhe mendojmë se është me rëndësi të theksohen dy momente. E para ka të bëjë me pavarësinë e tërë sistemit gjyqësor dhe gjyqtarëve nga ndikimet e jashtme dhe e dyta ka të bëjë me pavarësinë e gjyqtarëve brenda vet sistemit.

Seancat gjyqësore duhet që të jenë të hapura për publikun e gjerë. Drejtësia jo vetëm që duhet të bëhet por edhe duhet të shihet se si bëhet dhe publiku ka të drejtë të dijë se si bëhet drejtësia dhe çfarë vendimesh merren. Neni 6 i garanton çdokujt seancë brenda një afati të arsyeshëm. Është një ndër standardet që procesi i rregullt sanksionon në bazë të të cilit qëndron fakti që dhënia e drejtësisë duhet të jepet brenda një kohe sa më të shkurtër të mundshme. Se çka nënkuptohet me gjatësinë e kohës së arsyeshme ndryshon varësisht nga natyra e rastit në procedurë.

Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë për t'u mbrojtur vetë ose përmes përfaqësuesit ligjor. Ai gëzon të drejtën të ndihmohet nga një avokat të cilin e zgjedhë vetë, ose të ketë një avokat që është i caktuar për ta ndihmuar në interes të drejtësisë dhe pa pagesë, nëse ai nuk është në gjendje të përballojë pagesën. Kjo e drejtë, përfshin të drejtën për të qenë i pranishëm gjatë gjykimit, të drejtën për të mbrojtur vetën, të drejtën për ta zgjedhur vet mbrojtësin, të drejtën për të qenë i informuar mbi të drejtën për mbrojtës dhe të drejtën për të marrë ndihmë ligjore pa pagesë.

Parimi i prezumimit të pafajësisë përbën gjithashtu një element të rëndësishëm të të drejtës për proces të rregullt gjyqësor. Secili i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të prezumohet i pafajshëm dhe duhet të trajtohet si i pafajshëm deri, dhe vetëm atëherë, kur në bazë të ligjit dhe në gjykim të drejtë, provohet se ai, ose ajo është fajtor. Kjo është e rëndësishme të respektohet edhe nga autoritetet e tjera publike si dhe mediat. Zyrtarët publikë, në veçanti prokurorët dhe policia nuk duhet që të bëjnë deklarata rreth fajësisë apo pafajësisë së një të akuzuari përpara përfundimit të gjykimit. Është obligim i autoriteteve që të disiplinojnë median apo grupet e tjera të fuqishme shoqërore që të mos ndikojnë në rezultatin e një çështje e cila është në zhvillim në procedurat gjyqësore.

Secili ka të drejtë për mbrojtjen e barabartë të të drejtave të veta në çdo procedurë dhe kjo nënkupton të drejtën e secilit që të parashtrojë ankesë ose mjete tjera juridike kundër akteve të veçanta juridike të nxjerra në procedurën në shkallë të parë para gjykatës, organit të administratës ose organizatës dhe institucioneve të tjera që ushtrojnë autorizime publike. Shfrytëzimi i mjetit juridik është një mundësi e mirë që edhe njëherë autoritetet publike shtetërore t'i shqyrtojnë vendimet e tyre, t'i përmirësojnë gabimet ose lëshimet eventuale, që kanë mundur të ndoshin gjatë procedurave të ndryshme. Kjo e mundëson edhe parandalimin e padrejtësive, shpërdorimin e pushtetit, ofron vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj dhe e garanton parimin e sundimit të ligjit.

Procesin e rregullt gjyqësor në Kosovë gjatë administrimit të Misionit të UNMIK-ut e karakterizuan shumë faktorë. Gjatë këtij misioni në sistemin gjyqësor të Kosovës ishin të angazhuar edhe gjykatësit ndërkombëtarë të cilët vinin nga vende të ndryshme dhe me përvoja të ndryshme në zgjidhjen e rasteve. Gjatë këtij misioni në Kosovën Veriore funksionuan edhe gjykatat paralele të cilat i financonte shteti i Serbisë, kurse në shumë

qytete të këtij shteti funksionuan gjykata të cilat në vendimet e tyre thirreshin se janë gjykata nga Kosova. UNMIK erdhi pa kornizë të qartë ligjore në Kosovë. Në fazën fillestare korniza ligjore ndërtohej në formë të rregulloreve të UNMIK, ligjeve ekzistuese të Kosovës para marsit 89, dhe ato të pas marsit 89 në vendet ku paraqiteshin vakume juridike dhe konventave ndërkombëtare.

Ligjet e aplikueshme në Kosovë para 22 marsit 2009 dhe pas marsit 1989 paraqitesin një problem të veçantë në punën e sistemit gjyqësor, me këtë edhe të vetë procesit të rregullt gjyqësor. Ligjet e pas marsit 1989 për popullatën e shumicës në Kosovë janë parë si ligje qëmbartnin stigmën e kohës së diktatorit Milosheviq. Dispozita të tilla janë parë me rezervë nga vetë gjyqtarët. Përfshirja e gjyqtarëve ndërkombëtarë gjatë kohës së UNMIK-ut u përcoll me mangësi të mëdha. Ata nuk punuan si staf i gjykatës në të cilën punonin, por si staf extra gjyqësor dhe i përgjigjeshin jo gjykatës ku punonin, por vetë UNMIK-ut. Ata gëzonin imunitet nga ligjet e Kosovës, emëroheshin nga PSSP dhe në këtë mënyrë shiheshin si ndikim i degës ekzekutive në pavarësinë e gjyqësorit.

Gjatë administrimit të UNMIK në Kosovë u lejua që në lëmin e gjyqësisë të paraqiten paralelizma. Gjykatat e Serbisë i kanë shqyrtuar rastet të cilat ishin kompetencë territoriale e Kosovës dhe përfshinin pjestarët e nacionalitetit serb të Kosovës. Këto gjykata vepronin si gjykata të shkallës së parë, kurse vendimet e tyre apeloreshin në gjykatat e Serbisë. Vendimet e këtyre gjykatave nuk njiheshin nga gjykatat e tjera të Kosovës. Ky paralelizëm ishte i dëmshëm për palët pasi ata detyroheshin të zhvillonin procedura të dyfishta në gjykatat e Kosovës dhe gjykatat paralele serbe. Ndër çështjet më të rëndësishme në lëmin e të drejtave të njeriut dhe procesit të rregullt gjyqësor janë Paraburgimi nga ana e KFOR-it të njohura si “Mbajtjet “ COMKFOR si dhe zgjatja e

paraburgimit në bazë të të ashtuquajturave *Urdhëra ekzekutiv* të PSSP-së. Këto dy forma të paraburgimit konsiderohen se bënë pa bazë ligjore dhe përbënin shkelje të konventave ndërkombëtare e poashtu paraqisnin edhe forma të cënimit të pavarësisë së gjyqësorit. Ndryshe mund të konsiderohen si ndërhyrje të ekzekutivit ndërkaq ekzistonte edhe forma tjetër që është ndërhyrja e legjislativit në pavarësinë e gjyqësorit.

Misioni i EULEX-it filloi misionin e tij në rrethana tejet më të favorshme se sa ai i UNMIK-ut. Misioni që tanimë kishte bekimin e një organizimi tjetër, atij të BE-së gjeti pothuajse një infrastrukturë të gatshme ligjore, të logjistikës dhe kapaciteteve njerëzore. Por, EULEX trashëgoi problematikën e madhe që la pas misioni i UNMIK-ut, siç ishin shumësia e lëndëve të pa proceduara e që binin në kompetencën e këtij misioni, shumë raste të filluara, por të pa përfunduara në të gjitha instancat gjyqësore, fillimin me vonesë të reformës në gjyqësor, ekzistimi edhe më tutje Gjykatave paralele dhe mosfunksionimi i gjyqësorit në Mitrovicën Veriore etj. Përveç kësaj gjyqësori si edhe në kohën e UNMIK-ut vazhdoi që të punonte në raste të natyrës së rëndë, por që gjyqtarët nuk i përgjigjeshin gjykatës ku punonin por misionit ndërkombëtarë nga i cili ishin emëruar.

Caktimi i paraburgimit si masa më e rëndë që siguronte praninë e të pandehurit në procedurë, bëhej duke mos arsyetuar shkaqet e mos caktimit të masave të tjera alternative që ishin arresti shtëpiak, lajmërimi në stacionin policor, dorëzania e masa të tjera të parashikuara me Kodin e Procedurës Penale. Arsyetime pothuajse të shablonizuara përdoreshin edhe me rastin e vazhdimit të masës së paraburgimit. Procesi i rregullt gjyqësor kërkon që prokurorët të kërkojnë caktimin e paraburgimit vetëm kur ligji dhe rrethanat specifike të rastit e kërkojnë aplikimin e kësaj mase kufizuese dhe këto kërkesa të përmbajnë arsyet relevante dhe të mjaftueshme për një gjë të tillë. Gjithashtu procesi i

rregullt gjyqësor do të respektohej në këto çështje, vetëm atëhere kur gjyqtarët do të caktojnë paraburgimin kur rrethanat e rastit e kërkojnë një masë të tillë kufizuese dhe gjyqtarët japin arsye relevante të mjaftueshme në të gjitha vendimet për caktimin e paraburgimit në përputhje me ligjin vendor dhe ndërkombëtar. Në veçanti gjyqtarët duhet që të citojnë faktet relevante, rrethanat e veçanta faktike që bëjnë që paraburgimi të caktohet dhe nëvendimet e tyre lidhur me paraburgimin duhet të sqarojnë se përse masat e tjera alternative ndaj paraburgimit janë të pamjaftueshme.

E drejta që i dyshuari të ketë mbrojtësin e tij, në përgjithësi është respektuar në proceset gjyqësore në Kosovë. Megjithatë aplikimi i mbrojtjes në praktikat gjyqësore në shumë raste ka shfaqur edhe anën e errët të medaljes. Në një numër rastesh të pandehurve nuk u është ofruar mbrojtje adekuate.

Qëndrimi i të pandehurve në paraburgim në pritje të gjyqimit përbënte një problem në vete si gjatë kohës së misionit të UNMIK-ut e po kështu vazhdoi që të jetë problematike edhe gjatë kohës së misionit të EULEX. Qëndrimet e gjata në pritje të gjyqimit vinin si pasojë e numrit të pamjaftueshëm të gjykatësve në krahasim me numrin gjithnjë në rritje të lëndëve gjyqësore, pastaj menaxhimi jo i mirë i rasteve gjyqësore, menaxhimi jo i mirë i administrimit të gjyqësisë, mungesa e llogaridhënies së mjaftueshme nga bartësit e funksioneve të administrimit të drejtësisë, mungesa e profesionalizmit nga ana e inspeksionit gjyqësor etj.

Vonesa në hartimin me shkrim dhe dorëzimin e vendimit gjyqësor kishte për pasojë vënien në pozitë të vështirë të akuzuarit dhe mbrojtjen, sepse vononte që ata të ndërmarrin veprimet lidhur me mjetet e ankimimit dhe vështirësonte të drejtën për qasje në mjetet

gjqësore efektive. Raste të mosnxjerrjes së vendimit gjyqësor edhe pse ka përfunduar procedura janë hasur edhe tek çështjet e natyrës urgjente. Sipas sistemit ligjor në Kosovë kontestet nga marëdhënia e punës kanë përfaqësuar raste të natyrës urgjente. Në praktikë ka pasur raste kur edhe pse është bërë përfundimi i procedurës, nuk është bërë shpallja e vendimit dhe hartimi me shkrim i të njëjtit. Vonesat në hartimin e vendimeve gjyqësore apo mos hartimi i tyre me shkrim kanë patur ndikimin e tyre edhe në vonimin e parashtruesit të padisë apo palëve në kontest në arritjen e shpejtë të drejtësisë.

Procedura për dhënien e Urdhërit Ndëshkimor pa dëgjim para gjykatës sigurisht që ka rëndësinë e vet në efikasitetin e punës në gjyqësor dhe në ekonomizimin e procedurës penale, por vlerësojmë se aplikimi në praktikë i kësaj procedure përbën shkelje të të drejtave të të pandehurve të cilët në pamundësi të paraqitjes së mbrojtjes vihen në situatë jo të favorshme përballë palës tjetër që është prokurori i shtetit, e që është në kundërshtim me njërin nga parimet shumë të rëndësishme të procesit të rregullt gjyqësor- parimin e barazisë së armëve. Gjithashtu nxjerrja e vendimit në procedurën e konfirmimit të aktakuzës pa pjesëmarrjen e palëve në një proces të udhëhequr komponenta e gjykatësve të EULEX lidhur me krimet e luftës dhe peshën që kishte ky rast gjyqësor në opinionin e Kosovës, jo vetëm që paraqet shkelje të parimit të barazisë së armëve, por edhe cënim tejet të rëndë të procesit të rregullt gjyqësor.

Mbrojtja e dëshmitarëve ka qenë dhe mbetet një nga sfidat kryesore për autoritetet e drejtësisë në Kosovës. Autoritetet publike kanë për detyrë të mbrojnë dëshmitarët dhe të afërmit e tyre të ngushtë para gjatë dhe pas gjykimit. Mbrojtja efektive e dëshmitarëve është vendimtare për funksionimin e sistemit ligjor. Mirëfunksionimi i sistemit ligjor krijon mundësi edhe për procesin e rregullt gjyqësor, për të cilin mendojmë se roli i dëshmitarëve

është i pazevendësueshëm në arritjen e një drejtësie të mirëfilltë. Menaxhimi jo i mirë i rasteve gjyqësore ka ndikimin e tij në procesin e rregullt gjyqësor. Një menaxhim jo i mirë shkakton vonesa në arritjen e drejtësisë. Vonesa në arritjen e drejtësisë bie ndesh me parimin e procesit të rregullt, i cili kërkon që ky proces të bëhet brenda një kohe të arsyeshme.

Ballafaqimi i gjyqësorit me një mori sfidash komplekse dhe serioze kanë bërë që gjyqësori të jetë nën tryzni të jashtzakonshme. Numri i madh i lëndëve, krimi i organizuar i rrënjosur, kontestet pronësore të ndërlikuara, trashëgimi i një ndikimi të fuqishëm të ekzekutivit, krimet ndëretnike, pretendimet për korrupsion, ngarkesat me rastet e krimeve të luftës dhe infrastruktura e dobët janë disa nga sfidat që shoqëruan gjyqësorin e që kanë të bëjnë në mënyrë direkte me pavarësinë e tij.

Korrupsioni dhe nepotizmi, ndërhyrja e vazhdueshme politike në nivele dhe forma të ndryshme rastesh përfshirë këtu edhe punën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës përbën shqetësim serioz. Ndërhyrjet nga politika kanë shfaqur tendencën e tyre që të bëhët debatimi në Parlament për raste të caktuara gjyqësore që ishin në zhvillim e sipër ose që kanë përfunduar, si dhe tendencat që të diskutoheshin vendimet gjyqësore. Ndërhyrjet në gjyqësor janë shfaqur edhe në atë se gjyqësori në Kosovë nuk ka linjë buxhetore të veçantë dhe me këtë rast edhe nuk ka pasur mundësinë e rritjes së stafit mbështetës për gjykatat, domosdo ka edhe ndikimin e tij në procesin e rregullt gjyqësor. Ndërhyrjet janë vërejtur edhe në rastet ku si palë e paditur janë paraqitur institucionet e shtetit dhe të cilat raste kishin implikime buxhetore. Në këto raste kishte cënim të rëndë të barazisë së palëve dhe të drejtave të tyre në procedurë si dhe në vetë pavarësinë e gjykatës. Ligji për menaxhimin e financave publike në këto raste kërkonte që gjykata të bëjë ndërprerjen e procedurës në afat

prej 180 ditësh gjë që shkaktonte vonesa të shumta në drejtim të arritjes së shpejtë të drejtësisë.

Përdorimi i mediave për qëllime gjyqësore dhe ndërhyrja në punën e gjykatës, ka shënuar raste të shumta në Kosovë në këtë kohë. Gjykatësit të cilët kanë qenë të involvuar në rastet gjyqësore të cilat kanë cënuar interesa të grupeve të caktuara të interesit shpeshherë në media të shkruara dhe elektronike janë etiketuar dhe është bërë përpjekje që të paraqiten si jo kredibël e jo denjë për të ushtruar detyrën e gjykatësit.

Shqyrtimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut si gjatë Misionit të UNMIK e poashtu edhe gjatë Misionit të EULEX është bërë jashtë institucioneve gjyqësore. Paneli për shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut nuk paraqet mbrojtje adekuate të këtyre të drejtave. Llogaridhënia para të njëjtit Mision nuk mund të konsiderohet pavarësi dhe pa ndikueshmëri nga vetë strukturat e këtij Misioni. Paneli ka patur vetëm mundësi që të bëjëpërfshirjen e shkeljeve të gjetura në një vendim, i cili përfshinte rekomandime jo detyruese për shefin e Misionit. Viktimat objekt tëkëtyre shkeljeve asnjëherë nuk janë kompensuar.

Shkalla e gabimit gjyqësor në periudhën gjatë Misionit të EULEX ka qenë tejet e lartë. Gjatë periudhës 2008-20014 janë evidentuar rreth 602 raste të burgimit të padrejtë gjë që paraqet një shkallë mjaft të lartë të dështimit të procesit të rregullt gjyqësor kur në një vit kalendarik nuk ka qenë më e vogël se 100 raste. Në rastet e kompensimit të burgimit të padrejtë janë përdorur standarde të dyfishta ku në disa raste si palë e paditur është paraqitur Këshilli Gjyqësor i Kosovës, kurse në disa raste të tjera ky institucion ka shfaqur pretendimin se nuk posedon legjitimitetin procedural që të marr pjesë në procedurë. Për palët dhe gjykatat kjo gjë ka shfaqur pasiguri juridike dhe ka patur impakt negativ në

procesin e rregullt. Në Kosovë në këtë kohë as që mund të bëhet fjalë për kthimin në detyrë në rastet e pushimit të çështjes apo të fitimit të pafajësisë. Paditë e kësaj natyre për rikthim në detyrë janë hedhur poshtë apo refuzuar nga ana e gjykatave civile për shkak të lëshimit të afatit kohor për ngritje të padisë, i cili afat është prekluziv dhe shumë i shkurtër për personat të cilët ballafaqoheshin me çështje të rënda penale. Vlerësojmë se në të ardhmen Kosova duhet të ketë ligj të veçantë që do të saktësoj legjitimitetin se kush do të duhej që të paraqitet si palë e paditur në rastet lidhur me kompensimin e dëmit të personave të dënuar ose arrestuar pa arsye dhe personave në rast të heqjes së lirisë pa bazë, pastaj duhet që të jenë të qartësuar kriteret lidhur me kompensimin e këtyre personave, si dhe do të duhej të sanksionohej me ligj çështja e kthimit në detyrë ose në vendin e punës pas fitimit të pafajësisë në procedurën penale.

Procesi i rregullt ligjor nuk është thjeshtë vetëm një e drejtë. Ai sot trajtohet më shumë si një parim kushtetues që shtrihet ndaj disa të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ai ka si funksion dhe qëllim mbrojtjen e individit nga ndërhyrjet e paligjshme të autoriteteve publike. Kontrolli që e ushtron gjykata kushtetuese, kur individi pretendon cënimin e këtij parimi, i cili shfaqet edhe në formën e një të drejte themelore në vetvete, bëhet i mundur nëpërmjet ankimit individual kushtetues. Ankimi kushtetues është konceptuar si siguri ndihmëse ose plotësuese (subsidiare) krahas mjeteve të tjera ligjore, për këtë arsye ai mund të ushtrohet vetëm pasi të jenë shterruar të gjitha mjetet e parashikuara me ligj për të fituar një të drejtë. Gjykata Kushtetuese ka instaluar praktikën e kthimit në rigjykim të çështjeve tek gjyqësori i zakonshëm dhe ka urdhëruar që gjykata e rregullt të veprojë në mënyrë të caktuar në lidhje me meritumin e vendimit si dhe procedurën e gjykimit të saj. Kjo praktikë nuk ka qenë e njohur me parë në Kosovë dhe ka

bërë që me rastin e vlerësimit kushtetues të vendimeve të gjykatave të shfaqen përplasje kompetencash ndërmjet dy gjykatave më të larta në vend, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme të Kosovës. Përplasjet në mes të dy gjykatave më të larta në vend dhe qasjet e ndryshme për të njëjtën çështje kanë krijuar paqartësi dhe për një moment është krijuar përshtypja se ekzistojnë dy lloje të drejtësisë në të njëjtin sistem juridik në Kosovë. Çështja e urdhërimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese për gjykatat e rregullta *që të vendoset në pajtim me vendimin e vet Gjykatës Kushtetuese* sikur e humb rëndësinë e të mbajturit të sërishëm të procesit gjyqësor në gjykatën më të ulët. Nga praktika është parë se kjo ka reflektuar në paragjykim të rastit dhe në njëfarë mënyre ka pasur ndikim edhe në vet procesin e rregullt ligjor.

Në Kosovë, çështja e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nuk ka kaluar pa problematika. Nuk ka organ të posaçëm që merret me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Publikimi i vendimit për mosekzekutim nga ana e kësaj gjykate nuk ka pasur as efektin më të vogël në përshpejtimin e ekzekutimit të vendimit. Në Kosovë gjatë kësaj kohe, Konventa ka aplikim të gjerë dhe është e pranuar në shumë nene të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndërkaq për shkak se Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës, shtetasit e Kosovës nuk gëzojnë mbrojtjen gjyqësore që e ofron juridiksioni i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gëzimi i mbrojtjes gjyqësore para GJEDNJ do të ndikonte që institucionet e Kosovës të rrisin përgjegjësitë që të përmbushin standardet e pranuar të vendeve të përparuara dhe kjo do të ndikonte në përmirësimin e ambientit aktual të respektimit të të drejtave të njeriut e me këtë edhe vetë procesit të rregullt brenda Kosovës.

Gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të manjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Parimi i paanshmërisë në gjykim edhe në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, pra edhe në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë. Arsyeimi i Gjykatës Supreme se për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve nuk mund të respektohet çështja e mospjesmarrjes së të njëjtit gjyqtar në shkallë të ndryshme gjyqësore, përbën cënim të procesit të rregullt gjyqësor. Çështjet organizative nuk mundën që të shërbejnë si arsyetim për mosrespektim të Kushtetutës. Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast në shoqërinë demokratike jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar i thjeshtë, si garancia më e lartë se të drejtat e secilit në proceset gjyqësore do të respektohen maksimalisht.

Çështja e imunitetit të gjykatësve në Kosovë duhet të qartësohet. Mekanizmat ligjorë lidhur me imunitetin duhet të plotësohen duke përcaktuar kohëzgjatjen e imunitetit, mënyrën e heqjes së tij dhe organin që duhet të vendos për heqjen e imunitetit. Gjithashtu, duhet që të vendosen dhe qartësohen mekanizmat mbrojtës në rast të cënimit të imunitetit. Në rast të paqartësisë së imunitetit gjykatësit ndjehen të pa mbrojtur në pikëpamje proceduralo-penale. Kjo çështje ka impaktet e saj në procesin e rregullt. Praktika në Kosovë ka treguar se individët kanë keqpërdorur me të madhe çështjen e ekzistimit të veprës penale “nxjerrja e vendimeve gjyqësore të kundërligjshme”. Kjo vepër penale duhet të gjejë riformulimin e saj sa më shpejt që është e mundur dhe të bëhet rishikimi i Kodit Penal në këtë pjesë në mënyrë që në kushtet e ekzistimit të saj në mënyrë të saktë të qartësohet se në cilat raste gjykatësit do të duhej ti nështroheshin këtij sanksionimi ligjor. Meqë edhe janë

vërejtur mangësi të mëdha në punën e organit të akuzës lidhur me këto çështje atëhere mendojmë se kjo veper penale do të duhej që të gjejë zbatim edhe në sanksionimin e punës së prokurorëve, të cilët, pastaj me siguri do të shfaqnin kujdes më të madh karshi rasteve, të cilat do të implikonin gjykatësit dhe ku do të cënohej imuniteti i tyre. Vlerësojmë se të gjitha këto që u thanë më lartë, imunitetin e gjykatësve në Kosovë e bejnë të nevojshëm të ekzistojë nën kushtet e qartësimit të tij kushtetues dhe ligjor dhe shtrojnë nevojën e respektimit të tij. Imuniteti në asnjë mënyrë nuk duhet që të anashkalohet nga të tjerët, por nuk duhet që t'i mbrojë për veprimet jo të mira edhe vetë gjykatësit.

Ndonëse në shumë vendime të saj Gjykata Kushtetuese ka theksuar faktin se ajo nuk është gjykatë e “shkallës së katërt” dhe “nuk gëzon jurisdiksionin e apelit”, prapëseprapë kjo gjykatë nuk ka arritur që të mbajë këtë vijë dhe të ruaj “kujdesshmërinë e skajshme”, që të mos interferojë në vendimet e gjykatave të rregullta, dhe vendimet e saj të mos kuptohen në publikun e gjerë si gjykatë e instancës së katërt. Ndërhyrja e kësaj gjykate në punën e gjyqësorit të zakonshëm në rastin gjyqësor që kishte të bëjë me një kryetar komune, apo ndërhyrjet që ka bërë në procesin e zgjedhjes së Prokurorit të Shtetit, kanë cënuar rëndë procesin e rregullt gjyqësor. Gjykata Kushtetuese gjithashtu gjatë kësaj kohe në disa raste ka reflektuar mungesë profesionalizmi. Në rastin gjyqësor KI 186/14 Gjykata nuk ka trajtuar kërkesën e parashtruesit në tërësinë e saj sepse, pretendimet kryesore për shkeljen e të drejtave të parashtruesit për një proces të rregullt ligjor nuk janë shqyrtuar fare nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Mbi bazën e tërë asaj që është thënë dhe prezantuar si më lartë vjen në mënyrë të padiskutueshme argumentimi i hipotezës së parë se në kohën përgjatë dy misionëve ndërkombëtare nuk është respektuar në mënyrë adekuate neni 6 i Konventës, i cili

pjesmarrësve në proceset gjyqësore u garanton të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor, e gjithashtu bindshëm argumentohet edhe hipoteza tjetër se në Kosovë ekziston minimumi i nevojshëm i garancive ligjore për një proces të rregullt gjyqësor, ndërsa nuk ekzistojnë garancitë institucionale për këtë proces shumë të rëndësishëm nga Liritë dhe të Drejtat Themelore të Njeriut.

Rekomandime shtesë:

Përveç atyre që janë theksuar tek Propozimet për për përmirësim, që të bëhët garantimi i procesit të rregullt gjyqësor në gjyqësorin e Kosovës, rekomandojmë edhe që:

Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës:

- KGJK duhet që të ndërmarr masa që të vazhdohet me procesin e reformimit të gjyqësorit;
- Të bëhët shtimi i numrit të gjykatësve dhe stafit ndihmës të kualifikuar, bazuar në numrin e rasteve gjyqësore dhe të bëhët zvogëlimi në minimum i kohës në pritje të gjykimit;
- Të nxirret korniza ligjore dhe të bëhet fuqizimi i Zyrës për Verifikim dhe Vlerësim të gjyqtarëve, në mënyrë që të emërohen apo ngriten në detyrë ata që kanë performancën më të mirë;
- Të eliminohen vonesat në hartimin dhe dërgimin e vendimeve gjyqësore;
- Të ngritet përgjegjësia dhe ndërtohen mekanizma shtesë në menaxhimin më të mirë të lëndëve gjyqësore, si nga ana e gjykatësve e poashtu edhe nga personeli administrativ i gjykatës;

- Shqyrtimi i shkeljeve jashtë institucioneve gjyqësore të hiqet dhe sa i përket gjykatësve të EULEX dhe këta të vëhën nën përgjegjësinë e Gjykatës ku punojnë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në këto raste të krijohen edhe mekanizmat për disiplinim dhe kompensim në rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut;
- Të ndërmerret masa në mënyrë që të ndalohet praktika e marrjes pjesë, nga po i njëjti gjykatës në rastin e njëjtë, nëpër shkallët e ndryshme të gjyqësorit;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës të avancojë kornizën ligjore lidhur me procesin e përzgjedhjes, emërimit dhe avancimit në detyrë të gjykatësve;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës ndërmerret masat e duhura që të organizohen trajnime më të mëdha në numër, vizita studimore, punëtori etj, me qëllim që të bëhet ngritja profesionale e gjykatësve në drejtim të njohjes dhe aplikimit të Konventës si dhe njohjes dhe bazimit të vendimeve gjyqësore në Praktikën e GJEDNJ;
- Gjyqësorin e Kosovës në të ardhmen duhet që ta karakterizojë një shkallë e lartë e etikës, duhet të bëhet publikimi i vendimeve gjyqësore, të ngritet në shkallë sa më të lartë niveli i monitorimit dhe llogaridhënies si dhe të punohet në ndërtimin e një mekanizmi të qëndrueshëm dhe profesional në procesin e disiplinimit të gjykatësve;

Për Kuvendin e Kosovës dhe Ministrinë e Drejtësisë:

- Të bëhen ndryshime në Kushtetutën e Kosovës dhe të sanksionohet që numri më i madh i anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të mos zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës, por nga vetë gjykatësit;

- Të bëhen ndryshime në Kushtetutën e Kosovës në mënyrë që të qartësohet çështja e imunitetit të gjykatësve, kohëzgjatja e këtij imuniteti, mënyra e heqjes së imunitetit etj;
- Të bëhen ndryshime të Ligjit aktual për Gjykatat dhe të mundësohet hapja e degëve të gjykatave në nivel Apeli edhe nëpër qendrat e tjera të Kosovës, rastet gjyqësore do të trajtoheshin në mënyrë shumë më të shpejtë dhe në kohë sa më të arsyeshme;
- Të sponsorohet dhe nxirret ligj i veçantë me të cilin do të sanksionohet formimi dhe mënyra e funksionimit të Gjykatës Administrative;
- Të sponsorohet dhe nxirret ligj i veçantë lidhur me burgimin e padrejtë;
- Në Ligjin lidhur me burgimin e padrejtë, të sanksionohet “kthimi automatikisht në detyrë”, në rast të fitimit të pafajësisë, refuzimit të akuzës apo në rastet e parashkrimit në procedurën penale;
- Në Ligjin lidhur me burgimin e padrejtë të qartësohet se kush duhet të paraqitet si palë e paditur, në rastet e kompensimit për burgimin e padrejtë, apo arrestimit të paligjshëm;
- Të bëhen ndryshime në Kodin Penal, në mënyrë që të hiqet (fshihet) Urdhri Ndëshkimor (pa dëgjim para gjykatës), në mënyrë që palëve t’u mundësohet dëgjimi në gjykatë, para se të nxirret vendimi gjyqësor;
- Të ndryshohet Kodi Penal dhe Neni 432 [Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore], të vlejë edhe për prokurorët, në mënyrë që të sanksionohet edhe “Ngritja e kundërligjshme e aktve akuzuese”;

- Të bëhen ndryshime ligjore në Ligjin për Buxhetin, ose Ligjin për Gjykatat, ashtu që akordohet buxhet për gjyqësorin pa pasë të drejtë ndërhyrje nga ana e ekzekutivit. Kjo gjë të bëhet ngjashëm me buxhetin e Gjykatës Kushtetuese.

Për Këshillin Prokurorial të Kosovës:

- Kërkesat e prokurorëve lidhur me paraburgimin por edhe masat tjera të kufizimit të lirisë së të pandehurve, të jenë të mirëarsyetuara;
- Të reduktohet kërkimi nga prokurorët i masës së paraburgimit, vetëm në rastet kur këtë e kërkojnë rrethanat e rastit. Prokurorët të kenë fokusimin edhe ne masat alternative si arresti shtëpiak, paraqitja ne stacionin policor etj;

Për Qeverinë e Kosovës:

- Të ndahen mjete buxhetore dhe të ndërmerren masa lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve dhe familjeve të tyre;
- Qeveria të shmang nga fjalori i saj mënyrën e punës së gjyqësorit dhe rasteve që janë vendosur, apo që janë në procedurë të të vendosurit;
- Të rrisë buxhetin për Institutin e ndihmës juridike falas dhe këto zyra përveç qendrave kryesore të shtrihen edhe nëpër Komunitet të tjera të Kosovës;

Për Odën e Avokatëve të Kosovës:

- Oda e Avokatëve të Kosovës të ndërmarrë masat e duhura që të organizohen trajnime më të mëdha në numër, vizita studimore, punëtori etj, me qëllim që të bëhet ngritja profesionale e avokatëve në drejtim të njohjes dhe aplikimit të Konventës si dhe njohjes dhe bazimit të parashtrimeve dhe rekurseve në Praktikën e GJEDNJ;
- Oda e Avokatëve të ngrisë shkallën e përgjegjësisë dhe të bëjë sanksionimin e avokatëve, në rast të mos përfaqësimit adekuat, në rastet e angazhimit sipas detyrës zyrtare;
- Në Kosovë në të ardhmen kërkohet që krahas ndërtimit dhe forcimit profesional të organeve gjyqësore të bëhet edhe një reformë e thellë e avokatisë.

Për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës:

- Gjykata Kushtetuese të përmbahet që të mos bëjë shqyrtimin e rasteve për të cilat ende nuk janë shterur mjetet para gjyqësorit të zakonshëm;
- Roli i Gjykatës Kushtetuese duhet që të jetë analog me atë të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut: nuk vepron si gjykatë e “instancës së katërt” dhe nuk zevendëson interpretimet e saj ligjore me ato të gjykatave të zakonshme;
- Gjykata Kushtetuese duhet kufizuar vetëm në atë nëse ”gjykata e instancës më të ulët ka respektuar të drejtat kushtetuese të parashtruesve të kërkesave, siç është e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës).

SHTOJCA

Shtojca 1:



***PYETËSOR LIDHUR MË HULUMTIMIN E ZHVILLUAR NË GJYKATËN THEMELORE
NË PRISHTINË***

I nderuar,

Faleminderit që keni pranuar që të merrni pjesë në hulumtim.

*Hulumtimi zhvillohet në kuadër të punës kërkimore lidhur me Punimin doktorat me titull
“ Procesi i rregullt gjyqësor në Kosovë përgjatë dy misionëve ndërkombëtare “, të
kandidatit Rafet Haxhaj .*

Ju mund të identifikoheni me emër, por edhe mund të mos e bëni një gjë të tillë.

Iu lutem përgjigjuni pyetjeve si më poshtë:

- 1. Çka mendoni për pozitën e gjyqtarëve në Kosovë?*
- 2. Çka mendoni për imunitetin e gjyqtarëve?*
- 3. A mendoni se pagat e gjyqtarëve janë të barabarta me pagat e zyrtarëve të lartë
në dy pushtetet e tjera?*
- 4. Çka mendoni për normën e caktuar që keni?*
- 5. A mendoni se jeni të ngarkuar me numër të madh të lëndëve gjyqësore?*
- 6. Si mendoni të tejkalohet kjo gjendje e tanishme?*

7. *A mendoni se mbrojtësit/përfaqësuesit në proceduar gjyqësore u japin ndihmën e mjaftueshme palëve në procedurë. Nëse mendoni se mbrojtja u ofrohet palëve në mënyrë jo të mjaftueshme , ju lutem përmendni së paku një rast nga praktike e juaj.*
8. *Nga praktika e juaj e deritanishme a mendoni se palëve u është shkelur e drejta për gjykim të drejtë. Nëse po në cilat raste ?*
9. *Po të ishit në organin vendimmarrës, çka do të propozonit të ndryshonit në gjyqësor apo në gjykatën tuaj ?*

Prishtinë, nëntor 2013

Emri i të intervistuarit

Shtojca 2:



PYETËSOR LIDHUR MË HULUMTIMIN E ZHVILLUAR NË GJYKATËN E APELIT NË PRISHTINË

I nderuar,

Faleminderit që keni pranuar që të merrni pjesë në hulumtim.

Hulumtimi zhvillohet në kuadër të punës kërkimore lidhur me Punimin doktorat me titull “ Procesi i rregullt gjyqësor në Kosovë përgjatë dy misionëve ndërkombëtare “, të kandidatit Rafet Haxhaj .

Ju mund të identifikoheni me emër, por edhe mund të mos e bëni një gjë të tillë.

Iu lutem përgjigjuni pyetjeve si më poshtë:

- 1. Çka mendoni për rastet e paraburgimit në pritje të gjykimit , sa është numri i tyre në gjykatat e Kosovës dhe cili është ndikimi i kësaj në procesin e rregullt gjyqësor në Kosovë?*
- 2. A mendoni se mbrojtësit/përfaqësuesit në proceduar gjyqësore u japin ndihmën e mjaftueshme palëve në procedurë. Nëse mendoni se mbrojtja u ofrohet palëve dobët përmendni disa nga arsyet se përse behet një gjë e tillë?*
- 3. Nga praktika e juaj e deritanishme a mendoni se palëve u është shkelë e drejta për gjykim të drejtë. Nëse po në cilat raste?*
- 4. Po të ishit në organin vendimmarrës çka do të propozonit të ndryshonit në gjyqësor apo në gjykatën tuaj lidhur me gjykimin e drejtë?*

Prishtinë, nëntor 2013

Emri i të intervistuarit

Shtojca 3:



PYETËSOR LIDHUR MË HULUMTIMIN E ZHVILLUAR ME AVOKATËT NË PRISHTINË

I nderuar,

Faleminderit që keni pranuar që të merrni pjesë në hulumtim. Hulumtimi zhvillohet në kuadër të punës kërkimore lidhur me Punimin doktorat me titull “Procesi i rregullt gjyqësor në Kosovë përgjatë dy misionëve ndërkombëtare”, të kandidatit Rafet Haxhaj. Hulumtimi përfshin punën e institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare. Ju mund të identifikoheni me emër, por edhe mund të mos e bëni një gjë të tillë.

Iu lutem përgjigjuni pyetjeve si më poshtë:

- 1. Çka mendoni për procesin e rregullt gjyqësor gjatë Misionit të EULEX?*
- 2. Çka mendoni për caktimin dhe aplikimin e masës së paraburgimit duke përfshirë edhe kërkesat për caktim të paraburgimit dhe nivelin (cilësinë) e seancave të dëgjimit ?*
- 3. Çka mendoni për nivelin e ofrimit të mbrojtjes nga ana e avokatëve?*
- 4. Çka mendoni për kohëzgjatjen e paraburgimit në pritje të gjyqimit?*
- 5. Çka mendoni për vonesat në hartimin dhe dërgimin e aktgjykimeve?*
- 6. Çka mendoni për vazhdimin e ekzistimit të gjykatave paralele në Kosovë?*
- 7. Çka mendoni për dështimi në mbrojtjen e dëshmitarëve?*
- 8. Çka mendoni për menaxhimin e dobët i lëndëve gjyqësore nga ana e gjykatës?*

- 9. Çka mendoni për procesin e riemërimit dhe transferimit të gjykatësve?**
- 10. Çka mendoni për pavarësinë e gjyqësorit?**
- 11. Çka mendoni për shqyrtimin e shkeljeve të të Drejtave të Njeriut nga ana e zyrtarëve të EULEX jashtë institucioneve gjyqësore- dhe ekzistimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ?**

Prishtinë, prill 2014

Emri i të intervistuarit

BIBLIOGRAFIA

Burime Parësore

1. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës KI 06/12, dt.27 qershor 2012.
2. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës KI 78/12, dt. 24.01.2013.
3. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në Rastin nr. KI 06/10, Valon Bislimi kundër Ministria e Punëve të Brendëshme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë, Nr. Ref: AGJ 63/10, dt. 30 tetor 2010.
4. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në Rastin nr. KI 08/09, Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut, IMK, në Ferizaj, Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit C.nr.340/2001, të 11 janarit 2002.
5. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës Nr.ref: AGJ 221/12, dt. 23.04.2012.
6. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac.nr.90/2006, dt. 02.03.2007.
7. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 57/2009, i dt. 11.02.2009.
8. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.984/2014 i dt. 07.04.2014.
9. Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, GJPP.nr.45/2010, dt. 17.11.2010.
10. Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës MLc.Rev.nr.57/2013, dt.30.07.2013.
11. Aktvendimi për papranueshmëri i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës KI 186/14.
12. Alfredson, G., Eide, A., *Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut*, Martinus Nijhoff Publishers, The Hague/ Boston/ London, 1999- botimi në shqip nga Këshilli Finlandez për të Drejtat e Njeriut, Prishtinë.

13. Ankesa drejtuar Presidentit të Kosovës e dt. 16.06.2010.
14. Dosja gjyqësore C.nr.1925/13 në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
15. Kodi i Etikës Profesionale të Avokatëve.
16. Kodi i Procedurës Penale (i Kosovës).
17. Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut.
18. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
19. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
20. Leterpërgjigje e kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Prizren z Ymer Hoxha drejtuar të gjykuarit B.Z. në Burgun e Istogut, Agj.nr.1/07-125 e dt. 23.11.2007.
21. Ligji mbi Gjykatat e Rregullta, Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës 21/7.
22. Ligji mbi marrëdhëniet themelore pronësore-juridike (Gazeta Zyrtare e RSFJ 6/80).
23. Ligji Nr. 9381, dt. 24.04.2005, Për Kompensimin e Burgimit të Padrejtë-shpallur me dekretin nr.4572, datë 12.05.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.
24. Ligji Nr.8577, dt.10.02.2000, Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
25. Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Ligji Nr.03/L-121.
26. Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligji Nr. 03/L-223.
27. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike në Kosovë 2005/02-L-16.
28. Ligji për procedurën kontestimore, Ligji Nr.03/L-006, 30 qershor 2008.
29. Pakti ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike.
30. Pergjigje e presidencës së Kosovës Nr. Prot: 235/1,dt.18.08.2010.
31. Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, 26 Mars 2007.

32. Rasti 114/10, *Badivuku kundër Këshilli Gjyqësor i Kosovës*, i 18 majit 2011 në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.
33. Rasti 41/09, *Universiteti AAB sh.p.k. kundër Qeveria e Republikës së Kosovës*, Buletini i Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës 2009-2010.
34. Rasti gjyqësor C.nr. 2421/14 në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
35. Rasti gjyqësor P.nr.1853/07 në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
36. Rasti gjyqësor P.nr.371/2010 në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
37. Rasti gjyqësor P.nr.807/13 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.
38. Rasti gjyqësor *Prokuroria Komunale në Pejë kundër të pandehurit G.J.D.* në Gjykatën Komunale në Klinë.
39. Rasti KI 108/10, Fadil Selmanaj, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ac.nr.170/2009, dt.25 shtator 2009.*
40. Rasti KI 139/11 Ali Latifi, *Vlerësim i kushtetueshmërisë së Njoftimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për riemërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, Nr.01/118-658, të 27,28 tetorit 2010*, në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.
41. Rasti KI 41/12, *Parashtrues Gëzim dhe Makfîre Kastratikundër Gjykata Komunale në Prishtinë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës.*
42. Rasti KI 52/12, Adije Iliri, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ac.nr.95/2011, të 8 dhjetorit 2011.*
43. Rasti KI 99/14 dhe 100/14, *Vlerësim i kushtetueshmërisë së vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit*, në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.
44. Rregullore e Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, 2010.

45. Rregullorja e UNMIK 1999/1 Për autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë.
46. Rregullorja e UNMIK 2000/47 Për Statusin, Privilegjet dhe Imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe Personelit të tyre.
47. Rregullorja e UNMIK 2001/9 Për Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohëshme në Kosovë.
48. Rregullorja e UNMIK 2003/12 Mbrojtja kundër dhunës në familje.
49. Rregullorja e UNMIK 2004/34 Mbi procedurën penale ku përfshihen kryes me çrregullime mendore.
50. Rregullorja e UNMIK-ut nr.2001/18 për Themelimin e një Komisioni për Shqyrtimin e Paraburgimeve Jashtëgjyqësore të bazuara në Urdhëra ekzekutivë.
51. Urdhëresa 42 e KFOR-it, 2000.
52. Urdhëresa Administrative 2006/20 Mbi Zbatimin e Rregullorës së UNMIK-ut nr.2005/52 Mbi Themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
53. Vendim për Mospërmbarrim në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, të 17 dhjetorit 2010, në rastin KI 08/09.
54. Vendimi për papranueshmëri i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në Rastin KI 68/09 të parashtruesit Emrush Kastrati kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl.Nr.120/08, të 1 shtatorit 2009.

-Rastet dhe Vendimet nga praktika e GJND-së-

55. *Axen v. Germany*, Judgement, Strasbourg 8 December 1983.
56. *Alimentaria Sanders v. Spain*, Judgement, Strasbourg 7 July 1989.
57. *Behrami v. France, Saramati v. France, Germany and Norway*, App. Nos. 71412/01 & 78166/01, Grand Chamber, Decision, 2 May 2007.
58. *Bajrami kundër Shqipërisë*, Aktgjykimi 12 Dhjetor 2006.
59. *Balliu kundër Shqipërisë*, Ankimi nr. 74727/01, Vendimi përfundimtar 30.11.2005.
60. *Hauschild kundër Danimarkës*, Aktgjykim i 24 majit 1989.
61. *Kontrova kundër Sllovakisë*, Aktgjykimi 24 shtator 2007.
62. *Kudla kundër Polonisë*, Aktgjykimi 26 Tetor 2000.
63. *Loizdou v. Turkey*, App. no. 15318/89, Judgement (preliminary objections), 23 February 1995; Judgement (merits), 28 November 1996;
64. *L.C.B kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i 28 tetorit 1998.
65. *Mc Cann kundër Mbretërisë së Bashkuar* nr. 18984/91, Aktgjykimi i 27 shtatorit 1995.
66. *Oberschlick kundër Austrisë*, nr. 11662/85, dt. 23 maj 1991.
67. *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i 28 tetorit 1998;
68. *Opuz kundër Turqisë*, Aktgjykim i 9 qershorit 2009;
69. *Silver dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi 25 Mars 1983.
70. *Yaşa kundër Turqisë*, nr. 63/1997/847/1054, Aktgjykim i 2 shtatorit 1998.
71. *Vachev v. Bulgaria*-42987/98, Judgment 08.07.2004.

Burime Dytësore

1. Azizi, Abdullah, *Bashkimi Evropian- E drejta, institucionet dhe politikat*, Tetovë 2010.
2. Bajrami, Arsim, *Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2011.
3. Bianku, Ledi, *Të Drejtat e Njeriut në Europë*, Qendra Europiane, Tiranë 2001.
4. Buletini i Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, 2009-2010.
5. Buletini i Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, 2011.
6. Buletini i Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, 2012, Vëllimi I dhe II.
7. Buletini i Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës, nr.15, Prishtinë, 2007.
8. Buletini i Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës, nr.6, Prishtinë, 2007.
9. Çetta, Anton, *Prozë popullore nga Drenica I, II.*, Prishtinë 1990.
10. Daci, Jordan, *Të Drejtat e Njeriut*, Tiranë, 2008.
11. *Fjalor i shprehjeve parlamentare dhe ligjore*, OSBE Misioni në Kosovë 2005.
12. Foniqi, Tahir., *Krijimtaria popullore tregimtare e Llapushës*, punim i magjistraturës Fakulteti Filozofik i Prishtinës, 1982.
13. Gazeta *Express* (2008) Artikulli: "Vetëm zoti i ruan", 16 prill.
14. Gazeta *Infopress* (2008) Artikulli: " Antidrejtësia ", 17 janar.
15. Gazeta *Koha Ditore* (2008)Artikulli: "Komunat në pjesën veriore bastione të administratës paralele", 31 janar.

16. Gazeta *Koha Ditore* (2012), Artikulli: "Supremja dhe kushtetuesja në luftë për kompetenca", 1 gusht.
17. Gazeta *Kosova Sot* (2013), Artikulli: "Raporti i Progresit pritet me shqetësim-As Gjykata Kushtetuese nuk u ka shpëtuar kritikave", 12 tetor.
18. Gazeta *Telegraf* (2013), Artikulli: "Paraburgimi maratonik", 21 korrik.
19. Gojani, Skender, *Fjalor i shprehjeve juridike*, Kolegji Biznesi, Prishtinë 2013.
20. Gomien, Dona, *Udhëzues i shkurtër për Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut*, Instituti Norvegjez për të Drejtat e Njeriut, Universiteti i Oslos.
21. Gruda, Zejnullah, *Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut I, II*, Prishtinë 2001.
22. Hasani, Enver & Cukaloviq, Ivan, *Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës*, Prishtinë 2014.
23. Hasani, Enver & Doli, Dren & Korenica, Fisnik, *Mekanizmi i ankesave si mjet për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe lirive të njeriut: Rasti i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës*, Revista "E Drejta", Prishtinë 2012.
24. Haxhaj, Rafet, *Pozita e Sistemit Gjyqësor në Kosovë gjatë periudhës së Misionit të Kombeve të Bashkuara*, punim i magjistraturës, Fakulteti Juridik i Prishtinës, 2008.
25. Haxhaj, Rafet, *Sistemi Gjyqësor sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës*, Buletini i Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës, nr.17, Prishtinë, 2008.
26. Hila, Fatjon, *E drejta për një proces të rregullt gjyqësor*, Revista *Shëndeti mendor dhe të drejtat e njeriut*, Tiranë, 2010.

27. HUMAN RIGHTS IN THE ADMINISTRATION OF JUSTICE: A Manual on Human Rights for Judges, Prosecutors and Lawyers- përkthim jo zyrtar nga Kombet e Bashkuara.
28. *Indeksi i Reformës Gjyqësore në Kosovë*, ABA Rule of Law Initiative, Vëllimi III, 2007.
29. Islami, Iliriana, *Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut*, Doracaku për përgatitjen e Provimit të Jurisprudencës- KEAI, Prishtinë 2004.
30. Ismaili, Osman, *Fillet e së Drejtës*, Prishtinë, 2007.
31. Jashari, Jetish, *U.N. Field Missions in the context of legal and judicial reform: the Kosovo case*, Columbia University School of Law, Volume 1, number 1, 2007.
32. Kondo, Migena, *Për një proces të rregullt gjyqësor*, Avokatia, Tiranë, 2012.
33. *Kuptimi i të Drejtave të Njeriut- Doracak mbi arsimimin e të Drejtave të Njeriut*, Qendra Evropiane e Trajnimit dhe Hulumtimit për të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci (ETC), Grac, Austri, 2003- botimi në shqip nga Këshilli Finlandez për të Drejtat e Njeriut, Prishtinë.
34. Latifi, Juliana, *Instituti i Avokatit-Roli i tij për një proces gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm*, Revista Shqiptare për Studime Ligjore-ajls, Volumi 2, nr.1, Tiranë 2008.
35. *Manual i Gjykimit të Drejtë*, Amnesty International Publications, 1998.
36. Mole, N., Harby, C., *E Drejta për një proces të drejtë gjyqësor*, Këshilli i Evropës, Nëntor 2005- botimi në shqip nga Programi i IV-t i Përbashkët midis Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës, Mbështetje për Shkollën e Magjistraturës në Shqipëri.

37. Morina, Visar, *Gjyqësia Kushtetuese-shqyrtime teorike dhe krahasimore*, Instituti për Studime Kushtetuese dhe Parlamentare, Prishtinë 2013.
38. *Pavarësia e gjyqësorit në Kosovë: Dimensionet Institucionale dhe Funksionale*, OSBE-Misioni në Kosovë, janar 2012.
39. *Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë: Shqyrtim dhe analizë e brengave të mbetura*, OSBE- Misioni në Kosovë 2009.
40. *Përmbledhje materialesh për Provimin e gjyqtarit për kundërvajtje – Dokumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut*, OSBE- Misioni në Kosovë janar 2002.
41. Raporti i EULEX për vitin 2011.
42. Raporti i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë- Drejtoria e Studimeve, *Studim mbi procesin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese*, 2008.
43. Raporti i Progresit për Kosovë i Komisionit Evropian, COM(2013), 2013.
44. Raporti i Progresit për Kosovë i Komisionit Evropian, SEC(2010) 1239, 2010.
45. Raporti i Shërbimit Korrektues të Kosovës i dt.26.08.2013.
46. Raporti i Shtatë Vjetor i Ombudspersonit në Kosovë 2006-2007.
47. Raporti Special i Ombudspersonit në Kosovë 2004.
48. Raporti Vjetor i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut-PShDNJ (HRRP), 2012.
49. Rukiqi, Mehmet, *Krijues dhe bartës të tregimeve popullore në Drenicë*, Prishtinë, 1998.
50. Sahiti, Ejup, *E Drejta e Procedurës Penale*, Prishtinë, 2005.
51. Sahiti, Ejup, *Sistemi Gjyqësor në Kosovë*, Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, Prishtinë, 2003.

52. Salihu, Ismet & Zhitia, Hilmi &, Hasani & Fejzullah, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2014.
53. Saliu, Kurtesh, *E drejta Kushtetuese I.*, Prishtinë, 1998.
54. Sauli, Eriselda, *Drejtësia administrative shqiptare në kontekstin ndërkombëtar: Jurisprudenca administrative dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, Revista “Gjeopolitika”, Instituti Kërkimor “Barleti”, Shkodër, 2011.
55. *Siguria dhe mbrojtja e dëshmitarëve në Kosovë: vlerësim dhe rekomandime OSBE-Misioni në Kosovë*, nëntor 2007.
56. *Siguria dhe mbrojtja e dëshmitarëve në Kosovë: vlerësim dhe rekomandime OSBE-Misioni në Kosovë*, nëntor 2007.
57. *Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë 1999-2006*, OSBE- Misioni në Kosovë.
58. *Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë shtator 2001- shkurt 2002*, OSBE- Misioni në Kosovë.
59. *Sistemi i Drejtësisë Penale në Kosovë shtator 2001- shkurt 2002*, OSBE- Misioni në Kosovë.
60. Stavileci, Esat, *Kosova nën administrimin ndërkombëtar sjellje në rreth ose dalje prej tij*, Gjakovë, 2000.
61. Vorpsi, Arta, *Procesi i rregullt ligjor në Praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë*, Tiranë 2011.
62. Zaganjori, Xhezair & Anastasi, Aurela & Çani (Methasani), Eralda, *Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*, Tiranë, 2011.
63. Zaganjori, Xhezair, Vorpsi, Arta, Biba, Denar, *Parime Kushtetuese dhe të drejta themelore në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese*, Tiranë 2012.

64. Zyberi, Gentian, *Përgjegjshmëria e institucioneve të Qeverisë së Kosovës në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut: Aktualiteti dhe e ardhmja*, Revista Shqiptare për Studime Ligjore, Volumi 1, Tiranë 2007.

Faqe interneti

1. http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/A1999regs/RA1999_24.
2. http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2000regs/RA2000_4 - faqe interneti Gazeta Zyrtare e Misionit të UNMIK.
3. Arben Qirezi, *Lirimi i tre shqiptarëve të dyshuar për vrasje tregon mangësitë e sistemit të drejtësisë në Kosovë*- Instituti për Raportim në Luftë dhe Paqe-IWPR, http://iwpr.net/?apc_state=henibcr2002&1=sq&s=f&o=250708- Faqja zyrtare e Institutit për Raportim në Luftë dhe Paqe-IWPR.
4. www.lajmeshqip.com- portal gazete.
5. <http://www.kgjk-ks.org>- Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
6. www.kpaonline.org – Faqja zyrtare e Agjencionit Kosovar të Pronës.